

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE DHE KULTURORE TË
SHQIPTARËVE - SHKUP

BALLKANOLOGJIA

- 4 -

Akte të Konferencës shkencore ndërkombëtare

BALLKANI MIDIS INTEGRIMIT EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMIT RAJONAL

organizuar nga ITShKSh

Shkup, 28 tetor 2021



Shkup, 2022

Botues:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup
Biblioteka: Ballkanologji

BALLKANOLOGJIA

- 4 -

Për botuesin:
Prof. dr. Skender ASANI

Koordinator / Kryeredaktor:
Prof. dr. Sefer TAHIRI

Këshilli organizues / Redaksia:

Dr. Qemal MURATI
Dr. Skender ASANI
Dr. Isamedin AZIZI
Dr. Nora MALIQI ZYLALI
Dr. Zeqirija IBRAHIMI
Dr. Isamet BAKIU
Mr. Ardian RAMADANI

ISBN: 978-608-4897-65-1

www.itsh.edu.mk

Copyright©ITShKSh, 2022
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin

Ky botim financohet nga:

Република Северна Македонија
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Kulturës

Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare
BALLKANOLOGJIA - Edicioni IV

*BALLKANI MIDIS INTEGRIMIT EVROPIAN
DHE BASHKËPUNIMIT RAJONAL*

PËRMBAJTJA:

NË VEND TË HYRJES	7
KUMTESAT SHKENCORE	13
Sadri RAMABAJA: BALLKANI I HAPUR DHE GJEOPOLITIKA POSTMODERNE SERBE	15
Qemal MURATI: LUFTA PËR IDENTITETIN, VETJA NË TAVERNËN BALLKANIKE PËRMES "VJETËRSISË DHE DOMINIMIT NË GJUHË"	34
Sevdail DEMIRI: SFIDAT EURO-INTEGRUESE: NGA IRJM E DERI TE REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT	45
Isamet BAKIU: INTEGRIMI I RAJONIT DHE ROLI I SHQIPTARËVE KUNDREJT PËRPLASJES SË INTERESAVE TË FUQIVE TË MËDHA NË BALLKAN	54
Minir ADEMI & Avni AVDIU: BALLKANI I HAPUR: ALTERNATIVË APO KURTH I RADHËS PËR SHQIPTARËT...?!	71
Ardian RAMADANI: PANBALLKANIZMI DHE MINISHENGENI BALLKANIK PËRBALLË EVROPIANIZIMIT	83
Весна ПОПОСКА: ПАНЕВРОПСКИОТ НАСПРОТИ ЕВРОСКЕПТИЦИЗМОТ - ПРИДОБИВКИ И ПРЕДИЗВИЦИ ОД ОДРЖУВАЊЕТО НА ЕВРОПСКАТА АГЕНДА ВО РЕГИОНОТ	89
Anton PANÇEV: IDEOLOGJITË E VJETRA SI PENGESË PËR INTEGRIM NË BE	99
Besnik RAMETI: NDIKIMI I PROJEKTEVE HEGJEMONISTE NDAJ VONIMIT TË PROCESIVE INTEGRUESE TË VENDEVE TË BALLKANIT ..	116
Ramiz ZEKAJ: MARRËDHËNIET NDËRFETARE NË BALLKAN DHE MULTIKULTURALIZMI NË BASHKIMIN EVROPIAN	128
Ermal MEHMETI & Jeta STAROVA MEHMETI: "E KUJT ËSHTË KJO KËNGË", PALIMPSESTI I UNITETIT BALLKANIK PËRMES DIFERENCAVE	135

Kosovar BASHA: MARRËDHËNIET E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË GJATË VITIT 1968	143
Miftar KURTI: QËNDRIMI I FRANCËS PËR KOSOVËN (1998-1999).....	165
Besnik EMINI: QENDRAT E STUDIMEVE BALLKANIKE DHE BASHKËPUNIMI KULTUROR NË KUADËR TË DISA VENDEVE TË BALLKANIKE	177
Rini USEINI: BASHKËPUNIMET NDËRKULTURORE SI URË LIDHËSE NË BALLKAN	183
Stefan OKANT: “PALLATI I ËNDRRAVE” NGA ISMAIL KADARE APO MAKTHI KOMUNIST SIPAS NJË EVROPE TË CAKTUAR.....	192

NË VEND TË HYRJES

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve- Shkup më 29 tetor të vitit 2021 organizoi edicionin e katërt me radhë të konferencës shkencore ndërkombëtare të Ballkanologjisë, e cila temë boshte e kishte "Ballkanin midis integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal".

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se duke qenë gjithmonë në hap me tendencat evropiane të zhvillimit të mendimit dhe projektimit të ideve konkrete, edhe ITSHKSH-ja përmes kësaj konference shkencore synon të nxjerr në pah aspektet humane të përafrimit në mes të popujve, duke nxjerrë në treg konkurrencën e dijes dhe hulumtimit shkencor. "Deri më tani, përmes departamenteve tona si dhe përmes botimeve e aktiviteteve të ndryshme, ne si Institut jemi munduar të sjellim një qasje të re dhe krejt origjinale në tejkalimin e kontradiktave në mes të shoqërive, popujve dhe shteteve", tha Asani.

Në fjalën përshëndetëse, ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se "Ballkani Perëndimor ose siç dua ta theksoj e që mendoj se është emërim më adekuat Evropa Juglindore, nuk është ishull i izoluar, por gjendet në zemrën e Evropës. Të gjitha lidhjet tona, të gjitha rrugët tona kryqëzohen me BE-në, procesi i eurointegritit dhe procesi i bashkëpunimit rajonal plotësohen dhe çojnë drejt qëllimit të njëjtë, anëtarësimin e rajonit në BE", u shpreh Osmani.

Fjalë përshëndetëse pati edhe drejtori i Agjencisë për Përdorimin e Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut, Ylber Sela, si dhe pasardhësi i Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina.

Më pas u bë promovimi i përmbledhjes shkencore "Ballkanologjia III", për të cilën referoi koordinatori i konferencës dhe kryeredaktori i këtij botimi Sefer Tahiri.

Më pas, në kuadër të konferencës shkencore "Ballkani midis integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal", u shtjelluan tema tejet të rëndësishme dhe aktuale.

Kështu, referuesi i parë që u paraqit me kumtesën e tij ishte Syle Ukshini, i cili përmes një analize të detajuar shtjelloi Minishengenin ballkank si instrument politik të Serbisë për anashkalimin e Kosovës, si dhe si një aset të saj për të shtrirë ndikimin e saj, edhe ashtu hegjemon, në formë më të vrazhdë dhe më të rreptë. Konferenca vijoi me kumtesën virtuale të studiuesit, Anton Pançev nga Universiteti i Sofjes “Shën Klimenti i Ohrit”, i cili shtjelloi “Ideologjitë e vjetra si pengesë për integrim në BE”. Studiuesi i radhës, profesori nga Kosova, gjegjësisht nga Instituti Shqiptar i Gjeopolitikës, Sadri Ramabaja “Projekti i Novisadit” alias “Ballkani i Hapur” dhe gjeopolitika postmoderne serbe”, analizoi politikën serbe, duke hedhur dritë në të kaluarën, të tanishmen dhe të ardhmen e shteteve të Ballkanit Perëndimor. Studiuesja dhe profesoresha nga Universiteti “Vizion” në Gostivar, znj. Vesna Popovska, u paraqit me kumtesën e saj me titull “Pan evropianizmi kundrejt euroskepticizmit- përfitimet dhe sfidat nga qëndrueshmëria e agjendës evropiane në rajon”. Studiuesi dhe Besnik Rameti nga ITSHKSH-ja, në konferencë u paraqit me kumtesën e tij “Ndikimi i projekteve hegjemoniste ndaj vonimit të proceseve integruese të vendeve të Ballkanit”. Më tutje, Ana Çupevska, nga Universiteti “Kiril dhe Metodi”, foli në kumtesën e saj për temën vijuese “Paradigma bashkëkohore e politikës së jashtme për ndërtimin e miqësisë në marrëdhëniet ndërkom-bëtare”. Konferenca vazhdoi punimet me kumtesën e prezantuar nga Isamedin Azizi, nga ITSHKSH-ja, me titull “Tendencat e bashkëpunimit rajonal të organizatave revolucionare në Ballkan”. Ramiz Zekaj, studiues nga Instituti i Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit, paraqiti kumtesën e tij me titull “Marrëdhëniet Ndërfetarë në Ballkan dhe Multikulturalizmi në BE”. Më tutje, në kuadër së seancës së parë të konferencës, u paraqit z. Rubin Zemon, nga Qendra për Hulumtime të Avancuara, i cili shtjelloi kumtesën “Ballkani midis koncepteve për shtete kombëtare dhe shoqëri qytetare”. Referuesi i fundit në sesionin e parë ishte drejtori i Aleancës Franceze në Tetovë, Stephane Aucante, me kumtesën “Pallati i ëndrrave i Ismail Kadarese, ose makthi komunist sipas një Evrope të caktuar”, ku përmes këtij punimi u hodh në pah ngulfatja e ëndrrave, me qëllim shpërftyrimin e njeriut dhe largimin nga e drejta për të ëndërruar.

Sesioni i dytë i konferencës filloi me debatin mes pjesëmarrësve, për temat e shtjelluara në sesionin e parë. Kështu, Rubin Zemon, Sylë Ukshini, Emin Azemi, Sadri Ramabaja dhe drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, e begatuan këtë pjesë të konferencës përmes ndërhyrjeve të tyre frytdhënëse, sugjerimeve dhe shtruarjes së mendimeve.

Pasoi kumtesa e parë me radhë, në sesionin e dytë, e Minir Ademit nga ITSHKSH-ja, si koautorë së bashku me Avni Avdiun, nga Universiteti “Nëna Terezë”, në Shkup, që trajtuan temën “Open Balkan: alternativë apo kurthi i radhës për shqiptarët...?!”. Më tutje, Ardian Ramadani nga ITSHKSH-ja, trajtoi temën “Panballkanizmi dhe Minishengeni Ballkanik (Ballkani i Hapur) përballë europianizmit”, ku vuri në pah se nismat gjysmake që vijnë nga shtete të dyshimta, që ende nuk e kanë bërë katarsën e duhur, duhet shikuar me llupën e dyshimit. Konferenca vijoi me kumtesën e radhës nga Liridona Veliu, nga Dublin City University, në koautorësi me Adriana Cuppuleri, me titull “Rusia në Ballkanin Perëndimor: Një studim i fuqisë së butë”, me ç’rast me një qartësi dhe saktësi të pashoq u paraqit konceptualizimin e fuqisë së butë ruse në veçanti, përmes instrumenteve dhe një matrice teorike, revizioniste dhe tradicionaliste, si dhe riaktivizimin e saj në Ballkanin Perëndimor.

Më pas, studiuesi nga ITSHKSH-ja, Isamet Bakiu, paraqiti kumtesën me titull “Integrimi i rajonit dhe roli i shqiptarëve në përplasjet mes fuqive të mëdha në Ballkan”, me ç’rast vuri në pah premisat për integrimin rajonal, si dhe rolin e pashoq të kombit shqiptar në Ballkan, në suaza të këtij integrimi. Konferenca vazhdoi punimet me kumtesën e Murat Aliut nga Universiteti “Nënë Tereza në Shkup, me titull “Nacionalizmi etnik si peng i integritetit evropian: rasti i Maqedonisë së Veriut”. Me një video-prezantim, Kosovar Basha, nga Instituti i Historisë në Prishtinë, paraqiti kumtesën “Konteksti historik i bashkëpunimit politik dhe shkencor midis Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 1968”. Më tutje, përmes një video-prezantimi, Miftar Kurti, nga Instituti i Historisë në Prishtinë, paraqiti kumtesën “Roli dhe kontributi i Francës për paqen dhe lirinë e Kosovës”. Pasoi më tej kumtesa e Besnik Eminut nga ITSHKSH-ja me titull “Qendra e Studimeve Ballkanike dhe bashkëpunimi kulturor në kuadër të vendeve të Ballkanit”. Dhe referuesi i

fundit, Rini Useini, nga ITSHKSH-ja, paraqiti kumtesën “Shoqatat etnokulturore - ura ndërlidhëse midis antropologëve në Ballkan e më gjerë”.

Në fund, pas prezantimit të kumtesave, pasoi debati i shkurtër, ku me vërejtjet dhe ndërhyrjet e tyre i dhanë frymë dhe gjallëri konferencës disa studiuës të pranishëm.

Në numrin e katërt të revistës shkencore ndërkombëtare "Ballkanologjia", i botojmë punimet shkencore të studiuësve, të cilat i kanë dërguar për botim.





KUMTESAT SHKENCORE

BALLKANI I HAPUR DHE GJEOPOLITIKA POSTMODERNE SERBE

Abstrakt

Përfundimi i Luftës së Ftohtë shënoi edhe fillimin implodimit të socializmit, që do t'i jap fund BRSS, por edhe Federatës së sllavëve të Jugut të Europës - Jugosllavisë. Ndërkaq viti 1989 shënon njëkohësisht edhe fillimin e fundit të liberalizmit klasik.

Me këtë akt, siç shprehet I.Volerstin, zë fill procesi i restaurimit të neokonservatorizmit dhe restaurimi i Europës, respektivisht rikthimit të saj në skenën e diplomacisë botërore të rikomponuar. Ky proces do të vazhdojë për dy dekada rresht konform interesave gjeopolitike të fuqive të mëdha. Ndërkaq shfaqja e globalizmit monocentrik, ku fjalën kryesore do ta kenë SHBA-të, do të shenjojë hyrjen në epokën e shembjes së rendit ndërkombëtar, siç njihet ai përgjatë gjithë epokës së Luftës së Ftohtë.

Ndërkohë, pas përfundimit të luftërave në truallin e ish Jugosllavisë, shikuar nga ky kontest historik, Ballkani për diçka më shumë e dy dekada, ka përjetuar tranzicion të dyfishtë:

- 1. Tranzicionin ekonomiko-social dhe*
- 2. Tranzicionin e thellë gjeopolitik.*



Hyrje

Pranimi i rendit të ri politik - demokracisë liberale, tashmë në gjithë rajonin, ku në mënyrë më të organizuar e ku nën diktatin e neoliberalizmit

ekstrem konservator, ka imponuar transformimin e plotë të pronës dhe i mjeteve të prodhimit. Ky fakt e ka shndërruar Ballkanin në një periferi të pa peshë të ekonomisë së BE-së, ndërkaq në kuptimin gjeoekonomik, ai tashmë ka rrëshqitur në terrenin e rikolonizimit të butë.

Në anën tjetër tranzicioni gjeopolitik i Ballkanit është në përmbyllje e sipër, duke ju rikthyer shumica e shteteve-kombe hemisferës Perëndimore të interesit. Aderimi i Rumanisë dhe Bullgarisë në NATO pati reflektime të ndjeshme edhe në intervenimin e kësaj strukture politiko-ushtarake në Kosovë. Ai proces me peshë gjeostrategjike u pasua me aderimin e Sllovenisë, Kroacisë dhe së fundmi edhe të Malit të Zi dhe Maqedonisë, duke i bërë kështu Serbisë një “rrethim demokratik” të plotë. Me këtë cikël aderimesh rajoni po shkonte drejt mbylljes së ndikimit rus, duke e kufizuar atë realisht vetëm në Serbi dhe brenda Republika Serbskës (në Bosnjë e Hercegovinë). Ndërkaq pesha që kishte dikur Serbia në ish Jugosllavi, vështirë se mund të rikthehet.

Në këto rrethana të reja, në nivelin ndërkombëtar, Beogradi ka ndjekur një politikë të jashtme dy-vektoriale, shpesh skizofrenike midis palëve pothuajse të ballafaquara sërish me elemente të Luftës së re të Ftohtë mes Perëndimit dhe Ruisë.

Dhe nuk është vetëm Serbia në një situatë kaq të papërcaktuar dhe të pakonsoliduar. Ka vende të tjera kryesisht pas konfliktit në Ballkanin Perëndimor - si Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova (de facto) - të cilat nuk janë integruar në BE dhe NATO dhe veprojnë në një situatë politike, ekonomike dhe të sigurisë pothuajse përgjithësisht të paqëndrueshme. Cila është perspektiva e politikës së jashtme të këtyre vendeve dhe sa ndikohet nga dinamikat e brendshme politike? Ku janë vendet e Ballkanit Perëndimor në pozicionimin gjeopolitik të aktorëve me ndikim dhe çfarë pasojash mund të ketë tranzicioni i tyre i vështirë për një kohë të gjatë - këto janë pyetjet që kjo analizë përpiqet të përgjigjet. [Boris Varga: 2018]

Projekti i Novisadit — produkt i gjeopolitikës postmoderne serbe

Ashtu siç konsiderohet testamenti politik i Rishëljesë, që bazohet në teoritë e realizmit politik, duke hy në histori si gurthemeli i gjeopolitikës franceze, edhe Naçertania e Garashaninit mund të cilësohet si gurthemeli i gjeopolitikës serbe.

Shkolla franceze e gjeopolitikës gjatë gjithë procesit të ngjitjes së saj në shkollë më vete, ishte dhe mbetet si “përgjigje ndaj konceptit gjerman të gjeopolitikës.” [1]

Në rrugëtimin e gjeopolitikës serbe ndikim pati para së gjithash, krahas gjeopolitikës gjermane, edhe ajo ruse, sidomos kur bëhet fjalë për intencat permanente të Beogradit për zgjerim të hapësirës jetësore në dëm të fqinjëve, para së gjithash në dëm të shqiptarëve. Kjo do të vihet re që në etapat e para të gjeopolitikës si mendim dhe akt politiko-ushtarak, që do të shprehej përmes rivalitetit të ashpër të fuqive imperialiste (1875–1945). Këtë periudhë Serbia do ta shfrytëzoj në maksimum për zgjerim të hapësirës jetësore në jug, fillimisht (1877–1912), ndërkaq pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, që do të shpërthejë pikërisht duke u provokuar drejtpërdrejt nga Serbia (atentati ndaj princit Feranc Ferdinand, në Sarajevë, 1914), edhe në perëndim (Bosnjë), me ç’rast ajo projektet që kishte prodhuar mendimi gjeopolitik e gjeostrategjik serb, po i aplikonte në praktikë.

Edhe epokën e dytë, respektivisht **erën e dytë gjeopolitike, që përfshin periudhën që karakterizohet si** “Rendi botëror i Luftës së Ftohtë (1945 – 1990)”, [2] ku diskursi gjeopolitik u zhvillua si në teori edhe në praktikë, Serbia do ta aplikojë për aq sa i lejonin rrethanat, duke u kufizuar brenda hapësirës Jugosllave. Ajo zotronte komplet tregun e Jugosllavisë, ndërkaq drejtonte edhe politikën e jashtme duke marrë në konsideratë mbi të gjitha interesat jetike serbe brenda federatës.

Me afrimin e fundit të Luftës së Ftohtë (1990) Serbia do t’i rikthehet epokës së dytë të gjeopolitikës, duke projektuar zgjerimin faktik e real të gjeografisë serbe fillimisht në dëm të kroatëve e boshnjakëve, e më pas,

përmes projekteve si ai PATKOI edhe enë riciklimin e Toplicës në Kosovë, eedhe me çmimin e gjenocidit.

Idetë mbi të ashtuquajturin “Mini Shengen”, që në fakt do të duhej ëa kishte emrin real „Projekti i Novisadit” në bazamentitn e të cilit është intenca për rikrijimin e Jugosllavisë së re pa Sllovenin dhe Kroacin, por me Shqipërin dhe Kosovën brenda, duke i dhënë Beogradit sërish rolin drejtues e dominues, duket se janë produkt i gjeopolitikës post-moderne. Ky projekt serb dëshmon se gjeopolitika serbe nuk ka hequr dorë nga objektivat e saj themelore — zgjerimi dhe dominimi në Beogradit në Evropën Juglindore, por në pamundësi për qasje klasike, ai ka adoptuar elemente të reja të gjeopolitikës post-moderne, duke ju përshtatur qasjes së Brukselit dhe Moskës përgjithësisht për Evropën Juglindore dhe në veçanti për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Shqipëria gjendet në një pjesë nevralgjike të kontinentit të vjetër që dikur njihej me emrin Gadishulli Ilirik. Emri “Ballkan” vjen nga fjala turke qe do të thotë “një zinxhir i maleve i pyllëzuar.” Emri i lashtë grekë për Gadishullin Ballkanik ishte “gadishulli i Haemus (Χερσόνησος τοῦ Αἴμου, Chersónēsos tou Haímou)”. [3]

Në Mesjetën e vonshme ai u quajt Gadishulli Balkanik, sipas maleve të Ballkanit, që shtrihen përmes qendrës së Bullgarisë në Serbinë lindore. Rajoni ka një zonë të përbashkët prej 550.000 km² dhe një popullsi prej diku 55 milion banorësh me dendësi 110.7b/km².

Gadishulli Ballkanik shtrihet në Evropën Jugore dhe ka formën e një trekëndëshi, që futet thellë në Detin Mesdhe, midis Detit Adriatik, Detit Jon në perëndim, dhe Detit Marmara e Detit Egje në lindje. Konsiderohet se kufiri verior shkon deri në Triestë, Lubljanë, rrjedha e lumenjve Sava dhe Danub në gjatësi 1.200 km. Kufiri verior më tepër është kufi konvencional se natyrorë.

Ky gadishull, është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës juglindore. Ai krijon raporte të veçanta si me kontinentin mëmë — sidomos Evropën e Mesme, po ashtu edhe me Azinë, saktësisht me Gadishullin e Azisë së Vogël, respektivisht Gadishullin e Anadollit.

Harta e Ballkanit



I tërë Ballkani ka pas qenë “sinonim me perandoritë e vjetra Turke e Bizantine, me vargmale të paqeverisura që kishin penguar zhvillimin dhe me një standard zakonisht më të ulët të jetuari, që shkojnë pas dhjetëvjeçarë e shekuj krahasuar me tokat e perandorive të mëparshme Habsburgase dhe Prusiane në zemër të Europës.” [4]

Me shpërbërjen e Perandorisë Otomane dhe asaj të Austrohungarisë gjeopolitika ekspansioniste e Serbisë e mbështetur nga Fuqitë e Mëdha si Rusia, Franca dhe Anglia, në përputhje me interesat e tyre, u shtri tutje në jug e perendim, kryesisht në dëm të shqiptarëve, ndërkaq gjatë epokës së Luftës së ftohtë, nën petkun e Jugosllavisë ajo do të shndërrohej në fuqi rajonale dominuese. Nënndërkaq në epokën e gjeopolitikës postmoderne, Serbia pretendon ta zëvendësojë Jugosllavinë e Titos përmes krijimit të të ashtuquajturës zonë “Mini Shengen”. Këtë hap Serbia po e bën nën

ombrellën e Procesit të Berlinit, e kundër tij, duke marrë në konsideratë edhe interesat strategjike për ruajtjen e balancit mes shteteve të Ballkanit. Le të kujtojmë faktin se Procesi i Berlinit ishte dhe mbetet një iniciativë e përbashkët e BE-së me 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor, ku rol qendror kishte edhe Komisioni Evropian. Ky rol i Komisionit Evropian ndërlihet me faktin se, ky proces mbështet qasjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian dhe pranimin e tyre në BE, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, që përjashton çfardo rikrijimi të mundshëm të Jugosllavisë së re dhe dominimi të mundshëm të Serbisë. Shih për këtë, ky proces duhet të shoqorohet shpejt me një „Plan Marrshal“ për tejkalimin e pozicioneve që pretendon t’ i ndërtojë Serbia në dëm të kombeve tjera të rajonit dhe shqiptarëve në veçanti.

Fundi i Luftës së ftohtë ishte e pritshme të ishte edhe fundi i Federatës Jugosllave. Jugosllavia e re, respektivisht RSFJ-ja, ishte pasuese e Mbretërisë Serbo-kroato-slllove, e krijuar nën patronatin e drejtpërdrejtë të Konferencës së Versajes. Nëse ajo ishte de fakto produkt politik i përplasjeve të interesave gjeopolitike mes dy blloqeve tradicionale — atij gjerman në njërin anë (Gjermani-Austri) dhe anglo-francez e rus , në anën tjetër, dhe si e tillë mori fund me fillimin e LDB dhe pushtimin gjerman, shkërmoçja e RFJS-së i krijonte mundësi objektive gjeopolitikës postmoderne serbe për ripozicionim në dobi të zgjerimit të hapësirës jetike në perëndim përmes krijimit të Republikës Srbska në Bosnjë dhe kështu edhe të rikonfigurimit të fuqisë gjeopolitike serbe, ndërkohë me Beogradin si qendër drejtuese e zonës së ashtuquajtur “Mini Shengen”, hë për hë vetëm si ide.

Politikat e sukseshme lituaneze të energjisë mund të jenë një leksion për Evropën Juglindore

Promovimi i Rusisë si një "superfuqi energjetike", sidomos tani në prag të përfundimit të megaprojektit që do ta furnizojë Gjermaninë me gas - Nord Stream 2, është shqetësues jo vetëm për Perëndimin. Gjermania, që cilësohet si partneri më i rëndësishëm tregtar, po shndërrohet gjithashtu në partner absolutisht i varur nga furnizimet me energji ruse. Serbia ka kohë që vullnetarisht është plotësisht e varur nga energjia ruse.

Rusia e Putinit është e vetëdijshme për pozicionin e saj të fortë që gëzon në rrafshin ndërombëtar, ndërkaq rikthimi i saj në Ballkan përmes Serbisë, mbetet një prej objektivave të saj strategjike që nuk e fsheh fare. Ky pozicion bazohet jo vetëm në pasurinë e burimeve të vendit. Asnjë shtet tjetër nuk ka kaq shumë lëndë të para. Rusia është prodhuesi më i madh i energjisë në botë; vendi zotëron më shumë se një të tretën e rezervave të gazit natyror në botë, rreth gjashtë përqind të rezervave të naftës në nivel botëror dhe rezervat e dyta më të mëdha të qymyrit. Kjo ngjall frikë gjithandej.

Furnizimi me lëndë të para minerale dhe energjike është tashmë thembra e Akilit e ekonomive në Evropë, veçanërisht për kampionin botëror të eksportit Gjermaninë.¹

Por, krahas kësaj, edhe investimet gjermane në Rusi janë enorme.

Prandaj konkludimi i ekspertëve të fushës ekonomike se, nuk ka varësi të njëanshme, duket real. Varshmëria rezulton të jetë më shumë reciproke me avantazhe të gjithanshme. Në këtë plan duke konstatuar me të drejtë se në shumicën e vendeve konsumatore, ekziston një potencial i lartë për mundësi ekonomike, shkencore dhe teknike për rritjen e efikasitetit të energjisë, në kombinim me dijen si resurs specifik, Gjermania dhe vendet tjera perendimore, madje edhe Lituania, pretendojnë ta shnëdrojnë në një avantazh strategjik në konkurrencën globale.

Politikat e sukseshme lituaneze të energjisë mund të jenë një leksion jo vetëm për Gjermanin, por edhe për Evropën Juglindore.

Terminali LNG i Lituanisë ka qenë në funksion në portin e Klaipeda që nga viti 2014; ai ka shërbyer si strukturë e mirëmenduar për pranimin e gazit të lëngshëm natyror - LNG si "gaz natyror të lëngshëm". Me këtë investim, një nga të parët e këtij lloji në botë, vendi i vogël me vetëm 2.8 milion banorë ishte në gjendje t'i jepte fund me sukses monopolit të gazit të Moskës në shtetet baltike. Në atë kohë, Ministri i Jashtëm Lituanis, Linas Linkevicius, foli vetëm për një "përparim" për Lituania dhe rajonin, pa rrahur gjoks më shumë.

¹<https://internationalepolitik.de/de/russlands-energie-europas-achillesferse>

Ndërkohë SHBA-të kanë vepruar ngjashëm në Greqi, duke vënë në veprim terminale të saj LNG, si në Lituani, e që do të jenë në dispozicion të Evropës Juglindore.

Një nga përkrahësit e diversifikimit në sektorin e energjisë është Tomas Janeliunas. Ai sheh avantazhe shumë të qarta. "Për Lituaninë, terminali është një garanci e stabilitetit të çmimeve. Por, gjithashtu ai siguron furnizimin në përgjithësi, sepse vendi nuk është më i varur prej vetëm një furnizuesi, "thotë politologu nga Universiteti i Vilnius-it, një nga ekspertët më të njohur në temën e sigurisë së energjisë.

Aktualisht sot asnjë vend evropian, nuk merr më shumë gaz natyror nga Rusia sesa Gjermania; në vitin 2019 ishte 55.6 miliardë metra kub, më shumë se gjysma e importeve të përgjithshme të gazit të Gjermanisë.

Italia doli e dyta me 20.7 miliardë metra kub. Nord Stream 2 së shpejti do të sjellë deri në 55 miliardë metra kub më shumë në Gjermani - gjë që do të rrisë ndjeshëm varësinë nga Moska. Përkrahësit e projektit të gazsjellësit janë të lumtur të theksojnë se edhe Bashkimi Sovjetik ishte një furnizues i besueshëm i lëndëve të para për Gjermaninë gjatë Luftës së Ftohtë - shqetësimet e Ukrainës ose qeverisë polake, të cilat Nord Stream 2 i klasifikon si një kërcënim për sigurinë e energjisë të të gjithë BE -së, kështu pretendohet të largohen mënjandë.²

Këtë gjendje e ka shfrytëzuar Rusia e Putinit duke e zbrërthyer atë edhe në doktrinën e saj të re strategjike. Në qendër të kësaj doktrine gjithësesi qëndron nteresi nacional i kodifikuar me nocionin "Bota ruse", që në thelb ka rikthimin e ndikimit rus jo vetëm në ish republikat e BRSS, ku kishte pakica ruse, por edhe më tej. Rikthimi i saj "i butë" në Ballkan prandaj është një prej objektivave të gjeopolitikës postmoderne ruse.

Këtë fakt Serbia po përpiqet ta shfrytëzo dhe, siç vëren studjuesi J.Bugajski, Serbia, nën sundimin e Presidentit Aleksandar Vuçiç, po përpiqet në mënyrë të dëshpëruar të imitojë Rusinë. Ajo po kërkon të jetë fuqia dominuese në Ballkanin Perëndimor dhe po kopjon ideologjinë "Bota Ruse" të Putin për një "botë serbe,"³ qoftë kjo edhe më e vogël se ajo ruse. Por

2 <https://www.welt.de/politik/ausland/article232902687/Energiewende-Litauens-Erfolg-kann-fuer-Deutschland-eine-Lehre-sein.html>

3 <https://www.slobodnaevropa.org/a/vulin-vu%C4%8Di%C4%87-srpski-svet/31366884.html>

problemi për Beogradin është i dyfishtë: axhenda e tij ekspansioniste do të hasë në rezistencën e të gjithë fqinjëve të tij dhe atë të agjencive ndërkombëtare, ndërsa përpjekja për “madhështi” do të bëjë që Serbia të jetë gjithnjë e më e varur nga përllogaritjet e Moskës, konkludon Bugajski në një editorial për gazetën DITA të Tiranës.⁴

Varësia ekonomike e Serbisë nga Rusia vazhdon të thellohet, veçanërisht në fushën e energjisë. Në janar 2021, Beogradi nisi një ndërlidhje të re gazi përmes Bullgarisë dhe Turqisë, me një pjesë prej 400 kilometrave të gazsjellëses Turkish Stream (Rrjedha turke) për gazin rus. Serbia varet pothuajse tërësisht nga furnizimi i energjisë ruse dhe kjo e shton kontrollin e Ruisë mbi shtetin.

Por kjo vaërsi e Serbisë ndaj Ruisë edhe më e thellë është në planin ushtarak.

Moska është e prerë që të mos tolerojë asnjë lëvizje të Serbisë drejt anëtarësimit në NATO, konkludon me ët drejtë Bugajski në analizën e tij në fjalë.

Këtë vaërsi Putini gjithësesi mund ta shfrytëzojë në qastin më të leverdishëm, duke nxitur konfliktin fillimisht në Bosnjë, por pa përjashtuar edhe mundësinë e një Blic-Krieg-e në veriun e Kosovës, që fare lehtë mund ta përfshijë gjithë Ballkanin.

Ndërkohë Bashkimi Europian për shkak të bllokadës bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut ka vendosur sërish të mos çelë negociatat për antarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Nuk ishte e mundur të binim dakord për miratimin e kornizës së negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Shpresojnë që kjo të arrihet nën presidencën e Sllovenisë.”⁵, tha sekretarja e Portugalisë për Çështjet Europiane, Ana Paula Zacarias pas takimit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 21 qershor në Luksemburg. Në këtë gjendje pa perspektivë, kur procesi i integrimit të rajonit në BE po shtyhet për në “Kalendrat greke”, dalje në skenën politike me idenë e krijimit të të ashtuquajturit “Ballkani i hapur” rezulton të jetë më shumë një projekt i

4 [Dita, 7 gusht 2021] <http://www.gazetadita.al/raportet-mes-moskes-dhe-beogradit-janusz-bugajski-vucic-mund-te-nxitet-drejt-nje-konfrontimi-ushtarak-ndaj-fqinjëve-ne-ballkan/>

5 <https://www.youtube.com/watch?v=zWBdiar6iH0>

karakterit gjeopolitik, ku ngatërrohen sferat e interesit të fuqive të jashtme, se sa një zgjidhje e duhur e në kohën e duhur. Emri i tij për ideatorët, duket se është shfrytëzuar si “Letër lakmuesi”, si një mashtrim i llojit të vetë e për motive të dyshimta të atyre që e kanë inicuar.

Ballkani i hapur - alternativë që i kundërvihet procesit integrues në BE

Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, të cilat, ashtu si Kosova, kanë frikë nga mbizotërimi i Serbisë, nuk tregojnë asnjë interes për Ballkanin e hapur. Ndërkohë edhe Bosnjë-Hercegovina gjithashtu është “tërhequr” nga iniciativa, si duket nga presioni që ka nga bashkësia ndërkombëtare. Ekziston shqetësimi në Malin e Zi se një Bashkim Ballkanik, që de fakto do të ishte një “Jugosllavi e re” pa Slloveninë dhe Kroacinë, por me Shqipërinë brenda, mund të krijohet si një alternativë ndaj anëtarësimit në BE dhe se anëtarësimi në BE mund të zëvendësohet nga diçka tjetër. Dhe kjo nuk ishte ajo që ata dëshironin deri më tani në Podgoricë.

Për sa i përket përmbajtjes, "Ballkani i hapur" tani është pajisur me prerogativa që de fakto janë më shumë sesa lehtësimi i lëvizjes së njerëzve - përkatësisht krijimin e një zone ekonomike rajonale, njohjen e diplomave, çështjen e lejeve të punës dhe shkëmbimet e studentëve, duke pretenduar madje edhe një treg të brendshëm me të gjithë katër liritë për lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve, njerëzit dhe kapitalin. Megjithatë ky projekt edhe vetëm si ide ka rezultuar më shumë të jetë në funksion të ringjalljes së tensioneve politike dhe rritës së nacionalizmi, sidomos atij serb. Rrjedhimisht rezistenca ndaj kësaj ideje ishte më e theksuar në Kosovë dhe Mal të Zi, por ajo pritet të artikullohet edhe më qartë nga qarqet progresive gjithandej brenda Ballkanit Perendimor dhe nga Brukseli e Uashingtoni.

Për këtë ide, fillimisht të pagëzuar si Margaritis Schinas, nënkryetari i Komisionit Evropian, nuk ishte aspak i entuziazmuar, përkundrazi ai atë nuk e shihte në funksion të procesit të integritit të rajonit në BE.

"Në asnjë mënyrë qëllimi për t'u kthyer në Shengenin tonë të zakonshëm, duke hequr kufizimet aktuale në kufijtë tanë të brendshëm, nuk do të zëvendësohet nga një lloj mini Shengeni rajonal që copëtojnë tregun tonë të

vetëm dhe diskriminojnë Shtetet Anëtare jo-pjesëmarrëse. Kjo nuk është e mundur, ” pohoi ai.

Në veçanti, ai theksoi se nuk dëshironte që e ashtuquajtura 'fluska e udhëtimit Baltik' të bëhej një tipar afatgjatë, megjithëse ai nuk kundërshtoi veçanërisht heqjen e kufizimeve në udhëtimet e brendshme midis shteteve të BE me nivele të ngjashme epidemiologjike gjatë pandemisë .

Kjo marrëveshje e re midis Shqipërisë dhe Serbisë ndodh pikërisht kur BE po planifikon të rishikojë Zonën Shengen.⁶

Kalimi nga iniciativa e Novi Sadit që u bë më shumë e njohur me emrin “Mini Shengen” në “Balkan Open” duhet shikuar edhe si produkt i një lloji “skepticismi euro-atlantik” merr një dimension më të strukturuar dhe më të etabluar në mendësinë e politikanëve, të cilët gjatë ditës mendjen e kanë në Bruksel e Washington, kurse natën punojnë në gjetjen e alternativave për t’i zëvendësuar ato. [Emin Azemi: 2021, Fakti, 31 korrik]

Në emisionin e njohur të njërit nga tv serbe, RasPravda, St. Protić, historian dhe ish ambasadori serb në Zvicër dhe SHBA pohon se bombardimet e NATO-s mbi caqet e armatës serbe dhe mbi qytetet serbe (24 maj 1999 - 10 qershor 1999), paskan ndodhur meqë Perendimi, më saktë "disa nga fuqitë perendimore, nuk na honepsin dot si lider të Ballkanit." Ata, thellon më tej analizën e tij ish ambasadori dhe ndërkohë studjuesi

St. Protić, e kanë të qartë se "ne serbët, kemi vullnetin dhe dëshirën, fuqinë dhe aftësinë që të krijmë shtetin nacional dominant në Ballkan, i cili do të dominonte krejt këtë pjesë të kontinentit. Këtë fakt nuk mund ta tolerojë asnjë nga fuqitë e mëdha, e veçmas jo ato fuqi perendimore që në këto 20 vitet e fundit e kishin fjalën kryesore."⁷

Në këtë linjë është edhe studjuesi i njohur rus i çështjeve ballkanike, Valeri Emeljanov, Drejtor i Qendrës Ruse të Analitikës dhe Informacionit. Ai në një analizë botuar në 31 korrik 2021, tek trajton idenë për Ballkanin e Hapur, duke rreshtuar përfitimet e Serbisë nga kjo nismë, potencon se “*Shqipëria për Beogradin është dalje në det, nga e cila u privua me rënien e Jugosllavisë dhe më vonë të Federatës Serbo-Malazeze*”.

6 <https://www.etiasvisa.com/etias-news/mini-schengen-balkans>

7 <https://www.youtube.com/watch?v=AhHqopkTDS0>

Tutje ai nënvizon se dy përfituesit kryesorë të nismës do jenë, Serbia dhe Maqedonia.

“Serbia, shteti më i fuqishëm i aleancës së “Ballkanit të Hapur” natyrisht është e interesuar për vërshimin e mallrave të lira dhe të shërbimeve të lira nga vendet fqinjë. Përveç kësaj “Ballkani i Hapur” është rikthim i qartë tek statusi i liderit rajonal, të cilin Serbia dhe serbët tradicionalisht e kanë patur në Ballkanin Perëndimor. Mospjesëmarrja e Kosovës në aleancat e tipit të “mini Shengenit-“Ballkan i hapur”- realisht dhe qartë përcaktohet nga fakti se atë e drejton Serbia” – shkruan Valeri Emeljanov.⁸

Si nacionalisti racional e i matur serb Protić, edhe sivëllai i tij rus Valeri Emeljanov, nuk e fshehin faktin se ky projekt mund të konsiderohet edhe si kunëdrvënie BE-së, respektivisht filozofisë bazë mbi ët cilën është ngritur ky bashkim sui generis për historinë politike botërore. Prandaj Protić angazhohet për qasje tjetër ndaj Kosovës, për këmbim popullsisht mes Serbisë e Kosovës, për aneksimin e gadi gjysmës së Bosnjës (Republika Srbska...) dhe krijimin e Shtetit-komb të Serbisë.

Projekti "Ballkani i hapur" vallë, nuk na qenka pikërisht kjo qasje e Beogradit për krijimin e parakushteve që shpiejnë drejt arritjes së këti objektivi strategjik serb?!

Bashkimi doganor, i pamundur

Pjesëmarrja në një union të tillë ekonomik dhe për t'i gëzuar përfitimet e tij, akcili pretendues ka parasysh benefitet e tij.

Sipas kalkulimeve me karakter të pastër ekonomik, gjendja krahasimore mes tri shteteve inicuese është kjo: Shqipëria ka BPV (GDP) me përbërje: 21.7% bujqësi, 24.2% industri dhe 54.1% shërbime. Maqedonia Veriore ka BPV (GDP) me përbërje: 10.9% nga bujqësia, 26.6% nga industria dhe 62.5% nga shërbimet. Serbia ka BPV (GDP) me përbërje: 9.8% bujqësi, 41.1% industri dhe 49.1% shërbime. Për krahasim, Kosova ka BPV (GDP) me përbërje: 11.9% nga bujqësia, 17.7% nga industria, dhe 70.4% nga shërbimet.

⁸ Shih: “*eadaily.ru*”, 31 korrik 2021

Këto të dhëna dëshmojnë qartë se Serbia do të jetë shteti dominues i këtij unioni, ndërkaq Shqipëria dhe nëse do të hynte edhe Kosova, para së gjithash, do të shndërroheshin në treg të prodhuesve serb, duke i zëvendësuar ata sloven që dominonin në epokën e Jugosllavisë së Titos.

Për një treg unik, përveç katër lirive që parasheh ideja e “mini-Shengenit”, një bashkim doganor do të ishte i domosdoshëm. Ndërkaq realizimi i këtij objekti rezulton të jetë thjeshtë i pakconceptueshëm, sepse të gjashtë vendet kanë tarifa doganore shumë të ndryshme me vendet e tjera të treta. Serbia, për shembull, ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me Rusinë dhe tani gjithashtu një me Bashkimin Euroaziatik.

"Nuk ka gjasa që kufijtë për tregti dhe udhëtime midis vendeve të prekura do të hiqen," thotë dojeni i ekonomistëve të Evropës Juglindore, Vladimir Gligorov, në lidhje me idenë mini-Shengen për të përditshmen austriake STANDARD. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu kanë marrëveshje me BE mbi standardet dhe pengesat tregtare. "Nuk ka asnjë mënyrë për të sinkronizuar politikën përtej asaj që është rënë dakord me BE," përmbledh ai.⁹

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç u shpreh në një rast tjetër se, në rrethanat kur BE nuk ka një strategji të qartë ndaj Ballkanit Perëndimor, nisma rajonale Ballkani i hapur paraqet një mundësi, shpresë dhe detyrim të madh për të tre vendet për të krijuar një të ardhme më të mirë dhe të ndryshme në e tyre.¹⁰

Ndërkaq në një nga takimet e treshes Vuçiç-Rama-Zajev, presidenti serb Vučić nënvizon se „deri në fund të vitit 2021 duam të krijojmë kushtet, që të kalojmë nga vendi në vend vetëm me kartë identiteti. Këtë me Shqipërinë nuk mund ta bëjmë tani dhe shpresojmë ta arrijmë në takimet e ardhshme. Njëzet e gjashtë orë humbasin kamionët duke pritur në kufij dhe shikoni çfarë do të thoshte për ekonominë heqja e këtyre barrierave“.

Këto deklarata të Vuçiçit duhet vështruar të ndërlidhur me strategjinë serbe për dominim në rajon. Por, për hir të së vërtetës duhet pohuar se

9 Adelheid Wölfl: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>

10 <https://www.glasistre.hr/svijet/vucic-kritizira-eu-kaze-da-je-otvoreni-balkan-povijesna-prilika-za-cijelu-regiju-737408>

rajoni ka nënshkruar marrëveshje paraprake në kuaëdr të nismave tjera, prandaj tashmë ekziston një marrëveshje ekonomike, por që nuk funksionon. Marrëveshja CEFTA nuk funksionin dhe përgjegjëse për këtë është vetë Serbia. Atëherë është logjike të bësh pyetjen, përse nuk punohet për zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s, por futet në lojë Ballknain e hapur'? Konkluzioni është i qartë: përderisa Serbia nuk e njeh Kosovën si subjekt të barabartë në tavolinën e bashkëbisedimeve edhe për projekte të kësaj natyre, përderisa marrëdhëniet politike mes Beogradit dhe Prishtinës të mos zgjidhen, çfarëdo marrëveshje qoftë ajo, është vështirë, për të mos thënë e pamundur, të funksionojë, e mos të flasim për këtë lloj "bashkimi doganor", siç prezantohet "Ballkani i hapur" nga treshja e kapur nga oligokratët e rajonit që si duket janë fuqishëm të mbështetur nga ata rus dhe jo vetëm.

"Ballkani i hapur" pengon procesin integrues në BE

Kjo iniciativë duket e pakonsultuar ose minimalisht - e pakoordinuar me fqinjin tonë kryesor, me Kosovën, e cila bashkë me Bosnjën e Malin e Zi, e kanë bërë të dështojë që në fillim këtë iniciativë. Qeveria franceze, thuhet se ka dijani për një paketë të plotë të kësaj initiative, e cila në thelbin e vet zhvendos rajonin nga aksi i integritit të shpejtë në Bashkimin European dhe e dyta, fut në labirinte të errëta pavarësinë e Kosovës".

Për ish-diplomatën, Shaban Murati nisma mund të ketë efekte të tjera gjeopolitike. "Realisht projekti serb është krijimi i një miniblloku të ri ekonomik dhe politik si alternativë apo sfidë ndaj Bashkimit European. Presidenti serb e shprehu hapur këtë pas refuzimit të BE-së për hapjen e bisedimeve të pranimit me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, kur tha se 'refuzimi i BE-së tregon se sa të drejtë kemi ne që jemi lidhur me Rusinë dhe me Kinën'. Orientimin miniblloqeve ua jep shteti nismëtar ose shteti më i fuqishëm, që në rastin konkret është Serbia. Rusisë i interesojnë vatra të vogla ballkanike të shkëputura nga BE dhe prandaj Moska e përkrah projektin serb të zonës ekonomike ballkaniko-perëndimore", argumenton Murati.¹¹

11 Shaban Murati: <https://www.ishgj.org/gjeopolitika-rajonale/gjeopolitika-postmoderne-serbe-dhe-endrra-per-dalje-ne-adriatik/>

Murati nënvizon tutje në raport me qëllimet reale të Serbisë që ndërli-dhen me Bllkanin e hapur si projekt, duke e cilësuar si „lojë të komplikuar dhe të errët diplomatike dhe të metodës indirekte serbe për të marrë dalje në bregdetin shqiptar të Adriatikut“. Në këtë lojë, sipas Muratit, „Serbia hodhi ne tavolinat diplomatike shashkën që mund të pranonte njohjen e Kosovës në shkëmbim të së drejtës së daljes në bregdetin shqiptar në Adriatik. Është një tezë, që e përmend edhe media serbe “B92” në 20 mars 2020, kur del me njoftimin “Një pikë-dalje në det, ky është kompromisi i ofruar Serbisë”.¹²

Vladimir Gligorov thekson se BE do të donte idenë e "Mini-Shengenit", sepse "ajo ngadalëson procesin e zgjerimit" dhe meqë BE gjithsesi po promovon bashkëpunimin rajonal për arsye të politikës së sigurisë. Premtimi i Mini-Shengenit është gjithashtu "reklamim i mirë në Evropë" për Vuçiqin dhe Ramën, thotë ai. "Por, kjo nuk paraqet një përmirësim për Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Dhe Mali i Zi nuk dëshiron ndonjë ngadalësim të pranimit të tij në BE," shpjegon ai tutje. Prandaj, Gligorov arrin në përfundimin se asgjë nuk do të dalë nga e gjithë ideja - "përveç shumë bisedave".¹³

Shumë studjues të kësaj fushe gjithashtu theksojnë se tashmë ka mjaft iniciativa rajonale. Detyrimet për bashkëpunim më intensiv janë rënë dakord prej kohësh brenda kornizës së marrëveshjes ekzistuese rajonale të tregtisë së lirë Cefta dhe procesit të Berlinit. Kjo është arsyeja pse ideja Mini-Shengen "duket si një projekt tjetër i bashkëpunimit rajonal, i cili - kam frikë - së shpejti do të mbështetet nga Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, procesi i bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Cefta dhe kompani të tjera", thotë eksperti i njohur Florian Bieber i Universitetit të Graz-it në lidhje me pengesat që iniciativa të tilla u është dashur të përjetojnë deri më tani.

Pozicion i privilegjuar i Serbisë

Në fakt, marrëveshja rajonale e tregtisë së lirë Cefta u nënshkrua nga administrata e KB-së Unmik në Kosovë në 2007. Qeveria në Prishtinë më

12 Po aty.

13 Adelheid Wölfl: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>

pas theksoi se Kosova do të tërhiqej nga marrëveshja nëse nuk do të përfaqësohej në Cefta si Republikë tashmë e njohur nga mbi 100 shtete sovrane. Në përgjithësi, tregtia brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor tashmë është kryesisht pa taksa doganore brenda kornizës së Cefta-s, por kontrollat kufitare ende kërkohen për të zbatuar rregullat e origjinës. Në një studim të ri interesant nga Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (WIIW) dhe Fondacioni Bertelsmann, shqyrtohen me përpikëri përpjekjet e mëparshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe në këtë mënyrë edhe të stimulojnë rritjen ekonomike.

Përveç Cefta, Gjermania dhe BE kanë promovuar zgjerimin e infrastrukturës në rajon që nga viti 2014 duke e trajtuar si pjesë të Procesit të Berlinit. Një total prej katër miliardë eurosh do të investohet në zgjerimin e energjisë dhe rrjeteve të transportit.

Autorët e studimit tregojnë se efekti i marrëveshjeve të mëparshme të tregtisë së lirë në rajon ishte shumë më i vogël për Serbinë sesa ishte rasti për pesë shtetet e tjera si Bosnjë-Hercegovina, Kosovës, Malit të Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Krejt kjo sepse Serbia - e cila është ekonomikisht aq e fortë për sa i përket PBB-së sa të pesë shtetet e tjera së bashku - ka zgjeruar tregtinë e saj me BE, me theks në vitet e fundit. Falë Cefta-s, tregtia ndërrajonale u rrit me mbi 37%. Nëse Serbia do të përjashtohej nga llogaritja, ajo rritje ishte madje 70 %. ¹⁴

Ndryshe nga Evropa Qendrore dhe Lindore përpara se të bashkoheshin në 2004, nuk kishte asnjë lulëzim në Ballkan - përveç ndoshta investimit të Fiat Chrysler në Serbi. "Gjeografia e armiqësisë", siç e quajnë autorët e studimit tensionet e vazhdueshme politike midis Serbisë dhe Kosovës dhe brenda Bosnjë-Hercegovinës, është vendimtare për mungesën e zhvillimit. Kjo përforcon dobësinë ekonomike të rajonit, ky është argumenti kryesor.

"Serbia është në qendër të gjeografisë së armiqësisë, stimujt e saj për bashkëpunim të plotë rajonal janë të kufizuara," potencohet në këtë studim. "Serbia ka probleme territoriale me shumicën e vendeve tjera në rajon, megjithëse në shkallë të ndryshme. E gjithë kjo çon në një shpërndarje shumë të njëanshme të pushtetit rajonal. Fqinjët e Serbisë janë dukshëm më

14 Po aty.

të dobët në pothuajse çdo mënyrë, duke përfshirë popullsinë, fuqinë ushtarake dhe burimet e taksave shumë të vështira për të arritur ekuilibrin rajonal,"¹⁵ thotë studimi në fjalë.

Zhvillimi ekonomik i rajonit në çdo rast dëmtohet rëndë nga mosmarrëveshjet territoriale dhe bllokadat kushtetuese. Prandaj - pa ndonjë përparim në këto çështje - edhe iniciativat e bashkëpunimit rajonal të tilla si "Ballkna i hapur" nuk mund të ndryshojnë thelbësisht situatën.

Shih për këtë, autorët e studimit propozojnë qasje më të mirë në buxhetin e BE, pranim në bashkimin doganor të BE dhe një zgjerim të marrëveshjeve të mëparshme me BE. Anëtarësimi në bashkimin doganor të BE do të nënkuptojë se shtetet do të duhej të barazojnë marrëveshjet e tyre doganore me ato të BE. Do të ishte gjithashtu pozitive që barrierat tregtare të hiqeshin. Pra, më shumë Evropë është e nevojshme në Ballkan, jo domosdoshmërisht më shumë ide për bashkëpunim rajonal, në mënyrë që të sigurohet që ekonomitë e varfra të arrijnë hapin me bllokun e prosperuar ekonomik të BE-së.

Zona e re Ballkani i hapur pretendohet të përbëhet nga Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina.

Konklzione

Në fjalën e tij gjatë konferencës dyditore ndërkombëtare, Forumi I Prespës për dialog, kryeministri i Kosovës kërkoi që rajoni t'i rikthehet agjendës së integrimit evropian.

Në rast se BE shtyn tutje këtë agjendë, ka rrezik që rajoni të rrëshqas sërish në kaos.

Sipas studjuesit Boris Varga ekzistojnë katër faktorë kryesorë që ndikojnë në perspektivat e ardhshme të rajonit të Ballkanit Perëndimor:

- a) Ndryshimi i mjedisit të politikës së jashtme
- b) Problemi i dinamikave të brendshme politike
- c) Faktori Rusi
- ç) BE -ja dhe paradigma e re integruese¹⁶

15 Po aty.

16 Boris Varga: <https://pescanik.net/zapadni-balkan-geopolitika-nedovrsenih-drzava/>

Për shkak të ngërçit në zgjerimin e BE -së, oferta e anëtarësimit në NATO tashti për Kosovën është një lloj zëvendësimi real, por gjithësesi jo i plotë, në procesin integruar euroatlantik. Ndërkaq anëtarësimi në NATO i Malit të Zi dhe Maqedonisë do të duhej nënkuptuar si distancim nga Rusia. Por ndër vendet e që në vitin 2018 ishin objekt trajtimi e analize, vetëm në Maqedoni dhe Kosovë ekzistonte një konsensus i brendshëm social dhe politik në lidhje me anëtarësimin në Aleancë. Për Maqedoninë, anëtarësimi në NATO u dëshmuar se ishte edhe një faktor shtesë i stabilizimit dhe sigurisë.

Gjatë gjithë procesit të integritit të Ballkanit Perëndimor në BE, për fat të keq, stabilokracia si fenomen që aplikuar si prioritet nga Brukseli. Ky fakt dëshmon se Brukseli shpesh ka aplikuar standarde të dyfishta në vlerësimin e demokratizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor që po rezultojnë tashmë me minimin sistemik të demokracisë. Bakani i hapur është produkt i atyre garniturave të papërgjegjshme politike, sidomos në Serbi dhe Shqipëri, që për kohë të gjatë, gjithësesi pa meritë, gëzonin mbështetjen e Brukselit zyrtar. Në vitet 90-ta të shek. të kaluar edhe Slobodan Millosheviq që konsiderohej si një faktor stabiliteti. Përfundimi dihet tashmë.

Me refuzimin e hapjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ndjenjat euroskeptike dhe madje edhe anti-evropiane mund të nxiten më tej në gjithë Ballkanin Perëndimor. Këtë fakt ndërkohë po e shfrytëzojnë autoritarët e tipit të Vuçiqit e Ramës si në Serbi edhe në Shqipëri. Nëse braktiset orientimi evropian, elitat politike të orientuara nga këta lider autoritar, mund të kthejnë fare lehtë rajonin në fillimvitet e dekadës së fundit të shekullit të kaluar. Në këtë rast Serbia do të motivojë shkëputjen në Republikën Srpska, edhe përmes organizimit të një referendumit, ndërkaq Kosovën veriore edhe përmes një „blic krig-e“. Ajo logaritë gjithësesi në mbështetjen e Rusisë për këtë objektiv strategjik të saj.

“Lufta për kthimin e Kosovës nën sovranitetin e Serbisë do të jetë afatgjatë dhe e pasigurt. Ajo duhet e mundur të bëhet, vetëm përmes një strategjie bashkëpunimi dhe lufte permanente për të zhvilluar një vetëdije politike autonome gjithandej tek popujt e Ballkanit për nevojën për bashkëpunimin e tyre (riafirmimi i fjalëkalimit strategjik "Ballkani për popujt e Ballkanit" dhe "Evropa për evropianët"), duke fituar kështu një lloj

shprese për Europën e së ardhmes dhe botës. Duke u bërë një vend i fortë ekonomikisht dhe kulturor, Serbia do të rifitojë reputacionin e saj politik dhe do të sigurojë riintegrimin demokratik në këtë gjeohapësirë.” [Dr Ljubiša Mitrović: 2018]

Më qartë nuk ka se si thuhet se në themel të projektit “Ballkani i hapur” është pikërisht kjo strategji e përpunuar nga institucionet shkencore serbe në shërbim të politikës.

Rritja e fluiditetit gjeopolitik të Serbisë në njërën anë, që karakterizohen me raporte të mira qoftë me Moskën, qoftë me Brukselin, por po aq të afërta edhe me Pekinin, dhe, në anën tjetër, profilimi i saj si shtet autoritar, që nënkupton intensifikimi i politikave të forta shtetërore, i kanë imponuar qeverisë serbe të marrin masa shtesë për të zvogluar rreziqet që lidhen me “ndërveprimet ekonomike ndërmjet shteteve, të cilat kanë përdorur gjithmonë mjete të politikës ekonomike dhe të diplomacisë për të ndjekur qëllimet e tyre gjeopolitike.” [Rovena ALIRA]: 2018]

Në kontekstet e analizave gjeopolitike, indikatorët ekonomik zënë një vend të rëndësishëm në vlerësimin e fuqisë së shtetit.

Duke pasur parasysh realitetet e reja në botë, para së gjithash në Europën Perendimore dhe atë Juglindore, Shqipëria dhe Kosova duhet të ripërkufizojnë prioritetet e politikës së jashtme tok. Këto prioritete para së gjithash duhet të përqëndrohen e koordinohen në mbrojtje të interesit kombëtar.

Shqipëria politike tashmë është pjesë integrale e aleancës politiko-ushtarake më të madhe në historinë e njerëzimit - në NATO. Kosova aktualisht është nën suzerenitetin e Perendimit (SHBA-ve dhe partnerëve të saj tradicional). Këtë fakt duhet shfrytëzuar në maksimum.

Qemal MURATI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

LUFTA PËR IDENTITETIN, VETJA NË TAVERNËN BALLKANIKE PËRMES "VJETËRSISË DHE DOMINIMIT NË GJUHË"



Hyrje

Tavernë ballkanike përdoret me kuptim të figurshëm për një shoqëri të keqe, primitive, në të cilën nuk dihet kush pi dhe kush paguan, siç janë shoqëritë a popujt e Ballkanit. **Ballkani në thelb është si një turlitavë komunitetesh të ndryshme etnike, me përzierje, gërshetime dhe asimilime të shumanshme gjuhësore, kulturore, religjioze, e me tipare etnopsikologjike retrograde, parcializuese, veçuese. Ndryshe nga mendësia dhe kultura evropiane perëndimore, ballkanasit e kanë të përbashkët dogmën dhe paragjykimin, gënjeshtren si kreativitet, mbiçmimin e etnikumit të vet dhe urrejtjen e nënçmimin e etnisë tjetër. Në kuptimin e standardit linguistik, me termin ballkanizim mund të kuptonim tendencën për ruralizim, kthimin kah gjuha rurale a lokale, kurse termi evropieizim mund t'i referohet qytetërimit gjuhësor. Në këta terma, mund të flitet dhe për “shqipen evropiane” a për “shqipen standarde”, gjuhën që u shërben të gjithë shqipfolësve, dhe për “shqipen ballkanike” a “lokale”, gjuhën e një mjedisi të caktuar, shqipen e dialektit.**

Ballkani, dogma dhe paragjykimet

Dogma, sipas përkufizimit të fjalorëve të gjuhës, është pikëpamje, ide, koncept, doktrinë etj. që merret si një e vërtetë e pakundërshtueshme, e pandryshueshme historikisht dhe e shkëputur nga praktika e nga rrethanat

konkrete. Në Ballkan, ku gjithçka të shumtën e herëve perceptohet ndryshe nga e vërteta reale, dogma është diçka që është e ngulitur thellësisht te komunitetet etnike që gjëllin në këtë rajon, pasojat e së cilës i vuajnë edhe sot ballkanasit në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore: në komunikim, në gjuhë, në kulturë, në arsim, në sport, në ekonomi, në politikë etj., ku çdo gjë interpretohet në të kundërtën e saj. Në gjuhë përshfaqet mbiçmimi i gjuhës vetjake për lashtësinë dhe përçmimi dhe ndalimi i gjuhës së tjetrit. Në toponimi pretendohet posesiviteti i toponimeve dhe përdorimi i tyre nga grupet e tjera etnike me receta dirigjiste, që aksh toponim do të shkruhet e do të shqiptohet siç thotë padroni e jo siç e thotë gjuha marrëse. Shkurt: *“Ballkanasit nuk i pëlqen t’ i ndalohet hiperbola, irracionaliteti dhe skizofrenia”* (NaserAliu). Në këtë kuptim, qëndron dhe ajo thënia e famshme e WinstonChurchill (UinstonÇerçil), më 1941, se:

“Ballkani prodhon më tepër histori sesa është në gjendje të konsumojë”.

Ballkanasit dhe ndërliqësitë ballkanike

Vendet dhe popujt e Ballkanit historikisht kanë qenë e janë edhe sot shumë të ndërlikuar, aq sa historinë, gjuhën, etnokulturën, identitetin e tyre e shohin në një prizëm krejt ndryshe nga të tjerët, sipas kutit të vet. Ballkanasit përplasen ende për mite e mitizime, me mohime e nihilizime, për të shkuarën e largët antike e paraantike, në vend se të merreshin me të ardhmen për të ndërtuar të tashmen dhe fqinjësinë e përbashkët.

Maqedonasit dhe shqiptarët përplasen akoma për çka në të vërtetë nuk do të duhej të përplaseshin. Për të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoni: gjuha shqipe mund të përdoret zyrtarisht në një qytet që ka 20 për qind me popullsi shqiptare, por nuk mund të përdoret në qytete e vendbanime që kanë ta zëmë 19 për qind të popullsisë shqiptare; E ndërkaq, në Kosovë, serbishtja është gjuhë zyrtare edhe me 5 për qind. Sporadikisht përplasen dhe për prejardhjen e Nënë Terezës e të Skënderbeut, kur disa autorë maqedonas në botime të ndryshme e në libra shkollorë pretendojnë t’i shpallin këto dy personalitete botërore me prejardhje maqedonase. Në fakt, Skënderbeu dhe Nënë Tereza janë personalitete që i takojnë **kulturës origjinale shqiptare, po aq sa i takojnë dhe kulturës evropiane e**

botërore, dhe vetëm në këtë kuptim ata mund të jenë dhe maqedonas. Më tej, fiset ilire *Enkelejtdhe Dasaretët* paraqiten si fise maqedonase duke shtrembëruar kështu faktet historike mbi të kaluarën e tyre ilire. Mënyra se si e trajtojnë të kaluarën historianët maqedonas dhe ata të Ballkanit, me gjithë ato stupiditete, është mënyra më joshkencore që s'ka të bëjë fare me historinë.

Në Greqi shqiptarët janë të detyruar të ndërrojnë emrat e tyre për t'u dukur si "grekë", për të siguruar një vend pune, çka nuk do të gjeje një dukuri të tillë kurrkund në Europë;

Komunitetet etnike të Ballkanit (maqedonasit, bullgarët, serbët, grekët, shqiptarët) humbasin ende në retorikë politike pa fryt mbi kombësinë e tyre, për të argumentuar secili në mënyrën e vet të qenit indigjen në Ballkan dhe për të mohuar autoktoninë e tjetrit, në kuptimin e asaj se kujt i takon e drejta historike, atij i takon dhe territori;

Grekët dhe maqedonasit paradoksalisht edhe në Ballkanin e shekullit 21 kërkojnë që toponimet e arealit të tyre të tjerët t'i shkruajnë sipas formës së gjuhëve të tyre e jo sipas natyrës së gjuhës përkatëse: **Selanikut duhet t'i thuhet Thesaloniki, Shkupit duhet të quhet Skopje, e jo ndryshe, siç dalin të përdoren në gjuhët marrëse, që kanë natyrë të mëvetësishme nga greqishtja e maqedonishtja** (për këtë dhe Ballkani është i veçantë, ngaqë një shembull të tillë nuk e gjen askund në botë);

Gjuhëtarët e Ballkanit më shumë se për pasurimin e gjuhës së tyre angazhohen për pastrimin e gjuhës vetjake nga elemente të gjuhës së tjetrit: kroatët kërkojnë që kroatishtja e tyre të pastrohet nga serbizmat, serbët kërkojnë ta pastrojnë gjuhën e tyre nga kroatizmat, maqedonasit nga serbizmat e bullgarizmat, shqiptarët angazhohen për çserbizimin, çgreqizimin, çromanizimin e shqipes etj., paçka se një ndërmarrje e tillë është krejtësisht jo vetëm e padobishme, por dhe dëmsjellëse, sepse nuk ka raca dhe gjuhë të pastra, aq më tepër në Ballkan. Gjuhët në komunikimet e përditshme janë të parat që japin e marrin nga njëra-tjetra për nevojat e folësve. Po e tharkove gjuhën në plëngun vetjak, ia ke prerë asaj rrënjët ushqyese dhe enët e komunikimit.

Ballkanasit dhe dogma e lashtësisë

Ballkanasit e kanë të rëndësishme dogmën për lashtësinë e madhe të gjuhës së tyre, përkatësisht dogmën e të qenit të parët në këtë gadishull, të mbingopur me patriotizëm dhe me ide të brishta deri në bezdi. Këtë e thekson shprehimisht dhe albanologu i shquar Gustav Meyer, këtu e një shekull më parë, në parathënien e fjalorit të tij të famshëm etimologjik të gjuhës shqipe “*Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache*” (Strasburg, 1891), dhe parashikonte se fjalori i tij nuk do të mirëpritej nga ëndërrimtarët e tillë:

“Mendoj se patriotët shqiptarë dhe grekët nevojtarë për aneksim, të cilët e kanë të domosdoshme dogmën për lashtësinë e madhe të çdo fjale shqipe si mbështetje për teorinë e tyre pellazgjike ose çfarëdolloj teorie tjetër, kur të marrin në dorë librin tim nuk do të gëzohen shumë për mozaikun shumëngjyrësh që paraqitet këtu”.

Lufta për identitetin vetjak mes popujve në Ballkan përmes “vjetërsisë së gjuhës” e “dominimit në gjuhë” është një tjetër absurditet që homobalcanicus ka tjerre ndër shekuj, duke pandehur secili që gjuha e tij është e lashtë se e fqinjit. Në fakt, kur flitet për vjetërsinë e gjuhës nuk mund të mos kihet parasysh ky postulat i ballkanologut amerikan Viktor Fridman:

“Nuk mund të flitet për dominime në gjuhë. Gjuhët janë si njerëzit, ato zhvillohen me breza. Kur flitet për historinë e saj, nuk mund të flasim për vjetërsi, por vetëm për të dhëna që mund të jenë më të reja ose më të vjetra. Ndërsa nga pikëpamja linguistike nuk mund të themi se një gjuhë është më e vjetër se një tjetër, pasi të gjitha gjuhët fliten tani”.

Koncepte retrograde ballkanasit i kanë edhe sot e gjithë ditën dhe i ruajnë akoma në mënyrën më absurde. Veprat e mira shkencore, që ta thonë të vërtetën troç, ende nuk mirëprehen. Dhe në vend të tyre parapëlqehen e promovohen botime historike e gjuhësore që nuk i shërbejnë askujt dhe autorëve të tyre madje u thuren elozhe deri në qiell. Autorë pa kurrfarë njohurish paraprake në Ballkan, pa përgatitje të mirëfilltë shkencore, marrin të trajtojnë problematika nga të historisë, gjuhësisë, etimologjisë etj. krejtësisht sipas parapëlqimeve të tyre, produkti i të cilëve nuk është veçse një hiç, apo, më e shumta, që i bëjnë një dëm shkencës dhe kulturës vetjake. Kësisoj, historiani

zviceran OliverJensSchmitt, autor me kontribute të shquara i disa studimeve monografike nga më të rëndësishmet për shqiptarët, ndër këto dhe i botimit të një vepre madhore “Skënderbeu” (Tiranë, 2008), në vend që të vlerësohej e përgëzohej për ato arritje kulminante, gati sa nuk u kryqëzua vetëm pse heroin kombëtar të shqiptarëve e sheh në një dimension tjetër, përtej miteve e mitizimeve të kota. Botime të pafundme joshkencore të llojit të historive që ushqejnë mendësitë ballkanike me të pavërteta e banalitete të skajshme, ku çdo gjë shihet në prizmin e ngushtë e joshkencor, kanë mbushur libraritë dhe bibliotekat private e nacionale, ndërkohë që ato nuk do të duhej të botoheshin fare. Për më tepër, ide dhe koncepte të tilla regresiste, më tepër se vulgu i Ballkanit, ushqejnë dhe promovojnë vetë elitat akademike dhe ato politike për qëllime të tyre meskine pushtetmbajtëse. Në Gjermani në shumicën e rasteve fjala “nacionalizëm” është konsideruar gjithmonë negative. Në Ballkan nacionalizmi është diçka pozitive. Dhe kështu, në Ballkan, në vend të ndriçimit të mendjes, kemi përplasje të përhershme të kulturave, të gjuhëve e të komunikimeve të komuniteteve që e banojnë këtë Gadishull, ku nuk mungon as përçmimi dhe fjalori sharës më banal për gjuhën, kulturën dhe identitetin e tjetrit.

“Makedonishtja” antike, “maqedonishtja” sllave dhe mbijetesa e shqipes

Kur flitet për gjuhët e Ballkanit antik dhe të sotëm, duhet të bëhet një dallim i qartë mes “makedonishtes” antike dhe “maqedonishtes” së sotme sllave në Maqedoninë e Veriut. Autorët e sotëm maqedonas mëtojnë t’iidentifikojnë një gjuhë e vetme, që kjo e dyta është mbijetë e së parës, për të “dëshmuar” autenticitetin e tyre në këto hapësira, paçka se kjo nuk është veçse një pjellë fantaziste. Siç dihet, *makedonishtja* bashkë me popullin që e fliste *makedonët antikë* janë zhdukur, nuk nuk kanë mbijetuar, kurse termi i sotëm “maqedonishte” e “maqedonas” janë krijime të “Jugosllavisë së Titos”, që d.m.th. para vitit 1945 nuk kanë ekzistuar.

Maqedonia antike – vend i lashtë në skajin verior të gadishullit grek, që përfshin ultësirën bregdetare rreh Selanikut dhe vargmalet prapa saj. Në

kohën e Greqisë së vjetër ka qenë mbretëri, e cila në kohën e Filipit II dhe Aleksandrit të Madh u bë fuqi botërore. Ky rajon sot është ndarë ndërmjet Greqisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut (Enciklopedia e përgjithshme e Oksfordit, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2006, 791).

Makedonishtja - gjuhë indoevropiane në qendër të Gadishullit të Ballkanit, u asimilua që në kohën antike nga ana e greqishtes. Shkenca më objektive e pa paragjykime ka konstatuar se në thelb makedonishtja ka qenë një gjuhë më vete, e pavarur nga greqishtja; gjuhë e maqedonasve të lashtë, që shtrirjen më të madhe e pati në kohën e Mbretit Filip II dhe të birit të tij Aleksandrit të Madh (336-323). Shtrihej midis greqishtes, ilirishtes dhe trakishtes apo frigishtes. Aspak nuk është kjo që flitet tani, *maqedonishtja e sotme sllavojugore*. Termi “*maqedonishte*” në kuptimin e sotëm përdoret për një gjuhë sllavojugore krejtësisht tjetër (Ismajli 2003).

Maqedonishtja - gjuhë sllave e jugut e popullatës që veten e identifikon si maqedonase, strukturalisht, tipologjikisht dhe gjenetikisht e ngjashme me bullgarishten, në një anë, dhe dialektin torllak të serbishtes, në anën tjetër. Është e njohur që gjuha maqedonase në kuadër të lidhjes gjuhësore ballkanike përcaktohet si *gjuhë me leksik sllav dhe me gramatikë romane-ballkanike* (Z. Golomb), që domethënë se prania e gjuhëve ballkanike joslave është reflektuar para së gjithash në sistemin gramatikor të maqedonishtes, i cili është pasuruar me një radhë ballkanizmash strukturorë, që kanë ndikuar tipologjikisht të transformohet dhe të largohet nga gjuhët e tjera sllave, e njëkohësisht përmes ngjashmërive strukturore të afrohet me strukturën gjuhësore ballkanike joslave (Ismajli 2003, Stankovska 1978).

Ndërkaq, për vjetërsinë e shqipes dhe mbijetesën e saj ja se ç’thotë prof. I. Ajeti:

“Populli shqiptar është një popull i vjetër. Për shumë popuj që kanë jetuar në këto treva nuk dihet, nuk dihet as për trakasit, dakasit, makedonët e vjetër joslavë e për shumë popuj të tjerë që janë zhdukur, si gjuhë janë zhdukur, janë zhdukur gjuhët e tyre. Nuk dihet për trakishten, *makedonishten* (jo *maqedonishten*). Ka mbetur ndonjë gjurmë e tyre, por jo si tërësi, si gjuhë ato janë zhdukur. Shqipja mbijetoi! Si mos ta thuash këtë, more, diçka fenomenale duhet të jetë, natyrisht! Pse, qysh e ku jetuan ata që nuk u zhdukën?! Ndoshta edhe tendenca e tyre që gjithmonë të largohen nga qen-

drat urbane. Edhe sot pothuaj është ashtu: shqiptarët banojnë, ngrenë tabanët e tyre kryesisht jashtë qendrave. Ja, për shembull, në Jabllanicë, Medvegjë nuk ka patur pothuajse asnjëherë në qytet shqiptarë, në rrethe – po, edhe në Tupallë, Sfircë, Grboc ... Pra, edhe më herët këtë e kanë ndjekur shqiptarët, janë larguar nga qendrat e përziera, ku kanë qenë të izoluar. Kjo edhe është njëra nga arsyet pse mbijetuan sot e kësaj dite, sot e atë ditë!” (SmajlSmaka, *Akademik IdrizAjeti – Rilindasi i fundit*, Portali Telegraf.com).

Ballkanasit dhe gënjeshtat kreative

Thjesht, ballkanasit nuk skuqen nga gënjeshtat. Dhe ato i projektojnë në doktrina e programe. Standardi i atit të Serbisë DobricaÇosiç: *“Gënjejmë për interesa shtetërore të Serbisë”* (*“Laž je srpskidržavni interes”*), është aktual, jetësor dhe në zbatim. Fabrika me teknologji mesjetare nacionaliste, vijon të prodhojë të njëjtin produkt, të ndërtojë të njëjtët politikanë dhe sjellje të institucioneve.

“Mi lažemodabismoobmanulisebe, Lažemozbogslobode. Laž je vidrsrkog patriotizma i potvrdanašeurođeneinteligencije. U ovozemljisvaka-laž na krajupostajeistina. Lažemostvaralački, maštovito, inventivno”

[*“Ne gënjejmë në mënyrë që të mashtrojmë veten, ne gënjejmë për shkak të lirisë; gënjeshtat është një formë e patriotizmit serb dhe dëshmi e inteligjencës sonë të lindur. Në këtë vend, çdo gënjeshtër në fund bëhet e vërteta. Ne gënjejmë në mënyrë kreative, me imagjinatë krijuese”*].

Kjo është e vërteta e propagandës serbe, e pranojnë vetë (Irir Kanina, *Ana e panjohur e provokimit serb*, Gazeta “Shqip”, 8. 11. 2014).

Turlitavë gjuhësore ballkanike

Rajoni i Ballkanit, ku në një territor të ngushtë historikisht janë rrasur shumë popuj dhe gjuhë, është një turlitavë e vërtetë gjuhësh, kulturash e civilizimesh. Ky mozaik etnish, gjuhësh e kulturash të ndryshme, por që janë bërë të ngjashme, i ka dhënë titullin edhe një botimi në maqedonisht *“Jazičnaturlitava”* (Ohrid, 2008), ku autorët Dragi Pop Stefanija – Liljana

Miodonjska evidentojnë thënie e shprehje me mendësi tipike ballkanike: vulgarizma, fjalë obscene, sharje, fyerje etj., që komunitetet etnike kanë krijuar për fqinjën e tyre ballkanik. Në këtë botim mund të ndeshësh dhe shprehje të tilla me cilësimin më keqësues të gjuhës së tjetrit:

“Jadī grav za da zborviš grčki!” (ha fasule që të flasësh greqisht), “Sedi, sedi na kamen ako sakaš da zborviš grčki!”

që figurshëm do të thotë: të flasësh greqisht është sikurse të pjerdhësh. Apo që emri etnik në maq. grcietimologjikisht shpjegohet nga grd-ci “të shëmtuar”. Shprehje me cilësime tilla, që me aq me përçmim e cilësojnë gjuhën e tjetrit, vështirë se mund të gjesh në ndonjë vend tjetër sikurse i gjen ato në Ballkan. Me egzonimet tepër fyese që kanë krijuar popujt e Ballkanit për njëri-tjetrin mund të hartohet një fjalor i madh.

As në botën akademike, gjendja nuk është më e mirë se ajo me vulgun. “Numërojmë në gishta njerëzit që mund të flasin me kompetencë për kulturat e Ballkanit, e në anën tjetër jemi të shtrënguar të jetojmë në të njëjtën hapësirë” (R. Ismajli). Në Ballkan janë të pakët njerëzit që nuk urrejnë, gjithmonë ka armiqësi, grindje dhe urrejtje të vazhdueshme, mospranimin dhe refuzimin e tjetrit:

“Ndikimet dhe ndërveprimet kulturele që ne kemi shkëmbyer si njerëz e si kombe në gjithë këta shekuj bashkëjetese, na kanë bërë të këndojmë ngjashëm, të bëjmë dasma ngjashëm, të sillemi ngjashëm. Njerëz të thjeshtë, shqiptarë dhe serbë, janë dashuruar e kanë krijuar familje së bashku, e jetojnë të lumtur. Aq shumë kemi ndërshkëmbyerkulturalisht, sa shpeshherë ngremë tym sherrnajash edhe për legjendat dhe këngët” (Arian Galdini).

Nga repertori i mendësisë ballkanike

Studiuesi i ideve Naser Aliu, në një shkrim të tij “Tridhjetë tipare të ballkanasit” (Gazeta “Dita”, 9. 2. 2014), nga repertori i mendësisë ballkanike vinte në dukje ndër të tjera edhe disa tipare të ballkanasit që kanë të bëjnë me gjuhën e me kulturën:

“Ballkanasit nuk i pëlqejnë rregullat e drejtshkrimit, shenjat e pikësimit, gjuha letrare;

Ballkanasit nuk i pëlqen religjioni i fqinjit, mendimi kombëtar dhe arsimi i fqinjit;

Ballkanasit nuk i pëlqen gjuha e fqinjit, krenaria e fqinjit dhe sedra e tij;

Ballkanasi me këto tipare dhe bindje nga repertori i mendësisë ballkanike, është ballkanas profesional: i rritur dhe edukuar në frymën ballkanike dhe nëse shpërfillim aparaturën, makinerinë, makinat, avionët, kompjuterët, celularët dhe të arriturat tjera shkencore, atëherë ne ballkanasit mendërisht jemi shfaqje dhe dukuri e shekujve të kaluar, por me trup në shekullin e gabuar. Sikur të kishim shkencëtarë, që merren me historinë e ideve, atëherë çdo tipar, mund të varej në shekullin përkatës, por meqë nuk kemi, atëherë mund të supozohet se disa bindje të ballkanasave, kanë lindur në kohën romake, disa në kohën e Bizantit, disa të tjera gjatë perandorisë osmane dhe disa në epokën komuniste. Krejt këto së bashku kanë krijuar një mendësi, që përjashton kushtetutën dhe jetën moderne qytetare. Pra nuk jetohej jeta me ide të kohës, por duke u besuar bindjeve të lashta, që përpiqen t’ i lustrojnë me interpretime të reja. Kjo domethënë se ballkanasit nuk jetojnë jetën e vet bazuar në rregullat kushtetuese të kohës, por në shekullin XXI gjallojnë me bindjet e shekujve të kaluara dhe idetë e njerëzve, që nuk janë të pranishëm në kuvendet e tyre. Për shumë njerëz në Ballkan, respektimi i kushtetutës, që kanë aprovuar vetë, është turp dhe degjenerim. Kurse ajo që ballkanasit nuk i pëlqen gjuha e fqinjit, është degjenerim e shkuar degjenerimit.

Ballkanasit dhe kontestimi i standardit gjuhësor

Ballkani nuk do të ishte ky që është, pra Ballkan, në qoftë se nuk do të kishte kontestime për punë të gjuhës standarde edhe brenda të njëjtës etni. Në këtë rrafsh, kontestohet dhe formimi i shqipes standarde, pse u mor për bazë dialekti i toskërishtes e jo ai i gegërishtes, duke e ngatërruar këtë me çështjen ideologjike se standardi i shqipes na qenka produkt i diktaturës.

“Po të shfrytëzojmë në emër të demokracisë të drejtën për të përdorur gjithkush dialektin e vendlindjes së tij ose të saj, me fjalë të tjera, nëse ne du-


het të shfrytëzojmë demokracinë për të shkruar njëri shkodranisht e tjetri çamërisht, njëri dibranisht e tjetri korçarisht, njëri në dialektin gjakovar e njëri në dialektin e Tironës, lum kombi që na ka, se kështu do të fitojmë të drejtën t'i biem me kazmë kokës sonë, unitetit tonë, përparimit tonë!" (Kristo Frashëri, 2009).

“Trimëritë” dhe “e kaluara heroike” ballkanike

Në shumë shoqëri - për shembull në Ballkan - trimëria dhe vetësakrifica deri sot vazhdojnë të çmohen shumë lart. Shpesh atje flitet edhe për një “*të kaluar heroike*”. Por shpesh janë “*heronjtë e tryezave të kafeneve*”, që flasin me zë të lartë për heroiken. Ka shpesh njerëz, të cilët kurrë nuk do ta rrezikonin jetën e tyre, por që përpiqen t'i imponojnë gjithë shoqërisë ide e vlera arkaike. Dhe “*e kaluara heroike*”, së cilës ata i referohen, në shumë raste nuk është me të vërtetë heroike. Sepse heronjtë e një kombi janë shpesh xhelatët e popullit fqinj. Prandaj do të duhej që diskutimet për trimëritë dhe heroizmat të lihen në arkivat e historisë për t'ia lënë njeriut modern të drejtën që t'i marrë vetë vendimet dramatike për rrezikimin me vetëdije të jetës së tij. Çdo gjë tjetër është e vjetruar, e dalë nga koha. Dhe shpesh gjithsesi vetëm e shtirur dhe e gënjeshtërt. Në Bullgari “*Dita e Trimërisë*” është madje festë kombëtare – shprehet publicisti Aleksandër Andreev (*Perëndimi i heronjve*, (DW 22 Maj 2015; Gazeta “*Express*”, 22 Maj 2015). Për ta çmuar lart nocionin e “trimërisë”, po kështu dhe në Prishtinë, një lagje e madhe e këtij qyteti mban emrin “*Kodra e Trimave*” (të cilën e kishte pagëzuar kështu i pari veprimtari i njohur i çështjes kombëtare shqiptare Adem Demaçi, si shprehje e qëndresës dhe luftës së banorëve të kësaj lagjeje që kishin treguar kundër regjimit të Slobodan Milosheviç). Edhe në Kumanovë të Maqedonisë, një lagje e këtij qyteti pas një aksioni policor e ushtarak të qeverisë maqedonase kundër një *grupi të armatosur* të shqiptarëve nga Kosova (nga pala maqedonasi i quajtur *grup terrorist*), të ndodhur më 9 maj 2015, e ku mbetën të vrarë 10 veta të këtij grupi dhe 8 policë maqedonas, nga shqiptarët u quajt “*Lagjja e Trimave*”, kurse nga pala maqedonase “*Diva nasselba*” (*Lagjja e Egër*). Për këtë ngjarje në portale të ndryshme u shprehën cilësimet: “*Kuma-*

nova – djepi i trimërisë”, “Çerdhe e trimave dhe e djemve më të mirë të shqiptarisë”.

Pra, siç shprehet Aleksandër Andreev, **“Heroizmi” në Ballkan shpesh bëhet vetëm në kurriz të tjetrit.** Në Ballkan janë zhvilluar rreth 200 luftëra në emër të çështjeve të pazgjidhura nacionale, kurse në fakt ato kanë qenë luftëra për përfitime materiale.



Harta etnike e Maqedonisë

*Shqiptarët shumicë
Shqiptarët pakicë
Shqiptarë*

SFIDAT EURO-INTEGRUESE: NGA IRJM E DERI TE REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Fillimi i procesit të demokratizimit dhe pluralizmit politik në Maqedoni pas shkëputjes së saj nga ish-Federata Jugosllave në fillim të viteve të '90-ta të shekullit të kaluar, imponoi ndryshimin e prioriteteve edhe në politikën e jashtme. Rënia e bllokut socialist lindor dhe fuqizimi i bllokut perëndimor i udhëhequr nga vendet demokratike të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bëri që të gjitha shtetet ballkanike ta ndryshojnë kursin e tyre politik, duke u orientuar drejt vlerave perëndimore. Kështu, që në fillimet e veta si shtet kur filloi kontestimi i shtetësisë së saj nga ana e Greqisë, për shkak të emrit Maqedoni, kjo e fundit u fut në OKB dhe disa organizata tjera ndërkombëtare nën siglën IRJM (Ish-Republika Federale Jugosllave e Maqedonisë). Megjithatë, gjatë gjithë kësaj kohe gati se tridekadëshe, pra që nga IRJM-ja (kur me këtë emër hyri në OKB më 1993) e deri te Republika e Maqedonisë së Veriut (2019), shteti të cilin brenda e quanim Republika e Maqedonisë, (së paku formalisht) si prioritet kryesor në politikën e vetë të jashtme e pati integrimin euroatlantik. Ky orientim strategjik, në të gjitha dokumentet zyrtare të politikës së jashtme, theksohet si interes i lartë nacional i shtetit, i cili vlerësohet si jetik për stabilitetin afatgjatë, sigurinë dhe mirëqenien e vendit.

Anëtarësimi në NATO

Anëtarësimi i plotë në aleancën politiko-ushtarake më me ndikim në botë - NATO, ishte një prioritet themelor në politikën e jashtme të vendit tonë. Republika e Maqedonisë përcaktoi angazhimin e saj për integrimin në strukturat euroatlantike në vitin 1993, kur Kuvendi njëzëri miratoi

Rezolutën për Anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO dhe e riafirmoi atë qëndrim në vitin 2007. Si partner afatgjatë, Republika e Maqedonisë u dëshmuar si aleat i denjë i Aleancës, i gatshëm për të promovuar vlerat dhe përgjegjësitë e përbashkëta demokratike, thuhet veç tjerash në strategjinë e vendit për anëtarësim në NATO.¹⁷

Shikuar në mënyrë kronologjike, pas miratimit të rezolutës më 15 nëntor 1995, Republika e Maqedonisë nënshkroi Dokumentin Kornizë për Pranimin në Programin e Partneritetit për Paqe në selinë e NATO-s në Bruksel. Në të njëjtën kohë, Republika e Maqedonisë iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, më vonë me Këshillin Euro-Atlantik.

Që atëherë, Maqedonia ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet rajonale dhe multilaterale që janë me interes për shtetin dhe Aleancën e Atlantikut të Veriut. Ushtarë nga Maqedonia gjithashtu marrin pjesë në operacionet ushtarake ndërkombëtare në Bosnje, Irak dhe Afganistan, gjë që konfirmon gatishmërinë e ARM-së për të trajtuar të gjitha sfidat nën flamurin e NATO-s.

Përfaqësuesit e NATO-s në Maqedoni në vitin 2001 luajtën rol kyç në zgjidhjen e krizës ndëretnike të sigurisë. Atëbotë në Maqedoni mandati iu dha misionit për mbledhjen e armëve “Amber Fox”, e pastaj misionit “Harmonia Aleate” të NATO-s, e cila zgjati deri më 31 mars 2003.

Për integrimin më të shpejtë të Maqedonisë në strukturat e NATO-s, ambasadorët e misioneve të NATO-s në Maqedoni kanë dhënë kontribut të madh. Dëshira e tyre për anëtarësimin tonë të plotë në NATO, nuk ishte farsë, por qëllim i sigurt. “Është e vështirë për mua të imagjinoj Maqedoninë të mos jetë anëtare e ardhshme e NATO-s”, ishin fjalët e ish-ambasadorit të NATO-s në Maqedoni, Nikolas Beagmann, në forumin “Maqedonia në NATO”, mbajtur më 15-17 shtator 2003.

Republika e Maqedonisë me kohë i përmbushi kriteret politike dhe të mbrojtjes të kërkuara për një vend anëtar të NATO-s. Prandaj ishte i madh zhgënjimi që pasoi samitin e NATO-s në Bukuresht, më 2-4 prill 2008. Samiti ishte i njohur edhe si Samiti i Zgjerimit të Aleancës Euro-Atlantike, ku pritej të thirreshin të tre vendet nga i ashtuquajti Grupi i Adriatikut:

¹⁷ *Maqedonia dhe NATO*, www.mfa.gov.mk

Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia. Vetoja e vendosur nga Republika e Greqisë ishte pengesa kryesore për hyrjen e Maqedonisë në NATO së bashku me dy vendet e tjera të Ballkanit, Kroacinë dhe Shqipërinë. “Megjithatë, pavarësisht arritjeve të njohura qartësisht, angazhimit për vlerat dhe kontributet në aktivitetet operacionale të NATO-s, si dhe progresin në proceset reformuese që i bëri vendi, ftesa për Maqedoninë për anëtarësim në NATO mbeti prapa, me arsyetimin se ajo ftesë do të dërgohet nga Këshilli i Atlantikut të Veriut sapo të gjendet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht për kontestin rreth emrit.”¹⁸

Megjithatë, Republika e Maqedonisë vazhdoi në mënyrë të pandalshme përpjekjet për arritjen e këtyre qëllimeve strategjike. Kjo aspiratë erdhi vetëm pas ndryshimit të klasës politike maqedonase në pushtet. Me kalimin e partisë VMRO-DMNE të Nikolla Gruevskit në opozitë në vitin 2017, dhe me ardhjen në qeveri të LSDM-së nën udhëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev, u bë hapi i madh drejt zgjidhjes përfundimtare të kontestit shumëvjeçar rreth emrit ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Problemi u tejkalua me arritjen e Marrëveshjes së Prespës, më 17 qershor 2018, e cila hyri në fuqi më 12 shkurt 2019. Me këtë marrëveshje politike bilaterale, vendi ynë mori emrin e ri kushtetues “Maqedonia e Veriut”, që u njoh nga Greqia dhe rrjedhimisht u përshëndet edhe nga të gjitha vendet e familjes së madhe evropiane dhe SHBA-të. Pikërisht më 27 mars 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut u bë shteti i tridhjetë anëtar i Aleancës Veriatlantike, me çka u realizua një nga tri prioritetet kryesore strategjike të politikës së jashtme të vendit.

Në këtë vijë të përcaktimit të qartë strategjik europerëndimor, janë edhe shumica e sondazheve të opinionit publik në vend, të cilat tregojnë një shkallë të lartë besimi në integrimet euro-atlantike. Një zhgënjim në mesin e qytetarëve, kryesisht te popullata maqedonase, sipas rezultateve të sondazheve, bie në sy gjatë periudhës 1999 - 2001. Arsyet janë të thjeshta, për shkak të implikimit të drejtpërdrejtë të Aleancës së NATO-s për të zgjidhur krizën e luftës në Kosovë në vitin 1999, dhe atë në Republikën e Maqedonisë në vitin 2001. Në anën tjetër, sipas të njëjtave sondazhe, të bëra

¹⁸ Po aty

në të njëjtën periudhë nuk është vërejtur zhgënjim i popullsisë shqiptare, por përkundrazi ka pasur besim të vazhdueshëm të qytetarëve të bashkësisë etnike shqiptare në strukturat politike-ushtarake të NATO-s, madje duke shënuar rritje.

Përpjekjet për anëtarësim në Bashkimin Evropian

Menjëherë pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë (1991), filloi procesi i përgatitjes për integrimin evropian. E para përpjekje u regjistrua në vitin 1992, nëpërmjet emërimit të një përfaqësuesi diplomatik në Bruksel në nivelin e Misionit. Zyrtarisht, marrëdhëniet diplomatike midis Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian u krijuan në vitin 1995, kur Misioni u ngrit në nivel ambasadorësh. Jovan Tegovski u emërua si ambasador i jashtëzakonshëm dhe i plotfuqishëm.¹⁹

Në periudhën e ardhshme, në një pikëpamje të politikës së jashtme, Maqedonia ishte e orientuar drejt krijimit të bashkëpunimit institucional me BE-në. Në vitin 1997, në Luksemburg u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Marrëveshja e Transportit me shtetet anëtare të BE-së. Dialogu politik midis BE-së dhe Republikës së Maqedonisë filloi në vitin 1998, kur Komisioni Evropian (KE) hapi një përfaqësi, përkatësisht Zyrë, dhe e caktoi përfaqësuesin e saj të parë në Republikën e Maqedonisë, Hoze M. Pinto Tesheira (1998-2002). Zyra, e cila në vitin 2000 u ngrit në nivel Delegacioni, kontribuoi shumë në marrëdhëniet politike dhe ekonomike midis BE-së dhe Republikës së Maqedonisë. Fryti i këtij aktiviteti ishte Raporti mbi mundësitë e fillimit të negociatave mbi Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit të miratuar nga KE.²⁰

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komunitetit Evropian dhe vendeve të tyre anëtare ishte hapi tjetër drejt integritit tonë në BE. Ajo u iniciua në vitin 2000 në margjinat e Samitit të

¹⁹ Документи за Република Македонија 1990-2005 (Dokumente për Republikën e Maqedonisë 1990-2005), книга III, УКИМ - Правен факултет, Скопје, 2008, док. 204, 594-595.

²⁰ Љубица Јанчева, Македонија и Полска во европските интегративни процеси ('Maqedonia dhe Polonia në proceset evropiane integruese'), ИНИ, Скопје, 2009, 128.

BE-së për Ballkanin Perëndimor, mbajtur në Zagreb,²¹ e nënshkruar në vitin 2001,²² dhe hyri në fuqi në prill 2004. Kjo Marrëveshje është në fakt kuadri ligjor bazë për bashkëpunimin dypalësh me BE-në, deri në pranimin në BE. Në këtë drejtim ishte përfshirja e Maqedonisë në programin KARDS, me të cilin Komisioni Evropian financiarisht mbështet Maqedoninë në përpjekjet e saj për integrimin evropian.²³

Për të ruajtur paqen në vend, u angazhua misioni ushtarak i BE-së – Konkordia, i cili mori përsipër misionin e NATO-s nga marsi deri në dhjetor 2003, e ndjekur nga misioni policor i EUPOL ‘Proxima’, me qëllim të konsolidimit dhe reformimit të policisë.²⁴ Për konsolidimin e vendit pas krizës ushtarake të vitit 2001 dhe për lehtësimin e procesit politik për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të vitit 2001, Këshilli i Evropës filloi të emërojë Përfaqësues Special të BE-së në Republikën e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë më 22 mars 2004 e paraqiti kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian, pas Deklaratës së miratuar më parë për parashtrim për anëtarësim në BE nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë.²⁵ Këshilli Evropian, në lidhje me këtë kërkesë, e angazhoi Komisionin të përgatisë Mendim. Baza për përgatitje ishin përgjigjet e Pyetësorit të KE-së lidhur me Kërkesën, e cila personalisht u soll në Maqedoni nga Presidenti i Komisionit, Romano Prodi.²⁶ Në bazë të përgjigjeve nga pyetësi, të cilat janë përgatitur dhe dorëzuar në shkurt të vitit 2005, Komisioni Evropian përgatiti Mendimin dhe ia përcolli Këshillit në nëntor 2005. Një analizë e detajuar u bë në të, bazuar në kriteret e sipërpërmendura të Kopenhagës dhe Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor.²⁷

²¹ www.sep.gov.mk .

²² *Dokumente për Republikën e Maqedonisë...*, po aty, dok. 210, 621-684.

²³ Sipas Programit vjetor Nacional KARDS për Maqedoninë në vitin 2003, qe planifikuar ndihmë financiare prej 38,3 milionë eurosh, kurse 47,5 milionë euro për vitin 2004. Lubica Jançeva, *Maqedonia dhe Polonia...*, 129.

²⁴ PROXIMA kishte mandat deri më 2005. www.mfa.gov.mk.

²⁵ *Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.7/2004.*

²⁶ Љ.Јанчева, *Македонија и Полска...*,130.

²⁷ Në agjendën e miratuar më 2003 është theksuar: *Tempoja e afrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor kah BE-ja është në duart e tyre dhe do të varet nga sjellja e secilit vend në zbatimin e reformave, duke respektuar kriteret e vendosura nga Këshilli i Evropës në Kopenhagë në vitin 1993.* www.sep.gov.mk .

Komisioni në Mendimin e tij vuri në dukje se: “Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një demokraci funksionale me institucione të qëndrueshme që garantojnë të drejtën dhe respektin për të drejtat themelore... Vendi nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në vitin 2001 dhe që atëherë ka përmbushur detyrimet në lidhje me të në mënyrë të kënaqshme... Komisioni rekomandon që Këshilli t'i japë statusin e një vendi kandidat Republikës së Maqedonisë...”²⁸ Këshilli Evropian në dhjetor 2005, duke marrë parasysh sugjerimet e Komisionit, vendosi t'i japë Maqedonisë statusin e një vendi kandidat për anëtarësim në BE. Statusi është në të vërtetë një njohje politike e marrëdhënieve midis BE-së dhe Republikës së Maqedonisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit.

Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian në shkurt të vitit 2008 miratoi Partneritetin e Anëtarësimit të vendit, i cili përfshin përparësitë kryesore të vendit për reformën. Në tetor 2009, Komisioni Evropian i rekomandoi Këshillit të fillonte negociatat me vendin, si dhe të kalonte në fazën e dytë të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.²⁹

Çdo vit, Komisioni Evropian analizon arritjet e kandidatëve individualë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Deri më tani, Republika e Maqedonisë ka kryer një numër të madh të detyrave në agjendën evropiane, por për një kohë të gjatë, pengesa kryesore ishte mosmarrëveshja për emrin, e imponuar nga Greqia. Së fundit, problemi i ri ka lindur edhe me Bullgarinë fqinje, anëtare e BE-së, për shkak të mosmarrëveshjeve për çështje të caktuara identitare dhe historike.

Më 19 dhjetor 2009, Maqedonia, së bashku me Malin e Zi dhe Serbinë morën liberalizimin e vizave, gjë që nënkuptonte një hap të madh në hapjen e dyerve të Evropës për qytetarët në këtë rajon pas 20 vjet izolimi.³⁰ Deri te

²⁸ Mendimi i Komisionit për kërkesën e Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. www.mfa.gov.mk.

²⁹ Komisioni Evropian, *Raporti i përparimit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2010*, Bruksel, 09.11.2010, 3, www.sep.gov.mk

³⁰ Qytetarët e Republikës së Maqedonisë pa viza (me pasaporta biometrike) për një qëndrim të shkurtër mund të udhëtojnë në 25 vende të Bashkimit Evropian: Austri, Belgjikë, Bullgari, Gjermani, Greqi, Danimarkë, Estoni, Itali, Qipro, Lituani, Letoni, Luksemburg, Maltë, Poloni, Portugali, Rumania, Slloveni, Sllovaki, Hungari, Finlandë, Francë, Holandë, Çeki, Suedi, Spanjë, dhe tre vende joanëtare të BE-së që janë pjesë e Schengen-zonës: Islandë, Norvegji dhe Zvicër.

liberalizimi i vizave erdhi pas përmbushjes së kriterëve të vendit në pjesën e masave juridike e të sigurisë, të kërkuara nga ana e BE-së. Shije të keqe këtij procesi i dha ikja jashtë shtetit e shumë qytetarëve të pjesës veriperëndimore të Maqedonisë, kryesisht shqiptarë, të cilët liberalizimin e (keq)përdorën për ikje nga vendi dhe kërkim azili në vendet evropiane. Destinacioni dominant i shumicës së azilkërkuesve ishte Belgjika, por edhe Franca, Gjermania, Austria, Norvegjia, Suedia, etj.

Konsensusi nacional për kursin euro-atlantik

Integrimi euroatlantik i Republikës së Maqedonisë nuk është i mundur pa realizimin e një konsensusi të gjerë midis të gjitha partive politike, të majta, të djathta, të pozitës, të opozitës, të maqedonasve, të shqiptarëve apo të komuniteteve të tjera etnike. Ish – ministri i jashtëm, Sërgjan Kerim, vite më parë do të konstatonte me të drejtë se: “Konsensusi i parë politik, i arritur mes të gjitha partive dhe gjithashtu midis përfaqësuesve të grupeve etnike në Maqedoni, është bindja se Maqedonia do të jetë pjesë e fortë përbërëse e Evropës, dhe për rrjedhojë e Bashkimit Evropian. Së bashku me konsensusin e partive politike mbi anëtarësimin në NATO dhe politikën e përbashkët për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal të bazuar në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, këto janë tri shtyllat e politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë: anëtarësimi në BE, anëtarësimi në NATO, dhe bashkëpunimi rajonal i bazuar në marrëdhënie të mira fqinjësore. Pikërisht prej tyre vendoset përcaktimi strategjik i politikës së Republikës së Maqedonisë.”³¹

Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Veriut në Bashkimin Evropian është interes i përbashkët i të gjithë qytetarëve dhe ky proces do të hapte perspektiva të reja për vendin. Ky përcaktim strategjik është vullneti i shumicës së faktorëve politikë vendimmarrës, por fatkeqësisht ende ka forca politike sidomos në kampin maqedonas, të cilat kanë rezervat e tyre në këtë drejtim. Por, është për t’u theksuar vullneti politik i të gjitha subjekteve politike shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si gjithmonë dhe

³¹ Сргјан Керим, *Мостови кон иднината* (*‘Ura drejt së ardhmes’*), Матица Македонска, Скопје, 2005, 136.

tani, është shumë i qartë në drejtim të mbështetjes së kursit europerëndimor të vendit. Zaten, forcat politike shqiptare e patën rolin vendimtar në ndryshimin e klasës politike maqedonase në vitin 2017, dhe ardhjen e forcave që mbështesin integrimet euroatlantike.

Në të vërtetë, pas arritjes së Marrëveshjes së Prespës dhe ndryshimin e emrit të vendit nga IRJM (1993) në Republika e Maqedonisë në Veriut (2019), u hapën shtigje të reja edhe për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian. Maqedonia e Veriut bashkë me Shqipërinë, më 19 korrik 2022, me konferencën e parë ndërqeveritare në selinë e BE-së në Bruksel, hapën zyrtarisht negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Hapja e bisedimeve për Shkupin dhe Tiranën vjen pasi më 16 korrik, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miratoi një propozim francez që mundësoi heqjen e vetos së Bullgarisë për nisjen e bisedimeve me Shkupin. Megjithatë, hapja e bisedimeve në Bruksel është “simbolike”, pasi bisedimet reale apo ato për kapitujt e BE-së do të nisin vetëm pasi Maqedonia e Veriut të ndryshojë Kushtetutën e saj për përfshirjen në të të bullgarëve, si të barabartë me popujt e tjerë³².

Në të vërtetë, pengesa e radhës që vjen nga Bullgaria për Maqedoninë e Veriut, duket se nuk është aq e thjeshtë sa duket në horizont. Një sërë çështjesh të diskutueshme që kanë të bëjnë me identitetin nacional dhe historinë e maqedonasve, janë tema për të cilat çdo ditë flitet në të dyja vendet. Për tejkalimin e këtyre dallimeve është ngritur edhe një komisionin i ekspertëve të historisë të cilët me vështirësi po i tejkalojnë dallimet. Bullgaria ka shtuar presionin në forma të ndryshme duke kontestuar figura qendrore të historisë së maqedonasve, siç është Goce Dellçevi dhe të ngjashëm. Bullgaria ka filluar të hapë nëpër disa qendra të Maqedonisë së Veriut, si në Manastir e Ohër, qendra kulturore me emra të kontestuar të historisë, të cilët nxisin reagime të ashpra të masës dhe klasës politike maqedonase në vend. Nëse së shpejti nuk do të ketë një marrëveshje konkrete mes të dyja vendeve, kriza rrezikon të thellohet dhe integrimi i Maqedonisë së Veriut në BE mund të jetë një proces i gjatë dhe i lodhshëm.

³² Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria hapin zyrtarisht negociatat për anëtarësim në BE, <https://www.evropaelire.org>, Qasur më 20 shtator 2022

Megjithëkëtë, asgjë nuk guxon ta zbrapsë Maqedoninë e Veriut nga rruga e drejtë për bashkim në familjen e madhe evropiane. Kjo rrugë bëhet edhe më e nevojshme në kohën kur zhvillohet agresioni rus në Ukrainë, dhe vlerat europerëndimore vihen përpara një testi të rëndë. Prandaj, prioritet mbi prioritete të cilësdo përbërje qeveritare të vendit tonë, duhet të jetë hyrja nën ombrellën e Bashkimit Evropian. Për këto prioritete të larta të vendit, duhet aktivisht të punojnë të gjitha institucionet kompetente të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga Presidenti, Qeveria, Kuvendi, MPJ-ja, subjektet politike, ashtu si edhe organizatat joqeveritare dhe të gjithë qytetarët pa përjashtim. Konsensusi nacional për këto pika duhet të jetë qëllimi kryesor, në të gjitha fushat e sjelljes sonë të përditshme: politikë, ekonomi, shkencë, kulturë, sport. Vetëm në këtë mënyrë, Republika e Maqedonisë së Veriut mund të jetë e sigurt dhe me perspektivë nga qytetarët, nga fqinjët dhe nga faktori ndërkombëtar dhe të sigurojë mbijetesë historike e jetëgjatë si shtet evropian në Gadishullin Ballkanik.

INTEGRIMI I RAJONIT DHE ROLI I SHQIPTARËVE KUNDREJT PËRPLASJES SË INTERESAVE TË FUQIVE TË MËDHA NË BALLKAN

Abstrakt

Rëndësia gjeostrategjike e BE-së në aspektin global dhe vetë qëllimi i ekzistencës së saj është ngritur mbi vlera dhe parime të demokracisë dhe vlerave të botës perendimore kristijane. Është një projekt ekonomik por edhe politik dhe gjeostrategjik që vendon barazpeshë globale mes ShBA, Federatës Ruse dhe Kinës dhe sferave të ndikimit. Shqiptarët si në republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës, në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi kanë qenë dhe janë njëzëri në frymën e integritimeve evropjane dhe antarësimit në aleancën Euroatlantike. Dyshimet se rajoni që historikisht ka qenë shkaku dhe shkëndija e konflikteve dhe luftërave botërore mund të rrezikoj paqën përmbrënda BE-së. Procesi i integritimit gërshetohet me përplasjen e interesave të fuqive botërore. Përmbyllja e çështjes shqiptare dhe një marrëveshje historike me shqiptarët do të paraqesë një garancë edhe për stabilitetin e BE në përgjithësi. Shqiptarët përfundimisht janë pozicionuar në anën e vlerave perendimore. Evropa që do të bëjë lëshime rrezikon të mbartë një vullkan të shuar përkohsisht i cili mund ta rrezikojë vetë atë në një të ardhme të afërme. Vija e kuqe ku pansllavizmi dhe perendimpor edhe neo-otomanizmi ndeshen mund të dëmtojë vizionin e Evropës së Bashkuar.

Studimi do elaborojë edhe vlersimet e BE për shtetet e Ballkanit perendimor si dhe përplasjen e interesave ruse, me ato eurperendimore dhe pozicionimin Turk në Ballkanin perendimor. Si dhe do të jap një pasqyrë duke u bazuar në bibliografi ndërkombëtare lidhur me proceset e eurointegritimeve dhe

implikimet ruse, turke dhe të tjera në këtë situatë, duke krahasuar atëshitetet e Evropës Jugperendimorë.



Ndikimi politik përmes investimeve kapitale në rajon

Ballkani mbetet sferë interesi për shumë fuqi botërore të cilat i kthehen atij në mënyra të ndryshme qoftë përmes kthimit të trashëgimisë kulturore, qoftë përmes lidhjeve shpirtërore dhe fetare qoftë përmes intereseve ekonomike. Duke qenë një destinacion i synuar për një jetë më të mirë Bashkimi Evropian ka mbështetur shtetet në Ballkanin Perëndimor në rrugët e tyre përkatëse të integrimit, dhe Këshilli Evropian kishte ripohuar mbështetjen e tij më 9 mars 2017.³³ KE kishte miratuar Komunikatën "Një perspektivë e besueshme zgjerimi për dhe angazhimi të BE-së me Ballkanin Perëndimor," duke konfirmuar të ardhmen evropiane të rajonit si një investim gjeostrategjik në një Evropë stabile, e fortë dhe e bashkuar e bazuar në vlerat e përbashkëta.³⁴

Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit mbështet Ballkanin Perëndimor në përgatitjen e tyre për anëtarësimin në BE dhe lehtëson bashkëpunimin rajonal dhe ndërkuftar. Komisioni propozoi për Kornizën e ardhshme Financiare Shumëvjeçare për periudhën 2021-2027 një rritje e fondeve për Ballkanin Perëndimor në mbështetje të reformave në funksion të anëtarësimit në BE. Nga viti 2007 deri 2017 janë 8.9 miliard euro, për vitin 2018 ishin planifikuar 1.07 miliardë euro kurse deri me 2021, 1.84 miliardë euro. Prej të hyrave, investime direkte të jashtme në Ballkanin perëndimor gjatë 2007-2015, 72.5% janë nga BE-ja , 4.6% nga Rusia, 3.7% Zvicra, Norvegjia 3.0%, Turqia 2.0%, Kanadaja 1.4%, ShBA-të 1.1 %, Kina 0.1%. Nga kjo mbase mund të konkludojmë se tendenca dhe interesi gjeostrategjik i BE-së është shumë më i madh për Ballkanin Perëndimor.³⁵

³³ European Council, [https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/european-council/2017/03/09-10/\(15.05.2021\)](https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/european-council/2017/03/09-10/(15.05.2021))

³⁴ European Commission, https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/economic-relations_en.pdf (16.05.2021)

Ndikimi i Ruisë në Ballkanin Perëndimor

Vendet në Ballkanin Perëndimor janë tradicionalisht një fokus i intereseve ruse. Federata Ruse ka lidhje të forta historike me Ballkanin Perëndimor dhe ka një tërheqje relative të fuqisë së butë për ta, por megjithatë të saj ndikimi dhe ndikimi ekonomik në rajon janë në rënie, investimet dhe ndihmat nga BE-27 dhe lojtarë të tjerë, të tilla si Kina, kanë ulur investimet ruse.³⁶ Ballkani Perëndimor, së bashku me fqinjësinë evropiane, janë shfaqur si një ring konfrontimi gjeopolitik me Perëndimin. Studiuesi Brzezinski beson se dështimi i Amerikës për t'u angazhuar me Ruisë pas fundit të Luftës së Ftohtë ka dështuar, duke i dhënë Ruisë energjinë për t'u fokusuar në sigurimin e sundimit të saj autoritar brenda territorit të vet dhe rikthimin e ndikimit të saj në shtetet e ish-Bashkimit Sovjetik dhe më gjerë.³⁷

Zhënjimi shkaku i progresit të ngadalshëm drejt anëtarësimit në BE dhe stagnimi ekonomik po krijojnë një hapje për lojtarë të tjerë gjeopolitikë. Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë ende në rrugën e duhur për t'u anëtarësuar në BE. Tensionet e ndezura etnike, papunësia e lartë, eksodi i rinisë dhe rregullimet e lëkundshme kushtetuese krijojnë një mundësi për Ruisë që të përdorë ndikimin e saj në rajon.³⁸ Lidhjet kulturore dhe historike i japin Ruisë një fuqi të konsiderueshme të butë, veçanërisht midis serbëve,³⁹ por edhe maqedonasve opozitarë që drejtpërdrejt ndërlidhet me interesat e shqiptarëve në përgjithësi drejt integritimit.

Megjithëse investimet ruse në rajon janë rritur në terma absolutë, gjurma ekonomike e Ruisë si një pjesë e ekonomisë totale në Ballkanin

³⁵ European Commission, *ibid.*

³⁶ European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA\(2022\)733523_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA(2022)733523_EN.pdf) (17.05.2021)

³⁷ *Ibid.*

³⁸ *Ibid.*

³⁹ Lidhjet historike shkojnë si që nga lëvizja pansllave e shekullit të 19-të dhe mbështetja e Ruisë për pavarësinë serbe nga Perandoria osmane. Rusia hyri në Luftën e Parë Botërore në anën e Serbisë; në konfliktin e Kosovës*, ajo dënoi Bombardimin e Serbisë nga NATO dhe kundërshtoi me vendosmëri pavarësinë e Kosovës. Rusia përdor statusin e saj si Anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së në favor të Serbisë. Në 1994 dhe 2015, Moska vuri veton ndaj dy rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që dënonin dhunën e serbëve të Bosnjës, rezoluta e fundit ajo që kualifikon masakrën e vitit 1995 në Srebrenicë si gjenocid.

Perëndimor është tkurrur ose stagnuar në vazhden e sanksioneve ndërkombëtarëve për aneksimin e Krimesë nga Rusia. Edhe pse ndikimi ekonomik rus është i madh dhe i përqendruar në sektorin e energjisë, pesha e saj si përqindje e PBB-së është në rënie në të gjithë rajonin. Ndikimi energjetik Ruisë është më i madh në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe BiH, ku furnizon afër 100% të gazit. Ka nevojë dhe zotëron disa asete, si rrjeti i pikave të benzinës Lukoil. Rrjedha e Jugut e Gazpromit rus tubacioni do të kishte konsoliduar dominimin e Moskës në tregjet e gazit, por ai u braktis në dhjetor 2014 pasi Komisioni Evropian vendosi se ishte në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.⁴⁰

Nga ana tjetër, Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria aktualisht konsumojnë pak ose aspak gaz rus dhe të ardhmen Furnizimet ka të ngjarë të vijnë nga Azerbajxhani dhe jo nga fushat ruse, nëpërmjet Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP). Malit të Zi ndoshta do t'i duhet të presë disa vite përpara se të bëhet tubacioni lidhës Jon-Adriatik (IAP). Megjithatë, ekspertët paralajmërojnë se prania kryesore e Ruisë në sektorët strategjikë po i bën qeveritë e rajonit të prekshme ndaj presionit të saj dhe po thekson rrezikun e kapjes së shtetit.

Përtej medias, Kremli përdor Kishën Ortodokse Ruse si një mjet ndikimi në vendet me popullsi të konsiderueshme ortodokse. Moska përdor narrativën e vëllazërisë sllave dhe të krishterimit ortodoks të përbashkët për të forcuar marrëdhëniet e saj me udhëheqësit politikë, kishat dhe grupet e pavarura në Bosnje, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi.⁴¹

Patriarku Kirill shprehu shqetësimin e tij edhe për shkeljet e të drejtave të popullatës serbe në Kosovë. "Serbët duhet të jetojnë lirisht në Kosovë dhe Metohi. Askush nuk duhet t'i kërcënojë, askush nuk ka të drejtë t'u shkatërrojë monumentet, tempujt dhe manastiret e tyre. Askush nuk mund të pengojë lëvizjen e tyre dhe aftësinë e tyre për të qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me familjet e tyre", theksoi kleriku.⁴²

⁴⁰ European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA\(2022\)733523_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA(2022)733523_EN.pdf) (18.05.2021)

⁴¹ Carnegie Edowment for International Peace, <https://carnegieendowment.org/2019/02/06/russia-s-game-in-balkans-pub-78235> (21.05.2021)

⁴² Investgate Russia, <https://investgaterussia.org/media/2018-03-26/russia-connection-runs-through-greece> (30.05.2021)

Vendet e Ballkanit Perëndimor po përballen gjithashtu me 'sulmin asimetrik' ndaj demokracisë, të nisur nga mediat ruse media, si agjencia e lajmeve Sputnik, e cila ngriti një bazë në Beograd në 2014. Pavarësisht nga epoka sovjetike Fushatat e dezinformimit dhe përpjekjet diplomatike, shumica e popullsisë së Ballkanit Perëndimor i mbështet Pranimi në BE dhe politikat properëndimore. Në të kaluarën, opinioni publik serb ishte përkrahës i lidhjeve më të ngushta me të Rusi: një sondazh i kryer në mesin e vitit 2016 nga revista NSPM tregoi se 72% ishin në favor të një aleance me Rusinë, krahasuar me vetëm 8% për NATO-n. Megjithatë, një sondazh i shkurtit 2022 arriti në përfundimin se gjysma e serbëve duan të qëndrojnë neutralë kur përballen me një zgjedhje midis BE-së dhe Rusisë. Ky rreshtim i politikës së jashtme u bë shumë e dukshme në shkurt 2022, kur Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut u bashkuan me BE-në sanksione kundër Rusisë, ndërsa Mali i Zi njoftoi se do t'i miratonte ato në prill.⁴³

Kremlini premton të mbështesë çdo zgjidhje të pranueshme për Serbinë; nga ana tjetër, ajo përcakton se çdo marrëveshje me Kosovën duhet të bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila vendosi praninë e OKB-së në zonë. Rezoluta 1244 nuk përmend kurrë pavarësinë e Kosovës. Sipas Kremlinit, njohja e Kosovës është aq e dëmshme për interesat kombëtare të Serbisë, sa që vendi nuk duhet ta pranojë kurrë.⁴⁴

Përtej tubacioneve, kompanitë ruse kanë pasur më shumë fat duke depërtuar në tregjet e energjisë me projekte më pak ambicioze në Bosnjë dhe Hercegovinë (në tekstin e mëtejme Bosnjë), Bullgari, Rumani dhe Serbi, ku firmat ruse kanë fituar aksione ose kontrollin e prodhimit të energjisë elektrike, projekteve të energjisë bërthamore, rafinerive., dhe shitjet e benzinës.⁴⁵

Nëpërmjet investimit të tij në NIS, Gazprom Neft fitoi asete diku tjetër në rajon, duke përfshirë ndërmarrjet ndihmëse—pompat e benzinës,

⁴³ European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA\(2022\)733523_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA(2022)733523_EN.pdf) (05.06.2021)

⁴⁴ Carnegie Edowment for International Peace, <https://carnegiemoscow.org/2019/11/26/spoiler-in-balkans-russia-and-final-resolution-of-kosovo-conflict-pub-80429> (09.06.2021)

⁴⁵ Paul Stronski & Annie Himes, Russia's game in the Balkans, <https://carnegieendowment.org/2019/02/06/russia-s-game-in-balkans-pub-78235> (20.06.2021)

objektet e magazinimit, të drejtat e shpimit dhe eksplorimit dhe zyrat përfaqësuese—në Bosnje, Bullgari, Kroaci, Hungari dhe Rumani. Këto objekte u japin subjekteve tregtare ruse një prani të dukshme në të gjithë rajonin më të gjerë dhe krijojnë afinitete në komunitetet provinciale ku subjektet ruse zotërojnë - drejtpërdrejt ose tërthorazi - aksione në punëdhënës të rëndësishëm lokalë.⁴⁶

Lidhja midis trollëve ballkanikë dhe rusë mbetet e paqartë, por lidhja e krimit kibernetik (veçanërisht e keqe në Shqipëri, Bullgari dhe Serbi, përveç Maqedonisë) dhe të rinjtë teknikisht të zgjuar me perspektiva të kufizuara pune i ofrojnë Rusisë rrugë të mundshme ndikimi në fushën dixhitale.

Së fundi, Evropa Juglindore mbetet e ndjeshme ndaj sulmeve kibernetike si nga aktorët shtetërorë ashtu edhe nga ata joshetërorë, veçanërisht në pikat kyçe të kthesës në evolucionin politik të një vendi: zgjedhjet, referendimet politike dhe vendimet kombëtare për të kërkuar anëtarësim në organizata shumëpalëshe. Kosova ishte një viktimitë e hershme e sulmeve kibernetike në shkallë të gjerë gjatë luftës së viteve 1998–1999; Mediat kosovare pohojnë se institucionet politike të vendit sot mbeten viktima të shpeshta të sulmeve kibernetike. Sulmet kibernetike ndaj Malit të Zi ndodhën së bashku me një fushatë të fuqishme propagande anti-NATO të drejtuar nga Rusia.

Këto incidente nxjerrin në pah rëndësinë e aftësive kibernetike dhe dezinformimit në paketën e mjeteve të Rusisë. Me një shkëmbim të mundshëm toke që diskutohet nga Kosova dhe Serbia dhe anëtarësimi në NATO përsëri në horizont për Republikën e sapo riemërtuar të Maqedonisë së Veriut, aktorët keqdashës mund të përdorin mjete të ngjashme kibernetike dhe dezinformata për t'i penguar këto procese.⁴⁷

⁴⁶ Paul Stronski & Annie Himes, Russia's game in the Balkans, <https://carnegieendowment.org/2019/02/06/russia-s-game-in-balkans-pub-78235> (21.06.2021)

⁴⁷ Për t'iu afruar përgjigjes, HuffPost intervistoi Hysen Alimin, një freelancer i ri shqiptar i IT-së. Alimi krijoi të paktën shtatë faqe interneti në Shqipëri duke filluar nga marsi 2016, sipas regjistrimeve të domenit publik. Faqet, të cilat funksionuan gjatë zgjedhjeve presidenciale të Demokratëve dhe zgjedhjeve presidenciale në SHBA, nxorën një pamje të favorshme të senatorit Bernie Sanders (I-Vt.) ndërsa sulmonin ish-Sekretaren e Shtetit Hillary Clinton me histori të rreme. Mattes nuk është i bindur. "Si i vendosi ai faqet nëse mezi lexon anglisht?" ai pyeti. "Si e dinte se çfarë të kopjonte çdo ditë? Dhe kush e ushqente atë me kopje?" Alimi tha se nuk ka asnjë lidhje me Rusinë.

Turqia dhe ndikimi i saj në Ballkanin perëndimor

Edhe pse ajo është kontestuar që në fillim nga kundërshtarët e zëshëm të neootomanizmit – kryesisht të krishterët – Turqia po adhurohet njëkohësisht nga shumica e muslimanëve, të cilët e konsiderojnë kohën osmane si një epokë të artë. Duke ushqyer marrëdhënie të veçanta në zonat me shumicë muslimane të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Sanxhakut, Turqia ka penguar ndikimin e saj me komunitetet jomuslimane atje. Duke e përshkruar veten si një "mbrojtëse" e muslimanëve që është gati të përmbushë një rol udhëheqës dhe të vendosë vlerat osmane në qendër të ndikimit të saj politik, Turqia nuk ka qenë në gjendje të bindë publikun e Ballkanit Perëndimor për qasjen e saj universale ndaj rajonit dhe as paanshmërinë e saj. Për më tepër, retorika e pakujdesshme e diplomacisë publike të Turqisë shpesh ka thelluar ndarjet e gjata midis grupeve të ndryshme etnike në Ballkanin perëndimor.⁴⁸

Një problem me këtë ishte llogaritja e gabuar e Turqisë për rajonin, historinë e saj dhe banorët e saj. Shumica e serbëve dhe kroatëve – të dy të krishterë – si dhe pjesë me ndikim të inteligjencës shqiptare konsiderojnë sundimin osman si një periudhë skllavërimi dhe një tragjedi që zgjati për më shumë se katër shekuj.⁴⁹

Arsimi në gjuhën amëtare ishte një ndër shtyllat ku do mbështeteshte ngritja e kombeve përderisa "shqiptarët nuk lejoheshin të përdornin gjuhën e tyre dhe politika osmane i lejonte muslimanët shqiptarë të ndiqnin vetëm shkollat turke,"⁵⁰ popujt e tjerë kishin universitete kur shqiptarët do mbanin Kongresin e alfabetit në Manastir më 1908. Historia duhet të shqyrtohet vazhdimisht dhe të hulumtohen fakte dhe argumente të reja. Në studim koncentrimi është sidomos në periudhën e re të integritimeve evropjane dhe roli i Turqisë në ekonominë e shteteve të Ballkanit perëndimor është i theksuar.

⁴⁸ Vračić, Alida, SWP Research Paper No. RP 11/2016, Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), Berlin 2016 <https://www.econstor.eu/handle/10419/253173> (02.09.2021)

⁴⁹ Think tank Populari, A Political Romance (see note 14), <https://populari.org/en/home/> (25.09.2021)

⁵⁰ Piro Misha, "Invention of a Nationalism: Myth and Amnesia", in *Albanian Identities: Myth and History*, ed. Stephanie SchwandnerSievers and Bernd J. Fischer (London: Hurst, 2002), 33–48 (38).

Investimet e përgjithshme të Turqisë jashtë vendit u rritën nga 160 milionë euro në 2002 në 1.35 miliardë euro në vitin 2011, duke i bërë investimet e saj në Ballkan 10 për qind të totalit të IHD-ve të saj në 2011.⁵¹Përrjashtim i vetëm nga kjo është Kosova, e cila në vitin 2015 e shtyu Turqinë në vendin e dytë në listën e 10 investitorëve më të mirë, duke investuar 54.1 milionë euro.⁵²Të dhënat e Turqisë arritën nivelin më të lartë të të gjitha kohërave prej 45,762 milionë euro në qershor 2013 dhe një rekord të ulët prej -47,306 milionë euro në dhjetor 2021.⁵³

Fluksi i investimeve të Investimeve të Huaja Direkte (IHD-ve) të Turqisë në vendet e Ballkanit ka qenë relativisht i larmishëm. Vetëm në vitin 2007, Shqipëria mori 42.2 për qind të totalit të IHD-ve të jashtme nga Turqia. Kjo mund t'i atribuohet pjesëmarrjes së huaj në privatizimin e pjesshëm të kompanisë publike të telekomunikacionit të Shqipërisë ALBtelecom, e cila u ble nga një konsorcium turk në vitin 2007.⁵⁴Të dhënat arritën nivelin më të lartë të të gjitha kohërave prej 752.990 euro milionë euro në mars 2022 dhe një rekord të ulët prej 381.170 euro milionë euro në qershor 2014.⁵⁵ Shpërndarja e investimeve në të gjithë rajonin është mjaft e pabarabartë, por është në përputhje me politikën e Davutoglu për të krijuar marrëdhënie të ngushta me Bosnjën, IRJM-në, Kosovën dhe Shqipërinë.⁵⁶

Qendrat Kulturore Turke Yunus Emre kanë zyra në Shqipëri, BeH, Kosovë, Maqedoni dhe Rumani. Këto qendra kanë qenë aktive në përhapjen e mësimin të gjuhës turke në shkollat publike. Marrëdhëniet ushtarake midis Turqisë dhe Shqipërisë filluan në fillim të viteve 1990. Një pakt bashkëpunimi për mbrojtjen u nënshkrua midis dy vendeve në 1992 në Ankara, Tur-

⁵¹ United Nations Conference on Trade and Development, Investment Country Profiles: Turkey, UNCTAD/WEB/DIAE/IA/2012/6

⁵² Kosovo Investment and Enterprise Support Agency, Ministry of Trade and Industry of the Republic of Kosovo, <http://invest-ks.org/en/foreign-direct-investments-in-kosovo> (07.08.2021).

⁵³ CEIC, <https://www.ceicdata.com/en/kosovo/bpm6-foreign-direct-investment-by-country/fdi-turkey> (10.08.2021)

⁵⁴ Mustafa Çakir, "An Economic Analysis of the Relationship between Turkey and the Balkan Countries", Adam Akademi 4, no. 2 (2014): 77–86.

⁵⁵ CEIC, <https://www.ceicdata.com/en/albania/bpm6-foreign-direct-investment-by-country/fdi-stock-turkey>

⁵⁶ Sait Akşit, *An Alternative or Embedded in the Mainstream: Political Economy of Turkey's Involvement in the Balkans* (Izmir: Gediz University, Department of International Relations, 2001), 16

qi. Me këtë rast – dhe pavarësisht se Shqipëria nuk ishte anëtare e NATO-s – ministri shqiptar i Mbrojtjes, Safet Zhulali, vizitoi objektet ushtarake turke top-sekret, të cilat vetëm anëtarët e NATO-s lejoheshin të shihnin. Vetëm një muaj më vonë, anija detare turke TCG Mareşal Fevzi Çakmak vizitoi Durrësin, portin më të madh shqiptar. Kjo ishte vizita e parë e tillë që nga koha osmane. Gjashtë vjet pas vizitës historike në Shqipëri, në vitin 1998, Turqia dërgoi trupa në këtë vend në një kohë kur konflikti në Kosovë ishte përshkallëzuar dhe zyrtarët kosovarë kërkuan mbështetje në Turqi. NATO filloi sulmet ajrore mbi Serbinë dhe Malin e Zi në vitin 1999 dhe Turqia mori pjesë në këto sulme ajrore të NATO-s.

Më vonë, Turqia kontribuoi në forcën paqeruajtëse ndërkombëtare të stacionuar në Kosovë, me rreth 1000 ushtarë që u vendosën në korrik 1999. Turqia vuri në dispozicion të NATO-s objektet e saj ajrore ushtarake për sulmet e Aleancës, si dhe furnizoi avionë luftarakë F-16 si përcjellës për skuadrat e bombarduesve. Zyrtarët turq heshtën për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të Turqisë në sulmet ajrore të NATO-s në Kosovë.⁵⁷

Ashtu si Shtetet e Bashkuara, Turqia mbështeti politikisht dhe ushtarakisht Shqipërinë, Maqedoninë dhe Federatën Boshnjake-Kroate. Gjatë gjithë angazhimit ushtarak në Perëndim. Në Ballkan, Turqia ka qenë gjithmonë e detyruar të integrojë aktivitetet e saj në politikat e BE-së dhe SHBA-së për të mbetur një lojtar në rajon.⁵⁸

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova ka tërhequr nivelin më të lartë të IHD-ve nga Turqia gjatë pesë viteve të fundit. Vetëm në vitin 2015 Kosova ka tërhequr 316.3 milionë euro në IHD. Turqia u rendit e dyta, me një pjesë të IHD-ve prej 54.1 milionë euro, menjëherë pas Zvicrës, e cila investoi 70.3 milionë euro në të njëjtin vit. Ekzistojnë 62 biznese në pronësi turke në mjedisin dinamik të biznesit të Kosovës me pothuajse 4,000 investitorë të regjistruar.⁵⁹

⁵⁷ Sylvie Gangloff, “Turkish Policy towards the Conflict in Kosovo: The Preeminence of National Political Interests”, *Balkanologie* 8, no. 1 (June 2004): 105–22.

⁵⁸ Kosovo Investment and Enterprise Support Agency, Ministry of Trade and Industry of the Republic of Kosovo, <http://invest-ks.org/en/foreign-direct-investments-in-kosovo>, (29.05.2021).

⁵⁹ *Ibid.*

Sa i përket investimeve, dhe sipas Bankës Qendrore të Kosovës, Turqia ka investuar 86.8 milionë euro vetëm në vitin 2013. Nga viti 2004 deri në vitin 2014 investimet arritën në 360 milionë euro – 12% e gjithsej investimeve të huaja. Në mënyrë të ngjashme, si me Bosnjën dhe Hercegovinën, Turqia ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë si dhe një sërë marrëveshjesh të ndryshme që eliminojnë taksimin e dyfishtë. Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës që nga dhjetori 2015 ishin vendet e CEFTA-s, të cilat kishin 35.4 përqind të eksporteve të përgjithshme të Kosovës dhe 24.6 përqind të importeve; dhe BE-ja, e cila kishte një 20 për qindpjesë e eksportit dhe 43 përqind e importit. Me pjesëmarrjen e saj prej 4.3 përqind të eksporteve të Kosovës, Turqia zë vendin e nëntë pas Indisë, Shqipërisë, Serbisë, IRJM-së, Gjermanisë dhe Zvicrës.⁶⁰

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) ka investuar më pak se 3 milionë euro në Kosovë nga viti 2009 deri në vitin 2014 – prej tyre, 1.2 milionë euro janë investuar në xhaminë e Sinan Pashës në Prizren.⁶¹ Ndikimi në arsim solli deri te një zbutje e të shprehurit për të dhënat historike lidhur me Perandorinë në librat shkollorë.⁶²

Turqia luajti një rol të rëndësishëm duke ofruar ndihmë ushtarake për Maqedoninë. Zyrtarët maqedonas thanë se nuk donin mbështetje ushtarake nga Turqia, por shtuan se do të donin që Turqia të merrte një rol më efektiv në NATO.⁶³ Nga ana tjetër Erdogan citohet të ketë thënë se populli shqiptar ka të drejtën e vetëvendosjes dhe krijimit të një Shteti të Madh Shqiptar,⁶⁴se

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Investimet e TIKA në Kosovë

⁶² Uffe Andersen, “Kosovo’s New Golden Age?”, TOL, 6 December 2013, tek Vračić, Alida, SWP Research Paper No. RP 11/2016, Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), Berlin 2016 [https://www.econstor.eu/handle/10419/253173\(02.09.2021\)](https://www.econstor.eu/handle/10419/253173(02.09.2021))

⁶³ “Üsküp’e Savunma Yardımı” [Skopje Defense Help], Cumhuriyet, 18 March 2001, and “Turkey Condemns Violence, Refugee Inflow Continues”, Turkish Daily News, 22 March 2001, in Ekinci, Turkey and the Balkans in the Post-Cold War Era (see note 7). Vračić, Alida, SWP Research Paper No. RP 11/2016, Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), Berlin 2016 [https://www.econstor.eu/handle/10419/253173\(02.09.2021\)](https://www.econstor.eu/handle/10419/253173(02.09.2021))

⁶⁴ Dušan Reljić, The “Albanian Question” after the Turn in Tirana, SWP-Point of View (Berlin: SWP, 23 July 2013) tek Vračić, Alida, SWP Research Paper No. RP 11/2016, Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), Berlin 2016 [https://www.econstor.eu/handle/10419/253173\(02.09.2021\)](https://www.econstor.eu/handle/10419/253173(02.09.2021))

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk është organizatë terroriste revolucionare por shpreh vullnetin e shqiptarëve për të mbrojtur trojet e tyre; dhe se trupat turke janë në gatishmëri për të ndihmuar në çlirimin e tokave të pushtuara shqiptare.⁶⁵

Në Maqedoni ekzistojnë shkollat dhe kolegjet fillore dhe të mesme Jahja Kemal, si dhe Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik. Agjencia shtetërore e Turqisë, Anadolu, hapi një tavolinë dygjuhëshe maqedonase dhe shqipe në Shkup, duke zgjeruar më tej operacionet e saj në rajonin e Ballkanit. Në trrojet ku jetojnë shqiptarët Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, Fondacioni Turk Maarif ka hapur shkolla fillore dhe të mesme. Në Maqedoninë e Veriut marrëdhëniet e ngushta mes dy vendeve janë reflektuar në marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe tregtare. Në vitin 2008, kompania turke TAV fitoi kontratën 20-vjeçare për të operuar dy aeroportet e Maqedonisë, në Shkup dhe Ohër, dhe të ndërtohet një tjetër në qytetin e Shtipit në 10 vitet e ardhshme.⁶⁶ Në vitin 2020 pasi është analizuar se nuk ka përfitim ekonomik nga një aeroport mallrash në Shtip është marrë vendimi për rishpërndarjen e parave është marr nga TAV, gjithsej 49 milionë euro të planifikuara, 35 milionë euro janë rishpërndarë me vendim të qeverisë për realizimin e 99 projekteve infrastrukturore në 75 komuna.⁶⁷

Minoriteti turk duke qenë shumë i vogël pa rezik për pushtetin, turqit janë shpesh më të pranuar në mesin e maqedonasve se sa shqiptarët. Shqiptarët janë fajtorët kujdestar në çfardo kontesti të jetë shteti me fqinjët. Nacionalizmi maqedonas kalon në shovinizëm që ushqehet me urrejtje ndaj shqiptarëve. Gjuha politike shpesh i bën jehonë të shkuarës. Pas grushtit të shtetit ushtarak në korrik 2016, liderët nga Ballkani përshëndetën rivendosjen e kontrollit të Presidentit Erdogan në Turqi. “Gëzuar popullin vëlla turk dhe mikun tonë të vyer, Presidentin Erdogan, për daljen – me sukses të plotë

⁶⁵ Në vitin 1912, Shqipëria u bë vendi i fundit ballkanik që fitoi pavarësinë nga Perandoria Osmane. Por shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi mbetën jashtë shtetit të ri, duke lindur ëndrrën e një kombi të bashkuar shqiptar.

⁶⁶ TAV, <http://skp.airports.com.mk/en-EN/about-tav-airport/page/history> (10.01.2022)

⁶⁷ 360 Stepeni, <https://360stepeni.mk/namesto-za-kargo-aerodrom-vo-shtip-35-milioni-evra-se-raspredeleni-za-99-proekti-vo-75-opshtini/> (15.01.2022)

– nga një natë shumë e vështirë”, shkroi kryeministri shqiptar Edi Rama në Twitter.⁶⁸

Qëndrimi i Parlamentit Evropian

Parlamenti mbështet perspektivat në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Më 26 prill 2022, Presidentja e Kuvendi, Roberta Metsola, vuri në dukje se BE-ja duhet 'të mendojë për mënyrat për të përshpejtuar procesin e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor’, sepse “stabiliteti në fqinjësinë e afërt është jetik për vetë BE-në stabilitet’. Parlamenti ka shprehur shqetësim për ndikimin e Rusisë në rajon dhe përpjekjet e saj për të destabilizojë si rajonin në tërësi, ashtu edhe vendet individuale brenda tij (për Shqipëri, BiH). Parlamenti është i shqetësuar se investimet ruse në rajon paraqesin rreziqe të larta për korrupsionin dhe kapjen e shtetit.⁶⁹

Bullgaria dhe Rumania u bashkuan me Bashkimin Evropianë nga janar 2007, pas valës kryesore të pranimit të vendeve të Evropës Lindore. Në këtë periudhë këto shtete janë ritur ngadal por sigurt. Kanë përmirësuar standardin e jetesës, janë reformuar në shumë fusha të jetës publike, ekonomisë si dhe sistemit gjyqësorë.⁷⁰ Një argument që duhet përemendur është se këto dy vende u pranuan me rekomandim të Komisionit Evropian meqë nuk kishin përmbushur kërkesat e auditimit të BE-së.⁷¹

Nga ana tjetër aplikimi i Turqisë është mbajtur pezull për një kohë të gjatë meqëdisa vende anëtare të BE-së e kishin kundërshtuar pranimin e saj edhe pse ekonomikisht Turqia qëndronte shumë më mirë se Rumania dhe Bullgaria. Kroacia aplikoi për anëtarësim në BE në vitin 2003 dhe ishte në negociata nga 2005 deri në 2011. Më 9 dhjetor 2011 liderët nga BE dhe Kroacia nënshkruan traktatin e anëtarësimit. Vendi u bë vendi i 28-të anëtar

⁶⁸ Edi Rama, <https://twitter.com/ediramaal/status/754217860201848832> (05.05.2022)

⁶⁹ European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA\(2022\)733523_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA(2022)733523_EN.pdf) (15.05.2022)

⁷⁰ Cristian Gherasim, “15 years on: How are Bulgaria and Romania doing in the EU?”, <https://euobserver.com/rule-of-law/154137> (20.01.2022)

⁷¹ Georgi Gotev, “Romania and Bulgaria were not ready for accession, EU auditors confess”, <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/auditors-romania-and-bulgaria-were-not-ready-for-accession/> (20.01.2022)

i BE-së më 1 korrik 2013. Në referendumin e janar 2012, dy të tretat e votuesve kroatë mbështetën pranimin e vendit të tyre në Bashkimin Evropian si anëtare e 28-të.

Vendimi i prerë për të mos pranuar asnjë anëtar të ri (me iniciativën e politikanes më me ndikim të Evropës, Angela Merkel) ngjall hamendjen e politikanëve rajonalë për të bërë përpjekje serioze për një qëllim të largët e të pasigurt. Paknaqësia e BE me përpjekjet e liderëve ballkanikë do të sjellë edhe nisjativën për Ballkanin e Hapur si projekt paraprak për ta përgatitur Ballkanin perëndimor për një proces integrimi të përbashkët.

“Është gjithmonë një ide e mirë për të ardhur në ajrin e pastër dhe ujërat e kristalta të Liqenit të Ohrit, një nga vendet më të bukura në Evropë. Fatkeqësisht, arsyeja për mbledhjen e javës së kaluar të liderëve nga rajoni – ‘Ballkani i hapur’ – nuk është një ide e mirë. Në fakt, nuk është as një emër i mirë. Edhe zyrtarët janë të hutuar nëse emri është ‘Ballkan i Hapur’ [që tingëllon si komandë] apo ‘Ballkan i Hapur’ [që tingëllon si një përshkrim].”, do të shkruaj Edward P. Joseph për *Balkan Insight*.⁷² Sipas tij Serbia është anija kurse të tjerët do të jenë varka sepse ajo është një treg më i madh dhe gjithmonë duke patur parasysh se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut bashkë kanë PBM (GDP) sa vetë Serbia kuptohet se Serbia do përfitojë më shumë.

Por Ballkani i hapur si “një ballkon i Evropës” ose një ode/aneks pritjeje që pritet t’i bashkangjitet BE-së mund të paraqesë edhe një strehimore të interesave Ruse që perms Serbisë të qëndrojë edhe më gjatë në Ballkanin perëndimor.

Roli i shqiptarëve në proceset eurointegruese

Shqiptarët e Maqedonisë në vazhdimsi kishin ngelur në dhomën e pritjes sa i përket statusit të tyre politik. Përveç dakordimit me udhëheqësitë politike kosovare dhe atë shqiptare në një masë kishin raporte shumë të mira me diplomacinë perëndimore dhe shërbimet e ndryshme perëndimore. Shqiptarët e Maqedonisë kishin pranuar të presin për një zgjidhje të çështjes politike të Kosovës dhe pastaj me rradhë të realizonin të drejtat e tyre poli-

⁷² *Balkan Insight*, <https://balkaninsight.com/2022/06/15/open-balkans-is-not-just-unwise-its-dangerous/> (21.05.2022)

tike. Lufta e vitit 2001 e llogaritur si konflikt i mbrendshëm në Maqedoni nga një kryengritje për bashkim⁷³ u ndryshoi në kryengritje për drejtat dhe liritë e njeriut.⁷⁴ Kjo pastaj solli deri tek një marrëveshje politike që nuk përfundoi në frymën e idealeve të gjeneratave patriotike për bashkim kombëtar, por prodhoi një sistem makropolitik që menaxhoi konfliktin që njihet si “power sharing”.⁷⁵ MKO nuk solli zgjidhje territoriale as autonomi politike territoriale as republikë federale, dhe kjo falë kompromisit të shqiptarëve, presionit të ndërkombëtarëve dhe pozitës më të fuqishme negociuese të përfaqësuesëve të shtetit Maqedonas. Mbi të gjitha roli i faktorit politik shqiptar është treguar fleksibël dhe pozitiv për të përmyll konfliktin dhe për të çarmatosë UÇK-në dhe kështu duke i dhënë gjasa procesit të implementimit të MKO-së. Marrëveshja mes shqiptarëve dhe Maqedonasve për çështjet e garantuara me MKO gjithashtu janë vendimtare për integrimin e vendit në BE dhe kjo shifet në raportet e progresit të BE për Maqedoninë.⁷⁶

MKO si marrëveshje e garantuar ndërkombëtarisht që ka bartësit dhe afatet implementues falë një politike fleksibile dhe tolerante të lidërshiptit në bllokun politik shqiptar nuk ka penguar rrugëtimin e vendit drejt BE-së. Përkundrazi është apeluar vazhdimisht drejt ruajtjes së stabilitetit dhe procesit të përmbushjes së kushteve dhe kërkesave për integrim. Përkundër kësaj filozofie të re në politikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut qëndron me kokëfortësi filozofia e shtetit unitar, shtetit komb. Edhe në bllokun politik maqedonas me një LSDM të reformuar në një masë dhe një parti nacionaliste si VMRO DPMNE dhe një lëvizje e re e ekstremit të majtë si “Levica” tendencat politike drejt eurointegritimeve shfaqin ndikimet e sferave të ndryshme të interesit. Edhe në këtë kontekst shqiptarët shërbejnë si katalizator në ruajtjen e sistemit demokratik të vendit. Roli i shqiptarëve sin ë Marrëveshjen e Prespës ashtu edhe në kontestin me Bullgarinë ka qenë konstruktiv. Qëndrim konstruktiv ka mbajtur edhe shteti Shqiptar edhe Re-

⁷³Zeqirija Rexhepi, “Shfaqja e formacionit ushtarak në IRJM,” <http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/shfaqja-e-formacionit-ushtarak-n-irjm.html> (26.05.2022)

⁷⁴Ibid.

⁷⁵Isamet Bakiu, “Pushtetndarrja si instrument paqeje në Ballkan,” ITSHKSH, Shkup 2019, f.28-36

⁷⁶Blerim Reka, “Marrëveshja Kornizë e Ohrit – filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik” f. 16-17, https://www.seeu.edu.mk/files/research/projects/OFA_SHQIP_FINAL.pdf (22.05.2022)

publika e Kosovës. Veprimi politik ka qenë i kujdeshëm në mbështetje të procesit eurointegrujes.

Përfundimi

Ballkani perëndimor në procesin e eurointegrimi ballafaqohet edhe me lidhjet kulturore por edhe me lidhjet ekonomike të shteteve të fuqishme si Rusia dhe Turqia duke patur parasysh edhe shtetet perendimore si pjesë e BE-së por edhe jashtë saj si ShBA. BE dhe Turqia kanë qasje të ndryshme ndaj Ballkanit Perëndimor. Përderisa BE-ja kryesisht fokusohet në sigurinë Turqia ka në focus fuqinë e saj politike dhe ndikimin e saj në rajon në lidhje me muslimanët. Politika turke nuk ka për qëllim të parandaloj një integrim të Ballkanit perendimor, por vetëm të shtrij ndikimin e saj përmes investimeve ekonomike dhe mbajtjes së lidhjeve kulturore. Kriza mbizotëruese financiare në BE, fluksi i refugjatëve, terrorizmi, kriza në Lindjen e Mesme, Brexit¹⁸⁴ – kanë zhvendosur prioritetet e Bashkimit nga Ballkani Perëndimor. Politika e rritjes ekonomike, pluralizmit, demokracisë dhe lidhjeve më të ngushta me BE-në, është më e favorshme për shqiptarët sesa një Turqi me një sundimautoritar, antiperëndimor.

Vijat e ndikimit të butë në Ballkanin Perëndimor, mes Turqisë dhe fuqive konkurruese në rajon e gjenë BE-në pa disponim zgjerimi dhe kjo ngre emocionet dhe forcon lidhjet kulturore në baza fetare. Në vend që ta shikojë Turqinë si konkurrente, BE-ja duhet ta përfshijë Turqinë anëtare e NATO-s sa më shpejt të jetë e mundur në aktivitete shumëpalëshe në Ballkani Perëndimor (p.sh., përmes Procesit të Berlinit). Lufta në Ukrainë ka përshpejtuar procesin e anëtarësimit në NATO të shteteve si Finlanda dhe Suedija por edhe të integritetit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në BE.

Së fundi, vendet e rajonit duhet të formulojnë prioritetet dhe marrëdhëniet e tyre të politikës së jashtme – si me Turqinë ashtu edhe me BE-në – të cilat do të bazoheshin mbi interesat pragmatike si dhe zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike e politike. Një shtytje e fortë liberale nga brenda duhet të bëhet për të forcuar institucionet demokratike që mund të garantojnë sundimin e ligjit dhe reforma të thella. Shqiptarët duhet krijuar mekanizmat mbrojtës nga vendet që duan ta prolongojnë antarësimin e tyre në BE si

entitete politike por si tërësi etnike duke përfshirë shtete ku ata jetojnë në Ballkanin perëndimor.

Bibliografia

- Arben Hajrullahu, "Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE," Konrad Adenauer Stiftung, Prishtinë 2015
- Hysa Eglantina, Shehi Reina Zenelaj, "Paqja, konflikti dhe zhvillimet në Ballkanin Perëndimor: roli i integritimit në BE," Logos Berlin, 2020
- Florian Bieber and Nikolaos Tzifakis, "The Western Balkans in the world: linkages and relations with non-western countries," Abingdon, Oxon : Routledge, 2019
- Jasmin Mujanović, "Hunger and fury : the crisis of democracy in the Balkans", Hurst, London, 2018
- Eric Gordy, Adnan Efendic, "Meaningful reform in the Western Balkans: between formal institutions and informal practices," Peter Lang, Bern, 2019
- Blerim Reka, "*Marrëveshja Kornizë e Ohrit – filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik*" f.16-17, https://www.seeu.edu.mk/files/research/projects/OFA_SHQIP_FINAL.pdf
- Reka Blerim, "Theory and Practice of the International Administration," University of Prishtina, Prishtina 2005
- Reka, Blerim, "UNMIK as International Governance in the Post-war Kosova, NATO's Intervention- UN Administration and Kosovar Aspiration", Logos-A, Skopje, 2003.
- Isamet Baku, "Pushtetndarrja si instrument paqeje në Ballkan," ITSHKSH, Shkup 2019

Burime në internet

- Vračić, Alida, SWP Research Paper No. RP 11/2016, Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), Berlin 2016 <https://www.econstor.eu/handle/10419/253173>
- Blerim Reka, "*Marrëveshja Kornizë e Ohrit – filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik*" f.16-17, https://www.seeu.edu.mk/files/research/projects/OFA_SHQIP_FINAL.pdf
- Zeqirija Rexhepi, "Shfaqja e formacionit ushtarak në IRJM," <http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/shfaqja-e-formacionit-ushtarak-n-irjm.html>
- Ballkan Insight, <https://balkaninsight.com/2022/06/15/open-balkans-is-not-just-unwise-its-dangerous/>

- Georgi Gotev, “Romania and Bulgaria were not ready for accession, EU auditors confess”,
<https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/auditors-romania-and-bulgaria-were-not-ready-for-accession/>
- Cristian Gherasim, “15 years on: How are Bulgaria and Romania doing in the EU?”,
<https://euobserver.com/rule-of-law/154137>
- European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA\(2022\)733523_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/733523/EPRS_ATA(2022)733523_EN.pdf)
- TAV, <http://skp.airports.com.mk/en-EN/about-tav-airport/page/history>
- 360 Stepeni, <https://360stepeni.mk/namesto-za-kargo-aerodrom-vo-shtip-35-milioni-evra-se-raspredeleni-za-99-proekti-vo-75-opshtini/>
- Edi Rama, <https://twitter.com/ediramaal/status/754217860201848832>
- CEIC, <https://www.ceicdata.com/en/albania/bpm6-foreign-direct-investment-by-country/fdi-stock-turkey>
- Kosovo Investment and Enterprise Support Agency, Ministry of Trade and Industry of the Republic of Kosovo, <http://invest-ks.org/en/foreign-direct-investments-in-kosovo>
- Think tank Popolari, A Political Romance (see note 14), <https://popolari.org/en/home/>
- Paul Stronski & Annie Himes, Russia’s game in the Balkans, <https://carnegieendowment.org/2019/02/06/russia-s-game-in-balkans-pub-78235>
- Carnegie Edowment for International Peace, <https://carnegiemoscow.org/2019/11/26/spoiler-in-balkans-russia-and-final-resolution-of-kosovo-conflict-pub-80429>
- Investigate Russia, <https://investigaterussia.org/media/2018-03-26/russia-connection-runs-through-greece>

Minir ADEMI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

Avni AVDIU

Universiteti "Nënë Tereza" - Shkup

BALLKANI I HAPUR: ALTERNATIVË APO KURTH I RADHËS PËR SHQIPTARËT...?!

Abstrakt

Shqiptarët po kalojnë nëpër labirinthin e pafund drejt integritimeve me dëshirën e flaktë për t'u bërë pjesë e Bashkimit European. Synim i tyre proeuropian ishte i hershëm, madje edhe atëherë kur kanë qenë nën sundimin e Perandorisë Otomane. Rilindasit shqiptarë shpesh në veprat e tyre e rikujtuan faktin se Europa u detyrohet shqiptarëve t'i fusë në gjirin e vet, sepse pikërisht në saje të luftës dhe rezistencës së paepur të Skenderbeut, ajo e mbrojti të pacënuar qytetërimin e saj.

Për ironi të fatit, Europa jo vetëm që u tregua gjithnjë mosmirënjohëse ndaj këtij fakti, por ajo vazhdimisht nëpër konferenca e kongrese që u mbajtën nëpër kryeqendrat e saj, vulosi fatin ogurzi të ndarjes e copëtimit të trojeve shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore një pjesë të fajit për fatin e tyre në raport me Perëndimin, e bartin edhe vetë shqiptarët për shkak të keqorientimit të tyre ideologjik me Lindjen.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, shqiptarët morën një mbështetje të fuqishme ushtarake, politike dhe ekonomike nga Perëndimi. Kjo e krijoi përshtypjen e përgjithshme se tani e tutje Europa do të jetë në krah të shqiptarëve, të paktën për t'ua kompenzuar padrejtësitë që vetë ajo ua kishte shkaktuar. Megjithatë pritjet ishin të gjata ndër këto vite. Bisedime, kushte, zvarritje dhe premtime shterpe, pa ndonjë gjë konkrete. Duke e lënë pezull procesin e negociimit për anëtarësim me Shqipërinë dhe Kosovën akoma pa liberalizim vizash, Europa u dha goditje të rëndë shqiptarëve. Çështja shqiptare vetëm me qëllim zvarritjeje futet me pa të drejtë në paketë me vendet e tjera të Ballkanit, të cilat kanë probleme të pazgjadhura. Kjo ka irrituar kryeministrin e Shqipërisë, i cili me liderët e tjerë të rajonit, përpiket

t'i kundërpërgjigjet Europës me iniciativa rajonale, konkretisht me idenë e MiniShengenit që u riemërtua në 'openBallkan'. Për shkak të përfshirjes pa kushte të Serbisë në këtë iniciativë, Kosova e ka kundërshtuar, duke paralajmëruar bojkotimin e saj. Meqë kjo problematikë ka krijuar ndasi e përçarje të shumanshme të shqiptarët, në këtë vështrim do të merremi me analizën e avantazheve dhe disavantazheve të kësaj iniciative në rrafshin kombëtar.

Fjalë kyçe: minishengeni, open Balkan, Shqipëria, Kosova, përçarje



1. Ideja e hershme e MiniShengenit

Ideja e MiniShengenit ose tashmë së fundmi e emërtuar si 'Ballkani i hapur', nuk është diçka e re. Sokol Kolgjini në një tryezë të mbajtur në fund të korrikut të vitit të kaluar (2021) për këtë tematikë, në mes tjerash, kujtoi se: "Më 27 nëntor 1946 u bë një marrëveshje në mes qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave që përmbante disa pika: 1) Bashkimi doganor në mes RSFJ dhe Shqipërisë 2) Barazimi i monedhës së dinarit me lekun shqiptar 3) Krijimi i shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave për shfrytëzimin e mineraleve, naftës, hekurudhave dhe bregdetit të Shqipërisë. Pra shoqëri të përbashkëta për të shfrytëzuar gjithçka shqiptare. Në çdo zyrë ose institucion shqiptar, kishte edhe një përfaqësues serb".

Kujtojmë faktin se udhëheqësi diktator shqiptar Enver Hoxha, edhe pse i tradhtuar nga Tito-ja, fillimisht kishte simpati të jashtëzakonshme për të. Ai më 17 mars 1948 i ishte drejtuar Titos me këto fjalë: "Shoku Marshall, [...] Populli ynë është aq i lidhur shpirtërisht dhe ekonomikisht me popujt e Jugosllavisë sa asnjë popull tjetër dhe ky bashkim s'ka asgjë fromale, por ndihet thellë në zemrat e popullit tonë. Ne duhet të punojmë konkretisht për Federatën (Jugosllave) dhe për këtë gjë në vendin tonë punohet me të gjitha forcat, por çështja (është) që ne duhet të marrim iniciativën e para për të kërkuar këtë gjë [...] Ne kemi nevojë të na thuhet nga ju nëse ka ardhur momenti kur ne duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit [me Jugosllavinë] e të mbërrijmë në konkluzione dhe nga ana tjetër, do të dëshiro-

nim të na jepeshin dhe sqarime më plotësuese që ju i shihni të arsyeshme në lidhje me faktorë të tjerë të këtij problemi. Ne kemi bindjen se si kurdoherë, Komiteti Central i Jugosllavisë do të na sqarojë dhe do të na këshillojë hapat dhe shoqërisht mbi këtë çështje të rëndësishme për të dy vendet tona. Pranoni të falat e mia më të nxehta shoqërore”(foto nr.1).

Po cili ishte efekti i kësaj marrëveshjeje në atë kohë?! Në rrafshin ekonomik efekti i parë ishte zhvleftësimi i lekut shqiptar në 12 herë. Pasi leku pësoi këtë rënie,të gjitha produktet që ishin në tregun shqiptar u blen nga Jugosllavia dhe tregu shqiptar u boshatis tërësisht. Në atë kohë u përjetua një inflacion galopant. Ndërkaq në rrafshin politik praktikisht sovraniteti i Shqipërisë u vu në rrezik dhe pothuajse humbi. Më 1948 Shqipërinë nga kolapsi total e shpëtoi ndihma e Bashkimit Sovjetik. Në planin kombëtar e keqja filloi për faktin se duke qenë nën varësinë totale ekonomike nga Jugosllavia, në Shqipëri asnjë prej zyrtarëve shqiptarë të asaj kohe nuk guxonin më ta përmendnin Kosovën. Madje në fjalimin e tij të 18 dhjetorit 1946 diktatori Enver Hoxha u shpreh: “Kosovarët i kemi miq shumë të mirë, por ata duhet të vllazërohen me jugosllavët”.

“Shoku Mashall,

[...] Populli ynë është aq i lidhur shpirtërisht dhe ekonomikisht me popujt e Jugosllavisë sa asnjë popull tjetër dhe ky bashkim s’ka asgje formale, por ndihet thellë në zemrat e popullit tonë. Ne duhet të punojmë konkretisht për Federatën (Jugosllave) dhe për këtë gjë në vendin tonë punohet me të gjitha forcat, por çështja (është) që ne duhet të marrim inisiativën e para për të kërkuar këtë gjë. [...] Ne kemi nevojë të na thuhet nga ju nëse ka ardhur moment kur ne duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit [me Jugosllavinë] e të mbërrijmë në konkluzione dhe, nga ana tjetër, do të dëshironim të na jepeshin dhe sqarime më plotësuese që ju i shihni të arsyeshme në lidhje me faktorë të tjerë të këtij problemi. Ne kemi bindjen se, si kurdoherë, Komiteti Central i Jugosllavisë do të na sqarojë dhe do të na këshillojë hapat dhe shoqërisht mbi këtë çështje të rëndësishme për të dy vendet tona. Pranoni të falat e mia më të nxehta shoqërore.

Enver Hoxha, Tiranë, 17 mars 1948.¹⁵

**Jakova në vërejtjet për Muzeun e partisë*

15 AQSH, Fondi 14/AP, Dosja 4, 1948.

AQSH, Fondi 14/AP, dosja 4, 1948

Edhe studiuesi Kastriot Dervishi në një shkrim të tij ka kujtuar përvjetorin e ditës së bashkimit doganor me Jugosllavinë, duke e quajtur atë amanet i shokëve Milladin e Dushan. Ai theksoi se “më 27.XI-1946 në Beograd nga përfaqësuesit e qeverisë së Shqipërisë dhe Jugosllavisë u nënshkrua ‘Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe

barazimin e monedhave, midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë”.

Traktati u ratifikua nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.389 datë 27.XII-1946. Ky traktat që mbrohej nga Enver Hoxha, e plotësoi amanetin e shokëve Milladin e Dushan dhe të asaj që doli nga lufta civile e viteve 1943-1944.

Sipas Kastriot Dervishit ky ishte akti më i lartë i tradhtisë, i cili e ktheu vendin në një kopsht për tregun jugosllav dhe e varfëroi tërësisht Shqipërinë.

Është e çuditshme se fillimisht lajmi i nënshkrimit të traktatit u mbajt i fshehtë.

Njoftimi u dha me vonesë më 11.XII-1946 në gazetën ‘Bashkimi’ (foto nr.2).



Ballina e gazeta 'Bashkimi' e 11 dhjetorit 1946

Në artikullin me rastin e numrit të parë të revistës 'Shqipëri-Jugosllavi', në vitin 1947, Enver Hoxha shkruante: "Zhdukja e barrierave doganore, unifikimi i planeve të shteteve tona dhe ndihma konkrete që qeveria jugosllave po i jep vendit tonë për t'u mëkëmbur e për t'u rindërtuar, janë bazat e shëndosha dhe siguria e një jete më të mirë për vendin tonë. Ata që s'ia duan të mirën popullit tonë shpifin gjëra të paqena dhe vjellin vrer, duke thënë se 'Shqipëria e vogël e humbi independencën dhe pavarësinë e saj, duke u lidhur ngushtë me popujt e Jugosllavisë'. Po Shqipëria, përkundrazi e siguroi dhe e forcoi independencën dhe pavarësinë e saj, duke u lidhur ngushtë me Jugosllavinë e Re".

Sokol Kolgjininë tryezën e mbajtur në fund të korrikut të vitit të kaluar (2021), duke i pasur parasysh këto fakte vazhdoi: "Pra deri në këtë derexhe kishte rënë niveli i shtetit dhe kombit shqiptar.

Ne si shqiptar kemi një problem të madh si qytetar. Ne harrojmë. Meqë ne harrojmë shpesh dhe shpejt i lejojmë drejtuesit tanë që edhe gabimet trashanike që ata i bëjnë në rrafshin kombëtar, jo vetëm që nuk ua rikujtojmë, ashtu që të rregullohen e korigjohen, por ua japim mundësinë që ata ta kamuflojnë gabimin, sikurse s'ka ndodhë gjë ose ka ndodh për arsye o rrethana të tjera të jashtme dhe tejkalohet kjo sikur të mos kishte fare fajtor të brendshëm. Kjo harresë na çon atje ku ne shpesh i përsërisim gabimet.

Kështu mëvitin 2016 në mënyrë tinëzore në një takim të fshehtë në Nish që e ka bërë publike aktivistja serbe Sonja Biserko, janë bërë plane për ndarjen e Kosovës. Mirëpo për fat të mirë tonin me insistimin e ndërkombëtarëve, ky u quajt plan i dështuar. Atëherë meqë Ramës, Vuçiçit e Thaçit u dështoi plani A, pra për heqjen e një pjese të territorit të Kosovës, Serbia e vuri në pah planin B që nuk është më marrja e një pjesë të Kosovës, por marrja e edhe Shqipërisë edhe Kosovës. Në të vërtetë ç'nënkuptojnë këto katër pikat e reja që kanë arritur në takimin e Nishit, Ohrit e do të vazhdojnë në atë të Durrësit. Ata kanë përcaktuar këto liri, që janë: 1) liria e lëvizjes së njerëzve 2) e mallrave e kapitaleve si dhe 3) lëvizja e lirë e shërbimeve. Përkthyer këto në ditët e sotme në fakt janë të njëjtat terma që janë përdorur në vitin 1946 për t'i kamufeluar me liritë e lëvizjes që në fakt i kanë edhe vendet e tjera. Në qoftë se ne lejojmë lëvizjen e lirë të kapitalit me Serbinë, do të thotë që ekonominë e Shqipërisë që ka 15.1 bilion GDP (gji-di-pi) ta vëjmë

përballë ekonomisë së Serbisë që ka 47.6 bilion GDP (gji-di-pi). Në këtë rast është veçmë e kuptueshme se cila ekonomi do të mbisundojë. Supermacia ekonomike serbe do t'u mundësonte atyre të blejnë gjithçka shqiptare, njësoj sikurse e blenë mëvitin 1946.

Çdo produkt shqiptar do të zhvleftësohet nga konkurrenca e fortë e ekonomisë serbe. Thjesht MiniShengeni është një kamulfkim shumë i bukur, por që do ta rrënojë ekonominë shqiptare njësoj sikur mëvitet 1946-1948.

Në aspektin kombëtar, marrëveshja e MiniShengenit ose Ballkani i hapur është thikë mbas shpine për Kosovën. Si mund Shqipëria të thotë se po bën një marrëveshje me Serbinë, kur nuk ka territor të përbashkët tokësor ose pikë doganore. Pikat tokësore Shqipëria i ka të lidhura me Kosovën. Atëherë si mund Shqipëria ta anashkalojë Kosovën për të bërë marrveshje me Serbinë?! Këtë Shqipëria mund ta bëjë vetëm nëse e pranon atë që e thotë Serbia, se Kosova është pjesë e saj. Në këtë rast Shqipëria do ta lë Kosovën të izoluar dhe do ta detyrojë ta zgjat dorën dikund dhe kudo që do ta zgjaste Kosova dorën, do të ishte nën ndikimin serb. Ja pra këtë gjë mund t'ia bëjë Shqipëria Kosovës përmes MiniShengenit me Serbinë. Pra për arsye ekonomike, edhe Shqipëria do të jetë nën ndikimin serb, pra ashtu siç ishte më vitin 1946⁷⁷.

2. Kundërthënshmëria e 'MiniShengenit'

Me MiniShengenin synohet heqja e kontrollit në kufi për mallrat dhe qarkullimin e njerëzve, duke filluar nga 1 janari 2023, nismë kjo që nga 28 korriku i 2021 e ndryshoi zyrtarisht emrin në "Ballkani i hapur". Në Forumin Ekonomik në Shkup, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me qasjen e Bashkimit Europian ndaj Ballkanit Perëndimor. Shtypi perëndimor e ka cilësuar këtë nënismë si frustrim nga Brukseli. Edi Rama, Aleksandar Vuçiç dhe Zoran Zaev kanë folur përpërfitim në aspektin ekonomik dhe tregtar, teksa u shprehën se në kufijtë e tre vendeve do të ketë "zero minuta" pritje. Në rrugën europiane "të

⁷⁷ <https://www.facebook.com/watch/?v=984425338765557>.

mos presim që dikush të na çojë dikund, por ta ndryshojmë fatin tonë dhe të punojmë për interesin e qytetarëve tanë”, - është shprehur Vuçiq. Nuk është e saktë se Serbia do të fitojë më shumë sepse është më e madhe”, - tha Vuçiq, duke shtuar se të gjithë fitojnë me shmangien e vonesave në kufij dhe me uljen e shpenzimeve operationale në qarkullikmin e kamionëve me mallra. Ky takim nuk është kundër askujt, por është për jetë më të mirë për qytetarët tanë”, - përfundoi Vuçiq, duke i thënë disa herë Ramësmiku im i dashur e i nderuar.

Ata ikritikuan tre vendete tjera të Ballkanit Perëndimor: Maline Zi, Kosovës dhe Bosnjën për mosbashkimin në këtë nismë. Albin Kurti është shprehur se MiniShengeni është gatuar në bodrumet e ish-Jugosllavisë. MiniShengeni ballkanik ka rreziqet e veta dhe se ai paraqet Jugosllavinë e katërt, të cilën Serbia e do, kjo është intenca e Beogradit”, - ka pohuar Kurti⁷⁸.

Në një fjalim që mbajti në konferencën ndërkombëtare “Prespa Forum”, në Ohër më 2 korrik 2021, ai shtoi se Kosova refuzon pjesëmarrjen në nismën e MiniShengenit pasi sipas tij rajoni duhet t’i kthehet agjendës së integritimit në Bashkimin Evropian⁷⁹.

Po ashtu edhe ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, e ka kundërshtuar këtë ide. Sipas tij Edi Rama, “po përdoret” nga presidenti serb, Aleksandar Vuçiq.

Sipas Enriko Cekos ideja e MiniShengenit është një sjellje në tavolinë e idesë së kultivuar nga Garashanin në shek IX. Në vitet 1940-1941, një ideolog serb hodhi idenë e një Serbie të madhe në Ballkan, ndërkohë që ishte vala e dytë e ardhjes së sllavëve në Ballkan. Kjo ide një herë në 2-3 shekuj është hedhur në tavolinë, ndërkohë që në shekullin e fundit, në shek e XX është hedhur të paktën 5 herë në tavolinë. Mos të harrojmë që ndërmjet 2 luftërave botërore janë bërë 3 herë konferenca për Ballkanin të drejtuara nga Jugosllavia që në atë kohë ishte mbretëri, Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene. Pas luftës së 2-të botërore ishte Tito që hodhi idenë e Jugosllavisë së Madhe dhe tani kemi variantin e fundit që vjen pas variantit të Millosheviçit. Mos të harrojmë një luftë 8 vjeçare ’90-’98 të Serbisë, me idenë e mbrojtjes së ter-

⁷⁸ <https://www.botasot.info/lajme/1637583/kurti-tha-se-mini-shengeni-eshte-gatuar-ne-bodrumet-e-ish-jugosllavise-ja-cfare-thote-rama/>

⁷⁹ <https://www.botasot.info/lajme/1637490/sot-mbahet-forumi-ekonomik-ne-shkup/>

ritoreve të ish-Jugosllavisë, duke tentuar që të merrte dhe territorin e Shqipërisë.

Veprimtari i njohur i njohur i çështjes kombëtare Koço Kokëdhima në një shkrim në profilin e tij në facebook (më 21 dhjetor 2021) është shprehur: “Komisioneri i Zgjerimit të Bashkimit Evropian, Oliver Varheleyi ka inkurajuar liderët e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut që të vijojnë planin për krijimin e tregut të përbashkët rajonal, pasi në këtë mënyrë do të rritet me 1/3 Prodhimi i Brendshëm Bruto i rajonit. Një treg i hapur natyrshëm sjell rritje të prodhimit të brendshëm, por pyetja është kush do të rritet dhe në kurriz të kujt?! Që në korrik të 2017, pas samitit të Triestes, kur u hodh ideja e ‘Minishengenit Ballkanik’, paralajmërova se Shqipëria do të përmbetet nga produktet serbe dhe maqedonase të subvencionuara nga qeveritë e tyre, ndryshe nga Shqipëria që e ka lënë bujqësinë dhe agropëpunimin në dorën e Zotit. ‘Shqyerja’ e tregjeve në rajon, me bujqësinë tonë të falimentuar dhe primitive, do t’u shtojë Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut edhe 3 milionë konsumatorë të Shqipërisë dhe produktet e tyre do të përmbytin tregun tonë. Shqipëria ka objektiv strategjik anëtarësimin në BE, por deri në atë ditë që largohet, duhet të krijojë tregun unik me Kosovën. Me 5 milionë konsumatorë. ‘Shengeni shqiptar’ është shumë përfitues për Shqipërinë dhe Kosovën, ndërsa ‘Ballkani i shqyer’ i çon për skrap interesat shqiptare në rajon.

3. Përçarësja në rolin e prijësit të bashkimit

Serbia si gjithnjë historikisht, vazhdon të luajë lojë të dyfishtë: në një anë si aleate besnike e Ruisë dhe nga ana tjetër aspiruese dhe pretenduese për integrim në BE. Mirëpo zyrtarët në Beograd disa herë janë shprehur, se nëse kusht për inkuadrimit në BE bëhet njohja e pavarësisë së Kosovës, atëherë Serbia nuk do t’i nënshtrohej këtij kushti. Madje ajo ka vazhduar jo vetëm bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, por me trysninë e saj ka arritur që rreth 15 vende që kishin njohur shtetin e pavarur të Kosovës, ta tërheqin këtë njohje.

Në këtë kontekst ideja e ‘Ballkanit të hapur’ ose MiniShengenit Ballkanik, i konvenon më së shumti Beogradit, sepse është si shteg për të mbajtur

lidhjet e forta me Kinën dhe Rusinë. Analisti serb Dragomir Anxhelković ishte shprehur se “Ballkani i hapur, si një zgjidhje e detyruar për shkak të ngërçit të integritetit evropian, i jep Serbisë mundësitë e lidhjes me rajonin, të bashkëpunojë maksimalisht me BE, por edhe t’i mbajë partnerët e saj strategjikë, ekonomikë e gjeopolitikë në Lindje”.

Sipas ish-nënkryetarit të PD-së Tritan Shehut për TV News24Albania “baza e ‘OpenBallkanit’ është politike dhe jo ekonomike. Ideja është e dhjetë viteve më parë dhe këtë e ka pranuar Vuçiq, se është një tentativë e rikrijimit të Jugosllavisë sipas modelit të Titos, minus Slloveni e Kroaci, plus Shqipëri”⁸⁰.

Për diplomatin Lisen Bashkurti, nisma “Ballkani i Hapur”, është një nismë që i mungon konsensusi dhe mbështetja rajonale, pasi sikurse dihet tre vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e kanë refuzuar.

I ftuar në studion “Ditari” në A2 CNN, Bashkurti u shpreh se “*Nisma nuk mund të jetë ballkanike, për sa kohë gjysma e vendeve nuk i janë bashkuar, Serbia është e kënaqur se ajo është nismëtarja, ndërsa Shqipëria dhe RMV kanë patur një mbështetje okulte të liderëve sesa mbështetje gjithëpërfshirëse. Fakti që edhe në Mal të Zi e Kosovë e kundërshtojnë nismën do të thotë që nuk ka siguruar një bindje të plotë për qëllimin, objektivat dhe projektet dhe kjo e vë në dyshim jetëgjatësinë e nismës*”⁸¹.

4. Hapja ‘Open Ballkan’ ngulitje në kurth

Droja se minishengeni ose Ballkani i hapur mund të jenë ide e një kurthe të re serbe për shqiptarët, forcohet kur kihet parasysh fakti se Serbia ndryshe flet e ndryshe vepron: proklamoi paqe e bashkëpunim me Shqipërinë, kurse vazhdimisht armatoset dhe kërcënon hapur Kosovën me luftë. Se a ia vlen të besohet kjo lojë e re serbe, mbetet të dëshmojë sërish koha, sepse ne si duket e kemi humbur deri-diku kujtesën kolektive.

⁸⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=jrZLl4WGpck&list=RDCMUC8X73IwfsLqITaAHbXG05lg&index=4>

⁸¹ <https://politiko.al/e-tjera/ballkani-i-hapur-bashkurti-nisme-jo-e-qendrueshme-i-mungon-mbeshte-tja-ra-i450259?fbclid=IwAR1esMEdSOypY-EmPOfuOYkT6pWDI-RWF3RBounpEfgzUQg0AHcqXGMgAQw#.YcLvTp-lcqY.facebook>

Më 15 shtator të vitit të kaluar (2021) Serbia e kremtoi një festë të shpifur të ashtuquajtur ‘dita e unitetit serb, e lirisë dhe e flamurit kombëtar’. Serbët e kujtojnë 15 shtatorin e vitit 1918 kur e “shpërthyen frontin e Selanikut”, me ç’rast ushtria serbe marshoi drejt Kosovës, duke e ripushtuar atë.

Vuçiqi ftoi prindërit serbë që dorë për dorë bashkë me fëmijët e tyre të shkojnë në Ushçe në Beograd për të parë ekspozenë e armatimit më të fundit që ka blerë ushtria e Serbisë. Serbia armatohet vazhdimisht dhe pa ndalë e kërcënon sigurinë e Kosovës.

Është fort e logjikshme pyetja se si është e mundur që një shtet që pengon, kërcënon, shantazhon dhe s’ka lënë e s’lë gjë për të keq pa bërë për shqiptarët, në të njëjtën kohë ta proklamojë një projekt të tillë çfarë është ‘Ballkani i hapur’, si diçka paqësore, progresiste, integruese e madje edhe miqësore e vëllazërore për të mirën e dy popujve: atij serb e shqiptar.

5. Përmbyllje

Janë thënë e do të thuhën shumë opinione për dhe kundër idesë së ‘Ballkanit të Hapur’ ose ‘MiniShengenit Ballkanik’. Krahas shkrimeve dhe opinioneve të politikanëve, analistëve, historianëve dhe intelektualëve, mendimet janë të ndara edhe te popullata, ndërsa kjo shihet qartazi nga komentet e ndryshme në rrjetet sociale.

Kuptohet ata që janë pro kësaj iniciative, e shohin atë si alternativë të integrimit evropian, si fazë kalimtare deri te ky integrim ose edhe si kompensim i kohës së humbur në pritje të këtij integrimi.

Nga ana tjetër, ata që janë kundër, zakonisht këtë e lidhin historikisht me prirjet e Serbisë për dredhi, me mjeshtrinë e saj për të krijuar kurthe mashtruese për interesat e saj e kundër shqiptarëve. Kundërshtarët po ashtu nisen edhe nga aspekti politik i mosndryshimit të kursit të Serbisë kundrejt Kosovës qënga koha e Millosheviçit e deri në ditët tona. S’ka se si të ndryshojë Serbia kur krerët që udhëheqin sot politikën e saj janë ish-zëdhënësi i radikalit Voislav Sheshel, presidenti i tanishëm Alaksandër Vuçiq dhe ish-zëdhënësi i Slobodan Millosheviçit, ministri i tashëm Ivica Daçiq...

Dhe së fundmi, ata që kundërshtojnë këtë ide kapen edhe me dimensionin ekonomik të këtij projekti, duke i theksuar pasojat ekonomike që do t’i

vuanin shqiptarët nga dominimi i jashtëzakonshëm i ekonomisë serbe. Në fakt, a do të implementohet kjo ide, si do të realizohet dhe cilat do të jenë rrjedhat, apo do të mbetet vetëm utopi, mbetet të shihet.

6. Referenca

1. <https://news91times.com>
2. <https://politiko.al>
3. <https://news21post.com>
4. <https://www.botasot.info/lajme/>
5. <https://www.facebook.com/watch/?v=984425338765557>

PANBALLKANIZMI DHE MINISHENGENI BALLKANIK PËRBALLË EVROPIANIZIMIT

Abstrakt

Arsyeja e përzgjedhjes për trajtim të kësaj teme, që zgjon interesin dhe kërkshërinë e studiuesve, politologëve, si dhe aktorëve të politikbërjes, jo vetëm në arealin shqiptarë, por edhe më gjerë, është se nismat, që vijnë nga shtete të caktuara të Ballkanit Perëndimor, e që nuk janë të pranuar nga të gjitha shtetet e Ballkanit, nismat që janë parciais, duhet shikuar me llupën e dyshimit, e pse jo edhe me atë të kritikës.

Aq më shumë, kur nisma të këtilla, mëtohen të prezantohen me ambalazh evropian, e në prapaskenë kanë diçka krejtësisht tjetër, atë të dominimit të njërit shtet apo tjetrit, duke synuar arritjen e qëllimeve gjeostrategjike dhe politike, në dëm të shteteve dhe kombeve të tjera.

Krejt kjo, kur këto lloj nismash vijnë nga një shtet, që ende nuk ka bërë katarsën e duhur, ende mea culpa jo vetëm që nuk është në rend dite në atë shtet, por përkundrazi, militarizimi, shovinizmi, agresioni dhe tendenca për dominim, ka marr hovin më shumë se kurrë, përfshirë qëndrimin ndaj Kosovës, Bosnjës, e rishtazi edhe ndaj Malit të Zi...

Nisma e Minishengenit, e cila do të emërtohej më 29 korrik të 2021 me emërtimin e ri "Open Balkan" (shq. Ballkani i Hapur), është me të drejtë e them projekt i mëhershëm i panballkanizmit, edhe pse mund të mbajë në dukje edhe ambalazhin evropian. Kjo nismë lypset shtjelluar në hollësi, duhet ofruar argumente për ta analizuar, rrahur, debatuar, e edhe flakur tutje si ide, duke punuar rreth një synimi përfundimtar, e që është evropianizim i rajonit, që paraprakisht përmban një sërë kushtesh dhe kriteresh, e që në mesin e tyre, padyshim se duhet të ketë shpagimin, paqtimin dhe deshovinizimin.

Më shumë se kurrë, aktualisht, historia, kombeve që nuk mësojnë leksionin e duhur të saj, i përsëritet fillimisht si farsë, e më pas si tragjedi.

Në një analizë diku në një të përditshme në gjuhën shqipe në lidhje me këtë ide, ishte shtruar me të drejtë kjo çështje, « Ballkani i Hapur », por nga kush u pat mbyllur?!

Kjo ide, është e mbyllur nga revanshizmi i nacionalizmit dhe shovinizmit të shfrenuar serb, etja për territore, popuj e pasuri të pamërituara, ëndrra për dominim politik, nacional, etnik, religjioz.... E mbyllur nga dora e zgjatuar dhe e fshehtë e lakmive gjeopolitike për gllabërime.. E pati mbyllur edhe harresa e tekave të liderëve të caktuar, e mbase edhe e atyre në Perëndim, që e « harruan » këtë areal, duke e lënë në mëshirë të fateve të egra.



Kur më 10 tetor 2019, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut u takuan në Novi Sad të Serbisë dhe nënshkruan një deklaratë të përbashkët për bashkëpunim rajonal dhe integrim ekonomik, me qëllim të eliminimit të pengesave, për të nxitur lëvizjen e mallrave, njerëzve dhe shërbimeve midis tre vende, në dukje kjo ide u duk si një e arritur shumë e madhe dhe një nismë panevropiane. Objektivi i deklaruar i kësaj nisme mëtonte kalimin e kufijve midis tre vendeve të sipërpërmendura, nga 2021, vetëm me letërnjoftim. Kjo do të rriste, sipas kryetarit të Serbisë Aleksandar Vuçiq, nivelin e investimeve të huaja, do të kontribuonte në uljen e papunësisë dhe në nxitjen e konkurrencës. Sipas udhëheqësve të shteteve që bënë pjesë në këtë nismë, të tre vendet ishin të përkushtuara në trajektoren evropiane, e përmes kësaj marrëveshjeje të tre liderët dëshironin, të merrnin fatin në duart e tyre, në vend që të prisnin vendimet e të tjerëve.⁸²

Liderët kryesorë të tre vendeve e trumbetuan këtë nismë si një të arritur të madhe dhe tejet të vlefshme për paqtimin e rajonit dhe evropianizimin e tij.

Kur në këtë projekt, gjegjësisht në Samitin e tretë që u mbajt në Tiranë, Shqipëri, më 18 dhjetor 2019, ishte i pranishëm edhe presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanoviç, nisma e quajtur “Minishengen”, krijoi njëfarë simpatie më të madhe në vendet përkatëse, jo vetëm në vendet përkatëse por edhe në

⁸² <https://europeanwesternbalkans.com/2019/10/10/rama-vucic-and-zaev-pledge-to-intensify-flow-of-goods-and-mobility-in-the-region/>

kancelaritë perëndimore, paçka se Kosova dhe Bosnja nuk ishin pjesë e këtij koncepti.⁸³

Mirëpo, ky koncept, nuk ishte asgjë tjetër përpos një ide e presidentit serb Aleksandar Vuçiç, për të dominuar në Ballkanin Perëndimor, si dhe për të paraqitur Serbinë si fuqinë e pazëvendësueshme të kësaj nisme.

Ai e kishte zbuluar veten si nismëtar, diku që nga 21 nëntori i vitit 2019, në një intervistë për të përjavshmen gjermane “Der Spiegel”, kur kishte konfirmuar se ideja e tregut të përbashkët, me emrin Minishengen ishte e tij.⁸⁴

Pavarësisht zërave kundër që vinin nga Kosova, Bosnja, nga parti të ndryshme dhe qarqe të ndryshme, ideja e Minishengenit vazhdon të pluskojë edhe sot e kësaj dite.

Ky projekt, që nismëtar ka Serbinë, si shtet që ende nuk ka bërë denacifikimin dhe katarsën e duhur ps luftërave dhe tmerreve që shkaktoi, me retorikën luftënxitëse edhe më tej ndaj Kosovës dhe shteteve tjera, nuk është asgjë tjetër përpos projekt i vjetër, që njihet me emrin panballkanizëm.

Pa bërë denacifikimin e duhur, pa paguar dëmet dhe reparacionet, pa u dënuar kriminelët s’ mund të ketë as pajtim dhe as marrëveshje.⁸⁵

Po çka është në fakt panballkanizmi?

Në fjalorin në frëngjisht “Larousse” theksohet qartë se balkanizimi (balkanisation), nënkupton ndarjen e një njësie territoriale ose politike në shtete autonome, në mënyrë që të përfitohet nga ndarjet e krijuara, gjegjësisht ndarje e një institucioni, një administrate dhe bërja e saj joefektive.⁸⁶

Panballkanizmi si ide, është hedhur së pari nga Ilija Grashanini më 1844, me moton « Ballkani, popujve të Ballkanit».⁸⁷ Kjo formulë mund të zërthehet « Ballkani pa shqiptarë, ose Ballkani i serbëve dhe i grekëve ».

⁸³ <https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/18/third-meeting-of-regional-leaders-in-albania-on-friday-and-saturday/>

⁸⁴ <https://www.spiegel.de/consent-a?targetUrl=https%3A%2F%2Fwww.spiegel.de%2Finternational%2Furope%2Finterview-with-serbian-president-aleksandar-vucic-a-1297616.html&ref=https%3A%2F%2Fwww.google.com%2F>

⁸⁵ Ismail Kadare, Çlirimi i Serbisë prej Kosovës, Onufri, 2012, fq. 6

⁸⁶ <https://www.larousse.fr/dictionnaires/francais/balkaniser/7676>

⁸⁷ Hysamedin Ferraj, Skicë e mendimit politik shqiptar, Logos-A, Shkup 1999, fq. 115

Është pikërisht kjo ide me emrin Panballkanizëm ose Ballkanizëm që i kushtoi shumë shtrenjtë shqiptarëve, e ata ende nuk po e marrin leksionin e duhur të historisë. Këtë formulë e kishte përkrahur edhe Zogu, edhe Noli por të dy u lajthitën. Me këtë formulë tentoi Enver Hoxha të bashkëpunoj me komunistët jugosllavët, por u lajthit edhe më keq. Koketimi, sot e kësaj dite, me këtë ide, përmes një emërtimi tjetër (në dukje simpatik, Minishengen), nëpër sallone, zyra dhe kancelari të ndryshme, nëpër institucionet shtetërore ku janë shqiptarët, qoftë në Shqipëri, Kosovë apo Maqedoni, duke u propaganduar gjoja fundi i armiqësisë mes popujve të Ballkanit dhe duke u proklamuar një « happy start », nuk është formula e duhur. Ajo nuk përmban farën e evropianizimit, që në fakt është mishërimi, kërkimfalja, njohja dhe bashkëpunimi i sinqertë.

Panballkanizmi, si koncept i djeshëm, ishte ide ruse, e shpikur nga ish ministri i punëve të jashtme të Rusisë, Adam Czartoryski,⁸⁸ i cili përmes kësaj formule donte të siguronte nxitjen e ballkanasve për luftë kundër Perandorisë Osmane, për të zaptuar më pastaj këto territore, pas largimit eventual osman, duke sllavizuar dhe ortodoksizuar këtë rajon në tërësi.

E se çka ndodhi për shqiptarët, pasi i “sëmuri i Bosforit” u largua nga këto treva, e dimë shumë mirë. Panballkanizmi shqiptarëve u solli, ngushtim territorial, plojë, gjenocid, largim nga trevat shekullore, asimilim...

Në vend të këtyre nismave, duhet shtyrë nismën e evropianizimit, që nënkuptojnë paqtimin, pajtimin dhe mishërimin.

Çfarë përfaqëson evropianizimi?

Ideja e Evropës së bashkuar (doktrina evropianiste) e nxitur fillimisht nga Charlemagne, nga Otton le Grand e Charles Quint, nga Pierre Dubois, nga Saint-Simoni (1814),⁸⁹ nga Mazzini, nga Henri Feugneray dhe Victor Hygo, Briandi, Zhan Mone e deri te Shumani dhe protagonistët e UE-së së sotshme, është një ide dhe projekt me gjasa madhor me nxitje kryesisht franceze, e më pas edhe gjermane, që bazohet në krijimin e një institucioni supranacional, i cili në njëfarë forme do të duhet të ishte mekanizëm mbrojtës

⁸⁸ Po aty, fq. 116

⁸⁹ Zeqirja Rexhepi, Evropa e bashkuar, AER-ZZ, Tetovë 2012, fq. 115

prej nacionalizmave dhe shovinizmave eventualë, do të ruante Evropën nga përplasjet dhe konfrontimet eventuale, dhe vend ku secili shtet do të delegonte sovranitetin e tij kombëtar, me qëllim që Evropa të frymonte dhe të vepronte njëzëri në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ideja e evropianizimit që në vetvete nënkupton paqen, tolerancën, respektin e ndërsjellë, marrëdhëniet e mira dhe bashkëveprimin me shtetet fqinje, nënkupton edhe shmangien e kontesteve, tejkalimin e tyre, mirëkuptimin dhe harmoninë. Evropianizimi është doktrinë tipike që bën parashikimin e së ardhmes duke e krijuar atë. Ky proces nuk do të jetësohej pa pajtimin franko-gjerman, pa zgjidhjen e problemeve ndërkufitare, pa një bashkëpunim të ndërsjellë dhe pa denacifikimin e Gjermanisë.

Andaj platforma e evropianizimit të Ballkanit duhet të ngërthejë në vete jo copëzimin, por antipodin e saj, unifikimin e tij. Unifikimi i Ballkanit rreth doktrinës evropianiste nuk mund të bëhet në mënyrë serike apo në mënyrë veç e veç, por në pako, e as vetëm me 3 apo 4 shtete. Para se të ndodhë kjo nevojitet një pajtim i ndërsjellë. Pra, pajtimi duhet të determinojë integrimin. Nuk mund të ketë integrim pa pajtim. Nuk mund të ketë integrim me copëzim, krejt kjo ngase ideja evropianiste do të tjetërsohej, do të ballkanizohej. Thjesht nuk do të ishte më ide evropianiste.

Pajtimi duhet meodomos të jetë parakusht. Që të ndodhë kjo duhet të ketë njohje të fajit dhe pendim. Modeli franko-gjerman duhet të prevalojë këtë rajon. Pajtimi serbo-shqiptar duhet të ndodhë. Është mirë të ndodhë. E që të ndodhë kjo kërkohen parakushte. Dhe nuk mjafton vetëm kjo, nevojiten shumë pajtime. Pajtimi greko-shqiptar, maqedono-grek, bullagro-maqedonas.....

Serbia dhe serbët ende nuk e kanë bërë katarsën e duhur dhe të nevojshme nga Nacertanija. Serbia duhet të kërkojë falje kombit shqiptar, duke i paguar dëmet materiale dhe njerëzore, duke e njohur shtetin e Kosovës dhe duke ndaluar përpjekjet për minimin e saj, apo ndarjen e saj, (lexo: copëzimin, koncept antievropian në thelb). Pa e bërë këtë nuk mund të ketë raporte të mira mes shqiptarëve dhe serbëve. Këtë e ka bërë Gjermania dhe kombi gjerman me Francën dhe me francezët, ku edhe sot e kësaj dite paguhen dëme dhe reparacione këtij shteti dhe shteteve të tjera të cilave ajo i ka sjellë dëme. E Serbia lëre që nuk e ka bërë, po nuk ka as shenja treguese

minimale për ta bërë këtë. E di që Ballkani do të ishte shumë stabil dhe më rehatshëm nëse do të integrohej në Evropë, po në Evropë do të integrohemi atëherë kur në mes vete do t'i zgjidhim problemet mirë e mirë dhe do t'i pastrojmë hesapet ashtu si duhet. Gjermania e ka bërë këtë duke u denacifikuar (Gjyqi i Nurembergut). E njëjta gjë nuk po shihet në horizont të udhëheqësia serbe. Ende shef i Shtatmadhorisë së Armatës Serbe është personi i dyshuar për krime lufte.

Greçia, duhet patjetër të ndalojë politikën e saj ekspansioniste dhe hegjemoniste, me rivendikimet e saja territoriale ndaj Shqipërisë, por edhe ndaj fqinjëve të saj. Pretendimet greke që nuk kanë të ndalur, pangopësia dhe grykësia e udhëheqësve që kanë për bazë orientuese Megalidhenë, nuk përkon me doktrinën europianiste. Mosnjohja e faktit se brenda territorit grek ekzistojnë edhe komunitete tjera, asimilimi i tyre minon projektin evropian. E copëzon atë. E shpërfytyron atë.

Bibliografia

Libra

Ferraj Hysamedin, Skicë e mendimit politik shqiptar, Logos-A, Shkup 1999,
Kadare Ismail “Çlirimi i Serbisë prej Kosovës”, Onufri 2012,
Rexhepi Zeqirja, “Evropa e bashkuar”, AER-ZZ, Tetovë 2012,

Faqe interneti

1. <https://www.spiegel.de/consent-a-?targetUrl=https%3A%2F%2Fwww.spiegel.de%2Finternational%2Feuropa%2Finterview-with-serbian-president-aleksandar-vucic-a-1297616.html&ref=https%3A%2F%2Fwww.google.com%2F>
2. <https://www.larousse.fr/dictionnaires/francais/balkaniser/7676>
3. <https://europeanwesternbalkans.com/2019/10/10/rama-vucic-and-zaev-pledge-to-intensify-flow-of-goods-and-mobility-in-the-region/>
4. <https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/18/third-meeting-of-regional-leaders-in-albania-on-friday-and-saturday/>

ПАНЕВРОПСКИОТ НАСПРОТИ ЕВРОСКЕПТИЦИЗМОТ - ПРИДОБИВКИ И ПРЕДИЗВИЦИ ОД ОДРЖУВАЊЕТО НА ЕВРОПСКАТА АГЕНДА ВО РЕГИОНОТ

Абстракт

Триесетгодишнината од независноста на Северна Македонија помина во сенка на опитото разочарување помеѓу политичките елити и граѓаните од недобивањето на датум за почеток на преговори. Слична атмосфера владее и во соседна Албанија, но и во целиот регион: ваквата порака од Брисел беше силен сигнал на обесхрабрување за Косово, Црна Гора, Србија и Босна и Херцеговина. Во период кога светот е изложен на глобални предизвици под притисокот на глобалната пандемија, кризата во Авганистан и опитата хуманитарна катастрофа која натежнува на турската граница од блискиот исток, а ја чувствуваат помалку или повеќе сите земји од регионот и континентот, земјите од западен Балкан се борат со последни сили да претежнат повеќе накај западот, отколку накај Балканот- борејќи се со немирните духови на национализам, шовинизам и регионални спорови.

Иако незадоволни од европскиот исход, а задоволни од сопствениот прогрес, земјите од регионот мора да научат дека во политиката нема простор за разочарување, бидејќи не е игра во која се влегува со емотивен влог. Дополнително, сеуште има што да се одработи за да се постигне европски квалитет на живот, што впрочем е најголемиот мотив на сите гласачи, пред секои избори. Трудот има за цел да изврши објективна анализа и да развие потенцијални алтернативни сценарија за регионот во контекст на европската интеграција.

Клучни зборови: Западен Балкан, проширување, евроинтеграции, Европска Унија



Вовед

Зголемениот скептицизам и во ЕУ и во самите земји-кандидатки наведува на помислата дека „партнерите за танго“ семалку уморни⁹⁰. Елегантниот танц се претвори во битка на бес и трпение.

Единствениот настрадан во таа битка е, се разбира, иднината, седната на клупа губејќи надеж во исчекување на исходот. Во меѓувреме, растат екстремизмот и нетолеранцијата, па секој обинува секого, освен себеси, занастанатата ситуација. А, кога е виновен секој друг, освен самиот кој обвинува, обично сите се во право. И, тогаш единствениот начин да се излезе од хаосот е да се навлезе подлабоко во него, но под услов решеноста за разрешница да е доволно силна.

Не толку одамна, од страна на Freedom House⁹¹, Северна Македонија беше посочена како хибриден режим. Ваквата непријатна квалификација следеше по неколку позитивни извештаи кои пристигнаа директно од Брисел.

Од друга страна, спорот за името беше посочуван како главен виновник за европската (неб)иднина на земјата, уште од времето кога го стекна кандидатскиот статус. Денес, овие две линии добија сосема нови наративи за кои беше вложена огромна енергија и беа направени сериозни отстапки кои канализираа општествена поларизираност, но исходот не е многу поразличен, што води кон општа летаргија. За жал, ова се клучнителинии на имплементација на европските вредности во пракса за повеќетомлади во регионот, не само во Северна Македонија:

⁹⁰ Институт за демократија „Социетас Цивилис“ 2021, Анализа на јавно мислење „Политичка луда железница“ достапно на https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/A5_Political-Rollercoaster.-An-eventful-year-for-North-Macedonia-on-its-EU-pathMKD.pdf

⁹¹ Извештаи на Freedom House 2014-2021 достапни на <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2021>

едни кои гледаат хипокризија, други кои бараат излез за себе, и трети, најмалубројни, кои сонуваат европски. За жал, на ситеим недостига позитивен поглед за иднината. Ова е повеќе, или помалку, проблем на Европската Унија во целост: економската криза проследана со политичка и здравствена криза удри ниско вовредностите кои се вишеа со децении. Европската Унија мора да биде повеќе проактивна. Духот на замород проширувањето не е добра препорака за било која институција ие спротивен на самите европски вредности. Забавеното проширување ќе води до зголемена нестабилност и демотивација.

Регионална констелација

Сите земји од Западен Балкан недвосислено ги изразија своите аспирации за членство во Европската Унија и се понапред или поназад на интеграциската патека. Сите политички лидери до сега без оглед на политичката проминенција исто така го изразија својата јасна и одлучна припадност кон Европските вредности, иако нивната интерпретација често остава широк простор за толкување. На Западен Балкан во моментов во тек се преговорите за членство со Србија и Црна Гора, но се појавија проблеми околу давањето датум за започнувањето преговори со Северна Македонија и Албанија, иако ЕУ претходно даде препорака за започнување на преговорите. Босна и Херцеговина и Косово од страна на ЕУ се сметаат за потенцијални членки на Унијата.⁹²

Во поглед на членството во НАТО, Северна Македонија, Албанија и Црна Гора се веќе дел од алијансата, додека само Србија е децидно незаинтересирана што е разбирливо со оглед на историските случувања. Сите земји од регионот се корисници на определни придобивки од интеграциските процеси како што се претпристапните фондови, програмите за мобилност или безвизниот режим. Од друга страна, геополитичката констелација е неповолна за било какво задржување или одложување на пристапните процеси. Покрај криза во самата Европска Унија и тековни состојби во Западен Балкан, тука се и влија-

⁹² АА 2019, Анализа - ЕУ не ги одржа дадените ветувања кон Западен Балкан, <https://www.aa.com.tr/mk>

нијата од глобалните трендови и предизвици како што е пандемијата, руско-украинскиот конфликт, енергетската криза и бегалско-мигрантската криза. И внатре во земјите на западен Балкан, и надвор од нив постојат определни дивергентни сили кои се стремат да извршат влијание⁹³. Национализмот е во постојан пораст, а општествата се поларизирани. Генералниот проблем со недостиг на политичко лидерство и во ЕУ и во земјите на западен Балкан се засили по повлекувањето на германската канцеларка Меркел од политиката, како и на кризата внатре во Унијата по Брегзитот и непочитувањето на принципите на супрематија на правото на ЕУ од определени земји членки.

Ефекти по Брдо самитот

Бугарија, парализирајќи им го процесот на Северна Македонија и на Албанија доведе до една состојба на негодување и разочараност поради недостатокот од перспектива. Неенергичниот став на Унијата, кон односот на овој спор, може да биде причина таа да го турне Западен Балкан на друга страна, што се разбира нема да биде добро ниту за ЕУ и Западниот Балкан, ниту пак за самите земји од овој регион⁹⁴. Ваквата состојба не им користи ниту на граѓаните на Бугарија ниту од земјите на Западен Балкан, но оваа состојба може да допринесе кон политичкиот интерес на Русија и други големи сили кои имаат интерес во регионот. ветото кон Северна Македонија предизвика одржување вонредни избори во земјата на 12 април 2020 година. Во вестите и анализите објавени во меѓународните медиуми се вели дека донесените одлуки за преговорите за членство во ЕУ уште сега предизвикуваат проблеми во земјите кои се засегнати од тоа, додавајќи дека она што го доживеа Грција по изборите во Европскиот парламент би можело да се повтори во Северна Македонија.

⁹³ Баросо: Пораст на национализмот и ксенофобијата пред изборите за ЕП:

<https://kanal5.com.mk/baroso-porast-na-nacionalizmot-i-ksenofobijata-pred-izborite-za-ep/a187579>

⁹⁴ Радио Слободна Европа. 2022. ЕУ самит во Брдо: „5+1“ агенда за спорот Македонија - Бугарија. [online] достапно на: <https://www.slobodnaevropa.mk>

Потенцијални сценарија за 2035

Комисијата ја објави студијата „Стратешко предвидување на Западен Балкан: закрепнување на хоризонтот“. Студијата прикажува три сценарија за можната иднина на политиките за истражување и иновации (R&I) во регионот на Западен Балкан во 2035 година. Според оваа студија, за западен Балкан се можни три сценарија⁹⁵:

Scenario 1: Joining the Common Market

Албанија, Црна Гора, Северна Македонија и Србија постепено станаа членки на ЕУ до 2035 година.

Scenario 2: Looking beyond EU borders

До 2035 година ЕУ станува сè пофрагментирана и економски под притисок поради тоа на севкупните ниски стапки на економски раст отежнати со порастот на регионалните и социјалните разлики. Во 2035 година, заморот од проширувањето на страната на ЕУ е одговорен за заморот од пристапување во ЗБ, од постојано продолжување на пристапните преговори.

Scenario 3: Putting Business First

Иако политичките спорови на национално и регионално ниво продолжуваат, владите на ЗБ преку „Про-бизнис став“ ја олеснуваат размената и соработката помеѓу различните актери во овие економии. СБ продолжува со напорите за спроведување на Копенхашките критериуми, но пристапувањето кон заедничкиот пазар повеќе не е главен политички приоритет во повеќето економии. Долгите преговори за пристап во ЕУ се во тек, иако без политички пробив на хоризонтот.

Со оглед на новонастанатата ситуација во Украина, многу варијаб-ли се променети и не е извесно што може да се случи следно. Во секој случај, нема друга агенда освен европската која е логична и природна за земјите од Западен Балкан, кои колку и да се соочени со сопствената криза на вредности но и со кризата на вредности кај западните сојузници, се во потрага ако по ништо друго- по европски квалитет на живот.

⁹⁵ WBC-RTI.info. 2021. [Focus Article] - Strategic Foresight in the Western Balkans: Recovery on the Horizon. [online] достапно на <<https://wbc-rti.info/object/document/22314>>

Иако има многу аргументи и на едната и на другата страна, доколку се симулира **SWOT анализа**, според авторката таа би започнала вака:

<p>Strengths (internal)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Споделена историја на интеграциски процеси • Геополитичко значење • Искуство 	<p>Weakness (internal)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Демократска култура • Посветеност на реформите • Политичка конзистентност
<p>Opportunities (external)</p> <p>• 14,2 милијарди евра помош за приближување кон Европската унија. Средствата ќе се распределуваат во зависност од реформските напори на секоја земја.⁹⁶</p>	<p>Threats (external)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Замор од проширувањето во ЕУ • Потенцијални билатерални спорови • Странски влијанија

Препораки на Европскиот економски и социјален комитет (2019)

ЕУ-преговорите за проширување, особено кандидатите и потенцијалните кандидати за пристап во ЕУ, се на врвот на листата на приоритети за Европската економска и социјална комисија (ЕЕСК) во однос на надворешните односи⁹⁷. Во таа рамка, преку работа на форуми и експертски комисии формулирани се мислења и препораки кои се однесуваат на регионот, а чија имплементација сериозно ќе придонесе за европски квалитет на живот. Согласно извештајот, во неколку земји од регионот постојат сериозни проблеми во поглед на значителното

⁹⁶ DW 2021, Милијарди евра за Западен Балкан за приближување кон ЕУ | DW | 08.09.2021. [online] DW.COM, достапно на <https://www.dw.com/mk>

⁹⁷ Европски економски и социјален комитет, 2019 Односите меѓу ЕУ и Западен Балкан - препораки на ЕЕСК

отстапување во однос на слободата на здружување, собирање и изразување, како и независност на медиумите.

Со оглед на зголемената нетолеранција, расизмот и ксенофобијата кон мигрантите и бегалците во Европа, треба да се усвои поинаква приказна за миграцијата, каде што таа ќе се смета за нормален социјален и економски феномен и треба да се олесни напорот за едукација на општеството во однос на ова прашање, а со тоа и да ѝ се спротивстави на омразата. Унапредувањето на претприемаштвото може успешно да се постигне само преку обезбедување на почитување на владеењето на правото и ефикасно решавање на корупцијата (како на локално, така и на национално ниво), организираниот криминал и неформалната економија. Во овој контекст, улогата на истражувачкото новинарство е клучна во борбата против корупцијата. Властите во земјите од регионот се советуваат да воспостават и да го поддржат функционирањето на силни и независни регулаторни институции, особено во областите на борбата против корупцијата, слободата на пристап до информации, заштитата на приватноста, ревизијата и изборите. Здравствената заштита на Западен Балкан е препознаена како област што е особено подложена на корупција.

Зголемување на капацитетите во однос на здравствената заштита треба да продолжи со финансиска поддршка од претпристапните фондови на ЕУ. Овој процес треба да вклучува модернизација на опремата, зајакнување на административниот капацитет преку обука обезбедена за здравствените работници и создавање одржлива основа за здравствената работна сила со поголем број соодветни специјалисти, понатамошен развој на агендата за е-здравје и здравствениот информативен систем и подобро собирање на статистичките податоци за јавното здравје.

ЕЕСК ја нагласува потребата за понатамошно зајакнување на конкурентноста и за подобрување на структурните реформи во сите шест земји од Западен Балкан, со цел да се зајакне пазарот на трудот и да се забави емиграцијата.

Улогата на образованието е многу важна за надминување на споровите од минатото и подобрување на демократските вредности.

ЕУ и националните власти треба повеќе да соработуваат во однос на уништувањето на стереотипите за образование, со цел да им обезбедат на девојчињата и жените пристап до достапно и квалитетно образование во текот на нивниот живот, придобивање соодветни вештини и олеснување на Партнерите на ЕУ и Западен Балкан треба да посветат поголемо внимание на квалитетот на животот и социјалната сигурност на своите граѓани. Исто така, се сугерира дека треба да се разгледа можноста за примена на принципите на Европскиот столб на социјалните права при процена на исполнувањето на условите за членство во ЕУ. ивните кариери и пристап до квалитетни работни места на пазарот на трудот.

Заклучок: Реформите како цел

На нејзината последна турнеја низ Западен Балкан, германската канцеларка Ангела Меркел истакна дека интеграцијата на регионот е од геостратешко значење. ЕУ е најголемиот трговски партнер и инвеститор на Западен Балкан кој сочинува 70 отсто од вкупната трговија во регионот со 55 милијарди евра во 2019 година. Понатаму, ЕУ вети 30 милијарди евра во Економскиот и инвестицискиот план (ЕИП) за 2021-2027 година до натамошна соработка во регионот⁹⁸.

Процесот на пристапување во ЕУ останува клучна мотивација за реформи во земјите од Западен Балкан. На граѓаните им е важно да се постигне европски квалитет на живот, без оглед на политичката одлука за членство во Унијата и тоа подразбира низа услуги поврзани со дигитализација, инфраструктура, екологија, вработливост, правна сигурност. Неопходна е мудрост и сериозно политичко лидерство што ќе покаже силна посветеност кон реформите во оваа насока. Притоа, реформите и начинот на кој ќе се спроведат мора да биде прилагоден на локалниот контекст и можности.

⁹⁸ Kamath, 2021 Why the Western Balkans matter to the European Union? Достапно на <https://www.orfonline.org/expert-speak/why-the-western-balkans-matter-to-the-european-union/#:~:text=The%20EU%20is%20the%20Western,further%20cooperation%20in%20the%20region>

Случајот со Северна Македонија и нејзината сага за пристапување јасно ги илустрираат замките напристапот на ЕУ кон Западен Балкан – без моркови, без стапови, без кредибилитет и со заматена перспектива како резултат на компромитирање на инструментот за условување⁹⁹.

Моменталниот статус кво не им е во прилог ниту на земјите од западен Балкан, ниту на самата Унија, и клучно за одржување на европската агенда во регионот ќе биде храброста на политичкото лидерство на двете страни.

Референции:

1. AA Анализа - ЕУ не ги одржа дадените ветувања кон Западен Балкан 2019. <https://www.aa.com.tr/mk>
2. Clingendael report: The EU as a promoter of democracy or 'stabilitocracy' in the Western Balkans? 2022 достапно на <https://www.clingendael.org/sites/default/files/2022-02/the-eu-as-a-promoter-of-democracy-or-stabilitocracy.pdf>
3. D.W. 2021 Милијарди евра за Западен Балкан за приближување кон ЕУ | DW | 08.09.2021. [online] DW.COM. достапно на <https://www.dw.com/mk>
4. <https://www.orfonline.org/expert-speak/why-the-western-balkans-matter-to-the-european-union/#:~:text=The%20EU%20is%20the%20Western,further%20cooperation%20in%20the%20region.>
5. Kamath, 2021 Why the Western Balkans matter to the European Union? Достапно на
6. WBC-RTI.info. 2021. [Focus Article] - Strategic Foresight in the Western Balkans: Recovery on the Horizon. [online] достапно на <https://wbc-rti.info/object/document/22314>
7. Баросо: Пораст на национализмот и ксенофобијата пред изборите за ЕП <https://kanal5.com.mk/baroso-porast-na-nacionalizmot-i-ksenofobijata-pred-izborite-za-ep/a187579>
8. Европски економски и социјален комитет, 2019 Односите меѓу ЕУ и Западен Балкан - препораки на ЕЕСК Радио Слободна Европа. 2022. ЕУ самит во Брдо: „5+1“ агенда за спорот Македонија - Бугарија. [online] достапно на: <https://www.slobodnaevropa.mk>

⁹⁹Clingendael report: The EU as a promoter of democracy or 'stabilitocracy' in the Western Balkans? 2022 достапно на <https://www.clingendael.org/sites/default/files/2022-02/the-eu-as-a-promoter-of-democracy-or-stabilitocracy.pdf>

9. Извештаи на Freedom House 2014-2021 достапни на <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2021>
10. Институт за демократија „Социетас Цивилис“ 2021, Анализа на јавно мислење „Политичка луда железница“ достапно на https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/A5_Political-Rollercoaster.-An-eventful-year-for-North-Macedonia-on-its-EU-pathMKD.pdf

IDEOLOGJITË E VJETRA SI PENGESË PËR INTEGRIM NË BE¹⁰⁰

Abstrakt

Mbase vendet e Ballkanit Perëndimor përgatiten për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE, çështjet e lidhura me fqinjësinë e mirë dhe me zgjidhjen e kontesteve historike, si edhe zgjidhja e kontesteve dypalëshe mbeten kushte shumë të rëndësishme. Nxjerrja në pah të së vërtetës historike dhe pajtimi midis popujve janë me rëndësi të madhe për sigurimin e zhvillimit demokratik dhe për uljen e tensioneve ndëretnike. BE-ja nuk do të sjellë brenda konteste dypalëshe dhe ato duhet të zgjidhen nga palët para anëtarësisë, sidomos kur këto mosmarrëveshje janë të lidhura me vlerat thelbësore të Unionit. Pajtimi historik, fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi i ghithanshëm janë premisa për hyrje në BE. Në këto rrethana vendet candidate duhet të tregojnë shkëputje nga ideologjitë e së kaluarës, duhet të ndalin mohimin e identitetit të fqinjëve, duhet ta dënojnë gjuhën e urrejtjes. Ndërtimi i identitetit kombëtar dhe shtetëror duhet të bazohet vetëm mbi burimet autentike historike që të parandalohen përplasjet ndërmjet komuniteteve. Gjithashtu, parime themelore në BE janë këta të fqinjësisë së mirë, lufta me dezinformatat, dënimi i komunizmit dhe i regjimeve të tjera totalitare. Realizimi i përpiktë i Traktateve është parim kryesor në të drejtën ndërkombëtare. Këto parime janë vendosur me disa rezoluta dhe dokumente të tjera nga institucionet evropiane dhe vendet candidate duhet t'i realizojnë në mënyrë të plotë para anëtarësimit.

Fjalë kyçe: BE, ideologji, libra mësimorë, pajtim



¹⁰⁰ Ky punim është realizuar në kuadër të projektit “Bullgarët në Ballkanin Perëndimor (100 vite para dhe pas Traktatit të Njojtit)”, Fond “Hulumtime Shkencore” № KII-06-H30/5.

Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë baza solide dhe vazhdojnë të përhapen stereotipe, paragjykime dhe ideologji nga e kaluara totalitare jugosllave. Fyerjet kundër bullgarëve të Maqedonisë dhe ndaj bullgarëve në përgjithësi, shkëlja e të drejtave të bullgarëve në këtë shtet, sulmet raciste nëpër librat mësimorë dhe në tekste akademike, shkatërrimi i monumenteve nga trashëgimia bullgare, pretendimet territoriale ndaj Bullgarisë dhe dukuri të tjera të shëmtuara nuk janë ngjarje të rastësishme ose nisma nga persona të caktuara. Të gjitha këto janë rezultat nga urrejtja ideologjike kundër Bullgarisë dhe bullgarëve që është rrënjësore në vet themelin e kombit maqedon gjatë procesit të ndërtimit të tij në shekullin XX. Pas pushtimit të viseve të Maqedonisë së Vardarit gjatë Luftërave Ballkanike Serbia ka ndjekur një politikë të ashpër për asimilimin e bullgarëve atje. Fundi i Luftës së Dytë Botërore ua dha Beogradit dhe Moskës rrethanat e përshtatshme për realizimin e planeve të tyre gjeopolitike. U vranë mbi 20 000 bullgarë, mbi 100 000 të tjerë u burgosën dhe u torturuan, në Maqedoninë e atëhershme u instalua regjim i egër totalitar që përndiqte çdo person me ndjenje kombëtare bullgare dhe çdo manifestim të vetëdijes bullgare. Pas rënies së regjimeve totalitare Bullgaria e pranoi realitetin e hidhur në hir të stabilitetit dhe të paqes në Ballkan. Prandaj, pa asnjë pretendim e njohu pavarësinë e Republikës së Maqedonisë në janar 1992 (e para në botë), e ndihmoi njohjen e Maqedonisë si shtet nga ana e Federatës Ruse, e ndihmoi gjatë embargos greke, kurrë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë pretendime për integritetin territorial dhe për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në shoqërinë bullgare kishte shumë shpresa se marrëdhëniet ndërmjet të dy shteteve do të ishin miqësore, por ideologjia jugosllave vazhdonte të dominonte në institucionet politike dhe akademike, në mediat dhe biznesin e madh dhe Shkupi zyrtar vendosi me përkushtim të vazhdonte të ndërtonte kombin maqedon me falsifikime dhe me nënçmimin e historisë dhe të kulturës bullgare, pra me urrejtje të shtuar ndaj bullgarëve. Për 30 vjet pushtetarët në Shkup nuk ndryshuan asnjë libër mësimor, nuk rindërtuan asnjë monument bullgar – të kundërtën – vazhduan me avazin e vjetër për sulme direkte ndaj identitetit bullgar dhe ndaj shtetit dhe popullit fqinj.

Edhe pas nënshkrimit të Traktatit për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim më 1 gusht 2017 vazhduan të vepronin në të njëjtën mënyrë. Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve për katër vite faktikisht nuk arriti asgjë për shkak të bllokimit të punës së tij nga përfaqësuesit e Shkupit. Kjo situatë u rëndua edhe më shumë pas hyrjes së Maqedonisë së Veriut në NATO, kur çdo përpjekje për bashkëpunim u ndërpre. U pa shumë qartë se qeveritarët e Maqedonisë së Veriut kurrë nuk kanë pasur ndërmend që t'i përmbushin dispozitat e Traktatit dhe të ndërtojnë marrëdhënie të mira me Bullgarinë, por do të vazhdojnë me urrejtjen e tyre të shfrenuar ndaj bullgarëve. Në rrethana të tilla Bullgaria u detyrua që të bllokojë zhvillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare me BE që t'i mbrojë interesat e veta dhe vlerat evropiane, sepse një vend që nuk e ka dënuar ideologjinë totalitare dhe prodhon urrejtje ndaj fqinjëve nuk ka asgjë të përbashkët me parimet e Evropës së Bashkuar. Janë të kota shpresat se me fillimin e negociatave dhe sidomos me hyrjen në BE Republika e Maqedonisë së Veriut do të ndryshonte ideologjinë dhe qasjen e saj ndaj Bullgarisë dhe bullgarëve. Hyrja pa kushte në NATO, ku duhet të mbretërojnë “vlerat evropatlantike” e provon këtë. Edhe një shembull – secili që beson se me hyrjen në BE Shkupi do t'i ndryshonte qëndrimet e tij në mënyrë automatike, le të hulumtojë politikën e Greqisë që tashmë 41 vite është anëtare e BE-së, por nuk ka ndryshuar asgjë në lidhje me politikën e saj ndaj komuniteteve pakice dhe sidomos ndaj shqiptarëve.

Bullgaria dëshiron të ndërtojë marrëdhënie të mira me fqinjin e saj dhe ka dhënë prova të shumta për këtë pohim. As institucionet e Republikës së Bullgarisë, as shkencëtarët bullgarë nuk e mohojnë shfaqjen në dekadat e fundit të identitetit maqedon, i cili, në të gjitha rastet, nuk është strukturuar në mënyrë të qartë dhe pa dyshim përmban shumë nuanca që janë në kundërshtim njëra me tjetrën (mjafton të rikujtohen luhatjet në lidhje me identitetin antik). Këta njerëz natyrisht se mund të kenë komb, kishë, kulturë, identitet, gjuhë, mund të kenë çfarë dëshirojnë dhe e kanë këtë të drejtë pavarësisht mënyrës tragjike të formimit të komunitetit të tyre. Pra, secili njeri dhe secili komb e ka të drejtën e vet për identitet. Këtë të drejtë e kanë si të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, kështu edhe të gjithë qytetarët e Bullgarisë, si edhe bullgarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kjo është vlerë themelore evropiane.

Me politikën e saj Bullgaria ngriti në rendin e ditës të BE-së evrointegrimitin e Ballkanit Perëndimor¹⁰¹ dhe ka punuar shumë për përsheptimin e tij. Procesi i anëtarësimit duhet të jetë i qartë dhe të zgjidhen të gjitha mosmarrëveshjet, sepse brenda BE-së nuk mund të ketë konflikte ndërmjet vendeve anëtare që do ta bllokojnë zhvillimin e Unionit. Ngadalësimi i procesit buron nga refuzimi i qeveritarëve në Shkup të heqin dorë nga e kaluara totalitare, të dënojnë krimet e komunizmit, të ndriçojnë fatin e njerëzve të vrarë dhe të torturuar, të pranojnë historinë e vërtetë që bazohet mbi dokumentet autentike dhe ta shpërbëjnë modelin e vjetër të kombndërtimit duke u mbështetur mbi falsifikimet flagrante dhe mbi urrejtjen kundër fqinjëve. Pra, assesi nuk bëhet fjalë thjesht për debate në lidhje me çështje historike, por për dekonstruimin e një ideologjie që prodhon urrejtje ndërmjet njerëzve dhe kombeve, dhe që është baza ideologjike për diskriminimin e bullgarëve në Maqedoninë e Veriut.

Në tekstin në vijim janë dhënë shembuj nga librat mësimorë në gjuhën shqipe të përpunuar nga shteti maqedonas, ku shihet se falsifikimet, vjedhja e historisë bullgare, fyerjet raciste, pretendimet territoriale, arsyetimet e krimeve të regjimit totalitar, si edhe shembuj për mosrespektimin e traktateve dhe të legjislacionit relevant të Bashkimit Evropian. Të gjitha këto janë elemente nga një ideologji dhe strategji kombëtare që nuk lejon ky shtet të bëhet pjesë nga BE-ja në rrethanat e deritanishme, sepse shkel në mënyrë të hapur shumë norma të Bashkimit Evropian.

Racizmi në librat mësimorë dhe në hapësirën publike

Pa dyshim, politika e racizmit në këto troje u instalua nga Serbia¹⁰². Por edhe pas vitit 1991, në Republikën e Maqedonisë, kjo qasje për ndërtimin e identitetit dhe për shtypjen e komuniteteve të tjera mbi bazën e “diferencimit racor” ka vazhduar në traditën e vjetër serbomadhe. Këto “ide” vijnë nga

¹⁰¹ MEPs assess the results of the Bulgarian Presidency of the Council of the EU. In: <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20180628IPR06810/meps-assess-the-results-of-the-bulgarian-presidency-of-the-council-of-the-eu>. Qasja e fundit më 31 maj 2022.

¹⁰² Shih p.sh.: Milosavljević, Olivera. Crni Bugarine. Në: <https://pescanik.net/crni-bugarine/>. Qasja e fundit më 31 maj 2022.

“teoritë” e Cvijqit që kishte kërkuar arsytetime “shkencore” për shpërndarjen e propagandës serbomadhe ndër bullgarët e Maqedonisë. Disa diplomatë të Rusisë dhe të Austro-Hungarisë gjithashtu në fund të shek. XIX kishin mbështetur ide të tilla që të realizonin ambiciet e tyre për ruajtjen e “bilancës së forcave” në Ballkan. Tani këto “teori” shpërndahen edhe nga “ekspertë” dhe “institute” në vendet e ish-Jugosllavisë, por edhe në disa vende të tjera me qëllim që të mbrojnë konceptet e tyre gjeopolitike dhe ideologjike. Por pikërisht përfaqësuesit e këtyre vendeve duhet të kenë shumë kujdes, sepse “teori” të tilla ishin elaboruar atje që të nënçmojnë kulturat e huaja sipas traditës së “*untermensch-it*”.

Nga shembujt e shumtë për propagandë me bazë racore kundër bullgarëve mund të jepet mësimi nga libri mësimor “Historia për vitin e parë”: “Bashkimi i fiseve sllave në gjysmën e dytë të shekullit 7 u ndërpre me ardhjen e bullgarëve. Bullgarët ishin fis mongolo-tatar nga grupi turq i popujve. Si fis endacak bullgarët gjithmonë e kanë nderuar vendin e jetesës. Janë marrë me rritjen e kuajve, me gjueti dhe me plaçkitje”¹⁰³. Kjo propagandë është ndikuar madje edhe mbi ndonjë shkencëtar shqiptar: “Fjala është për përzierjen tërësore të popullsisë bullgare me atë sllave, midis një populli indoevropian (Sllavët) dhe një tjetri joindoevropian, ose midis racës së bardhë dhe asaj të verdhë tatarë-mongole”¹⁰⁴.

Edhe kundrejt shqiptarëve ka mjaft sulme raciste në libart mësimorë: “Prej shqiptarëve të Maqedonisë ekzistojnë fise që e llogarisin vetëveten si autokton. Kryesisht ata janë popullsi maqedone që gjatë periudhës së sundimit turk e kanë pranuar fenë islame dhe gradualisht janë shqiptarizuar. Midis tyre ka edhe nga ndonjë fis që ka prejardhjen turke, rome ose çerkeze”¹⁰⁵.

Janë përpunuar edhe “filma dokumentarë” mbi “çështjet racore” dhe “diferencimi” ndërmjet bullgarëve dhe maqedonëve¹⁰⁶. Të ndikuar nga kjo

¹⁰³ “Historia për vitin e parë”, Prosvetno dello, Shkup, 2018, f. 152.

¹⁰⁴ Buxhovi, Jusuf. Maqedonia – Nga Antika deri te Koha jonë. Houston, Prishtinë, 2019, f. 190-191.

¹⁰⁵ “Gjeografia e Republikës së Maqedonisë për vitin II të gjimnazit të reformuar”, Prosvetno dello, Shkup, 2015, f. 99.

¹⁰⁶ “Film dokumentar”, përpunuar nga shkencëtarë nga Maqedonia e Veriut: https://www.youtube.com/watch?v=ISDOV0yfJTQ&t=984s&fbclid=IwAR2IBABbH93wSBOxwWtFM3gxlUvleLD-1kUmiOUcLC9_rxNqDkEoAW87fkU

propagandë jonjerëzore janë edhe disa “ekspertë” ndërkombëtarë: „The independent Bulgaria was established on the basis of the agreement between the Russian Empire and the Ottoman Empire, that is the Treaty of San-Stefano from 1878. The then territory of Bulgaria was predominantly inhabited by Bogomil, Macedonian and Turkish population, which later under strong pressure of the newly established state was forcibly “bulgarized.”¹⁰⁷”.

Nuk qëndron vetëm problemi shkencor, ndonëse të gjitha këto pohime janë krejtësisht të pavërteta. Bullgarët e lashtë kanë qenë popull nga bashkësia e madhe të fiseve huno-tyrke¹⁰⁸. Pra, nuk kanë qenë “mongol”, derisa tatarët kanë qenë fis mongol perëndimor, që erdhi në Evropë në vitin 1240 gjatë pushtimeve të pinjollëve të Çingiz Hanit. Problemi është se ideologjia e maqedonizmit është ngritur mbi stereotipe dhe urrejtje racore kundër etnisë bullgare; një problem tjetër është se nuk mund të përdoren etnonime (“mongolë”, “tatarë”) në mënyrë fyese. Kjo shihet shumë qartë nga librat mësimorë dhe nga deklaratat sistematike të disa politikanëve, gazetarëve dhe akademikëve nga Maqedonia e Veirut. Bëhet përpjekje direkte për “diferencimin” e bullgarëve dhe “maqedonëve” mbi bazën e dallimeve racore! Të ngrihet një ideologji mbi “shenjat e racës” është në kundërshtim të plotë me parimet shkencore dhe me vlerat evropiane. Natyrisht, luftimi i dukurive raciste është pjesë e rëndësishme e politikës së Bashkimit Evropian. Mjafton që të citohen vetëm disa dokumente kryesore në këtë fushë¹⁰⁹. Ka edhe mjaft dokumente të pranuar në nivel global¹¹⁰. Në

¹⁰⁷ IFIMES, “2021 Elections in Bulgaria: Bulgarian ‘assault’ on North Macedonia”, 2 april 2021.

¹⁰⁸ Duhet të sqarohet se nuk bëhet fjalë për “turq”, por për fise të shumta që u shfaqën në Mesjetë nga stepet e Azisë Qendrore. Gjithsesi, formësimi etnik i bullgarëve ka qenë një proces i gjatë dhe shumë i komplikuar, por duhet të themi se përqendrimi më i madh i bullgarëve të lashtë ka qenë pikërisht në rajonin e Prilepit – Manastirit, pra në territoret e Maqedonisë së sotme të Veriut – shënim i autorit.

¹⁰⁹ Discrimination on the grounds of racial or ethnic origin is prohibited in the European Union (EU). Direct and indirect discrimination based on racial or ethnic origin is defined in Article 2 of Council Directive 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin (the ‘Racial Equality Directive’).

¹¹⁰ **Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor**, neni 4: “Shtetet-pjesëmarrëse e dënojnë çdo lloj propagande dhe të gjitha organizatat, bazuara mbi idetë dhe teoritë e superioritetit të një race ose të një grupi njerëzish...ose që bëjnë përpjekje që të arsyetojnë ose të stimulojnë urrejtjen racore dhe diskriminimin në çfarëdo forme”.

veçanti i është kushtuar vëmendje mësimdhënies së historisë për parandalimin e urrejtjes racore¹¹¹.

Gjuha e urrejtjes, mohimi i identitetit dhe fyerjet ndaj identitetit bullgar

Mohimi i identitetit bullgar përmes ndërtimit dhe shpërndarjes së stereotipave racore jo vetëm se është në kundërshtim të plotë me vlerat evropiane dhe me shkencën botërore, por është pjesë e pandashme e politikës shoviniste ndaj bullgarëve dhe të kësaj të trajtimit të tyre si njerëz të dorës së tretë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bullgarëve vendës u imponohet përmes sistemit arsimor, mediatik dhe politik një imazh tepër i shtrembër, që ka për qëllim përruljen e tyre dhe mbron mjedisin diskriminues ndaj të drejtave të tyre kulturore dhe politike¹¹². Nxënësit, studentët dhe të gjithë njerëzit në këtë shtet duhet të mësojnë historinë dhe shkencat e tjera sociale mbi bazën e arritjeve të shkencës botërore dhe jo mbi bazën e një ideologjie shoviniste. Bullgarët e Maqedonisë në shek. XIX kanë qenë në themelet e Rilindjes bullgare në të gjitha aspektet e saj. Lufta kishtare, pra për shkëputjen e bullgarëve nga kthetrat e Patrikanës së Stambollit, që ishte bërë vegël e shovinizmit grek për greqizimin e popujve të tjerë ortodoksë në Perandorinë Osmane, ka filluar pikërisht në Shkup dhe në qytete të tjera të Maqedonisë. Edhe përpjekjet për arsim në gjuhën bullgare dhe për mbrojtjen e identitetit bullgar ka marrë hov pikërisht në këto vise. Personalitete si Partenij Pavloviq, vëllezërit Milladinovi, Kuzman Shapkarev, Grigor Përliçev dhe shumë rilindës të tjerë nga Maqedonia kanë dhënë një kontribut të jashtëza-

¹¹¹ Combating stereotypes and raising awareness of history Stereotypes can be centuries-old, with a tenacious hold on attitudes and a tendency to be self-perpetuating. Too often, stereotypes are reinforced by a tendency towards social divisions that place minorities in a different space from the majority, socially but also physically. Prejudices and stereotypes can, in the first place, be addressed by acknowledging the **historical roots of racism**. History and the teaching of history are an important focus of the **Council of Europe's** education programming. In: <https://www.coe.int/en/web/history-teaching> Qasja e fundit më 31 maj 2022.

¹¹² Shih p.sh. këtë intervistë me një bullgar nga Maqedonia e Veriut: „Петър Колев: Равенството на гражданите пред законите не важи за българите в Македония”. Në: <https://btvnovinite.bg/predavanja/lice-v-lice/petar-kolev-nie-kato-balgari-iskame-da-badem-ravnopravni-v-makedonija.html>. Qasja e fundit më 31 maj 2022.

konshëm dhe të pazëvendësueshëm në Rilindjen kulturore dhe arsmiore bullgare. Këto kanë qenë procese të natyrshme dhe këta veprimtarë ishin motivuar nga atdhedashuria e tyre të pakursyer dhe shpesh e kanë paguar me përndjekje dhe me jetën e tyre. Prandaj, janë shumë qesharake pretendimet e disa qarqeve që këta njerëz qenkan ndikuar nga Ekzarhia bullgare dhe paskan qenë shpërndarës të propagandës bullgare! Këto pretendime hidhen poshtë vetëm me rikujtimin e faktit se Ekzarhia bullgare u krijua në vitin 1870, por në viset e Maqedonisë u funksionalizua vetëm në fillim të viteve 90-ta të shek. XIX për shkak të rrethanave të pafavorshme politike, kurse shteti bullgar është rimëkëmbur në vitin 1878, por faktikisht Sofja zyrtare ka filluar nismat diplomatike në ndihmesë të bullgarëve të Maqedonisë pas vitit 1887. Atëherë bëhet pyetja kush e paska bërë “propagandën bullgare” në Maqedoni deri vitet 90-ta të shek. XIX si po manipulohet nga ideologjia zyrtare në Maqedoninë e Veriut? Të themi se në Maqedoni janë ndeshur propagandat bullgare, greke, serbe do të thoshte të pohonim p.sh. se në Korçë paskan luftuar propagandat greke dhe shqiptare për greqizimin dhe për shqiptarizimin respektivisht të popullatës vendëse! Kjo tingëllon në mënyrë absurde, sepse patriotët shqiptarë e kanë mbrojtur identitetin e shqiptarëve kundër manipulimeve greke të bazuara kryesisht mbi ndjenjat fetare. Dhe pastaj, strukturat e Ekzarhisë dhe të shkollave bullgare në Maqedoni ishin kompletuar dhe ishin mbështetur kryesisht nga bullgarët vendës që kanë punuar për përparimin e etnisë së tyre. Propagandat greke dhe serbe kanë përdorur mjete brutale për ndryshimin e vetëdijes etnike të bullgarëve në këto vise. Sukseset e pjesshme në këtë drejtim, pra kalimi i katundeve bullgare në petkun e Kishave greke dhe serbe ishte bërë me terror, me kanosje dhe në mënyrë administrative me ndihmën e autoriteteve osmane me qëllim dobësimin e faktorit etnik bullgar në Maqedoni. Por edhe këta njerëz në shumicën dërrmuese të rasteve vetëm formalisht ishin regjistruar si “grekë” ose “serbë”, derisa kanë mbetur bullgarë. Me këto rrethana në prapavijë është shumë irrituese sjellja e “shkencëtarëve” maqedonas që bëjnë përpjekje absurde të shpjegojnë identitetin e natyrshëm bullgar të shumicës së popullsisë në këto vise me “propagandën e Ekzarhisë dhe të shtetit bullgarë”! Pra, me fjalë të tjera, bullgarët i paskanë joshur me përfitime “maqedonët” dhe ata ishin regjistruar si bullgarë dhe shumë më pak si serbë ose

grekë! Këta “shkencëtarë” ndoshta nuk kuptojnë si e vetëshkatërrojnë dhe minojnë kombin e vet maqedon që dëshirojnë ta ngrenë mbi gjermadhat e trashëgimisë bullgare. Sipas teorisë së tyre, “maqedonët” kanë qenë analfabetë të skajshëm, të vetmit në Evropë që në fillim të shekullit XX nuk kanë pasur vetëdije etnike dhe kanë shkuar pas përfitimeve të ndryshme! Pra, të vetmit që nuk kanë ndërtuar institucione kulturore, kishtare dhe arsimore edhe pse paskan qenë trashëgimtarë të Qirilit dhe të Metodit, të Shën Kliment Ohridskit, të Samuilut etj. Poshtërim më i madh për kombin e vet nuk besoj që mund të ekzistojë dhe pikërisht “akademikët” në Shkup e njollosin historinë e kombit maqedon. Kjo është edhe njëprovë se ideologjitë e vjetra totalitare përmbajnë në vete edhe elemente vetëshkatërruese. Gjithsesi, Bullgaria nuk mund të lejojë që ky lloj falsifikimesh historike të përdoren edhe në shekullin e ri për degradimin e identitetit të bullgarëve në Maqedoninë e Veriut, për poshtërimin e vetëdijes së tyre etnike dhe për diskriminimin e tyre në sistemin arsimor, mediatik, ekonomik, politik dhe shoqëror.

Keqpërdorimi i termave “fashizëm”, “fashist/e”

Ideologjia komuniste jugosllave ka përdorur etikimin “fashist” dhe “bashkëpunëtorë të fashistëve” që të arsyetonte dhe të motivonte vrasjen dhe përndjekjen e oponentëve politikë, por edhe shtypjen e të drejtave të disa popujve në Jugosllavi. Edhe sot në Maqedoninë e Veriut vazhdon përdorimi i kësaj ideologjie për linçime dhe për njollosje të komunitetit bullgar, por edhe jo vetëm. Vërehet se edhe ca historianë dhe gazetarë shqiptarë i kanë rënë pre propagandës komuniste dhe jugosllave për gjoja “Bullgarinë fashiste” dhe “bullgarët fashistë”. Janë të nevojshme disa sqarime të shkurtra në lidhje me këtë temë. Në Bullgari në periudhën 1941-1944 nuk ka pasur as regjim fashist, as politikë “fashiste”. Ky konstatim provohet shumë lehtë duke analizuar karakteristikat e regjimit autoritar bullgar, të cilit i kanë munguar të gjitha tiparet e shteteve dhe të ideologjive fashiste/naciste – partia e vetme, ideologjia totalitare, kontrolli i rreptë mbi popullsinë etj.¹¹³.

¹¹³ Shih p.sh. konceptet e hulumtuesve si Hannah Arendt (Аренд, Хана. Тоталитаризмът. София, 1993).

“Okupimi” i një pjese të Maqedonisë në prill 1941 faktikisht ka sjellë liri për shumicën e qytetarëve, sepse alternativa ka qenë sundimi nacist. Shumica e oficerëve dhe të ushtarëve të Armatës së Pestë bullgare kanë qenë me prejardhje nga Maqedonia, kurse shumica e administratorëve kanë qenë bullgarë vendës. Bullgaria ka investuar shumë mjete financiare në këto troje, madje edhe me një përqindje më të lartë në krahasim me territoret e vjetra bullgare¹¹⁴. Nuk duhet të harrohet se kjo zonë ka qenë “nën administrimin e përkohshëm bullgar” dhe statuti i saj, sipas planeve gjermane, do të përcaktohej pas Luftës. Për këtë arsye gjermanët kishin ruajtur pozicione të forta në Maqedoni – kontroll mbi pikët strategjike, mbi minierat, hebrentë nuk kishin marrë nënshtetësi bullgare sipas kushtit gjerman. Në këto troje ka pasur një lëvizje të zbehtë partizane, por kjo ka qenë vetëm me prapavija ideologjike dhe assesi me vija etnike. Lëvizja komuniste ka qenë rezultat nga prirjet prokumuniste/projugosllave të një pjese tepër të vogël të këtyre viseve dhe shumica e partizanëve kanë qenë ushtarë bullgarë që kishin dezertuar nga ushtira bullgare. Pra, edhe një pjesë prej komunistëve në Maqedoni kanë qenë me vetëdije bullgare dhe kanë qenë nën kontrollin e Partisë punëtore bullgare (komuniste) deri në vitin 1943. Atëherë, pas presionit të vazhdueshëm të Titos dhe të Moskës çetat komuniste në Maqedoni kanë kaluar nën petkun e komunistëve jugosllavë. Regjimi autoritar bullgar ka kryer shumë mizori ndaj kundërshtarëve majtistë, por ato kanë qenë të motivuara nga urrejtja ideologjike dhe shumica dërrmuese prej këtyre akteve ishin kryer në territoret e vjetra bullgare¹¹⁵. Shteti komunist e ka përdorur etikimin “fashist” që të bënte gjenocid kundër bullgarëve në Maqedoni. Komunistët jugosllavë e kanë përdorur këtë skemë për etikimin e rrejshëm kundrejt organizatave nacionaliste dhe kundër veprimtarëve nacionalistë bullgarë dhe shqiptarë, por edhe kundër popullatës gjermane p.sh., që ka përjetuar përndjekje të tmerrshme nga partizanët komunistë. Po, nuk ka dyshim që edhe shumë gjermanë në Jugosllavi kanë marrë pjesë në krimet e

¹¹⁴ Никифорова, Сия. Българската стопанска политика във Вардарска Македония (1941-1944). МНИ, София, 2018.

¹¹⁵ Për administrimin bullgar në trojet e Maqedonisë së Vardarit shih: Българското управление във Вардарска Македония (1941-1944). Документален сборник. Държавна агенция „Архиви”, София, 2011.

nacizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore, por veprimet kundër civilëve gjermanë nuk mund të justifikohen. Sa patriotë shqiptarë ishin pushkatuar, ishin torturuar, ishin burgosur nga regjimet totalitare të Titos dhe të Hoxhës me pretekstin “fashist”? Greqia e ka ndjekur pikërisht këtë “model” duke e falsifikuar historinë se çamët paskan qenë “bashkëpunëtorë” të nazistëve për ta “justifikuar” gjenocidin kundër tyre. Historianët dhe gazetarët shqiptarë që përdorin pa dashje parulla propagandiste kundër Bullgarisë dhe bullgarëve nga koha jugosllave, do të ishte mirë që të kuptojnë se çdo përdorim të tillë patjetër do t’u kthehet si bumerang shqiptarëve. Pra, këto elemente dhe propaganda nga historiografia manipulese serbomadhe duhet të hiqen dhe kjo periudhë të trajtohet në mënyrë të drejtë.

Pretendimet territoriale dhe për minoritetet (arsyetimet e krimeve të komunizmit)

Pretendimet ndaj territorit bullgar janë të palejueshme, jo vetëm për shkak të shkëljes të së drejtës ndërkombëtare, por edhe për shkak të armiqësisë së hapur ndaj një vende anëtare të BE-së. Ky lloj pretendimesh janë produkt të ideologjisë së vjetër jugosllave dhe ka shumë shembuj në librat mësimorë në Maqedoninë e Veriut, ku sfidohet integriteti territorial dhe sovraniteti i Bullgarisë. Kështu, në librin e gjeografisë për vitin e dytë të gjimnazit mund të lexohet se: “...pjesa e Pirinit ishte e okupuar prej Bullgarise (6 798 km², ose 9,9%), por edhe një pjesë e vogël i takonte edhe Shqipërisë (802 km² ose 1,2%)”¹¹⁶.

Po në të njëjtin libër: “Në cilat kufij etnik Maqedonia përfshin sipërfaqe prej 68 451 km². Prej tyre Republikës së Maqedonisë i takojnë 25 713 km² (ose 37,5%), pastaj 34 411 km² (50,3%) gjenden në Greqi, pastaj 6 798 km², (9,9%) në Bullgari, 802 km² (1,2%) në Shqipëri dhe në Serbi dhe Mal të Zi 727 km² (1,1%)”¹¹⁷. Pastaj në këtë libër paraqitet teza se në Bullgari paska 400 000 maqedonë, që nuk i kanë “të drejtat e plota”. Madje autorët e librit mësimor shprehin shpresën se “në periudhën e ardhshme qeveria bullgare

¹¹⁶ “Gjeografia e Republikës së Maqedonisë për vitin II të gjimnazit të reformuar”, Prosvetno dello, Shkup, 2015, f. 9.

¹¹⁷ Po aty, f. 17.

do të ketë raport edhe më liberal lidhur me pakicën e maqedonasve dhe të tjerëve”¹¹⁸.

Edhe në librat mësimorë të historisë vazhdojnë akuzat e pabazuara: “U bë një periudhë e akuzimeve të rënda, mohimi i gjuhës dhe kulturës maqedonase. Mosnjohja e gjuhës, historisë dhe kulturës maqedonase vazhdon deri ditët e sotshme”¹¹⁹.

Këto tekste janë në kundërshtim edhe me vetë Kushtetutën Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku thuhet se “1. Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje” (Amendamenti I).

Shumë politikanë në Maqedoninë e Veriut kanë pretendime për “pakicë maqedone” në Bullgari, por me këto veprime shkelin edhe Traktatin e Miqësisë (neni 11, pika 5). Duhet të sqarojmë se bullgarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut kërkojnë përfshirjen e tyre në Kushtetutën e vendit si pjesë e popullit bullgar dhe të marrin të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që burojnë nga ligjet vendore. Ata i kanë të gjitha argumentet për këtë kërkesë – prezenca e bullgarëve në këto troje ishte regjistruar nga shekulli VII këndej me mijëra dhe mijëra prova të ndryshme. Mbi 100 000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë marrë edhe nënshtetësi bullgare duke vetëdeklaruar origjinën dhe vetëdijen e tyre bullgare me paraqitjen e dokumenteve të nevojshme. Bullgaria i mbështet kërkesat e tyre dhe nuk ndërhyr në rendin kushtetues të Maqedonisë së Veriut, sepse disa komunitete të tjera janë përfshirë në Amendamentin IV të Kushtetutës së saj. Modeli kushtetues i Republikës së Bullgarisë është model liberal që bazohet mbi mbrojtjen e të drejtave individuale. Secili komunitet etnik dhe fetar i ka të drejtat e tyre të plota kulturore dhe të drejtën individuale për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit. Pra, nuk mund të ketë kërkesa për ndryshimin e modelit kushtetues të Bullgarisë nga ana e qeveritarëve të Shkupit. Një argument tjetër që na shtyn të jemi shumë të kujdesshëm me paraqitjen e “komunitetit maqedon” në Bullgari, janë krimet e komunizmit. Është e vërtetë se shteti komunist bullgar nën presionin e fortë sovjetik dhe jugosllav në vitet 1948 dhe 1956 kishte regjistruar mbi një qind mijë “maqe-

¹¹⁸ Po aty, f. 108.

¹¹⁹ “Historia për vitin e tretë”, Prosvetno Dello, Shkup, 2018, f. 226.

donë” në Bullgarinë Jugperëndimore përmes dhunës dhe makinerisë totalitare. Por, çdo argumentim që do ta përdorte krimin komunist, është jovalid nga pikëpamje morale dhe shkencore. Ky pohim vlen edhe për historinë shqiptare – as “vendimi i vullnetshëm” për përfshirjen e Kosovës në Serbi (Jugosllavi) në vitin 1945, as të dhënat nga “regjistrimi” i popullsisë në Maqedoninë e atëhershme në vitin 1953, nuk mund të pranohen si pikë referuese për proceset e tanishme politike. Gjithsesi, secili qytetar bullgar, që ndihet maqedon e ka këtë të drejtë dhe mund t’i realizojë të drejtat e tij kulturore dhe politike në kuadër të ligjeve bullgare. Organizata politike të maqedonëve në Bullgari nuk regjistrohen nga gjykatat, sepse në statutet e tyre ato deklarojnë hapur që kanë qëllime separatiste ndaj Republikës së Bullgarisë, derisa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrton mundësitë për krijimin e shoqatave dhe nuk merret me çështje të sigurisë kombëtare. Prirjet separatiste nuk janë të lejueshme në asnjë vend në Evropë dhe nuk mund të rrezikohet integriteti territorial i vendeve evropiane.

Respektimi i traktateve dhe i vlerave evropiane

Mënyra e zgjidhjes së këtyre dukurive negative që Maqedoninë e Veriut e mbajnë “peng” të së kaluarës totalitare, janë përfshirë në Traktatin e miqësisë, nënshkruar më 1 gusht 2017 nga Bullgaria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Atje thuhet shprehimisht se nëse ka mosmarrëveshje për periudha, ngjarje ose figura historike, ato duhet të zgjidhen mbi bazën e “burimeve historike, të bazuara mbi prova autentike për trajtimin shkencor të ngjarjeve historike”, (neni 8, p. 2). Prandaj janë të papranueshme të gjitha përpjekjet për moszbatimin e këtij traktati dhe për mbrojtjen institucionale të falsifikimeve totalitare. Një shembull i keq në këtë drejtim ishte votimi i “Rezolutës për përcaktimin e pozitave shtetërore maqedonase në kontekst të bllokimeve të evrointegritimeve”. Me të drejtë menjëherë reagoj edhe Ministria e Jashtme e Bullgarisë: “Për Bullgarinë do të ishte plotësisht e papranueshme përmes akteve të tilla të motivohet ose të arsyetohet mospërbushja e Traktatit të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit nga viti 2017, që hyn në kundërshtim me parimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare. Rruga e vetme e drejtë për gjetjen e vendimeve të qëndrueshme dhe të

pranueshme në mënyrë të ndërsjellë për sfidat aktuale në marrëdhëniet tona, është prëmbajtja strikte ndaj marrëveshjeve të arritura dhe ndaj angazhimeve të marra përsipër, përmeshja e tyre efektive dhe me përkushtim, si edhe përmes realizimit të dialogut të plotë dhe të sinqertë”¹²⁰.

Kërkesat që “të respektohen studimet shkencore maqedonase në lidhje me autoktoninë e popullit maqedonas dhe vazhdimësinë historike, gjuhësore, kulturore. Të respektohen studimet shkencore, sipas të cilave gjuha maqedonase dhe dialektet e saj kanë vazhdimësi hapësinore dhe kohore”, janë në kundërshtim të plotë me të vërtetën historike. “Të respektohen studimet shkencore maqedonase” do të thotë se nuk duhet të respektohen fare studimet e tjera të mirëfillta shkencore nga e gjithë Evropa (përfshirë këtu edhe nga shkencëtarë shqiptarë). Prandaj, ishte e çuditshme që edhe shumë deputetë shqiptarë në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut votuan në mbështetje të kësaj rezolute, sepse “të respektohen studimet shkencore maqedonase” do të thotë se partitë shqiptare në Maqedoninë e Veriut kanë votuar edhe për këto “arritje” të “studimeve shkencore maqedonase”, që mund të lexohen në librat mësimorë të këtij shteti dhe/ose në monografitë e “akademikëve” maqedonë: shqiptarët paskan qenë ardhacakë në trojet e Maqedonisë dhe të Kosovës; Skënderbeu dhe familja e tij, Nëna Tereza edhe personalitete të tjera shqiptare paskan qenë me origjinë “maqedone”; shqiptarët në Jugosllavi qenkan shpërngulur në mënyrë vullnetare drejt Turqisë dhe vendeve të tjera; e shumë të tjera.

Mund të jepen edhe shumë shembuj të tjerë për falsifikime të ndryshme të kulluara në “studimet shkencore maqedonase”, por me rëndësi është fakti që partitë maqedone përmes deklaratës së tyre dëshirojnë të bllokojnë edhe rrugën evropiane të vendit, duke vazhduar përkrahjen për ideologjinë e tyre destruktive.

Për këto arsyë është e nevojshme që Maqedonisë së Veriut t’i jepet ndihmesë nga jashtë. Optimizmi në Bullgari në këtë drejtim vjen nga fakti se të gjitha kërkesat bullgare dhe sidomos këto të lidhura me trajtimin e çështjeve historike dhe me të drejtat e komunitetit bullgar në Maqedoninë e

¹²⁰ Deklarata e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë në lidhje me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pranuar më 29 korrik 2021. Në: <https://www.mfa.bg/bg/news/30653> Qasja e fundit më 31 maj 2022.

Veriut, janë përfshirë në shumë dokumente të Bashkimit Evropian. Në Rezolutën e fundit të Parlamentit Evropian (PE) në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut, votuar më 19 maj 2022, janë përfshirë të gjitha kërkesat bullgare që kanë për qëllim reformimin e thellë të këtij shteti¹²¹:

Në pikën 28 PE “rikujton se është me rëndësi që të mbrohen të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe t’u kundërvihet në mënyrë efektive të gjitha rasteve të diskriminimit; shtyn qeverinë që të garantojë mbrojtjen e barabartë në Kushtetutë të të drejtave të të gjitha komuniteteve etnike, kur përkon me qëllimet e saj, dhe të mbrojë dhe të pormovojë trashëgiminë, gjuhët dhe traditat e tyre kulturore përmes qasjes jodiskriminuese dhe afruese në fushën e arsimit dhe të mediave”;

Në pikën 31 PE “thërret për përmirësime shtese në lidhje me realizimin e të drejtave të njerëzve, që janë pjesë të komuniteteve jo shumicë, përfshirë të vetëvendosjes. Thekson rëndësinë e rishqyrtimit dhe të pranimit të akteve normative në fushën e arsimit, që e heqin përmbajtjen diskriminuese dhe linçuese dhe është harmonizuar me Ligjin për parandalimin e diskriminimit”;

Në pikën 37 PE “...rreptësisht e dënon retorikën nxitëse dhe thërret me këmbëngulje për përforcimin e përpjekjeve të ndërsjella për parandalimin dhe përndjekjen penale të të gjitha rasteve të deklaratave që shtyjnë drejt urrejtjes dhe armiqësisë, si edhe krimet nga urrejtja, të bazuara mbi origjinën kombëtare ose etnike”;

Në pikën 39 PE “rikujton nevojën për hapjen e arkivave të Shërbimit sekret jugosllav (UDBA) dhe të Shërbimit sekret të Ushtrisë popullore jugosllave (KOS)”;

Në pikën 76 PE “thërret për pajtim historik mbi bazën e historisë së përbashkët, si është paraparë në Traktatin për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim”;

Në pikën 79 PE “thërret përsëri të gjithë liderët rajonalë politikë që të krijojnë një komision rajonal për sqarimin e fakteve sa i përket të gjitha

¹²¹ Rezoluta e Parlamentit Evropian në lidhje me Raportin e Komisionit për Maqedoninë e Veriut nga data 19 maj 2022. Në: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0213_EN.html. Qasja e fundit më 31 maj 2022.

viktimize të krimeve të luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë”;

Në pikën 80 PE “thërret me këmbëngulje për rifillimin e punës në lidhje me librat mësimorë në lëndën e historisë për shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut; thekson se tekstet duhet të paraqitin trajtimin e fakteve dhe të ngjarjeve historike nga historia e përbashkët të të dy popujve mbi bazën e dokumenteve/burimeve autentike historike; mendon se kjo është baza mbi të cilën të dyja shtetet duhet t’i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre, dhe se marrëdhëniet midis brezave të ardhshme të Maqedonisë së Veriut dhe të Bullgarisë do të jenë reflektime të proceseve arsimore në të dyja shtetet”;

Në pikën 81 po dënohet çdo përpjeje për zëvendësimin e monumenteve historike dhe/ose të artefakteve, përfshirë shkatërrimin e trashëgimisë autentike kulturore, si edhe të gjitha përpjekjet për rishkrimin e historisë; thekson se incidente të tilla shkaktojnë shqetësime serioze, përfshirë edhe në kontekstin e mungesës së përmbushjes së Traktatit për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim nga viti 2017.

Përfundime

Për fat të keq shoqëria në Maqedoninë e Veriut ende nuk ka treguar se i posedon resurset qytetare që të reformojë shtetin dhe institucionet e saj në mënyrë të thellë dhe të pakthyeshme me qëllim që të gjitha komunitetet të jenë plotësisht të barabarta dhe të respektohen të gjitha të drejtat e tyre dhe sidomos identiteti i tyre. Për këtë arsye, në Maqedoninë e Veriut duhet të ketë debate të sinqerta për rrugën që duhet të ndjekë ky shtet në të ardhmen që të arrihen qëllimet strategjike, të lidhura në mënyrë të ngushtë me integrimin e plotë në BE.

Vetëm me pranimin dhe me realizimin e të gjitha vlerave evropiane Maqedonia e Veriut mund të shkojë përpara drejt anëtarësimit të shpejtë në BE dhe të shkëputet nga e kaluara jugosllave. Vazhdimi i promovimit të ideologjisë së vjetër prej Shkupit do të nënkuptonte jo vetëm që të mos zhvillohet një shoqëri me barazim të plotë për të gjithë qytetarët, por edhe

mosmarrëveshje të ashpra me Bullgarinë në vitet dhe madje në dekadat në vijim, që do të rrezikonte rregullist procesin e anëtarësimit.

Në këtë proces përgjegjësinë e vetë e kanë edhe disa faktorë të jashtëm. Çdo përpjekje për mohimin dhe nënçmimin e qytetërimit dhe të identitetit bullgar nga ekspertë të ndryshëm do të thotë se ata janë propagandues të ideologjive të vjetruara dhe vazhdojnë me avazin e dikurshëm që ka sjellë kaq katastrofa për Evropën. Këta ekspertë dhe institute duhet të hulumtojnë ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha në Ballkan, të zbardhin rolin e shteteve të tyre në gjenocidin kundër bullgarëve dhe shqiptarëve dhe të kërkojnë fajle për projektet e dikurshme hegjemoniste, dhe jo të krijojnë mosmarrëveshje të reja. Pra, kjo situatë është edhe një mundësi për politikanë, diplomatë dhe studiues nga disa vende evropiane të heqin dorë nga e kaluara kolonialiste e shteteve të tyre dhe të pranojnë përfundimisht barazinë e të gjitha kulturave evropiane.

Besnik RAMETI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

NDIKIMI I PROJEKTEVE HEGJEMONISTE NDAJ VONIMIT TË PROCESIVE INTEGRUESE TË VENDEVE TË BALLKANIT



Rezyme

Ky hulumtim merret kryesisht me historinë e popujve të Ballkanit të periudhës së shekujve XIX dhe XX, posaçërisht të shtetit grek dhe serb që janë përplasur me shqiptarët dhe krijuan dy projektet e rrezikshme me emrat Megali Idea (Ideja e Madhe) dhe Naçertanie, të elaboruara nga kryeministri grek Jorgos Koleti dhe nga ministri serb Ilija Garashanin. Këto dy projekte në veprimin e tyre janë jointegruese, por hegjemoniste, ku përmes realizimit praktik kanë arritur qëllimet e tyre t'i zgjerojnë territoret shtetërore. Me përkrahjen e shteteve evropiane dhe përmes spastrimit etnik, luftërave, vrasjeve, shpërnguljes me dhunë dhe gjenocidit, tentuan t'i zhdukën shqiptarët nga vatrat e tyre stërgjyshore. Edhe në fund të shekullit XX Serbia në Luftën e Kosovës (1998-1999), dëshmoi me projektin Patkoi synimin për shfarosjen e shqiptarëve dhe falë intervenimit të NATO-së u ndërpre plani eliminues i Serbisë ndaj Kosovës. Sot Serbia për të qenë vend anëtar i Bashkimit Evropian do të duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Nacionalizmat e shteteve ballkanike dhe projektet hegjemoniste

Megale Idea dhe Naçertania

Fuqitë e Mëdha të Evropës edhe Rusia në vitet e 80 të shek, XVIII, sytë i kanë nga Ballkani. Në këtë kohë Porta e Lartë po përballej me shkatërrimin

nga brenda, asaj ju deshtë të përballet me sulmet e reja të këtyre Fuqive të Mëdha.¹²²

Shekulli i XIX ishte njëri nga shekujt me zhvillime të mëdha jo vetëm tek shqiptarët dhe Gadishulli Ballkanik, por dhe në zhvillimet evropiane, pasi shumë nga zhvillimet evropiane, posaçërisht të shteteve që përbënin Fuqitë e Mëdha, diplomacia dhe gjeopolitika evropiane ndodhej para rënies së Perandorisë Otomane. Për mënyrën se si qe ndërtuar dhe kishte funksionuar kjo perandori, funksionimi dhe organizimi, politik që kishte ndjekur, marrëdhëniet që kishte krijuar me popujt dhe qeveritë e këtyre vendeve, kishte nevojë të vëzhgoheshin me kujdes të madh.

Në këtë kohë zhvillimesh të shpejta dhe thelbësore, kur popujt ballkanik, qofshin shqiptarët dhe grekët që ishin ndër më të vjetërit e tij, por dhe sllavët, të cilët prireshin në histori nga mbretëritë e tyre të njohura me pushtet të hershëm prej pushtimeve deri në Greqi, po kërkonin të evidentoheshin, të njiheshin si shtete në kuadër të reja që po pësonte Ballkani. Kjo periudhë, veçmas me fillimin e aktivitetit politik, kulturor dhe letrar të Rilindjes Shqiptare, si gjithë popujt e tjerë ballkanik u zgjua interesi i kërkesave kombëtare, me qëllim që të merrnin në dorë dhe të drejtonin Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.¹²³

Duhet shikuar mirë se në vitin 1830, tri fuqitë, Franca, Britania e Madhe dhe Rusia me traktat ndërkombëtare e krijuan Greqinë si një mbretëri të pavarur.¹²⁴ Kështu, ky shtet filloi zhvillimin e vet politik, së paku në letër, një hap përpara Serbisë, autonomia e së cilës vetëm qe përcaktuar atë vit.¹²⁵ Në këtë periudhë të gjysmës së parë të shek. XIX do të paraqiten dy projektet shoviniste të cilët ishin shfaqur hapur, kishin një lloj mbështetje nga Fuqitë e Mëdha të Perëndimit, por më së shumti kishte interes Rusia, e cila e përkrahte botën sllave në Ballkan¹²⁶, ku mbështeste serbët dhe grekët, për

¹²² Charles & Barbara Jelavich, *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1920*, Tiranë, 2004, f.28.

¹²³ Skender Asani, *Shqiptarët e Shkupit ndër shekuj*, Shkup, 2009, f.139.

¹²⁴ Charles & Barbara, *vep. e cit.*, f.70.

¹²⁵ *Po aty*, f.70.

¹²⁶ Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit shekulli XVIII – XIX*, Tiranë 1999, f.196.

shkaqe fetare dhe daljes në ujërat e Mesdheut dhe Adriatikut për të treguar forcën e vetë ndaj shteteve evropiane.

Me ardhjen në pushtet të kryeministrit Jorgos Koleti në Greqi ai do të paraqes projektin shovinist kombëtar të Greqisë së Madhe të quajtur Megale Idea, ku kjo platformë u ngrit në Asamblenë Kombëtare të Greqisë në vitin 1844, kryeministri Jorgos Koleti e shpalli atë themel të shtetit të Greqisë.¹²⁷ Megale Idea është projekt i cili mbështetet në lashtësinë e historisë dhe kulturën e Greqisë. Kjo kulturë e lashtë greke, ishte joshëse për gati gjithë vendet perëndimore.

Megale Idea si projekt paraqet një konflikt të gjerë dhe të ashpër në Ballkan veçanërisht, sepse me rënien e Kostandinopojës në vitin 1453, politika hegjemoniste e ndihmuar dhe nga autoriteti i besimit ortodoks kishte rënë. Gjatë kësaj kohe përmes Kishës Ortodokse dhe autoritetit të Patriarkut (që ishte shumë i fuqishëm) grekët diktonin jo vetëm në Ballkan, por dhe më gjerësisht, duke i bërë grekët diktues dhe me pushtet të padiskutueshëm, me një hierarki interesante, me perceptimet e një shteti të rimëkëmbur, me një histori të shkuar të ndritur që nga antikiteti.

Duke shikuar rrethanat lidhur me territoret shqiptare, Megale Idea është e njohur me pretendimet territoriale të Greqisë deri në Shkumbin, e sigluar me emrin Vorio - Epiri, me ç'rast ata kërkojnë aneksimin pa kushte të krahinës së Korçës dhe të Gjirokastrës.

Kjo ngjarje dëshmohej se një nga rastet e ushtrisë greke, e cila aksionin e saj kundër popullsisë çame e shoqëroi me krime e masakra të llahtarshme duke vrarë e duke djegur. Megali Ideja nuk u ndalua, përkundrazi ajo u mbështet në një lloj kuptimi dhe në Kongresin e Berlinit, duke i njohur asaj, sipas rekomandimit të tij që vilajeti i Janinës, qytetet dhe rajonet e Janinës, Prevezës, Artës e Paramithisë t'i jepeshin Greqisë.

Qysh me kryengritjen e parë serbe 1804, do të paraqiten idetë e zgjerimit territorial në Ballkan. Projekti më ideor dhe serioz ka qenë ai i Ilija Garashanin në vitin 1843, i cili ka qenë Ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e Serbisë.¹²⁸

¹²⁷ Charles & Barbara, *vep. e cit.*, f.78.

¹²⁸ Mirko Grmek, Marc Gjidara, Neven Shimac, *Spastrimi Etnik*, Tiranë 2002, f.61.

I një natyre nacional-shoviniste është dhe projekti tjetër i shpallur në vitin 1844 nga Ilia Grashanini, një projekt i cili me të drejtë mund të thuhet se ka themeluar dhe kolanën e projekteve nacional - shoviniste kundër shqiptarëve. Projekti i ashtuquajtur shteti serb, mbahet si gurthemeli, mbi të cilin është mbështetur gjithë lufta dhe angazhimi i shtetit problematik sllav, i njohur si Serbia, i cili është shpallur që nga viti 1844 e më pas, në të gjithë rastet dhe rrethanat historiko-politike të Serbisë, sa herë që në skenë kanë dalë mundësi dhe rrethana për t'i elaboruar ato.¹²⁹

Naçertania është projekti i rëndë, vrastar, mbi të cilin janë ndërtuar mekanizma shfarosëse ndaj shqiptarëve, është shtrembëruar deri në absurditet e drejta etnike me çështjet historike, janë ndërtuar harta territore të shumta mbi tokat shqiptare, e që për t'i bërë ato efektive dhe si të vërteta është mbjellë gjak dhe terror mbi popullsinë e pafajshme. Janë ndërtuar dhjetëra herë dëbime masive me dhunë dhe spastrime etnike të shqiptarëve nga trojet e tyre për në Anadoll dhe në vende të tjera të largëta.

Projekti Gashanin ka pak a shumë të njëjtin qëllim, si ai i Megali Idesë së Koletit, pasi si njëri dhe tjetri synojnë shtrirjen e shtetit të tyre në tokat shqiptare, pavarësisht se motivacionet janë të ndryshme, njëra për “atdheun e grekëve” dhe tjetra “për krijimin e shtetit serb. Projekti ishte një “elaborat” i kompletuar, pasi në të kishte pasqyrë të mirëstudiuar mbi territoret që synonte Serbia si Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria e Veriut, si dhe të gjitha zotërimet turke me banorë serb. Shqipëria përveç pasurive të mëdha që kishte, ajo i mundësonte Serbisë një dalje jugore në det, gjë që do të shmangte rrezikun e bllokimit Austriak të tregtisë së jashtme serbe.

Kjo bëhej jo mbi termat e Naçertanies, jo me motivacionin e vjetër, të një “shteti” serb, i cili kërkonte kufijtë e vet në hapësirën ballkanike, kur ata (serbët) ishin pushtues, por për shkak të ekuilibrave euro- ballkanik, Kongresi i Berlinit ishte një lloj mbështetësi i kësaj platforme të njohur nacional-shoviniste.¹³⁰

¹²⁹ Po aty, f. 70.

¹³⁰ Po aty, 78.

Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit copëtuan tokat shqiptare

Ushtria Ruse në fillim të vitit 1878, në çdo front korrnin fitore ndaj ushtrisë osmane. Disfata e ushtrisë osmane i shqetësoi të gjitha Fuqitë e Mëdha e posaçërisht Britaninë e Madhe e cila dërgoi flotën luftarake në detin Marmara. Pas këtyre humbjeve në Evropë dhe Azi, Perandoria Osmane ishte e detyruar të pranojë armëpushimin me rusët dhe të zhvillojë bisedime me ta. Kështu ndërmjet dy palëve erdhi deri te nënshkrimi i Marrëveshjes së Shën Stefanit më 3 mars 1878. Atë e nënshkroi Safet Pasha, sepse ajo gjithsesi përmban kushte të rënda për Perandorinë Osmane.¹³¹

Traktati i Shën Stefanit nuk i kishte shqetësuar vetëm shqiptarët, por me të ishin shqetësuar edhe shtetet e mëdha evropiane Anglia dhe Austro-Hungaria, të cilat nuk dëshironin që ndikimi Rusë të shtohet në Ballkan. Kushtet e paqes do të jenë tepër të rënda për perandorinë Osmane e cila parashihte 9 kërkesa dhe me këtë marrëveshje Rusia cariste i shkëputte Perandorisë Osmane në Ballkan dhe në Kaukaz territore me një sipërfaqe prej 350 mijë km². Qëllimi i Ruisë ishte që me krijimin e Bullgarisë së madhe të dalë në ujërat e ngrohtë të Mesdheut dhe Adriatikut.

Në bazë të traktatit të Shën Stefanit tre shtetet (Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi) kishin këto përfitime territoriale: Bullgaria e cila ishte pjesë e Perandorisë Osmane morri një sipërfaqe prej 172,5 mijë km², Mali i Zi i cili më 1877 kishte një sipërfaqe prej 4,7 mijë km² e rriste deri 15,7 mijë km², kurse Serbia nga 37,7 mijë km² arrinte deri 52,7 mijë km².¹³²

Paqja e Shën Stefanit jo vetëm që i përlligjite pushtimet e fqinjëve ballkanik mbi trojet periferike shqiptare, por edhe u aneksonte vise të tjera. Perandoria Ruse e gjymtonte rëndë tërësinë tokësore të Shqipërisë dhe e vështirësonte tejet luftën e Popullit Shqiptar për krijimin e shtetit kombëtar¹³³.

¹³¹ Ali Muhamed Salabi, *Perandoria Osmane Faktorët e Ngritjes dhe Rënies së sajë*, Prishtinë 2009, f.444

¹³² Zeqirja Idrizi, *Historia e Diplomacisë*, Prishtinë 2013 f.92-93.

¹³³ Shaban Braha, *Gjenocidi Sërbo-Madh dhe qëndresa Shqiptare 1844-1990*, Tiranë, 1992, f.55

Perandoria Ruse tokat shqiptare i konsideronte si toka Osmane. Me 12 prill të vitit 1878 Abdyl Frashëri shkruante se Cari Rus nuk do të ndalej vetëm me këtë copëtim të trojeve shqiptare dhe se ky traktat ishte vetëm hap i parë drejtë asgjësimit të plotë të Shqipërisë.¹³⁴ Dukej se shumica e Shqipërisë do të vihej nën dominimin e sllavëve edhe të kishës ortodokse.¹³⁵

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Kongresi i Berlinit

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të luftës së Popullit Shqiptarë për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit edhe për çlirimin Kombëtar.¹³⁶ Lidhja Shqiptare e Prizrenit u krijua nga ideologët dhe veprimtarët më të shquar të Rilindjes Kombëtare të cilët kuptuan lojërat diplomatike të fuqive të mëdha të cilat për interesat e veta ruanin ekuilibrin e balancuar ndërmjet vete të cilët erdhën si rezultat i viteve të 70 të shekullit XIX të cilët kishin qëllim për dominim kolonial në botë duke shkelur dhe bërë padrejtësi mbi tërësinë territoriale të popullit shqiptarë të cilët ishin pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane kur ajo gjendej me një gjendje të vështirë ekonomike, politike, financiare dhe ushtarake kjo do të vije si rezultat i revidimit të paqes së Shën Stefanit dhe pakënaqësive të krijuara nga fuqitë evropiane që do të thirrnin Kongresin e Berlinit, edhe pse për një periudhë shumë të shkurtë kohore, 3 mars 1878 dhe 13 qershor 1878, trangu i inteligjencies shqiptare vetëdijesuan popullin shqiptarë që brenda tre muajve të motivon të gjitha krahsinat, që tri ditë para Kongresit të Berlinit më 10 qershor 1878 do të thirrnin Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë akt populli shqiptarë provoj jo vetëm se ekzistonte tani më si një komb i formuar dhe i bashkuar por krahas kësaj tregoj dëshirën e tij të zjarrtë dhe të aftë si në aspektin diplomatik dhe atë luftarak për të mbrojtur paprekshmërinë e trojeve të veta, dhe për të themeluar shtetin e vetë kombëtar.

¹³⁴ Kristo Frashëri, *Vep e cit* f.144,145.

¹³⁵ Edwin Jacques, *Shqipëtarët Historia e popullit Shqipëtarë nga Lashtësia deri në ditët e sotëme*, Tiranë 1995 f.286.

¹³⁶ Instituti i Historisë, *Lidhja Shqipëtare e Prizrenit në dokumentet Osmane 1878-1881*, Tiranë 1978 f.3.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u mbajt më 10 qershor të vitit 1878 ku morën marrin pjesë të gjithë delegatët nga trojet shqiptare të 4 vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës. Kuvendi kombëtar i Prizrenit punimet i filloi më 10 qershor 1878 por atë ditë nuk morën pjesë të gjithë delegatët nga trojet shqiptare. Në fillim morën pjesë 110 figura të delegatëve shqiptarë të të gjitha shtresave të ndryshme ndër figurat më të shquara që merrnin pjesë në kuvendin e përgjithshëm ishin: Ali Pash Guçia, Iljaz Pash Dibra, Hasan Pash Tetova, Imer Prizreni, Abdullah Bej Dreni, Ahmed Koronica, Sulejman Vokshi, Zija Bej Prishtina, Jashar Bej Shkupi, Ali Ibra, Abdyl Frashëri dhe delegatë nga Bosnja, ku kryetar i kuvendit u zgjodh delegati më i moshuar Iljaz Pash Dibra.

Kjo platformë njihet si Kanuni - një petition që do t'i dërgohet Kongresit të Berlinit dhe Portës së Lartë. Të dyja petitionet u miratuan më 15 qershor të vitit 1878 që do t'i tregon Kongresit të Berlinit dhe Portës së Lartë se shqiptarët janë të gatshëm për të mbrojtur me çdo kusht tërësinë territoriale. Platforma e Lidhjes së Prizrenit parashihte një autonomi në kuadër të Perandorisë Osmane dhe qëllimi i saj ishte për të mbrojtur fronin e përbashkët të të gjitha forcave shoqërore, për të mos i dhënë shkak të shpërbërjes nga lëvizja krahut të saj të moderuar përfaqësuesit e të cilët ndonëse të cilit ishin të interesuar në ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit.¹³⁷

Kongresi i Berlinit punimet i filloj më 13 qershor 1878 dhe i përfundojë më 13 korrik 1878. Ky kongres ishte një nga mbledhjet më të mëdha diplomatike të shekullit XIX, ai ndryshonte nga kongresi i mëparshëm i Vjenës sepse kësaj here, fuqitë e mëdha nuk bënë ndonjë përpjekje për të fshehur faktin se ishin ato që do ti merrnin vendimet¹³⁸. Udhëheqës kryesor ishte Oton Bizmarku ai mbizotëroj mbledhjet dhe vendimet e Kongresit të Berlinit ndaj çështjes shqiptare vepruan në mënyrë të padrejtë sepse shteteve ballkanike si Serbia, Mali i Zi dhe Rumania u njohën si të pavarura nga sundimi Osman.

¹³⁷ Kristaq Prifti, *Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar*, Prishtinë 2008, f.28.

¹³⁸ Norman Rich, vep e cit, f.226 ; Zeqirja idrizi, vep e cit, f.94.

Në përgjithësi Kongresi i Berlinit veproi padrejtësisht ndaj shqiptarëve duke i nda disa territore në të mirë të shteteve Ballkanike. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ndaj veprimeve të Kongresit të Berlinit aktivitetet e saja i filloi në fushën diplomatike, ajo i dergoi kongresit shumë protesta dhe memorandumë për ruajtjen e integritetit të tokave shqiptare. Duke u mbështetur në dokumentet angleze, franceze, austro-hungareze dhe osmane përmes memorandumëve, patriotët shqiptarë iu drejtoheshin fuqive të mëdha dhe konjekturave politike ndërkombëtare që të jenë pro shqiptare duke shpresuar në Anglinë e cila ishte për krijimin e një Shqipërie të fortë që do ti kundërvihet interesave grabitqare të Ruisë cariste dhe shteteve sllave në Ballkan që përkraheshin Rusinë.

Memorandumi i parë që iu dërgua Kongresit të Berlinit ishte ai i 13 Qershorit, ky memorandum u përpilua nga një grup patriotësh shkodranë. Memorandumi iu dërgua Kryeministrit anglez Lordit Bikonsfill, përfaqësuesi i Anglisë në Kongresin e Berlinit, ku kërkohej që çështja shqiptare të shqyrtohet pasi që kombësitë tjera, në Perandorinë Osmane kanë një qeveri dhe një diplomaci që iu shpreh dëshira vetëm shqiptarët nuk kanë asnjëfarë përfaqësues.¹³⁹

Fuqitë e mëdha të Evropës janë mbledhur për të zgjedh çështjet e ligjshme në përbërje të çështjes së Evropës Juglindore, sigurisht nuk do të jetë i huaj zëri i shqiptarëve midis shumë të tjerëve, që kërkojnë drejtësi duke tërhequr vëmendjen e përfaqësuesve fuqiplotë. Në këto kushte lidhja mori në duar të veta fatin e kombit duke deklaruar në arenën ndërkombëtare se kurrkush nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi tokat e banuara prej shqiptarëve e t'i bënte ato monedhë këmbimi dhe se Zoti i vetëm i tyre ishte populli shqiptarë.¹⁴⁰

Lojërat diplomatike të Kongresit të Berlinit mbi fatin e shqiptarëve si pjesë e Perandorisë Osmane Shtetet Ballkanike Serbia, Mali i Zi dhe Greqia sipas vendimeve që kishte caktuar Kongresi i Berlinit dhe fuqitë tjera evropiane trojet shqiptare do të ndahen në të mirë të fqinjëve ballkanik dhe pjesa

¹³⁹ Qamil Gexha, *Marrëdhëniet Shqiptar-Malazeze 1839-1912*, Gjakovë, 2003, f.72-73 ; Gazmend Shpuza, *vep e cit*, f.87.

¹⁴⁰ Stefanaq Pollo, *Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirim dhe bashkim Kombëtar*, Tiranë 1990, f. 158.

tjetër do t'i takon Perandorisë Osmane. Kryengritësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i dëshmuar Kongresit të Berlinit, Perandorisë Osmane se gabimisht kanë vepruar ndaj trojeve dhe çështjes shqiptare edhe pse Lidhja do të shuhej me gjak nga porta e lartë nga Shtetet Ballkanike dhe Fuqitë Evropiane ajo do të ketë jehonën e vetë në ngritjen e vetëdijesimit të kombit shqiptar dhe përpjekja e Lidhjes së Prizrenit kishte në epiqendër themelimin e një shteti të bashkuar kombëtar.

Kushtetuta e Vidovdanit (1921)

Në krye të qarqeve dhe rretheve, shumicën dërrmuese të administratorëve dhe të udhëheqësve politiko-ushtarakë e përbënte kuadri serbo-kolonial i ardhur nga Serbia dhe viset e tjera sllave, por edhe elementi luajal vendës që kishte kontribuar për rikthimin e administratës borgjeze serbe.¹⁴¹

Pas stabilizimit të gjendjes dhe shtypjes së revoltave masive të popullatës shqiptare në të gjitha territoret, komanda ushtarake e Armatës së III-të dha pëlqimin për ndarjen e territorit në krahina. Kështu, më 1 nëntor të vitit 1919, territori i “Serbisë së Vjetër” (Serbisë së Jugut) u nda në tri krahina, përkatësisht në tri divizione ushtarake: të Kosovës, të Manastirit dhe të Vardarit. Kjo ndarje administrative-territoriale qëndroi në fuqi për një vit e gjysmë, deri më 28 qershor 1921, kur u miratua Kushtetuta e Vidovdanit. Sipas kësaj kushtetute këto territore të Mbretërisë do të ndahej në qarqe.¹⁴²

Ndarja e re në krahina, e cila u fut me projektligjin e 5 nëntorit të vitit 1921 dhe u bë me dekretligjin e 22 prillit 1922, ku parashihej formimi i 33 krahinave, si njësi tokësore administrative. Por, edhe pas shpalljes së dekretligjit, për zbatimin në praktikë të kësaj ndarjeje u deshën 3-4 vite. Ky riorganizim i njërive tokësore u bë ngaqë qarqet, duke qenë njësi tepër të mëdha, mund të ktheheshin në vatra të qëndresës së shqiptarëve kundër pushtetit serb.

¹⁴¹Петар Стојанов, *Македонија времето на балканските и Правата Светска Војна (1912-1918)*, Скопје, 1969, f.136; Bogomil Hrabrak, *Stanje u Vardarskoj Makedoniji u Jesen i zimu 1918*, “Istoriski Glasnik”, 1966, f.27.

¹⁴² Marija Jovanović, *Prosvetno – politički prilici vo Vardarska Makedonija (1918-1929)*, Shkup, 1983, f.38.

Ndarja e trefishtë ushtarake-policore-civile, si dhe caktimi i kufijve bëhej në atë pjesë ku popullsia e tyre ishte etnikisht e përzier. Me këtë kishin si qëllim t'u mohoheshin të drejtat kombëtare shqiptarëve, shiheshin etnikisht “si të huaj”, donin të dobësohej bashkimi e qëndresa e popullit shqiptar dhe të lehtësohej serbizimi i këtyre trevave. Për këtë punonin edhe organet vendore, të cilat nëpërmjet shpërnguljes së shqiptarëve dhe kolonizimit të brendshëm bënë lëvizjen dhe rishpërndarjen e popullsisë sllave brendapërbrenda krahinës, pra sillnin popullsi serbe dhe i vendosnin në viset shqiptare.¹⁴³

Sipas hierarkisë qeverisëse, krahinat e Kosovës, Maqedonisë së Vardarit në krye kishte zhupanin e madh, i cili emërohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mbreti. Zhupani nëpërmjet organeve shtetërore i qeveriste të gjitha punët administrative në krahinë. Sipas nenit 98 të kësaj kushtetute, organet e tjera administrative të krahinës ishin: kuvendi krahinor dhe këshilli krahinor. Ndërsa neni 135 parashihte që qarqet si njësi administrative shtetërore të mbeten përderisa këto nuk hiqen me ligj. Kushtetuta e Vidovdanit nuk dha zgjidhje definitive në lidhje me ndarjen e vendit në krahina. Por një ndarje e tillë do të bëhej më vonë me anë të legjislaturës së rëndomtë. Mirëpo, autonomia e krahinave ka ekzistuar normalisht nga vitit 1921 deri 1925.¹⁴⁴

Konventa Jugosllave-Turke (1938)

Me formimin e Qeverisë së Millan Stojadinoviçit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë filluan konsultimet intensive lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme ilegalisht u formua Komiteti i Ngushtë, i cili në korrik 1935 duhej të përgatiste një maket-projekt për shpërnguljen e shqiptarëve. Më 24 shtator 1935, Komiteti i Ngushtë analizoi projektin në harmonizim me Ligjin e Shtetësisë, neni 55, të cilin ia dërgoi forumit të themeluar nga Këshilli i Ministrave. Kjo konferencë ndërministrrore u realizua enkas për shpërnguljen e popullatës me prejardhje joslave nga e ashtuquajtura Serbi Jugore, më 1 te-

¹⁴³ Merenglen Verli, *Reformat agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*, Tiranë, 1992, f.55-56.

¹⁴⁴ Limon Rushiti, *Rregullii administrative i Kosovës (1918-1929)*, në “Përparimi”, Prishtinë, 1976, f.256.

tor 1935 në Beograd, nën kryesinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ilija Milikiqit.

Në këtë gjendje kaotike, kur shqiptarët protestonin me të madhe kundër politikës kolonizuese jugosllave, në Ankara u mbajt një mbledhje ndërministrore e këshillit të vendeve ballkanike, e ashtuquajtur “*për marrëveshje*”, më 25-27 shkurt 1938. Në këtë takim, përveç të tjerave, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë doli me propozim për shpërnguljen e myslimanëve të vendeve ballkanike në Turqi.

Këtë propozim, qeveria jugosllave e priti pa durim, duke marrë masa përgatitore që ky problem për shpërnguljen e myslimanëve të fillonte sa më parë, ku prapa kësaj fshihej shpërngulja e shqiptarëve, qarqet jugosllave ishin të interesuara së pari për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova, Maqedonia dhe Sanxhaku.¹⁴⁵

Menjëherë, pas vendimit të Këshillit Ballkanik të 25-27 shkurtit 1938, u realizua mbledhja në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë me pesë konferenca brendaministrare, me qëllim që të përgatitin materialin për të hyrë në bisedime me qeverinë turke, dhe në bazë të tyre, përgatitën konventën dhe parimet e rregullores së përgjithshme për shpërngulje. Për shpërnguljen e shqiptarëve, Komanda e III-të doli me propozim se “*së pari të shpërngulen shqiptarët e banuar nëpër vendet kufitare, e mandej ata në brendi, e së fundmi të shpërngulen turqit*”. Klika jugosllave në krye me Stojadinoviçin shprehte idenë... “*Është e pamundur shtypja e shqiptarëve me kolonizim gradual, ai është i vetmi popull i cili ka mundur gjatë një mijë vjetëve të fundit, jo vetëm të mbahej... por edhe të rritet në dëm tonin, duke shtyrë kufijtë tanë nga veriu dhe lindja*”. Në vitet ‘30 synimet e Beogradit për të arritur shkombëtarizimin e trevave shqiptare nuk ishte realizuar.¹⁴⁶

Kur nisemi nga fakti se shtypja graduale e shqiptarëve me kolonizimin tonë gradual ka qenë joefikas, e vetmja rrugë ishte shpërngulja në masë”.¹⁴⁷

Në këtë gjendje kaotike, shqiptarët protestonin me të madhe kundër politikës kolonizuese jugosllave, në Ankara u mbajt një mbledhje ndërministrore e këshillit të vendeve ballkanike, e ashtuquajtur “*për marrëveshje*”, më

¹⁴⁵ Milovan Obradoviç, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, f.189.

¹⁴⁶ *E vërteta mbi Kosovën dhe Shqiptarët në Jugosllavi*, 268.

¹⁴⁷ Vasa Çubrilloviq, *Shpërngulja e Arnautëve (Shqiptarëve)*, 7 mars 1937.

25-27 shkurt 1938. Në këtë takim, përveç të tjerave, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë doli me propozim për shpërnguljen e myslimanëve të vendeve ballkanike për në Turqi, i cili propozoi themelimin e një komisioni, me përfaqësim nga dy përfaqësues të secilit vend.¹⁴⁸

Konventa u nënshkrua në Stamboll, ku parashihej shpërngulja e disa qindra mijë “myslimanëve” nga Mbretëria e Jugosllavisë në Turqi. Siç theksohej në një informacion tepër sekret të përfaqësues jugosllave në Ankara, nga Ministria e Jashtme e Beogradit, qëllimi i vërtetë sekret i saj ishte shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Kosova dhe nga Maqedonia.¹⁴⁹

Lufta e Kosovës (1998 – 1999)

Për spastrimin etnik nga ushtria jugosllave të popullatës shqiptare në Kosovë u paraqit në fund të shekullit XX nga diktatori fashist Slllobodan Millosheviqi i cili bëri masakër, vrasje, terror, dhunë, gjenocid dhe spastrim etnik të popullatës së pafajshme shqiptare ku rreth 1 milion e popullatës i lëshuan vatrat e tyre dhe u strehuan në Shqipëri, Maqedoni dhe vende të tjera të botë. Falë ndërhyrjes së forcave veri atlantike – NATO-së sot Kosova është shteti pavarur dhe Sovran.

Edhe në ditët e sotme të gjitha projektet, vijnë të mbeten një kërcënim dhe eventualitet i vështirë për Ballkanin dhe në kohën e Rendit të Ri Botëror.

Në Serbi dhe në Greqi, shtresa intelektuale, shkolla, eksponentë akademik dhe institucionet fetare, vazhdojnë të praktikojnë edukimin nacionalist, me nota të theksuara armiqësore ndaj shqiptarëve, duke shpallur thelbin historik dhe nacionalist mbi dhe me të cilët janë motivuar të gjitha këto projekte hegjemoniste kanë ndikuar për integrimin e këtyre vendeve në Unionin Evropian.

¹⁴⁸ Milovan Obradoviç, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, f.189; Hakif Bajrami, *Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve*, f.258-265.

¹⁴⁹ Milotin Folliq, *Akcije Studenata Kosova za prava Albanskog naroda u periodu 1937-1941*, f. 43.

MARRËDHËNIET NDËRFETARE NË BALLKAN DHE MULTIKULTURALIZMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Abstrakti

Toleranca, respekti dhe pranimitëbesimit të zgjedhur nga gjithsecili do relaksojë komunikimin ndërmjet popujve, besimeve dhe etnive të ndryshme në rajonin e Ballkanit. Studimi dorealizohet me qëllim që të identifikojë momentet ku fryma pozitive ka sjellur një mirqënie dhe jetë të rehatshme, por edhe do prekë ato momente kur mos komunikimi, intoleranca dhe ekstremet e politikave të caktuara kanë sjellur pasoja të pallogaritshme për grupe të caktuara fetare dhe etnike.

Në vazhdim do të evidentohen të gjithë aktorët institucionalë dhe të tjerë që kanë kontribuar në përmirësimin e dialogut ndërfetar dhe ndëretnik, e që sollën më pas frymën e re të bashkjetesës, por që edhe ndikuan në promovimin e të drejtës për fjalën e lirë, mirqënies ekonomike dhe ndërveprimin të besueshëm në mes të komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike.

Nëpërmjet sigurimit të lirisë së besimit dhe përkrahja që vazhdojnë të kenë në nivele shtetërore dhe private, në dekadën e fundit të shek. XX, e sidomos nga vitet 2000-2021, bashkësitë fetare fituan hapësira më të madhapër përcjelljen e mesazhit të tyre paqësor, duke përkrahur edhe aspiratat e popujve të Ballkanit për pranim në BE/NATO dhe duke synuar në të njëjtën kohë edhe plotësimin e qëllimeve nacionale për përmirësimin e kualitetit të jetesës.

Hulumtimi do mbështetet edhe në rezultate të marranga pyetësorë, ku do jenënë fokus grupe dhe intervista me titullarë të besimeve, specialistë të fushave të teologjisë dhe shkencave humane, stafetë OJF-ve dhe aktivistë të shoqërisë civile.

Fjalë kyçe: multikulturalizëm, besim, tolerancë, liri e besimit, Ballkan, teologji.



Trajtimi i marrëdhënieve ndërfitare në Ballkan në optikën e multikulturalizmit Evropian, kërkon një analizë të situatës aktuale të ndërlidhur me zhvillimet historike e sociale të mëhershme të popujve e kulturave në kontinentin tonë. Peizazhi fetar i Evropës është thelbësor në diskutimet mbi rolin e fesë në shoqërinë bashkëkohore. Një ndër arsyt lidhet me faktin se zhvillimet evropiane, përfshirë këtu dhe ato fetare, historikisht kanë patur një ndikim të fortë në pjesën tjetër të botës. Kjo influencë bëhet akoma më e dukshme sot në kohët moderne kur proceset njohëse mes kulturave kan marë dimensione të reja dhe zhvillohen me shpejtësi të madhe për të arrit në çdo cep të globit në pak minuta.

Procesi i komunikimit mes besimeve dhe kulturave nga njëri kontinent te tjetri ka nisur shumë herët, kjo evidentohet nga librat dhe burimet historike ebreike, të krishtera dhe ato islam, por ai mori përmasa të reja gjatë zgjerimit të kolonializmit perëndimor evropian në këto kontinente. Nëpërmjet kolonializmit, modeli perëndimor i të jetuarit u eksportua gradualisht në pjesën tjetër të botës, përfshirë modelin e shtetit-komb, strukturën e ekonomisë kapitaliste, shkencën dhe teknologjinë. Kështu ai u kthye në një element ndikues në transformimet e mëpasme që do vërehen në shoqëritë jo-evropiane.

Ky proces transformimi vazhdon edhe sot dhe ai në vazhdimësi paraqet sfida për fetë e tradicionale në gjithsecilin kontinent, pasi ai ka efektet e veta në zhvillimet por edhe në ndryshimet fetare që jan një proces i pashmangshëm, duke përfshirë edhe Evropën ku intensiteti i ndërveprimeve është më i lartë në krahasim me pjesën tjetër të botës.

Për këto qasje, mund të ketë perceptime të ndryshme midis Perëndimit dhe Lindjes, midis Jugut dhe Veriut të globit, kjo në varësi nga qëndrimi që gjithsecili ka ndaj vlerave themelore njerëzore por edhe për shkak të papajtueshmërisë fetaro-kulturore.

Kjo kontradit ndërkulturore dhe ndërjetare nxjerr në pah disa çështje të rëndësishme në rang global.

Së pari, kjo tregon se kultura dhe feja nuk janë pronë e një grupimi nacional e as kontinental por edhe se ajo që ndodh në Europë, Amerik, Azi, ose Afrikë mund të ketë një ndikim të menjëhershëm kudo në botë.

Së dyti, besimet tradicionale që mbështeten në librat e shpallur hyjnor në çdo rast kan argumenta të mjaftueshëm teologjik por edhe multikulturor që të ndërlihin aktorët fetarë kudo në botë, veçanërisht në raste krizash dhe mosëmarrëveshjesh në nivel lokal ose më gjerë.

Prandaj mund të themi se ky realitet ka sjellë edhe formësimin e multikulturalizmit në paraqitjen e vet të tanishme që na meson më së miri nevojën për të bashkërenduar gjithçka që është e mundur në rrugëtimin tone të përbashkët në planet. Sigurisht që kjo realizohet në frymën e tolerancës dhe respektit që duhet të kemi ndaj diversiteteve me qëllim që të realizohet jeta paqësore, e cila do të jetë në funksion të stabilitetit shpirtëror e material dhe mirëqenjes së njeriut.

Disa studijues në kohë të kaluara jan përpjekur ti japin Evropës Perëndimore karakteristika unike, krahasuar me pjesën tjetër të botës, duke tentuar që Krishterimit në Evropën Perëndimore, t'i atribuohet një rol më i fortë publik në krahasim me besimet tjera. Kjo lidhet me prirjen globale drejt të ashtuquajturave "religjione kontinentale" të cilat kërkojnë të zotërojnë influenca rajonale duke marginalizuar grupimet tjera shoqërore si në baza fetare ashtu edhe në baza racore e kombëtare.

Në këtë vazhdë, duhet ti kujtojmë gjithsecilit se islami nuk është diçka e re për Evropën. Viti 711 cilësohet shpesh si koha kur muslimanët nga Afrika e Veriut hynë në Spanjë; megjithatë pika e parë zyrtare e kontaktit të Islamit me Evropën ishte kur profeti Muhamed a.s. dërgoi apostullin Dihyah al-Kalbi te perandori bizantin, Herakli në vitin 628¹⁵⁰. Ndërsa pas vitit 652 Muavije ibn Ebu Sufjani dërgoi trupa në Siçili. Që nga këto kohë muslimanët kanë qenë në kontakte të vazhdueshme me Evropën, në një formë apo tjetrën. Në fakt do të ishte e drejtë që të thuhet se Islami ka qenë një

¹⁵⁰ "Sahih al-Bukhari 2940, 2941 - Fighting for the Cause of Allah (Jihaad) - كتاب الجهاد والسير". sunnah.com (në anglisht). Sunnah.com - Sayings and Teachings of Prophet Muhammad (صلى الله عليه وسلم), 18 gusht 2021.

fenomen evropian, gjatë pjesës më të madhe të historisë së tij – pasi Islami ka qënë për afro 800 vjet prezent në Spanjën muslimane dhe për më tepër se 250 vite në Siçili. Përveç këtyre kohësh themelimi për komunitetet muslimane në Evropë, ka patur edhe pika të tjera takimi të Islamit me Evropën – siç ka qënë prezenca e shkurtër e muslimanëve në Francën e Jugut, konfliktet në Austri dhe natyrisht kryqëzatat.¹⁵¹

Prandaj Krishterimi në evropë duhet të shpreh pikëpamjet e veta si çdo besim tjetër, por pa kërkuar të mbizotërojë në mënyrë absolute sferën ligjore dhe publike. Sinagogat, Kishat dhe Xhamitë duhet të mësohen të pranojnë zërat ndryshe dhe divergjencat në kontekstin pluralist të të jetuarit në kohën e sotme. Si rezultat, roli i besimit në Zot i përtërirë në publik nuk do të perceptohet më si kërcënim nga aktorët ateist të shoqërisë.

Një ndryshim domethënës por jo të mjaftueshëm në këtë aspekt në dekadat e fundit e gjejmë edhe në peizazhin fetar dhe multikulturor të Ballkanit ku për fat të keq akoma vazhdon të ketë *“lëvizjeve ekstremiste”* me ngjyrimë diskriminuese e racore. Për që për fat të mirë tani këto lëvizje nuk po arrijnë të nëpërkëmbin bashkjetesën tradicionale, e cila ka nevoj të mbështetet akoma më shumë nga të gjitha institucionet për të arritur tek të gjithë njerëzit, pavarësisht moshës, gjinisë, shtresës, përkatësisë etnike, gjuhës apo kombësisë. Tendencat pajtuese dhe paqtuese në Ballkan duhet të jenë më të dukshme sidomos në kupolat e hierarkisë fetare, qoftë te të krishterët ose te myslimanët por edhe te grupimet tjera fetare që në ballkan jan në minoranc.

Është e vërtetë se një numer i organizatave e institucione me peshë si: Federata Botërore Lutherane, Vatikani, Konferenca e Kishave Evropiane, Konferenca e Këshillit të Peshkopëve Evropian etj, kryesisht këto 20 vitet e fundit, kanë realizuar një numër të madh takimesh me Bashkësit Muslimane ne Evropë, dhe kan nënshkruar një numër të madh dokumentash për bashkëpunim mes vete pasi besimet hyjnore kërkojnë vazhdimisht të kapërcejë barrierat që bart me veti diversiteti i kulturave dhe besimeve, midis

¹⁵¹ Dilaver Hussein, kërkuar pranë Fondacionit Islamik në Londër, <https://kohaislame.com/evropa-dhe-islami-perspektiva-dhe-e-ardhmja/>

të krishterëve në rend të parë dhe ndërmjet të krishterëve dhe jo të krishterëve në kontinent.

Prandaj Bashkimi European mbështet me resurse të vazhdueshme dialogun dhe bashkëpunimin e të gjitha besimeve si në veprimtari sociale ashtu edhe veprimtari tjera kulturore, artistike, fetare etj. të shtrira në të gjitha vendet që tashmë janë anëtare të Bashkimit Europjan por edhe ato që tashmë janë kandidatë për tu bërë anëtare në një të afërme sa më të shpejtë. Këto iniciativa shpesh adresojnë edhe probleme delikate duke iu kundërvu pikëpamjeve të ngjashme si ato të ish-kryetarit të Partisë konservatore britanike Lord Tebbit i cili shprehej se: “Ju nuk mund të keni një kuadër të fuqishëm të kulturave të ndryshme në një shoqëri, ju duhet të keni një kulturë për një shoqëri. Multikulturalizmi është forcë ndarëse”.

Pavarësisht këtyre qëndrimeve dhe të ngjashme me to që i ndeshim jo rrallë, e rëndësishme është se elitat qytetare në kulturen evropiane dhe ato ballkanike janë të orientuara që të ndihmojnë në pranimin e multikulturalizmit. Është një fat i mirë që sot në Evropë marrëdhëniet midis Krishterimit dhe vendeve islame kanë ndryshuar shumë. Tashmë, që nga përplasja e myslimanëve me të krishterët në shek.VII deri në vitin 1683 me rrethimin e dytë Osman të Vienës, marrëdhëniet mes tyre nuk kush-tëzohen nga kontradiktat njëmijëvjeçare se kush do ta zotërojë Europën. Shtetet evropiane nuk janë më në territoret myslimane, dhe shtetet myslimane nuk e shohin Europën si objektiv për invazion. Ndoshta ky model do ishte i dobishëm të adaptohej më me shumë forcë edhe në vendet e Ballkanit. Prandaj institucionet përkatëse të vendeve të Ballkanit, me anë të projekteve të ndryshme duhet të bëjnë të mundur njohjen e vlerave të trashëguara me nxitjen e respektit dhe të solidaritetit të ndërsjellë mes popujve dhe komuniteteve me identitete të ndryshme kulturore, etnike apo fetare.

Disa prej këtyre projekteve mund të jenë:

- Organizimi dhe promovimi i seminareve dhe takimeve në lidhje me çeshtjet që kanë të bëjnë me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe roli i fesë në një shoqëri moderne.

- Rishikim i të gjithë programeve të sistemi arsimor të vendeve ballkanike, përfshirë shkollat private fetare që ekzistojnë në këto vende, në

mënyrë që lëndët e mësuara, t'u përçojnë nxënësve mirëkuptimin dhe respektin ndaj besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare e ndaj kulturave të tjera të botës.

- Të rivlerësohen programet e shkëmbimeve për profesorët e universiteteve dhe studentët pasuniversitarë.

- Shkëmbime programesh dhe veprimtarish të përbashkëta rinore në kuadrin ballkanik. Në këtë kontekst, në rajonin tonë do të paraqisnin interes programet që nxisin shkëmbime ndërmjet të rinjve që vijnë nga hapësira të ndryshme kulturore apo etnike.

- Nxitja e zhvillimit të marrëdhënieve të mira ndërfitare, evidentimi dhe ndjekja e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të besimit fetar, si dhe atyre që nxisin akte dhune, vetëfljimi, etj. nëpërmjet idesë së besimit fetar.

- Zhvillimin e një dialogu të rregullt, ndërmjet përfaqësuesve të Qeverive, bashkësive fetare, shoqërisë civile dhe mjeteve të informimit, në nivel vendor, kombëtar, rajonal e më gjerë.

Përmbyllje

Toleranca, respekti dhe pranimi i besimit të zgjedhur nga gjithsecili do relaksojë komunikimin ndërmjet popujve, besimeve dhe etnive të ndryshme në rajonin e Ballkanit. Studimet që realizohen në këtë fushë duhet të kenë për qëllim të identifikojnë momentet ku fryma pozitive ka sjellur një mirqënie dhe jetë të rehatshme, pa harruar të përmendim edhe ato momente kur mos komunikimi, intoleranca dhe ekstremet e politikave të caktuara kanë sjellur pasoja të pallogaritshme për grupe të caktuara fetare dhe Etnike.

Ashtu siç është e rëndësishme të evidentohen të gjithë aktorët institucionalë dhe të tjerë që kanë kontribuar në përmirësimin e dialogut ndërfitar dhe ndërëtnik, e që sollën më pas frymën e re të bashkjetesës, por që edhe ndikuan në promovimin e të drejtës për fjalën e lirë, mirqënies ekonomike dhe ndërveprimin të besueshëm në mes të komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike.

Nëpërmjet sigurimit të lirisë së besimit dhe përkrahja që vazhdojnë të kenë në nivele shtetërore dhe private, në dekadën e fundit të shek. XX, e

sidomos nga vitet 2000-2021, bashkësitë fetare fituan hapësira më të madha për përcjelljen e mesazhit të tyre paqësor, duke përkrahur edhe aspiratat e popujve të Ballkanit për pranim në BE/NATO dhe duke synuar në të njëjtën kohë edhe plotësimin e qëllimeve nacionale për përmirësimin e kualitetit të jetesës.

Burimet

1. <https://www.trt.net.tr/shqip/bota/2018/11/07/koment-islami-evropian-1082859>
2. <http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/marredheniet-mes-islamit-dhe-krishterimit-ne-evrope-ne-te-kaluaren-te-tashmen-dhe-te-ardh/#.YX-kYZhpByUk>
3. https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=122571dd-1bf5-f4fc-b65c-f4b98e896114&groupId=252038
4. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/13999.pdf>

Ermal MEHMETI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

Jeta STAROVA MEHMETI

Fakulteti Pedagogjik - Shkup

“E KUJT ËSHTË KJO KËNGË”, PALIMPSESTI I UNITETIT BALLKANIK PËRMES DIFERENCAVE

(në shembullin e filmit dokumentar të Adela Peeva-s)

Abstrakt

Autorët e punimit ndjekin kërkimin për njërin nga interpretimet e shumta dhe zbulimin e shtresave të ndryshme kulturore si një lloj këngësh, të cilat në bazë, me substratin e tyre të njejtë muzikor, përmbajnë kuptime të ndryshme, karakteristike për secilin prej popujve të Ballkanit. Bëhet fjalë për një melodi hibride, e cila nxjerr në pah stereotipet e imagjinuara kulturore dhe etnike në komunitetin ballkanik.

Adela Peeva do të vij në ide për të krijuar filmin "E kujt është kjo këngë" pas një takimi miqësor në Stamboll kur në një "natë ballkanike" me një grek, maqedonas, turk dhe serb, ata do të dëgjojnë këngën "Rrugës për Yskydar ", dhe secili nga të pranishmit, bazuar në substratin muzikor, do ta interpretojë atë si këngën e tij. Duke u përpjekur për të lidhur fijet kulturore të Ballkanit, me anë të muzikës, si një lloj palimpsesti muzikor, autori i filmit dokumentar, në kërkim të së vërtetës, arrin në përfundimin se është pothuajse e pamundur si vetëm një këngë, mund të dëshmojë në mënyrë aq të vërtetë dhe autentike për

madhështinë dhe prapambetjen e njerëzve të saj, të bashkësisë ballkanike.

Kënga në kërkim të së vërtetës, (të ngjashme me paradigmen „cinema vérité”), ofron drejtime të shumta të kërkimit muzikologjik. Në interpretimin e këngës turke "Rrugës për Yskydar " mbeten të zbulohen arketipet e gjdo varijanti ballkanik të këngës. Me sfida të tilla ne ballafaqohemi edhe në punimin tonë.

Fjalë kyçe: këngë, Ballkan, arketip, supstrat muzikor, palimpsest.



* * *

Për një shekull e më shumë, Gadishulli Ballkanik është bërë një hapësirë fizike dhe shpirtërore ku ndodhën tronditjet dhe pasiguritë më të mëdha të qytetërimit evropian. Për shekuj me radhë, Ballkanikët kan luftuar për të krijuar identitetin e tyre kompleks civilizues, për të fituar vërtet institucionet e tyre dhe për të vendosur identitetet e tyre kombëtare. Në Gadishullin Ballkanik, pas përhapjes së vlerave të mëdha të qytetërimeve të lashta, shfaqen qytetërimet bizantine, pastaj osmane.

Ballkanikët kanë qenë të detyruar të dilin nga rrënojat e qytetërimeve të shkatërruara. Ballkanikët u detyruan nga vlerat e tyre të përbashkëta për të nxjerrë vlerat e tyre nga qytetërimet e dështuara, me të cilat ata do të "rrethonin" shtetin e tyre të pavarur.

Kështu ndodh në bashkësitë e reja shtetërore, për të përfshirë vlerat e qytetërimeve të mëparshme. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me muzikën e artit popullor. Ka shumë shembuj në krijimtarinë popullore me tipare të përbashkëta. Për një formë të tillë të pranisë së përbashkët të substratit muzikor në përmbajtje të ndryshme, zgjodhëm filmin dokumentar të kinematografes bullgare Adela Peeva "E kujt është kjo këngë".

Muzika në të gjitha manifestimet e saja vokale, instrumentale, solo, në orkestra, në muzikologji, në opera, në koncerte muzikore, në xhaz, në dirigjim, në afërsi dhe në bashkpunim me artet e tjera: letërsia, artet e

bukura, baleti ka një efekt unifikues dhe universal pothuajse në të gjitha fazat e njerëzimit.

Muzika shpreh majat e shprehjes njerëzore në sintezën sublime të fjalëve dhe muzikës në hymne, në marshimet fitimtare, në koret e vajtuesve. Muzika gjithashtu ka fuqinë e thellë artistike për të qenë një ind lidhës i jetës dhe vdekjes, për të mbajtur gjallë kujtesën popullore.

Në këto mendime na çon rruga e një kënge që përcjell të gjitha kuptimet e saja semantike në tekstin dhe shoqërimin muzikor të popujve ballkanikë përmes filmit dokumentar të krijuar me sukses "E kujt është kjo këngë" të kineastes së njohur bullgare Adela Peeva¹⁵².

Me idenë për të krijuar këtë film, ajo hyri në një restorant të bukur në Stamboll pranë Bosforit duke darkuar me disa miq nga vende të ndryshme të Ballkanit: grek, maqedonas, turk, serb dhe autorja bullgare. Gjatë darkës, një këngëtare e famshme turke me një zë të bukur dhe shoqërim orkestral në një moment filloi të këndojë këngën e famshme turke "Rrugës për Yskydar" e cila do të tërheqë fort vëmendjen e të pranishmëve. Ballkanasit në tryezë së bashku me Adela Peeva, secili me radhë, do të pretendojnë se kënga është e tyre. Ajo e dinte mirë se kënga që kishte kënduar që në fëmijëri ishte bullgare, por nuk mund ta kuptonte "përse miqtë e saj nga Ballkani e konsideronin të tyren".

Ideja që kënga mund të ndahet nga kombet dhe popujt ballkanikë që kanë jetuar krah për krah për qindra vjet, të gjithë ndanë vetëm të njëjtën melodi. Për Adela Peevën inventive, ngjarja në restorantin e Stambollit nuk ishte vetëm një episod kalimtar, por një rast për të kaluar katër vitet e ardhshme, pas ngjarjes në restorantin e Stambollit, në krijimin e dokumentarit 70-minutësh " E kujt është kjo Këngë ".

Filmi dokumentar "E kujt është kjo këngë" u shfaq për herë të parë në Bullgari. Pasi filmi fitoi disa çmime në festivalet e filmit dhe televizionit me

¹⁵² Adela Peeva (1947) u diplomua për film dhe televizion në Akademinë e Teatrit, Filmit dhe Televizionit në Beograd. Nga viti 1973 deri në vitin 1990 ka punuar në Studion e Filmit Dokumentar në Sofje. Ajo është autore e më shumë se 50 dokumentare dhe disa filmave artistikë. Duke filluar nga viti 1991, ajo u bë një producente e pavarur filmash në Sofje. Dokumentarët e saj janë nominuar për Çmimin Evropian për Dokumentarin më të Mirë dhe kanë fituar shumë Çmime Dokumentare Evropiane për Dokumentarin më të Mirë.

famë botërore, veçanërisht në Paris dhe Nashvillë, filmi nuk ishte thjesht një episod për Ballkanin përmes një filmi më të mirë, por kjo arritje e rëndësishme filmike, sipas Peeva, tregoi se sa shumë Ballkani ka të përbashkët në histori. Në këtë Dokumentar Peeva ndjek punën mbi të, në të gjitha vendet e Ballkanit: Maqedonia, Turqia, Greqia, Shqipëria, Bosnja, Serbia dhe Bullgaria. Në shumë vende është një këngë dashurie me tekst të ndryshëm, por në vende të tjera si Bosnja dhe Turqia përdoret si këngë lufte¹⁵³. Sipas Peeva, ajo nuk përpiqet të përcaktojë origjinën në dokumentar, edhe pse gjatë hulumtimit has në interpretime të ndryshme. Në të gjitha vendet e Ballkanit, reagimet janë pothuajse të njëjta: njerëzit shfaqin zemërim, mosbesim kur Adela Peeva sugjeron që ta trajtojnë melodinë si të tyre dhe si fqinjët e tyre.

“Turqit na morën këngën, ne jemi një nga kombet më të vjetra në botë”, pohon një shqiptar në intervistë. Filmi nuk përpiqet të përcaktojë se nga erdhi kënga. Sipas Peeva, dokumentari ofron supozime të ndryshme për zbulimin e gjenezës së tij. Ekziston edhe një shpjegim për mundësinë që kënga dokumentare të jetë prezantuar nga trupat skoceze të vendosura në Turqi gjatë Luftës së Krimesë. Edhe pse ka shumë versione të ndryshme, Peeva arrin në përfundimin se të gjitha ato theksojnë faktin se shumica e popujve ballkanikë ndajnë traditën që u është përcjellë atyre nga Perandoria Bizantine dhe më pas nga Perandoria Osmane.

Arsyeja pse Adela Peeva u nis në kërkim të këngës së kujt është, duke zgjedhur dokumentarin si pasqyrën më të mirë të së vërtetës. Siç thotë ajo në filmin dokumentar, "ajo është në kërkim të së vërtetës".

Të pranishmit në restorantin e Stambollit, të mbajtur nga e njëjta melodi, secili prej tyre do të këndojë këngën me fjalë dhe inkurajim të ndryshëm. Në fakt, të gjithë të pranishmit e kënduan këngën me fjalë nga gjuha e tyre, duke theksuar se kënga i përket vetëm popullit të tyre! Kështu do të lindë ideja e regjisores Peeva për të realizuar një "film dokumentar ballkanik" të titulluar "E kujt është kjo këngë?".

¹⁵³ Filmi dokumentar "E kujt është kjo këngë" në Turqi ishte subject i filmit artistic "Katip" (Shërbëtori).

Këndimi i kësaj kënge ballkanike, me të njëjtin substrat melodik autentik, nga autorja Peeva, do të shihet si një lloj "palimpsesti ballkanik", pra një lloj "palimpsesti muzikor" në të cilin futen substrate të ndryshme kulturore dhe muzikore.

Autorja Peeva do të përfshihet në krijimin e filmit dokumentar " E kujt është kjo këngë " në kërkim të supozimeve të vërteta në të gjithë rajonin, të ripërcaktuara në perspektivën kombëtare shtresat e imagjinuara kulturore dhe etnike të veçanta, të cilat do të shënohen nga e njëjta shtresë melodike.

Sipas rritjes së nacionalizmit në Evropë në shekullin XIX, traditat e përditshme të shpërndara në kuptimin Juglindor kombëtar dhe nationalist, do të jenë realitet sipas Aleks Drejs- Frensis studiues universitar nga Londra, në publikimet e tij të kulturës së identiteteve në Europën Juglindore.

Në fakt, Adela Peeva u përball me një këngë popullore hibride, sipas identifikimeve melodike, e njëjtë mes të gjithë popujve që e këndojnë atë në raste të ndryshme për shekuj me një titull të ndryshëm, por me melodinë identike dhe të dallueshme. Varianti fillestar i këngës shfaqet së pari tek turqit, që nga koha osmane, si një arketip i këngës popullore turke "Rrugës për Yskydar", pastaj variantit grek "Nga një vend i huaj".

Melodia e kësaj kënge ishte e njohur për komunitetet hebraike në të gjithë botën, si dhe melodija e Yskydarit, Fel Shara, Terk në Amerikë, ka qenë e pranishme pothuajse gjithandej, nga Turqia gjer në Shtetet e Bashkuara, dhe në Ballkan. Nga një here kënga ka qenë e kënduar edhe nëpër sinagoga. Por është e vështirë të përcaktohej gjeneza e kësaj kënge, një enigmë e vërtetë muzikologjike.

Ky do të jetë motivi kryesor i Adela Peeva për të pranuar sfidën përmes „cinema vérité”, për të kërkuar në Ballkan për të zbuluar se nga vjen kjo këngë e famshme me shumë emra: *Usküudara, Kitabim, Ruse kose curo imas, Terk in Amerika, Anadolka, Mu në bashtën tënde, Ya Banat Iskandaria*.

Adela Peeva, në kërkim të gjenezës së këngës së pazakontë, në kuadër të projektit të saj të vetëm dokumentar do të angazhohet në kërkimin hulumtues të këngës në një takim me banorë të vendeve të Ballkanit: nga Serbia, Maqedonia, Shqipëria, Bosnja, Turqia, si dhe vendin e saj të lindjes Bullgarinë. Duhet theksuar se ky dokumentar është realizuar pas luftërave vëllavrasëse gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. Edhe pse filmi u krijua nga

Adela Peeva në kërkim të "së vërtetës ballkanike", me një temë interesante në vetvete, autorit i intereson "zëri dokumentar", i krijuar nga regjisori përmes skenografisë dhe njerëzve që interviston në Ballkan nga shtete të ndryshme.

Autorja e dokumentarit "E kujt është kjo këngë" Adela Peeva arrin të përdorë me mjeshtëri lentet e kamerës së filmit dhe fokusin e saj të sinkronizuar. Këto elementë jo vetëm që dëshmojnë për misterin e filmit, por më e rëndësishmja, ky film ngre pyetjen kryesore të ngjashmërisë kulturore dhe diversitetit perceptues, midis nacionalizmit në faza të ndryshme dhe identitetit të popujve të Ballkanit. Edhe pse dokumentari "E kujt është kjo këngë" nuk ka prirje politike për sa i përket identitetit, kënga e tregon, dëshmon për kërkimin e tij, por pa lënë anash edhe intolerancën kombëtare të popujve të Ballkanit. Por ndodh që gjatë inçizimeve spontane të intervistave, Adela Peeva, duke mos e ditur mirë situatën në disa zona, të përballlet me reagimet e paparashikuara të Ballkanasve të intervistuar. Për të lidhur trashëgiminë kulturore përmes muzikës, Adela Peeva më në fund do të arrijë në përfundimin se, duke u përpjekur të lidhë trashëgiminë kulturore të mjedisëve të ndryshme ballkanike, të harmonizojë marrëdhëniet e të ndryshmeve, ajo do të befasonet, duke u përpjekur të lidhë trashëgiminë kulturore të Popujt ballkanikë, këtë herë përmes muzikës. Ishte pothuajse e pabesueshme që vetëm një këngë me një sfond të panjohur mund të gjeneronte urrejtje mes njerëzve të etnive të ndryshme në teritorin ballkanik. Kjo tregohet në fund të dokumentarit kur një festë kthehet në një fushë të djegur dhe shpëtohet nga "njerëz të etnive të ndryshme". Kjo po ndodh në kufirin mes Bullgarisë dhe Turqisë.

Për kinematografinë inventive Adela Peeva, pyetja bazë ishte: a ishte një këngë dashurie, një këngë lufte, një këngë nostalgjike? Fjalët ishin të ndryshme në secilin version, me atë që melodija e këngës ishte gjithmonë e njejtë. Dëgjuesi i bënte vetes gjithmonë pyetjen: është një këngë që bashkon apo që ndan? Ndonjëherë kënga ka qenë e bukur, e pazakontë, një perlë muzikologjike, e cila ka qenë e shpërblyer vazhdimisht në festivalet ndërkombëtare të filmit.

Dokumentari i Adela Peevës, përveç reagimeve kryesisht pozitive në rajonin e Ballkanit, do të përjeton edhe rishikime dhe analiza edhe nga ballkanologë me reputacion në mbarë botën. "Mark Mazover, profesor i histo-

risë në Universitetin e Kolumbisë (SH.B.A) dhe autor i librit "Ballkani", i cili eksploron identitetet dhe nacionalizmin në Ballkan, thotë se filmi i Adela Peevës është më i riu në një seri që zbulon imazhe të kahershme të identitetit kombëtar.¹⁵⁴

Ai deklaron se filmi grek "Pamja e Uliksit" nga Theo Angelopoulos (1995) është një shembull i patejkalueshëm, i cili në një mënyrë të veçantë tregon identitetet e paqarta dhe të përziera në Ballkan. Sipas këtij studiuesi, në thelb ka pasur një kulturë të përbashkët për sa i përket kuzhinës, jetës shtëpiake, muzikës dhe veshjeve, por ato dallime nuk janë theksuar si dallime kombëtare, por ato do të ritheksohen dhe theksohen gjatë shekullit të njëzetë, kur fundi i Perandorisë Osmane do të shënohet me dëbimin dhe shkëmbimin e popullsisë greke nga Greqia me popullsinë turke, si dhe me luftën vëllavrasëse dhe konfliktet ndëretnike në ish-Jugosllavi.

Përfundim

Trashëgimia e përbashkët kulturore dhe artistike mes popujve ballkanikë, e cila kontribuon në eliminimin e stereotipeve politike dhe ideologjike, me të cilat do të harmonizohen marrëdhënjet medis bashkësive etnike të ndryshme. Ka qenë për çudi në hapësirën në të cilën ka patur shumë të përbashkëta, që do të jetë prezent rivaliteti, jotoleranca. Një nga ilustrimet më të mira të këtyre kushteve mund të gjendet në dokumentarin e jashtëzakonshëm - Paradigma *E kujt është kjo këngë* e autores bullgare Adela Peeva. Filmi trajton një melodi shumë të përhapur dhe të njohur që këndohet ose luhet në shumicën e popujve të Ballkanit, por e shoqëruar nga fjalë të ndryshme. Në fakt, ekziston një "luftë e vogël" që shkon nga vendi në vend për epërsi mbi këngën. Pothuajse të gjithë, pa përjashtim, pranuan se melodia është e bukur, por gjithashtu pohuan se kënga është ekskluzivisht një produkt i kulturës kombëtare "të tyre" dhe të askujt tjetër. Ndërkaq ngecet përpjekja për të transformuar trashëgiminë e përbashkët kulturore në një forcë që do të veprojë në mënyrë integruese.

¹⁵⁴ Marc Mazower, *Le Balkas*, The Wolfson Prize for History, 2001

Ky është një shembull i mirë i veprimit të një dokumentari të rrallë dhe të jashtëzakonshëm, sinteza e magjisë dhe dokumentit, mund të ketë një kuptim të veçantë, si një paradigmë se si të arrini tek e vërteta, jo vetëm midis popujve të Ballkanit, të cilët jetojnë me shtresa të dendura në ndërgjegjen e së shkuarës historike dhe me pasoja në kërkimin e vërtetë të së vërtetës. Kjo është arsyeja pse dokumentari "E kujt është kjo këngë" nga Adela Peeva mund të jetë një mësim për popujt e Ballkanit, i cili zëvendëson me sukses tekstet shkollore që lavdërojnë të kaluarën e tyre historike të secilit prej popujve të Ballkanit.

Literatura

1. Maia Bolesti, *Between Hospitality and Hostility: Crossing Balkan Borders in Peeva's Whose is this Song*, in *Uncertain Territories*, p.239-258
Mazower, Mark, The Balkan, 2001
2. Todorova, Maria, *Imagining the Balkans*, Oxford University Press, New York, 1997
3. Amin, Samir, *Eurocentrism*, New York, 1989.
4. Castellan, Georges, *Histoire des Balans*, Fayard, Paris, 1991.
5. Said Edward W., *Orientalism*, New York, Pantheon, 1978.
6. Todorov, Tsvetan,, „Reading as Construction”, Princeton University Press, New York, 1980.
7. <http://adelamedia.net/>

MARRËDHËNIET E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË GJATË VITIT 1968

Abstrakt

Ky studim hedh dritë mbi raportet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë gjatë vitit 1968. Duke shfrytëzuar dokumentet arkivore në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë, literaturën relevante dhe shtypin e kohës, autori synoj të trajtoj me kujdes këto raporte në disa aspekte si politike, arsimore, dhe shkencore. Zhvillimet ndërmjet dy vendeve përfshirë organizimet e rëndësishme akademike, rolin e intelektualëve në Kosovë, kërkesat e studentëve për republikëen e Kosovës në kuadër të RSFJ, dhe Shqipërinë në këtë mes shihen nga autori si pjesë të pandara të një konteksti historik. Historiografia shqiptare ka studime me vlerë në dritën e këtyre marrëdhënieve komplekse për periudhën 1968-1981. Autori si karakteristikë kryesore të këtij bashkëpunimi nxjerr aspektin politik si kryesorin që mbizotëroj këtë relacion brenda dy vendeve.



Vështrim rreth marrëdhënieve politike shqiptaro-jugosllave dhe Kosova gjatë viteve 1946-1967

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave patën një intensifikim edhe para LDB. Ata u bënë të prekshme qysh ndërmjet dy luftërave Botërore. Jugosllavia ishte vendi i parë që njohu regjimin në Shqipëri. Vendi i parë me të cilin Shqipëria lidhi marrëdhënie diplomatike pas LDB ishte Jugosllavia.¹⁵⁵ Pas këtij akti marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin mjaftë të mira, në sferën politike, kulturore, arsimore. Këto marrëdhënie ndërvarësie u kurorëzuan

¹⁵⁵ Vladimir Dedijer, *Interesne sfere*, Prosveta, Beograd, 1980, 257.

më shumë në sferat e lartëpërmendura.¹⁵⁶ Si rezultat këtij bashkëpunimi të ndërsjell kemi vizitën e Enver Hoxhës në Beograd më 1946 i cili në bashkëbisedim me Titon, paraqiti pikëpamjet e tij për Kosovën.¹⁵⁷ *Ky takim u botua në librin e tij nga diplomati i njohur shqiptar Lisien Bashkurti. Enver Hoxha me Titon në takimin e Beogradit kishte potencuar se “Unë i shpreha mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera shqiptare të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t’i kthehen kësaj. Shqiptarët luftuan që të këtë një Shqipëri të lirë e sovranë, të cilës tani duhet t’i bashkohen edhe viset e tjera shqiptar. Pala jugosllave kishte plane të tjera për plotësimin e ambicieve të popujve sllav që me anë të ndarjes në tri republika jugosllave popullsia shqiptare mund të pakësohej dhe të ishte më pak homogjene.*¹⁵⁸ Nga viti 1948 marrëdhëniet dy vendeve u ndërpreu dhe mbetën të ngrira gjerë më 1953. Rivendosja e raporteve diplomatike me Jugosllavinë u propozua nga pala shqiptare në nëntor 1953. Kështu në vitin 1954 u hapën përfaqësitë në Tiranë respektivisht në Beograd.¹⁵⁹ Shteti shqiptar u interesua për çështjen e Kosovës nga viti 1959 në forma të ndryshme. Referuar veprës së Enver Hoxhës në vëllim e 17 të veprës së tij botuar më 1974 ai evokon kujtimet e tij ku shpalo mbledhjen e Byrosë Politike ku diskutohej “*Mbi disa probleme të historisë së Shqipërisë*” Enver Hoxha deklaroi se “*çështja e pasqyrimin të historisë së Kosovës pas 1912 meriton një studim të veçantë*”.¹⁶⁰ Kurse historiani Sabit Syla na ofron të dhëna me fakte konkrete ku Shqipëria me anë të liderit të saj ngru zërin në aktiviteteve të ndryshme për Kosovën. Edhe në fund vitet ’50 të shek.XX, Shqipëria ishte e heshtur me veprime konkrete mbi situatën politike në Kosovë. Disa nga arsyet pse shteti shqiptar heshti mbi zhvillimet politike në Kosovë ishin të natyrës së situatës së brendshme politike të Shqipërisë si dhe raporteve ndërkombëtare të saj. Shqipëria nga vitet 1948-1961 pati marrëdhënie politike me Bashkimin Sov-

¹⁵⁶ Sabit Syla-Qerim Lita, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948, vëllimi I*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2020, 341, 392.

¹⁵⁷ Lisien Bashkurti, *Diplomacia e vetëizolimit, rasti i Shqipërisë 1961-1989*, Tiranë, 2004, 597.

¹⁵⁸ Bashkurti, *Diplomacia*, 597.

¹⁵⁹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej AMPJ), viti 1953, dosja.B/I-1, 6. (cituar sipas Sabit Sylës, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2017, 154).

¹⁶⁰ Enver Hoxha, *Vepra, vëllimi.17*, Tiranë, 8 Nëntori, 1974, 77-78.

jetik. Në këtë periudhë shteti shqiptar kishte pak bërë shumë pak përpjekje në rrafshin diplomatik që të ndikoj në thellimin e ndikimit të saj mbi Kosovën. BRSS nuk ishte e gatshme ta mbështes Enver Hoxhën në mbështetjen rreth Kosovës. Qeveria shqiptare e kryesuar nga Enver Hoxha pas takimit që kishte me Stalinin morri rekomandime në mars të vitit 1949 ku shprehimisht theksohej se “*çështja e Kosovës duhej të kalonte në plan të dytë*” dhe se çështja e parë ishte “*rrëzimi i klikës së Titos*”.¹⁶¹ Lideri i BRSS, Nikita Hrushovi kërkonte mbylljen e çështjes së Kosovës dhe përmirësimin pa kusht të marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë. Orientimi politik i Shqipërisë në politikën e jashtme nga Kina, solli edhe një ndryshim të kursit në petkun ideologjik të saj. Duhet thënë që Shqipëria filloj ta përdor kartën e nacionalizmit qysh nga fund vitet '60. Kurse në fillim vitet '60 kemi një qasje pakëz më serioze në udhëheqjen shqiptare mbi Kosovën. Njëjtë vepruan edhe liderët shqiptar të Kosovës, të cilët deri atëherë as që e kishin qarur ndërmend të bënin këtë gjë sepse shtypje e egër serbe e pamundësonte një gjë të tillë. Personalitetet historike shqiptare si Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ishin pika të forta ku ata u kapën për të promovuar ndjenjën kombëtare dhe për të proklamuar para popullit ndjenjën e atdhedashurisë. Shqipëria me anë të veprimeve të saj të cilat lidheshin kryesisht mbi takimet e liderit shqiptar me popullin, në qytete të ndryshme shqiptare shprehu qëndrimet mbi shqiptarët e Kosovës. Së këndejmi takime të shumta u mbajtën në qytete si Peshkopia, Gjirokastra, Fushë-Kruja etj. Në të gjitha këto takime Enver Hoxha theksoj se pakica shqiptare në Jugosllavi duhet t'i këtë të drejtat e barabarta me popujt tjerë jugosllav. Është me rëndësi se situata politike në Kosovë gjatë kësaj periudhe u shikua me kujdes në nivel të propagandës dhe veprimet e Shqipërisë, ishin në masë të madhe fjalime dhe jo qëndrime diplomatike zyrtare.¹⁶²

Deri më rënien e Rankoviçit më 1966 nga pushteti politika zyrtare jugosllave ishte kundër bashkëpunimit të popullisë shqiptare të Kosovës me Shqipërinë në çfarëdo fushe të jetës. Në gjysmën e dytë të vitit 1966 në

¹⁶¹ Sabit Sylaj, *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj demonstratave në Kosovë më 1968*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë-Tiranë, Tiranë, nr.3/4, 2012, 287.

¹⁶² Sabit Sylaj, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2017, 191.

Jugosllavi kishin filluar rrethanat të lehtësoheshin për shqiptarët e Kosovës dhe në këtë kontekst Shqipëria dhe Kosova filluan të afrohen nëpërmjet rrugëve ekonomike. Plenumi IV i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë nisi punimet më 01 korrik 1966 në Kroaci.¹⁶³ Në këtë Plenum pos Sekretarit të Përgjithshëm të LKJ- Tito, merrnin pjesë edhe anëtarët e Komitetit Qendror të LKJ dhe kryetari i komisionit të Revizionit të LKJ.¹⁶⁴ Delegacioni shqiptar nga Kosova ishte i kryesuar nga Kryetari i Komitetit të LK Veli Deva.¹⁶⁵ Për shkak të deformimeve të mëdha nga Rankoviçi dhe klika e tij në këtë Plenum u theksuan dëmet që i shkaktoj Jugosllavisë kjo politikë. Vendimet e këtij Plenumi patën jehonë në opinionin e gjerë zyrtar e publik në Serbi dhe Kosovë.¹⁶⁶ Në të gjitha institucionet e vendit, por edhe në organizatat punuese ku kishte më pak kombësi shqiptare u krijua një frymë dhe situatë e re aktive. Tendenca për të parë me sy kritik realitetin politik social-kushtetues në Jugosllavi, në Kosovë erdhi gjithnjë në rritje.¹⁶⁷ Pas këtyre rrethanave niveli federativ i RSFJ e lejoi shtypin shqiptar të dënonte publikisht disa prej krimeve kundër shqiptarëve. Lidhja Komuniste e Jugosllavisë në të gjithë vendin promovoj parullën “*tash e tutje gjithçka do të rregullohet*”. Ndryshimet në nivelin federativ u pasqyruan në institucionet në Prishtinë. Disa prej përfaqësuesëve të klikës së Rankoviçit në Kosovë të cilët kishin punuar në organet e Sigurimit Shtetëror si Ibër Haskaj nga Deqani, Enver Hoxha nga Gjakova etj, emra të njohura për keqtrajtimin e shqiptarëve të Kosovës të cilë u shkarkuan nga institucionet e sigurisë shtetërore së Kosovës.¹⁶⁸ Tirana zyrtare kishte informacione të bollshme për raportin e Titos dhe Rankoviçit pas Plenumit të Brioneve. Së kndejmi ajo kishte arritur të siguronte edhe informacione mbi listën e oficerëve të UDB të cilët kishin bërë krime në Kosovë.¹⁶⁹ Këto ngjarje të reja sollën edhe qëndrimin politik të Shqipërisë për statusin politik të Kosovës.

¹⁶³ Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2021, 34.

¹⁶⁴ Rilindja, 02 korrik 1966, 1.

¹⁶⁵ Pero Simiq, *Tito-tajna veka*, Beograd, 2009, 329.

¹⁶⁶ Simic, *Tito*, 330.

¹⁶⁷ *Historia e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985, 500.

¹⁶⁸ Atdhe Hetemi, *Lëvizjet studentore për Republikën e Kosovës 1968, 1981, 1997*, Artini, Prishtinë, 2020, 155.

¹⁶⁹ Syla, *Shteti shqiptar*, 213.

Pas korrikut 1966, Shqipëria e konsideronte dhe parashihte zgjidhje të çështjes së Kosovës si vijon: pakicë kombëtare, autonomi etj. Lideri komunist Enver Hoxha, më 1 gusht 1966 do të theksonte : Pra *“Pakicat kombëtare duhet të ndjekin rrugën e drejtë revulucionare, rrugën e luftës kundër klikës së Titos për çlirimin e popujve të Jugosllavisë”*.¹⁷⁰ Udhëheqja shqiptare e shihte zgjidhjen e problemit të Kosovës gjithnjë brenda kuadrit të ideologjisë marksist-leniniste sepse kështu ajo nuk do të sillte telashe për të. Enver Hoxha nuk e mbështeti idenë për zgjerimin e statusit të Kosovës duke u shprehur se para pëlqente ruajtjen e autonomisë së saj në kuadër të Jugosllavisë. Nga kjo kohë në Kosovë filloj të ndizej edhe ideja e Republikës së Kosovës nga politikan komunistë të kohës por edhe nga intelektualët e pakët kosovar të cilët kishin një formim solid por edhe një atdhedashuri. Të gjitha qëndrimet “kosovare” kishin një objektiv të vetëm – shkëputjen e Kosovës nga Serbia në planin politik. Por edhe pse duket e quditshme, politikanët kosovar si Fadil Hoxha, Veli Deva, Sejfedin Bakalli e ndonjë tjetër nuk ishin të ndikuar fare nga ideologjia komuniste e Tiranës. Ata në masë të madhe, kishin orientim pro-jugosllav, por ishin të mveshur me petkun kombëtar legalisht pas Plenumit të Brioneve. Këta politikan nuk kundërshtuan nismat e intelektualëve kosovar mbi mundësinë që ata të deklaroheshin për statusin e Kosovës. Intelektual si prof.. Gazmend Zajmi e prof.. Syrja Pupovci si jurist profesionist, pastaj edhe prof.. Ali Hadri e ndonjë tjetër nuk kishin fare ndikim nga Tirana zyrtare. Shqipëria e nuhati mirë situatën duke kundërshtuar me qdo kusht “Republikën e dytë shqiptare”. Influncën që donte ta kishte Tirana ishte e qartë, dhe kjo shihej nga qëndrimi i saj karshi këtyre zhvillimeve që i pa me kujdes në Kosovë në periudhën që po trajtojmë. Një nga arsyet tjera kryesore që Kosova nuk favorizohej të ishte republikë, ishte se rrjedhat ndërkombëtare ishin të disfavorshme në këtë vit dinamik. Për fat të keq elita kosovare nuk u kuptua drejtë nga shteti shqiptar dhe puna e bërë shkoj në uj. Tirana zyrtare asnjëherë nuk arriti ta kuptojë që elita kosovare ishte atdhetare, dhe se ajo e bënte luftën e saj brenda Federatës Jugosllave me forcat e veta sidomos kur kishte marr zemër pas korrikut 1966. Në fund mund të themi se elita

¹⁷⁰ Syla, *Shteti shqiptar*, 212.

kosovare si ajo politike dhe intelektuale vepruan në kuadër të koniukturave politike jugosllave. Shqipëria nga ana tjetër mbajti qëndrime të cilat i cekëm më lartë. Me anë të liderit të saj Hoxha, ajo bënte thirrje të ndryshme mbi statusin e Kosovës. Duke parë me kujdes shënimet e kohës po përmendim disa nga këto mendime të dhëna në gusht të vitit 1966 ku Enver Hoxha thekson : *“Dëgjojmë të flitet për një republikë të Kosovës. Kosovarët duhet të tregohen shumë të kujdesshëm ndaj revizionistëve titistë, të cilët mund të luajnë edhe kartën e krijimit të “republike shqiptare kosovare” në vend të “krahinës autonome”, për të gënjyer shovinizmin kosovar, për të shtypur më mirë luftën çlirimtare të Kosovës dhe për të luftuar Republikën Popullore të Shqipërisë”*. Në Kosovë era e ndryshimeve po vinte nga gjysma e vitit 1966 e tëhu. Interesimet e shtetit shqiptar për Kosovën do të vinin në dukje nga viti 1967 e tutje kur Shqipëria me politikën e saj do të afrohej me Kosovën në sferat sferën shkencore. Politika e shtetit shqiptar karshi Kosovës në vitet që trajtuam më sipër ishte në koherencë me status qoun në Jugosllavi dhe deri më 1966 nuk ishte aq intensive në rrafshin diplomatik. Shqipëria me vite vite refuzoj çfardo kontakti shkencor ose kulturor me institucione ose individ në Jugosllavi, duke përfshirë këtu edhe Kosovën.¹⁷¹ Viti 1967 do të ishte një shtet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe Kosovën, sepse veprimet e para do të realizoheshin me letërkëmbime të institucioneve të Shqipërisë dhe atyre kosovare.

Konferenca e dytë e studimeve albanologjike në Tiranë 12-17 janar 1968

Në kohën kur në Europë kishte filluar Detanta dhe tensioni midis Lindjes dhe Perëndimit ishte ulur, udhëheqësit shqiptare u përpoqën të shfrytëzojnë këtë moment për të shtrirë ndikimin e tyre në Kosovë. Në rrethanat e krijuara, kur edhe në Jugosllavi Federata po u lëshonte republikave dhe krahinave autonome disa nga kompetencat e saj, rruga më e mirë shihej nëpërmjet zhvillimit të shkencës dhe kulturës kombëtare në Kosovë. Disa nga arsyet pse marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u përmirësuan ishin me sa

¹⁷¹ Petrit Imami, *Serbët dhe shqiptarët*, vëllimi III, Beograd, 2017, 60.

vijon : Shqipëria ishte ndarë nga BRSS dhe po përgatitetej për izolim, përdorimi i elementëve të identitetit kombëtar, pozita gjeografike dhe gjeostrategjike e dy vendeve, partneriteti ekonomik që kishte filluar nga 1966 ndërmjet firmave të tregtisë së jashtme nga dy vendet. Për Shqipërinë ishte një mundësi e mirë për të ndihmuar shqiptarët e Kosovës. Kurse për Jugosllavinë kjo kishte të bënte me ruajtjen e integritetit territorial.¹⁷² Duke u nisur nga zhvillimet e jashtme ndërkombëtare dhe ato të brendshme ndërmjet dy vendeve lindi një rrezik i ri e ai ishte Bashkimi Sovjetik i cili kishte pushtuar Çekosllovakinë dhe në këtë mënyrë veqanërisht Shqipëria e shihte veten të rrezikuar nga BRSS. Në vështrimin e historianit Skënder Lutfiu ai vëren disa arsye pse Jugosllavia bëri lëshime shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të tjera në këtë periudhë me sa vijon : 1. Për të balancuar fuqinë e kroatëve në dëm të serbëve sepse sa më të fortë shqiptarët aq më të dobët do të mbesin serbët ; 2. për t'i thënë botës se ju jep të drejta pakicave kombëtare : 3. Për të pasur një fqinjësi të mirë në Ballkan ngase ishte e interesuar për një gjë të tillë duke pasur parasysh rrethanat politike të kohës.¹⁷³ Pikërisht me zhvillimin e proceseve të reja në Kosovë, përkonte edhe 500 vjetori i vdekjes së Skënderbeut të cilin Shqipëria e kishte injoruar deri atëherë. Tirana do ta kujtonte heroin me evenimente të rëndësishme shkencore e kulturore. Populli shqiptar i Kosovës e sidomos rinia e saj priste të shijonte këto organizime si ngadhënjim mbi shtypjen e deri djeshme serbe edhe gjithashtu si pikëtakim kombëtar me shtetin shqiptar. Në fund të vitit 1967 Komiteti për Marrëdhëniet Kulturore me Botën e Jashtme të Shqipërisë me nënshkrimin e Misto Treskës, dërgoj një telegram drejtuar Kuvendit të Kosovës, ku ftoi një delegacion të shqiptarëve të Jugosllavisë të bashkohej në festimin e 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut në Shqipëri. Qysh në fillim pati debat sepse Tirana, kërkoj që në delegacion të mos ishte ndonjë serb ose turk dhe kjo i binte që kremtimi ishte ekskluziv vetëm për shqiptarët. Pas pranimit të këtij telegrami, Fadil Hoxha iu përgjigj këtij telegrami në fjalë.¹⁷⁴ Ai *“vlerësonte rolin e Skënderbeut si një personalitet historik, rëndësia e të cilit shkonte*

¹⁷² Skënder Lutfiu, *Roli i Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave gjatë viteve 70*, “Vjetari”, nr.50, Prishtinë, 2014, 450.

¹⁷³ Lutfiu, *Roli i Kosovës*, 456.

¹⁷⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJ), viti 1968, Dosja 17/1, 18.

përtej kufijve kombëtarë të shqiptarëve, sepse ai luftoi kundër pushtuesve osmanë për të mbrojtur lirinë e kombit shqiptar". Për këtë arsye ishte planifikuar të festohej së bashku. Për më tepër, Fadil Hoxha informoi se ky jubile do të mbahej jo vetëm në Kosovë por edhe në Maqedoni dhe Mal të Zi ku jetonin shqiptarët. Ai shprehu gatishmërinë e Kuvendit të Kosovës për të dërguar një delegacion në Tiranë (janar 1968) i cili do të ishte "një ngjashmëri e popullsisë së Kosovës".¹⁷⁵ Në këtë kontekst ai ftoi një delegacion nga Shqipëria për të marrë pjesë në festimin historik të Skenderbeut në Prishtinë në maj 1968. Marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, natyrisht nuk ishin të një rëndësie të madhe dhe në telegramin Fadil Hoxha dha sigurinë se "delegacioni shqiptar do të ishte vërtet i mirëpritur dhe i respektuar plotësisht".¹⁷⁶ Në këtë konferencë ishin të ftuar Mark Krasniqi gjeograf dhe dekan i Fakultetit Ekonomik, Syrja Pupovci docent në Fakultetin Juridik, Fehmi Agani drejtor i Institutit Albanologjik, Zef Mirdita asistent i historisë në Fakultetin Filozofik, Anton Çeta bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik.¹⁷⁷ Në librin me kujtime, prof. Mark Krasniqi, ka fiksuar disa momente nga vizita e grupit Kosovar dhe takimi i tyre me udhëheqjen e Shqipërisë në qytetin e Krujës.. Ai thekson ndër të tjera "para se të niseshim na ftuan në Këshillin Krahinor për të na dhënë udhëzime me rastin e qëndrimit në Shqipëri. Na pritën Fadil Hoxha, Ilia Vakiqi dhe Kadri Reufi, funksionar të lartë partiak në Lidhjes Komuniste të Kosovës. Ata na thanë se duhet të kemi kujdes nëse flitet diçka kundër Titos, Partisë Komuniste dhe Jugosllavisë dhe delegacioni Kosovar e ka detyrë të proteston aty për aty. Fadil Hoxha madje sipas prof. Markut ju tha se nëse ndodh kjo, atëhere ata duhet të protestonin me zhurmë, dhe ta braktisnin mbledhjen". Për të parë tablën e takimit të profesorëve kosovar me Enver Hoxhën dhe kabinetin me ministra të qeverisë Shehu është mirë të shohim tablën e takimit. Sipas prof. Mark Krasniqit "asnjëri nga delegacioni ynë nuk bisedoj pos tij (Markut), i cili theksoj se ne jemi mysafir të Universitetit të Tiranës dhe çdo sukses i Shqipërisë është krenaria jonë në Kosovë. Ne urojmë që të normalizohen marrëdhëniet

¹⁷⁵ Arkivi Qendror Shqiptar (më tej AQSH), viti 1968, Fondi 511, Dosja 30, 30.

¹⁷⁶ Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (më tej ASHAK), Fondi : Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, Informata dhe të ndryshe 1962-1984, 4.

¹⁷⁷ Rilindja, 09.01.1968, 10.

me Jugosllavinë në planin politik. Enver Hoxha në fjalimin e tij që bëri para profesorëve kosovar në Kruje në janar të vitit 1968 ju premtaj atyre bursa dhe libra.¹⁷⁸ Midis tjerash Enver Hoxha, theksoj “*se ne jemi bijtë e një nëne dhe babe, dhe se gëzohemi që ju të fitoni sa më shumë të drejta dhe që ju kemi midis nesh*”. Në fund të rrëfimit informohemi nga prof. Mark Krasniqi se delegacioni Kosovar pasi u kthye në Tiranë, vrapoj në Ambasadën Jugosllave, për të rrëfyer “takimin shqiptaro-shqiptar”.¹⁷⁹ Objektivi kryesor nga dy vendet ishte përmbushur dhe afrimi i Kosovës me Shqipërinë tashmë në aspektin kulturor dhe shkencor ishte i prekshëm. Kronika e ngjarjeve na ofron të dhëna për evenimentet që kishin ndodhur në janarin e vitit 1968 në Tiranë. Kështu u bë përrurimi solemn i statujës së Skënderbeut i cili u zhvillua në qendër të Tiranës. Fjalën kryesore e mbajti prof. Aleks Buda i cili referoj kumtesën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe epoka e tij”.¹⁸⁰ Në këtë konferencë shkencore, u lexuan edhe studimet e punonjësve shkencorë nga Kosova. Mark Krasniqi “Lufta kundër feudalizmit në poezinë tradicionale të shqiptarëve”, Syrja Pupovci “Kanuni i Leke Dukagjinit”. Synimet e shqiptarëve të Kosovës të udhëhequra nga Fadil Hoxha si politikani kryesor kosovar ishin që Kosova të kishte një derë afrimi me Shqipërinë. Ai me kujdes përzgjedhi elitën e profesorëve kosovar të cilët ishin në inkuadruar në kuadër të Fakulteteve të Prishtinës që vepronin nga viti 1960 në suaza të Universitetit të Beogradit. Kujdesi i profesorëve kosovar në prononcimet e tyre mbi situatën politike ishte vërejtur që në fillim. Këto quadro kosovare në rrafshin shkencor patën një prezantim tejet të mirë edhe pse përvoja e tyre nuk ishte e madhe. Krahas me profesorët më në zë shqiptar ata mbrojtën tezat e tyre në këtë konferencë mbi tema të ndryshme të historisë, jurispondencës shqiptare në shekujt e mesjetës. Profesorët kosovar, patën mundësinë e mirë që të njiheshin edhe me eksperiencën e pedagogëve dhe studiuesve shqiptar, të cilët kishin një përvojë më të madhe sepse arsimit i lartë atje ishte ngritur shumë më herët, por edhe përvoja e tyre e fituar në vende të ndryshme si Austria, Bashkimi Sovjetik etj, do të ishin një përvojë tejet solide për profesorët kosovar. Ecuria e mirë në zhvillimet akademike e

¹⁷⁸ Sylja, *Shteti shqiptar*, 220.

¹⁷⁹ Mark Krasniqi, *Kujtime e përjetime*, Pejë, 2012, 300-301.

¹⁸⁰ Rilindja, 11.02.1968, 13.

shkencore po shënonte një fillim të mbarë në rrafshin kombëtar në këto sfera ndërmjet dy vendeve. Kosova kishte një interes shumë më të madh për fillimin e këtyre marrëdhënieve, edhe për shkak të shtypjes së madhe nga serbët, por edhe sepse vetëdija kombëtare kishte mbetur e lartë gjithmonë sidomos pas vitit 1948 kur kufijtë u mbyllën për dy vendet. Enver Hoxha ishte i interesuar që ta vazhdonte këtë marrëdhënie duke dhënë sinjale të qarta se në maj të vitit 1968 do të dërgonte një ekip të kryesuar nga një zyrtar me origjinë nga Kosova prof. Bujar Hoxha.

Simpoziumi për 500 vjetorin e Skënderbeut në Prishtinë – Maj 1968 dhe efektet e tij

Nga mesi i vitit 1968 marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u normalizuan dukshëm dhe u arrit një klimë më e favorshme ndërmjet dy vendeve. Pas një korrespondence disa mujore midis strukturave të Kosovës dhe asaj shqiptare nga një delegacion profesorësh të Universitetit të Tiranës për të marrë pjesë në Simpoziumin shkencor për 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut të përbërë nga prof. Aleks Buda, prof. Ndreçi Plasari, prof. Bujar Hoxha, prof. Dhorka Dhamo, prof. Thoma Murzaku, prof. Mediha Shuteriqi arriti në Kosovë më 8 maj 1968. Autoritetet politike kosovare kishin mundur edhe ndihmuar thellë institucionet shkencore të Kosovës në mënyrë që cdo gjë të ishte madhështore. Elita politike kosovar kishte edhe arsye të dukej më mirë para popullit sepse në të kaluarën nuk kishte mundur të vepronte lirshëm në dobi të interesave kombëtare. Brenda të gjitha mundësive të krijuara nga rrethanat e kohës, mbajtja e këtij simpoziumi ishte një afrim kombëtar me vëllezërit shqiptar. Kurse për të pasqyruar sa më objektivisht qëndrimin e delegacionit shqiptar në Kosova, kemi edhe shënime nga delegacioni shqiptar. Ndjenjën e veçantë të pritjes e dëshmon dhe bija e prof. Aleks Budës, Tatjana Haxhimihali në kujtimet që i botoj në shenjë të babait të saj prof. Aleks Budës. Me sa shohim në këto shënime me vlerë delegacioni i profesorëve nga Universiteti i Tiranës u prit në Prishtinë me dashuri dhe ngrohtësi të jashtëzakonshme. Ishin ndjenja të forta patriotike që identifikohehen me Shqipërinë. Kjo qartë dëshmon një numër të madh të qytetarëve, intelektualë, studentë që dëshironin të takoheshin me anëtarët e delegacio-

nit.¹⁸¹ Organizatori i simpoziut ishte Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Enti i Historisë së Kosovës. Simpoziumi Shkencor filloi në prani të Kryetarit të Kuvendit Fadil Hoxha, Veli Deva kryetar i Komitetit Krahinor të LK, Ilija Vakiq kryetar i këshillit ekzekutiv dhe Idriz Ajeti kryetar i simpoziut të këshillit shkencor. Në këtë eveniment ndodhën edhe indidente që lidhen edhe me politikën përgjithësisht. Shoqëruesit e delegacionit shqiptar u morën edhe me shpërndarjen ilegalisht të fotografive të Enver Hoxhës, kartolinave me panorama nga Shqipëria etj. Duke e parë situatën se sa e ndjeshme ishte në popull, njerëzit e delegacionit shqiptar donin edhe ta provonin ndjenjën e dashurisë së kosovarëve ndaj shtetit shqiptar. Delegacioni i profesorëve nga Universiteti i Tiranës u prit në Prishtinë me dashuri dhe ngrohtësi të jashtëzakonshme. Ishin ndjenja të forta patriotike që identifikohen me Shqipërinë. Kjo qartë dëshmon një numër të madh të qytetarëve, studentë, intelektualë, studentë që dëshironin të takoheshin me anëtarët e delegacionit.¹⁸² Të ngazëllyer nga pritja, në Rugovë u bë një pritje madhështore sidomos për prof. Aleks Budën, sikur të ishte prijësi i tyre shpirtëror. Gjatë kësaj periudhe serbët në muret e fakulteteve dhe konvikteve të Prishtinës shkruan parulla si “Kosova është e serbëve”, “Serb bashkohuni sepse jemi në rrezik”, “Gjuha shqipe nuk ka vend në Kosovë” etj.¹⁸³ Se sa ndikoj negativisht te serbët ky *“bashkim” i shqiptarëve në këtë kohë, dëshmojnë edhe veprimet e nxitura nga serbët në dëm të organizimeve të përbashkta “shqiptaro-shqiptare”*. Serbia me instrumentet e saj sidomos me ato të Sigurimit Shtetëror organizoj veprime që donin ta prishnin edhe madhështinë e këtij manifestimi gjithëkombëtar. Por me vendosmëri të madhe asgjë nuk shkoj keq, dhe situata mbeti nën kontroll gjatë ditëve që ishte delegacioni shqiptar. Fadil Hoxha si tutor i këtij jubileu deshi të zgjeronte spektrin e këtyre takimeve shkencore e festive dhe të ngrinte çështje aktuale e thelbësore me delegacionin shqiptar. Dhe ai e dinte se njeriu më i përshtatshëm për takim ishte Bujar Hoxha, me të cilin ai ishte njohur gjatë luftës së dytë botërore. Bujar Hoxha e refuzoj takimin. Megjithatë, Fadil

¹⁸¹ Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda-kujtme 2*, Tiranë, 242-259.

¹⁸² Haxhimihali, *Aleks Buda-kujtme 2*, 242-259.

¹⁸³ Esat Myftari, *Enver Hoxha dhe Kosova*, Tiranë, 2016, 73.

Hoxha e mirëkuptoj dhe gjeti mëryra tjera për të ja dhënë mesazhin e vet.¹⁸⁴ Në darkën zyrtare që shtroj Sali Nushi si sekretar i Komitetit për Arsim dhe Kulturë të Kosovës, për nder të delegacionit të Shqipërisë, i njoftoj të pranishmit nga Shqipëria me funksionet e kryetarit të këshillit ekzekutiv të Kosovës - Ilia Vakiqit i cili bëri një takim kokë më kokë me Bujar Hoxhën.¹⁸⁵ Ky i fundit në takim shtroj nevojën e bashkëpunimit të ngushtë me Shqipërinë. Pos tjerash theksoj se Kosova të bëjë tregti me Shqipërinë në kuadër të marrëdhënieve ekonomike shqiptaro-jugosllave, duke pasur leverdi e fitime dhe gjithashtu të blej mallra. Të kaluarën sipas Vakiqit duhet ta harrojm tha ai në takim me prof. Hoxhën në prani të delegacionit shqiptar. Ai theksoj se interesi është i përbashkët sepse në Kosovë jetojnë mbi 1 milionë shqiptar të cilët kërkojnë lidhje me shtetin shqiptar. Duke qenë afër Elhami Nimanit anëtar i Komitetit Qendror të Jugosllavisë, në takim, Ilia Vakiqi theksoj se duhet të përmirësohen marrëdhëniet në rrugë shtetërore. E vuri në konsideratë mendimin se marrëdhëniet duhet vënë në bashkëpunim me Titon. Në fund ai vuri në dukje se të gjithë jemi për afrim e bashkëpunim.¹⁸⁶ Enver Hoxha e kishte ngarkuar Bujar Hoxhën¹⁸⁷ që të ofronte të dhëna mbi qëndrimin e komisionit të amandamenteve dhe kërkesës së kosovarëve për republikë duke ju referuar deklaratës së 22 prillit 1968 të Fadil Hoxhës në Komitetin Krahinor të LK Kosovës ku shtronte mundësinë që Kosova të ishte Republikë në kuadër të RSFJ. Edhe pse e kishte refuzuar takimin me Fadil Hoxhën, kuptohet Bujar Hoxha veproj prapa perdeve, sepse i kishte njerëzit e besuar, nga të cilët do të informohej me saktësi për pikëpamjet e tyre dhe do të shpaloste qëndrimin e Enver Hoxhës. Bujar Hoxha me këtë rast e njoftoj ambasadorin Lik Seiti i cili pastaj njoftoj qendrën “*në takimin zyrtar që ka pasur Bujar Hoxha me disa anëtar të komi-*

¹⁸⁴ Myftari, *Enver Hoxha*, 73-74.

¹⁸⁵ Bujar Hoxha (1920-2006). Kreu studimet për filozofi në Universitetin e Leningradit (1951). Për 40 vite ishte pedagog në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në vitet 1981-1982 konsull i Shqipërisë në Stamboll. Poashtu ishte njeri që kreu koordinim të politikës zyrtare të shtetit shqiptar me grupet ilegale jashtë Kosovës si dhe gjatë periudhës 1968-1990 mbeti ndër njerëzit më me ndikim për politikën e Shqipërisë ndaj Kosovës. (Shih : *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* 2, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, 957.).

¹⁸⁶ AMPJ, Viti 1968, Dosja 360, 201-231.

¹⁸⁷ Myftari, *Enver Hoxha*, 74.

sionit për ndryshimin e statutit të Kosovës, ka mësuar se autonomia e saj do të forcohet edhe për shumicën e problemeve ajo do të këtë lidhje me Federatën dhe jo me Republikën e Serbisë. Udhëheqja e Kosovës nuk ka propozuar vetë për krijimin e Republikës së Kosovës pasi një propozim i tillë sipas mendimit të tyre nuk është opurtun për situatën e tanishme”.¹⁸⁸ Emocionet e ofruara nga shqiptarët e Kosovës për delagacionin shqiptar, ishin një dush i ftoft prej Tiranës zyrtare pas këtij evenimenti. Shqipëria kishte një heshtje të plot në qëndrimet e saja karshi Kosovës. Kështu e shpreh legata shqiptare në Beograd këtë situatë “*intelegjencës së Kosovës i ka bërë përshtypje jo të mirë, që si shtypi ashtu edhe radioja jonë, nuk dhanë as edhe një njoftim zyrtar për simpoziumin e Skënderbeut që u mbajt në Prishtinë, poashtu edhe për përshtypjet e delegacionit tonë që morri pjesë atje*”.¹⁸⁹ Simpozimi për Skënderbeun ishte manifestim shkencor ndërmjet dy vendeve, por ai ishte i paramenduar të kthehej në arenë të debateve të ndryshme që kishin karakter politik. Elita kosovare si nikoqire ishte e interesuar të kishte një afri më të madhe me shtetin shqiptar dhe kjo shihet nga veprimet e liderëve politik kosovar.

Kërkesa për Republikën e Kosovës, demonstratat e nëntorit 1968 dhe Shqipëria

Në Kosovë nga fillimeve i viteve të gjashtëdhjeta problemet politike, ekonomiko-shoqërore e kulturore qenë rritur në përmasa serioze si rezultat i kontradiktave të papajtueshme ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Shqiptarët kërkonin më shumë të drejta dhe shpallën vendosmërinë e tyre për të luftuar për të drejta kombëtare dhe njerëzor. Kërkesa për Republikën e Kosovës i ka filltet e veta në gushtin e vitit 1968 kur në aktivin e komunistëve të qytetit të Gjakovës për herë të parë u ngrit si ide Kosova Republikë. Këtu u kërkua që kombësia shqiptare të emërtohet si kombi shqiptar, të përcaktohet përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar, Kosova Republikë në kuadër të RSFJ, e drejta për vetëvendosje, Kosova të këtë 20 përfaqësues në dhomën e kom-

¹⁸⁸ AMPJ, Dosje 360, 1968, 5-14.

¹⁸⁹ AMPJ, dosja 411, viti 1969, 2-6. (cituar sipas Esat Myfarit, *Kosova dhe Enver Hoxha përmes dokumenteve arkivore të pabotueme deri më sot*, Tiranë, 2016, 83-84.)

beve të Kuvendit Federativ.¹⁹⁰ Këto mendime të shprehura në këtë aktiv u përkrahën nga institucionet kosovare dhe intelektualët edhe patën jehonë në tërë Kosovën. Pas këtyre qëndrimeve sigurisht që rrinte Fadil Hoxha si promotor i gjithë këtij eventi politik për kohën. Impakti ishte ndier edhe në Beograd ku pati reagime të ashpra të qarqeve politike dhe intelektuale serbe dhe nacionaliste të cilat kishin reaguar në tubime të mbajtura nga studentët e Universitetit të Beogradit në gushtin dhe shtatorin e vitit 1968 në të njëjtën kohë.¹⁹¹ Në anën tjetër intelektualët kosovar x filluan të mbështesin edhe më zëshëm kërkesën e Kosovës për vetëvendosje. Kështu duke trajtuar këto problematika historiani Ali Hadri deklaroi se “duke shfrytëzuar të drejtën për vetëvendosje popujt e Kosovës ishin element kreativ në krijimin e Jugosllavisë së re”. Kurse Gazmend Zajmi theksoj në gazetën “Rilindja” se “Kombësisë si kolektivitet i takon kjo e drejtë sic i takon edhe kombit”. Fehmi Agani bëri të ditur se “duhet përkrahur të gjitha kërkesat që janë prezantuar si kërkesa të shumicës dërrmuese të popullsisë”. Kurse më radikali në këtë aspekt ishte Rrezak Shala, i cili në gusht 1968 në aktivin e Komunistëve të qytetit Gjakovës si prokuror krahinor ngulmonte se “*Republika e Kosovës është imperativ i Kosovës dhe nga ajo e drejtë nuk duhet hequr dorë*”.¹⁹² Të gjitha këto diskutime do të fashiteshin pas një periudhe një mujore nga organet e partisë së Kosovës të udhëhequra nga Fadil Hoxha. Në shtator 1968 Fadil Hoxha pati një takim me Titon dhe udhëheqësit tjerë jugosllav si Kardeli e Bakariqi. Premtimet e Titos kishin qenë të qarta : Kosova do të përfiton më shumë në të drejtat e saja për vendimarrje, flamurin kombëtar, etj.¹⁹³ Pikërisht Fadil Hoxha kryetar i komisionit për ndryshime kushtetuese pranoi se nga kjo tërheqje e udhëheqjes kosovare kishte bërë fakti se në takimin e kosovarëve me Titon dhe Kardelin ishin dakorduar që kjo çështje të lihet për më vonë sepse reaksioni serb ishte i madh. Në fund të kësaj odiseje pati një pozicion të detyruar të cilin do ta shtjellon Fadil Hoxha para Kuvendit të Kosovës me fjalët “nuk do të thotë se nuk mund të shtrohet çështja e Republikës.., por duhet të vlerësojmë se çka është reale,

¹⁹⁰ Rilindja, 19 gusht 1968, 1-2.

¹⁹¹ Branko Petranovic, *Istoriya Jugoslavije 1918-1970*, Beograd, 1980, 572.

¹⁹² Jusuf Buxhovi, *Kosova 3*, Prishtinë, 2015, 339.

¹⁹³ Jusuf Buxhovi, *Kthesa historike – shteti paralel dhe rezistenca e armatosur*, Prishtinë, 2009, 104.

vërtet reale dhe e mundshme në këtë drejtim të afirmimit të autonomisë, që do të thotë esenca të arrihet dhe nga ana tjetër të kuptohet se çka është dëshirë”.¹⁹⁴ Sipas legatës shqiptare në Beograd ndodhën kthesa të mëdha në muajin shtator të politikës kosovare karshi propozimit dhe kërkesës për Republikës. Fadil Hoxha hyri në polemikë me Rrezak Shalën ndaj të cilit edhe morri masa duke inicuar shkarkimin e tij nga Prokurori i Kosovës dhe duke ja mundësuar që të doktoroj në Zagreb. Në fund shohim se Rrezak Shala ishte i revoltuar nga këto ngjarje dhe shprehte indinjatë ndaj liderëve udhëheqës së Lidhjes Komuniste të Kosovës duke thënë se “*Veli Deva dhe Fadil Hoxha po tërhiqen nga kërkesat legjitime.*”¹⁹⁵ Intelektualët kosovar ishin të pakët që folën hapur mbi këtë fenomen që deri atëherë as që e kishte qar dikush ndërmend ta përmendte. Sakrifica e këtyre profesorëve nuk ishte e vogël në dobi të çështjes kombëtare. Të drejtat e popullsisë shqiptare po mbroheshin tanimë me zë kumbues dhe kjo kishte një vlerë të jashtëzakonshme. Ndër njerëzit që la mbresa të mëdha ishte edhe përpjekja e Rrezak Shalës, prokuror i cili ishte në pozitë mjaft delikate në kompetencat që ushtronte. Rrjedha e ngjarjeve bëri që ai të humbiste shumë privilegje si humbja e punës, vetëm e vetëm pse situata doli nga kontrolli kur politika e LKJ në krye me Titon nuk favorizoj një status të Republikës për kosovarët. Profesorët e tjerë nuk humbën asgjë madje as punën e tyre. Fadil Hoxha si figurë politike kryesore, për një periudhë të shkurtër hyri në zemrën e popullit për guximin e tij. Lidhja Komuniste nuk bënte përjashtim nga vendimet që merreshin në organet e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë. Vendimet që i morri Tito, u pranuan një zëri në tërë elitën politikë kosovare. Udhëheqja shqiptare nuk kishte besim te iniciuesit e Republikës së Kosovës dhe e konsideronin këtë alternativë të parakohshme, të hedhur nga reaksioni ose elementë të tjerë në republikat e ish-Jugosllavisë. Arsyeja kryesore ishte frika se mos një republikë e tillë mund të përdorej nga Titoja kundër Shqipërisë komuniste-staliniste dhe për rrjedhojë do të çonte deri në rrëzimin e vet udhëheqjes shqiptare dhe të përmbysjes së regjimit në Shqipëri. Por, në të njëjtën kohë ato shprehin dhe mosbesimin ndaj atyre që u prinin proceseve, të cilët me sa

¹⁹⁴ Buxhovi, Kthesa historike, 104.

¹⁹⁵ AMPJ, Dosja 411, 1969, 5-9. (cituar sipas Esat Myfarit, *Kosova dhe Enver Hoxha përmes dokumenteve arkivore të pabotueme deri më sot*, Tiranë, 2016, 73-74.)

duket nuk ishin nën kontrollin e saj. Ndërrimi i kursit brenda një periudhë të shkurtër kohore ishte interesant por edhe dëshprues sepse fundi nuk u realizua me sukses, atë që e priste populli kosovar. Rruga legale u pamundësia të vazhdohej më tej edhe nga shtatori 1968 kërkesa për Republikën e Kosovës ishte mbyllur përgjithmonë. Duket se kjo i konventonte edhe Tiranë zyrtare. Udhëheqja e shtetit shqiptar donte ta zgjidhte problemin shqiptar brenda skemave të ideologjisë marksiste-leniniste, sepse përndryshe nacionalizmi në Kosovë do të bëhej minus edhe për të në Tiranë. Nacionalizmi shqiptar në Kosovë dhe internacionalizmi i PPSH-së nuk mund të harmonizoheshin me njëri-tjetrin. Zhvillimi i këtyre demonstratave dhe situata që i parapriu atyre përkonin me një gjendje të acaruar për Shqipërinë e cila veçohet me një politikë jo balancuese në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare.¹⁹⁶

Të gjitha këto zhvillime politike të kërreëve kosovar dhe intelegjencies së Kosovës nuk do të kënaqnin popullit shqiptar. Pas një periudhe tre mujore vlimet politike do të kishin rrjedhën e vet. Ndikimi i lëvizjeve që kishte nisur në Europë dhe Jugosllavi do të prekte edhe Kosovën por këtë në rrafshin kombëtar duke kërkuar të drejtua legjitime. Demonstratat e para filluan më 6 tetor në Prizren në organizim të të rinjve etj, në të njëjtën kohë në Pejë nga nxënësit e shkollës normale “Ali Kelmendi” ku u hodhën parulla për flakurin dhe Universitetin e Kosovës dhe mbi të gjitha Kosovën Republikë.¹⁹⁷ Demonstrata në qyteteve të vogla u mbajtën edhe në Suharekë, Gjilan më 27 nëntor. Gjithashtu në Podujevë pati në të njëjtën ditë demonstratë me organizator. Këto manifestime do të merrnin arrinin kulmin e tyre më 27 nëntor 1968 në Prishtinë. Në gjithë synimet e veta këto demonstrata ishin të orientuara me kërkesat e veta si : Kosova Republikë, Duam Republikë, etj.. Në të gjitha demonstratat që u organizuan në Kosovë pati burgosje të shumta nga Gjykatat.¹⁹⁸ Shumë serbë përmes letrave që ia shkruan “Rilindjes” akuzuan Shqipërinë se po ndërhynte në punët e brendshme të Jugosllavisë. Marko Nikeziqi në diskutimin e tij që mbajti para aktivitet politik të Serbisë, duke akuzuar Shqipërinë, ndër të tjera tha: “Liberalizimi ynë nuk

¹⁹⁶ Sylva, *Qëndrimi i Shqipërisë*, 289.

¹⁹⁷ Zymer Neziri, *Isa Demaj – jeta dhe veprimtaria atdhetare*, Prishtinë, 2000, 112.

¹⁹⁸ Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetëtetës 1*, Prishtinë, 2008, 116.

do të thotë se do të bëjmë lëshime në llogari të integritetit të Jugosllavisë”. Edhe udhëheqësit kosovarë, si: Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Ali Shukriu e Veli Deva, gjatë diskutimeve të tyre kishin theksuar se “demonstratat në Kosovë qenë të influencuara nga propaganda e Tiranës”. Po ashtu Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës demonstratat i quajti të organizuara nga nacionalistët e irredentistët shqiptarë të nxitura e të influencuara nga jashtë me pikësypnim Shqipërinë. Ata nxorën edhe një deklaratë ku dënoheshin demonstratat dhe cilësoheshin si të shkaktuara nga elementë “shovinistë, antijugosllavë” dhe të “drejtuara kundër rendit në Jugosllavi, kundër Kushtetutës dhe vetadministrimit”. Në qarqet shtetërore jugosllave dhe serbe ekzistonte frika e influencës gjithmonë në rritje të Shqipërisë të shqiptarët në Jugosllavi.¹⁹⁹ Pjesëmarrësit e mbledhjes së jashtëzakonshme në Komitetin Krahinor mbajtën qëndrime të ashpra. Duhet veçuar edhe deklaratimet e Ismajl Bajrës i cili ndër të tjera tha : *“nacionalistët nga kombësia shqiptare përpiqen që aktivitetin e tyre ta paraqesin si përpjekje për realizimin e të drejtave të kombësisë shqiptare në emër të klasës punëtore, dhe intelegjencies shqiptare. Sipas Bajrës nacionalistët e këtillë i shprehën interest e tyre, si egoiste dhe nacionaliste”*. Kurse vulën kryesore të qëndrimeve ndaj demonstratave e dha Fadil Hoxha i cili theksoj *“nuk do të lejojmë që në asnjë mënyrë të futet krimbi i mosbesimit mes shqiptarëve dhe serbëve. Këtë kurr nuk do ta lejojmë po që se ka nevojë edhe gjakun do ta derdhim”*.²⁰⁰ Në mbledhje u sulmua edhe bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Raportet e ndërsjella u vunë në goditje të forta të lidërsipit të Kosovës. Mbledhja në fjalë solli konkluzione përmes së cilave u kërkua “luftë e vendosur e konsekuente” kundër organizatorëve dhe “platformës së tyre nacionaliste”.²⁰¹ U burgosën krerët e të gjitha këtyre manifestimeve. Pos këtyre masave u vendos një kontroll i rrept edhe mbi revistën “Fjala” e cila botoj shkrime të autorëve shqiptar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në faqet e saj gjatë vitit 1968. Poashtu u vendos të shkarkohej edhe Ali Sutaj nga posti

¹⁹⁹ Sylja, *Shteti shqiptar*, 212-214.

²⁰⁰ Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RS të Maqedonisë 1966-1974*, Logos, Shkup, 2021, 224.

²⁰¹ Lita, *Problemi shqiptar*, 225.

i kryeredaktorit të revistës, sepse dyshohej për nacionalizëm të pastër.²⁰² Dënimet preknin edhe anëtarët e thjeshtë të Lidhjes Komuniste të Kosovës ku 2 anëtarë nga kombësia shqiptare u përjashtuan me motivacionin se nuk kishin dakord me vlerësimin e demonstratave. Kurse po anëtar të LK, u përjashtuan 8 për pjesëmarrje në demonstratë. Informacionet që legata shqiptare i posedonte thuhej se u pushuan nga puna 9 persona.²⁰³ Jehona e demonstratave të vitit 1968 mbeti shumë e madhe sepse për herë të parë ndërgjegjja kombëtare ishte ngritur pas LDB. Një nga arsyet kryesore pse Kosova u bë me të drejta më të mëdha në kompetencat ekzekutive në formën e vendimmarrjes ishin këto manifestime të rëndësishme ku shprehej revolta e përgjithshme popullore për të drejta më të mëdha në kuadër të RSFJ. Megjithatë, në procesin e ri të gjendjes kur edhe ndryshoi kursi i lëvizjes së shqiptarëve në Kosovë më 1968-ën nuk ndryshoi edhe aq qëndrimi i Shqipërisë për zgjidhje të çështjes së saj, me gjithë veprimtarinë e bujshme në drejtim të Kosovës. Tirana zyrtare kishte marr menjëherë informacionet e para mbi rrjedhën e demonstratave në Kosovë. Dokumentet e botuara të provinencës shqiptare të cilat i ka publikuar studiuesi Sabit Sylja na shpalos më së miri këto informacione të analizuara nga Ministria e Jashtme Shqiptare për rrjedhën e ngjarjeve në Kosovë. Gjithnjë sipas dokumentit të emërtuar “*Buletin nr.23 dhe 24 mbi demonstratat në Kosovë*”, theksohet se demonstratat janë rezultat i luftës që bën intelgjencja shqiptare për të fituar më shumë të drejta dhe sigurimin e vetëvendosjes së Kosovës ; demonstratat kishin karakter paqësor por u bënë të përgjakshme ; organizatorët nuk janë të formuar ideologjikisht dhe nuk manovruan në mënyrën e parashtrimit të kërkesave ; demonstratat shkaktuan shqetësim në klikën e Titos etj.²⁰⁴ Këto lajme që kishte në dispozicion Shqipëria, përmes kanaleve të saj ishin të themi informacionet e para mbi gjendjen në Kosovë. Por për të parë më mirë qëndrimet e shtetit shqiptar është mirë të ndalemi në analizimin me kujdes të vlerësimeve të krerëve dhe institucioneve të shtetit shqiptar mbi këto zhvillime tejet të rëndësishme. Tirana zyrtare nuk i

²⁰² Sabit Sylja-Jakup Krasniqi, Nuri Bexheti, *Kosova në arkivat e shtetit shqiptar 1950-1969*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2019, 313.

²⁰³ Sabit Sylja-Jakup Krasniqi, Nuri Bexheti, *Kosova në arkiva*, 324.

²⁰⁴ Sabit Sylja-Jakup Krasniqi, Nuri Bexheti, *Kosova në arkiva*, 322.

kaloi kufijtë e legalitetit dhe nuk u angazhua me veprimtari konkrete subversive, ndonëse do të akuzohet nga udhëheqja e Jugosllavisë në krye me Titon për ndërhyrje në punët e brendshme të saj. Mbrojtja e çështjes shqiptare iu nënshtrua moduleve marksiste-leniniste dhe ideologjisë komuniste. Në këndvështrimin e Tiranës, kërkesa për Republikë barte shumë rreziqe. Fqinja veriore e Shqipërisë, Jugosllavia, ishte një vend revizionist dhe popullsia shqiptare nën juridiksionin e saj mund të manipulohet. Dokumentet arkivore të pabotuara e të shikuara me kujdes nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë na japin një pasqyrë të efektit të këtyre demonstratave në Kosovë. Diplomacia shqiptare u gjallërua nga nëntori 1968 me qëndrimet e saja politike. Në këtë informacion të lëshuar nga ministri i jashtëm shqiptar Nesti Nase²⁰⁵ thuhet se : *“interesi ynë dhe i vëllezërve kosovar e don që situatë në Kosovë të mos ashpërsohet, që demonstratat të mos dramatizohen”*.²⁰⁶ Shqipëria doli me disa qëndrime kryesisht në shtypin e kohës lidhur me qëndrimet mbi Kosovën. Në nëntor 1968 u botuan artikuj në “Zëri i Popullit” si “Mohimet e fakteve dhe shtrembërimet e historisë nuk mund të fshijnë tradhtinë titiste”, “Shqiptarët e Kosovës dhe flamuri kombëtar”, qenë shkrime të cilat patën vlerën e tyre në Kosovë.²⁰⁷ Shqipëria zyrtarisht nuk i mbështeti demonstratat dhe kërkesën Kosova Republikë. Demonstratat e vitit 1968 u vlerësuan nga udhëheqësit komunist kosovar si armiqësore e të propaganduara nga Tirana zyrtare.²⁰⁸ Më 05 dhjetor 1968 Enver Hoxha ofron më shumë informacion se si u vlerësuan nga shteti shqiptar këto demonstrata. Ai fillimisht thotë se “më 27 nëntor në Prishtinë dhe në shumë qytete të Kosovës u zhvilluan demonstratat e rinisë studentore”, për të vazhduar më tutje se “sipas njoftimeve zyrtare pati një të vrarë dhe shumë të plagosur nga njerëzit e UDB që sulmuan demonstruesit.²⁰⁹ Enver Hoxha vazhdoi të mbaj vijën se *“ky parim nuk pa pengon të ngrem zërin në mbrojtje të drejtave të popullsisë shqiptare në Jugosllavi”*. Në të gjitha këto qëndrime të

²⁰⁵ Nesti Nase (1922-1995). Diplomati, Ministër i Jashtëm i Shqipërisë 1966-1982.

²⁰⁶ Esat Myftari, *Kosova dhe Enver Hoxha përmes dokumenteve arkivore të pabotueme deri më sot*, Tiranë, 2016, 83-84.

²⁰⁷ “Zëri i Popullit”, 24.11.1968, 4. (cituar sipas Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2017, 224-225).

²⁰⁸ Syla, *Shteti shqiptar*, 225.

²⁰⁹ AQSH, Fondi : 10, Viti 1968, Dosja : 238, 1-2.

lartë përmendura Shqipëria nuk kishte kurajon që të dilte për Kosovën Republikë por e mbështeste të drejtën e kosovarëve për më shumë të drejta në kuadër të Jugosllavisë. Është me rëndësi se qëndimet e saj ishin në koherencë të plotë me ato të liderëve kosovar të cilët u pajtuan më herët me këto qëndrime të bëra nga Tito dhe klika e tij në LKJ. Këto synime të Shqipërisë, do të ishin të njëjta për Kosovën deri më 1981 kur Tirana zyrtare do të ndryshonte kursin e saj në rrafshin diplomatik. Ai shprehej ndër të tjera se “natyrisht ne nuk kemi as gishtin më të vogël në këto demonstrate, ne nuk zhvilluam asnjë punë agjenturore dhe subversive as në Jugosllavi, as në Kosovë”. Hedhjen e parrullave lideri komunist Hoxha, ia dedikoj provokuesve të futur në rradhët e demonstruesve që duan t’i japin ngjyrë tjetër demonstratave. Në fund ai shfaq hapur mendimin dhe qëndrimin e tij për Kosovën si një çështje e të drejtave nacionale.²¹⁰ Jehona e demonstratave të vitit 1968 ishte e madhe edhe në Jugosllavi dhe kjo reflektoj që të këtë një qëndrim të Titos në Kongresin e 9 të LKJ-së që u bë pas 5 muajve në Beograd. Tito reflektoi në tri drejtime: duhej përshpejtuar ndryshimet kushtetuese, të zhvillohet në aspektin e kompetencave vendimmarrëse Krahina Socialiste e Kosovës, shqiptarët duhet ta kenë flamurin por flamuri duhet të jetë në pajtim me sovranitetin dhe integritetin e Jugosllavisë.²¹¹ Gjatë kësaj periudhe Legata Shqiptare në Beograd kishte pranuar një kërkesë nga grupi patriotik i Kosovës, për mbështetje nga shteti shqiptar, për vazhdimin e luftës për çlirimin e Kosovës. Ministria e Jashtme e Shqipërisë i dërgoj një letër, Legatës Shqiptare në Beograd se *“shokët e përfaqësisë nuk kanë të drejtë apriori t’u besojnë kosovarëve, prandaj atyre duhet t’u jepet porosi të jenë vigjilent ndaj atyre që ngrënë të tilla kërkesa, dhe se problemin e Kosovës nuk e ndajm nga zgjidhja e problemit të përgjithshëm të Jugosllavisë”*.²¹² Në vazhdim Ministria e Jashtme në udhëzimet e saja theksonte se *“qëndrimi ynë ndaj Jugosllavisë nuk ka ndryshuar dhe se ne këshillojmë kosovarët që të luftojnë për të fituar të drejta në të gjita drejtimit*

²¹⁰ Et’hem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Prishtinë, 2009, 179.

²¹¹ *Deveti Kongres SKJ*, Beograd, 1969, 86-87.

²¹² AQSH, Viti 1968, Dosja : b/7-2/b, nr.360, 1-2. (Et’hem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Prishtinë, 2009, 179).

duke synuar që të arrijnë të gëzojnë po ato të drejta që i gëzojnë edhe kombësitë e tjera në Jugosllavi”.²¹³ Grupet patriotike si forma të organizimit ilegal vepronin jashtë vendit në forma të ndryshme. Duke menduar se Shqipëria i mbështet ato disa herë shtrinë dorën te legatat shqiptare si në Beograd e gjetiu, në mënyrë që të koordinohen punët rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës. Por shteti shqiptar mendonte se ishte akoma herët kur duhej të mbështeste grupet ilegale që kishin orientime të tjera në luftën për çlirim kombëtar, ose mënyrën se si Kosova të bëhej republikë. Këto drejtime shihen qartë në “Buletinin” nr. 23 të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, përmes së cilit nënvizohej që të ndiqeshin me kujdes dhe pa bujë, por në mënyrë aktive zhvillimet e situatës në Kosovë; të bëhej kujdes që elementi patriot kosovar të mos binte në provokacionet e sigurimit shtetëror serb; t’u bëheshin të qarta kosovarëve qëndrimi dhe politika e PPSH-së dhe e Qeverisë së Shqipërisë ndaj Jugosllavisë në përgjithësi dhe ndaj Kosovës në veçanti; së fundi, që të shfrytëzoheshin të gjitha format e kanalet, qoftë edhe nëpërmjet bisedave me diplomatë jugosllavë, për t’ua bërë të ditur se Shqipëria nuk ndërhynte në punët e brendshme të Jugosllavisë, por thjesht ajo po kujdesej për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi. Kjo gjë theksohej me qëllim që organet jugosllave të mos hidhen në reprezalje e në masa të ndryshme kundër kosovarëve dhe të drejtave të tyre nacionale, por të shfrytëzoheshin me maturi dispozitat e Kushtetutës jugosllave.²¹⁴ Me pak fjalë Shqipëria ishte shumë e kujdesshme të mos dilte jashtë orbitës së saj të politikës së jashtme karshi Jugosllavisë dhe Kosovës brenda RSFJ.²¹⁵

Konkluzioni

Nga se u tha më lartë vërehet se politika e Shqipërisë karshi Kosovës ishte tej mase e përqendruar brenda koniukturave politike të rrethanave të krijuara. Nga janari deri në muajin nëntor rrethanat në Kosovë ishin tejet të

²¹³ Çeku, *Kosova në sfondin*, 181.

²¹⁴ Çeku, *Kosova në sfondin*, 181.

²¹⁵ Sabit Syla, *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj demonstratave në Kosovë më 1968*, “*Studime historike nr.3/4*, Instituti i Historisë-Tiranë, Tiranë, 2012, 283-289.

ngjeshura në aspektin politik, Politika e Kosovës u mundua të afrohej me Shqipërinë në gjysmën e parë të vitit 1968 dhe kjo shihet qartazi në dokumentet e kohës. Ngjarjet e tetorit dhe nëntorit 1968, bën një ndarje në vijën e bashkëpunimit të ndërsjell. Shteti shqiptar nuk mbështeti Kosovën Republikë duke shprehur qartazi se Kosova duhej të punonte që të fitonte të drejta më shumë në kuadër të Federatës Jugosllave. Rezultatet kryesore të këtij bashkëpunimi sidomos shkencor ishin se dy vendet u njohën me politikat reciproke si dhe në aspektin politik biseda të cilat ishin tej mase të rezervuara. Shqipëria zgjodhi ta mbaj thëllimin e përkrahjes së Kosovës në planin diplomatik. Shteti shqiptar kishte problemet e veta substanciale gjatë këtij viti. Një ndër shkaqet kryesore të rezervimit të Tiranës zyrtare ishin me sa vijon : ajo doli nga Traktati i Varshavës, pastaj donte të mbante raporte ekuilibruese me Jugosllavinë në mënyrë që të afrohej me Kosovën. Shteti shqiptar dha sinjalet e qarta të të interesimit të saj më të dukshëm për Kosovën nga fillimi i vitit 1969. Masat që ajo ndërmorri ishin se ajo kishte ndërmend të kishte interesim më të thellë për Kosovën në të gjitha aspektet e jetës. Që ta dëshmonte veten se paragjykimet e Shqipërisë, ishin shuar ajo me urdhër të Komitetit Qendror të PPSH më 1969 krijoi sektorin e posaqëm (drejtoria e pestë).²¹⁶ Kjo drejtori do të kishte detyrë në punën e saj që të njihej me gjendjen reale në Kosovë, në fushën e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore. Drejtoria në fjalë morri përsipër të afronte politikat e shtetit shqiptar me Kosovën, në arsim dhe kulturë ku ndërgjegjia kombëtare ishte më e madhe. Së këndejmi, shteti shqiptar nga viti 1969 me rezultata të drejtëprdrejta rriti intensifikimin e bashkëpunimin dhe afrimin me Kosovën, nëpërmjet profesorëve të Universitetit të Tiranës në ndihmën dhënë Universitetit të Prishtinës të themeluar më 1970, pastaj këmbimet në fushën e kulturës ku shquheshin marrëveshje nga më të ndryshmet si në teatër, kinemtaografi, muzikë etj.

²¹⁶ AMPJ, viti 1981, dosja 1140, 19. (cituar sipas Sabit Sylës, Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2017, 229).

QËNDRIMI I FRANCËS PËR KOSOVËN (1998-1999)

Abstrakti

Qëndrimi Francës për paqen dhe lirinë e Kosovës ishte i drejtë. Kontributi i saj ishte i madh dhe pothuajse edhe përcaktues për paqen jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan, sepse, siç dihet, Serbia për dhjetë vjet me radhë (1989-1999), ua kishte mohuar shqiptarëve të Kosovës të gjitha të drejtat legjitime. Spastrimi etnik ishte qëllimi i vërtetë i luftës së Serbisë në Kosovë. Fuqitë e Mëdha, në mesin e tyre edhe Franca, nuk e lejuan një gjë të tillë. Francezët u vunë në ballë të kësaj lufte dhe luajtën rol të rëndësishëm diplomatik, ushtarak dhe humanitar. Atyre u atribuohet edhe ideja për mbajtjen e Konferencës së Rambujesë (6-23 shkurt). Për shkak se Delegacioni jugosllav refuzoi nënshkrimin e “Marrëveshjes së ndërmjetme për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë” (18 mars 1999, Paris), NATO i shpalli luftë Serbisë. Nga 24 marsi e deri më 12 qershor 1999, me vendim të Presidentit të Republikës dhe në marrëveshje me Qeverinë, Franca mori pjesë në këtë luftë së bashku me aleatët e saj. Kontribut të veçantë dha edhe në aspektin humanitar. Në krye të të gjitha këtyre angazhimeve qëndronin presidenti Chirac, kryeministri Jospin, ministri i Punëve të Jashtme, Védrine dhe Ministri i Mbrojtjes Richard. Mediet (shtypi dhe televizioni) gjithashtu ishin vënë në shërbim të paqes dhe lirisë, kundër mizorive dhe barbarisë. Edhe personalitetet e ndryshme franceze nuk kishin heshtur para një krize të tillë me përmasë ndërkombëtare. Falë kontributit të shtetit francez dhe Fuqive të tjera Perëndimore, më 12 qershor 1999, Kosova u çlirua, ndërsa më 17 shkurt 2008 u shpall shtet i pavarur. Ajo u njoh nga shumë shtete, në mesin e të cilave edhe Franca. Gjithashtu, falë qëndrimin të drejtë dhe kontributit të Francës sot edhe Ballkani është më i qetë, jeton në paqe dhe me mundësi të sendërtimit të një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Fjalët çelës: Kosova, Franca, Serbia, Konferenca e Rambujesë, NATO, lufta.



Kosova aktualisht është shteti më i ri në Evropë. Historia politike e saj është një spirale e dhunës në shekullin XX, që, në rastin konkret, zgjati nga vitit 1912 deri më 1999²¹⁷. Në Kosovë, më 1998-1999, u zhvillua lufta e fundit e shekullit XX²¹⁸. Luftën e kishte imponuar Serbia me dhunën dhe terrorin e saj shekullor. Dhuna e terrori u intensifikuan posaçërisht në dhjetëvjetëshin e fundit. Serbia, për dhjetë vjet me radhë (1989-1999) shqiptarëve ua kishte mohuar të gjitha të drejtat legjitime. Dhuna kundër tyre ishte bërë përditshmëri. Forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe përdornin të gjitha format e dhunës: dëbime masive, arrestime arbitrare, ekzekutime, shkatërrim sistematik i fshatrave²¹⁹. Vetëm nga muaji shkurt e deri në muajin tetor 1998, nga 945 fshatra, që ka Kosova, nga forcat serbe u bombarduan e u dëmtuan 398, u dogjën e u dëmtuan 23044 shtëpi, u vranë 1215 veta dhe u plagosën qindra të tjerë²²⁰. Në vjeshtën e vitit 1998, në arrati ishin 230 mijë shqiptarë, 50 mijë prej tyre ishin zhvendosur. Terrorizimi dhe dëbimi i popullatës shqiptare ishin qëllimi i vërtetë i luftës²²¹ të Serbisë në Kosovë. Spastrimit etnik i Kosovës ishte ide e vjetër²²², të cilën Millosheviqi e kishte shndërruar në projekt më 1999²²³. Këtë nuk e lejuan Fuqitë e Mëdha. Këtë nuk e lejoi as Franca²²⁴, e cila ka luajtur gjatë shekujve që kanë kaluar dhe

²¹⁷ Oliver Jens Schmitt, *Kosova, histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (Koha: Prishtinë, 2012), f.134

²¹⁸ Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018, f.14.

²¹⁹ Déclaration de M. Lionel Jospin, Premier ministre, en réponse à une question sur la situation au Kosovo et sur les frappes aériennes de l'OTAN sur la Serbie, à l'Assemblée nationale le 6 avril 1999. Données originales sur: <https://www.vie-publique.fr/discours/177710-declarations-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-sur-la-situation-au>; Déclarations de M. Lionel Jospin, Premier ministre, sur la situation au Kosovo, notamment les frappes de l'OTAN sur la Serbie, Paris les 26, 30 et 31 mars 1999. Données originales sur: <https://www.vie-publique.fr/discours/177710-declarations-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-sur-la-situation-au>, Qasja 05/04/2021.

²²⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi IV, Botimet Toena, Tiranë, 2008, f. 375.

²²¹ Joshka Fisher, *Vitet kuq-gjelbër*, Koha, Prishtinë, 2008, f.100.

²²² *Liberation*, 30/03/1999.

²²³ *Le Monde*, 30/03/1999, f. 17.

²²⁴ Enciklopedia e përgjithshme-OXFORD, *Instituti i Dialogut dhe Komunikimit*, Tiranë, 2006, f. 374, 376.

luan edhe sot e kësaj dite, një rol të dorës së parë në ecurinë e qytetërimit dhe të ngjarjeve botërore²²⁵. Ajo u vu në ballë të kësaj lufte²²⁶.

Franca ka shfaqur interesim dhe angazhim për çështjen e Kosovës që nga viti 1997. Njëpërpjekje për ta parandaluar eskalimin e situatës si rezultat i dhunës së ushtruar nga Serbia, më 19 nëntor 1997, Ministri i Punëve të Jashtme të Francës Hubert Védrine dhe ai i Gjermanisë Klaus Kinkel i kishin shkruar Letër Presidentit Millosheviq, duke i kërkuar atij të vendosë një status të veçantë për Kosovën²²⁷. Beogradi refuzon²²⁸. Kur dhuna shpërtheu në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit 1998, shteti francez u shndërrua në një lojtar kryesor në reagimin homogjen të Grupit të Kontaktit kundër akteve të dhunës. Në një takim ministror të mbajtur në Londër, më 9 mars, Grupi i Kontaktit vendosi sanksionet e para kundër Beogradit dhe lëshoi një ultimatum për Presidentin Millosheviq. Embargoja e armëve konfirmohet nga Rezoluta 1160 e Këshillit të Sigurimit të KB (31 mars). Sanksionet e reja (ngrirja e investimeve në Serbi, embargo ajrore) u vendosën edhe më 8, 12 dhe 15 qershor 1998. Ngase dhuna nuk kishte të ndalur, atëherë autoritetet franceze propozuan të përdorej kërcënimi për përdorimin e forcës në mbështetje të diplomacisë. Në korrik, nga Franca, paraqitet një projekt rezolutë në Këshillin e Sigurimit, e cila rezultoi në votimin e rezolutës 1199 më 24 shtator në Nju Jork²²⁹. Refuzimi i Jugosllavisë për të zbatuar dispozitat e këtyre dy rezolutave, e detyroi Këshillin e NATO-s, që më 13 tetor 1998, të aktivizoi *Urdhërat e Aktivizimit*²³⁰. Jugosllavia u detyrua të nënshkruante

²²⁵ Georges Duby, *Historia e Francës nga zanafilla deri në ditët e sotme*, SHTB Dituria, 2012, f.19.

²²⁶ Déclaration de M. Jacques Chirac, Président de la République, sur l'acceptation par les autorités de Serbie du plan de paix présenté par la communauté internationale et sur la préparation de sa mise en oeuvre, Cologne le 3 juin 1999. Données originales: <https://www.vie-publique.fr/discours/194995-declaration-de-m-jacques-chirac-president-de-la-republique-sur-lacce>, Qasja 05/04/2021.

²²⁷ Le rôle de la France dans la crise du Kosovo, *Reliefweb* 18/08/1999. Données sur: <https://reliefweb.int/report/serbia/le-r%C3%B4le-de-la-france-dans-la-crise-du-kosovo>, Qasja 13.04.2021.

²²⁸ Médecins Sans Frontières, *Violences contre les Kosovars albanais, intervention de l'OTAN, 1998-1999*, Australie: Septembre 2006 / Juin 2014, f.16.

²²⁹ Le rôle de la France dans la crise du Kosovo, *Reliefweb* 18/08/1999. Données sur: <https://reliefweb.int/report/serbia/le-r%C3%B4le-de-la-france-dans-la-crise-du-kosovo>, Qasja 13.04.2021.

²³⁰ NATO, *Doracak*, Office of Information and Press, 2001, f. 128.

marrëveshjen (më 16 tetor) me OSBE-në për krijimin e Misionit Verifikues të Kosovës (MVK) për të siguruar zbatimin e rezolutave të Këshillit të Sigurimit dhe marrëveshjen me NATO-n, e cila e autorizoi atë për të ngritur një mision ajror për të verifikuar tërheqjen e njësisë të sigurisë jugosllave nga Kosova²³¹. Këto marrëveshje u ratifikuan nga Grupi i Kontaktit, gjatë një takimi ministror të kryesuar nga Z. Védrine në Paris dhe nga Këshilli i Sigurimit (Rezoluta 1203, votuar më 24tetor). Gjatë dimrit pasuan operacionet shtypëse të forcave serbe. Franca bëri përpjekjen e fundit për të arritur një marrëveshje nga të dy palët. Në këtë kontekst, kishte dhënë idenë për t'i ftuar në një vend të mbyllur palët për të gjetur një zgjidhje përmes dialogut²³². Franca, që sapo kishte marrë presidencën e Bashkimit Europian, parapëlqente që bisedimet të organizoheshin brenda kornizës të Grupit të Kontaktit dhe brenda territorit të saj. Më 29 janar 1999, gjatë një mbledhjeje të mbajtur në Londër, gjashtë anëtarët e Grupit të Kontaktit, përfshirë dhe Igor Ivanovin nga Rusia, njoftuan se bisedimet për paqe do të fillonin më 6 shkurt. Ashtu ndodhi. Më 6 shkurt 1999, në Kështjellën e Rambujesë në Francë, nisën bisedimet mes Delegacionit shqiptar të Kosovës të kryesuar nga Hashim Thaçi dhe Delegacionit të Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi) të kryesuar nga zëvendëskryeministri Nikolla Shainoviq. Ndërmjetësuesit e Grupit të Kontaktit ishin: ambasadori Christopher Hill (SHBA), ambasadori Wolfgang Petritsch (Bashkimi Evropian) dhe ambasadori rus Boris Majorski. Dokumenti bazë i Rambujesë njihet me emrin “Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo - Marrëveshja e ndërmjetme për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë”. Bisedimet në Rambuje zgjatën deri më 23 shkurt²³³. Derisa presidenti i RFJ-së, Millosheviqi,

²³¹ Djamchid Momtaz, “L'intervention d'humanité” de l'OTAN au Kosovo et la règle du non-recours à la force, Article, *Revue internationale de la Croix-Rouge*, 837, 31-03-2000. Données sur: <https://www.icrc.org/fr/doc/resources/documents/misc/5fzg3n.htm>, Qasja 05/04/2021.

²³² Le rôle de la France dans la crise du Kosovo, *Reliefweb* 18/08/1999. Données sur: <https://reliefweb.int/report/serbia/le-r%C3%B4le-de-la-france-dans-la-crise-du-kosovo>, Qasja 13.04.2021.

²³³ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës, Prishtinë*, 2018, f.1050, 1051; Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018, f. 148, 149, 151, 154, 202, 210; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Kosova në vështrim enciklopedik*, Botime Toena, Tiranë, 1999, f. 144, 146; Déclarations de M. Lionel Jospin 06/04/1999 b; “Situation au Kosovo.” Déclaration du Gouvernement et débat sur cette déclaration. Assemblée nationale de France - séance du 26 mars

tallej me Fuqitë e Mëdha²³⁴, delegacioni shqiptar i Kosovës, më 23 shkurt, në Rambuje, deklaroi se parimisht e quante të nënshkruar marrëveshjen, por i nevojitej një periudhë minimale dyjavore konsultimi me popullin për vendimin përfundimtar²³⁵. Procesi i bisedimeve vazhdoi nga data 15-18 mars 1999 në Paris²³⁶. Ditën e fundit, më 18 mars 1999, delegacioni shqiptar nënshkroi një marrëveshje të përkohshme paqësore²³⁷, kurse delegacioni jugosllav me kokëfortësi refuzoi të bënte të njëjtën gjë²³⁸. Pavarësisht se Grupi i Kontaktit kishte bërë gjithçka për të gjetur një zgjidhje politike për krizën, kjo nuk u arrit. Procesi kaloi në një rrafsh tjetër, në atë ushtarak. Përdorimi i forcës ishte bërë i pashmangshëm²³⁹. Ky ishte edhe qëndrimi i Francës.

Më 24 mars 1999, NATO i shpalli luftë Serbisë. Nga 24 marsi e deri më 12 qershor, me vendim të Presidentit të Republikës dhe në marrëveshje me Qeverinë, Franca mori pjesë në këtë luftë së bashku me aleatët e saj²⁴⁰. Kjo luftë bëhej, siç deklaronte kryeministri Jospin, *...në emër të lirisë dhe të drejtësisë*, sepse po kërcënohej *paqja dhe siguria ndërkombëtare* ngase regjimi i Milosheviqit i kishte shkelur *rregullat e të drejtës ndërkombëtare*²⁴¹. Kjo luftë ishte përgjigje ndaj refuzimit të Serbisë për të nënshkruar marrëveshjen e propozuar nga Grupi i Kontaktit (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Brita-

1999, *comptenduintégralprésidence de m. Laurentfabius. Donnéesoriginales: <https://www.assemblee-nationale.fr/11/cri/html/19990203.asp#02969>, f. 2968-2987, Qasja 05/04/2021; Reliefweb 18/08/1999.*

²³⁴ *Le Monde*, 21-22/02/1999, f. 2.

²³⁵ *Le Monde*, 25/02/1999, f. 2.; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Kosova në vështrim enciklopedik*, Botime Toena, Tiranë, 1999, f. 145.

²³⁶ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, Prishtinë, 2018, f. 1050.

²³⁷ Letter of m. HashimThaçi 15/03/1999: Text of Kosovo Albanian acceptance of interim peace deal, *Données sur <https://reliefweb.int/report/serbia/text-kosovo-albanian-acceptance-interim-peace-deal>*, Qasja: 12/14/2021.

²³⁸ Assemblée Nationale - Séancedu 26/03/1999.

²³⁹ Déclarations de M. Lionel Jospin 06/04/1999 b; *Reliefweb* 18/08/1999.

²⁴⁰ *Le Monde*, 25/03/1999, f. 1; Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018, f.230.

²⁴¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (AMPJRS), Dosja: *Franca për Kosovën, 1999*.

nia e Madhe, Franca, Gjermania, Rusia, Italia)²⁴². Operacioni i NATO-s i vitit 1999 u krye, në fakt, në aleancë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)²⁴³, kishte deklaruar gjenerali sir Michael Jackson, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Britanike dhe komandant i KFOR-it²⁴⁴. Ka mendime se UÇK mbështetej në mënyrë të fshehtë nga Presidenti Chirac dhe ministri i Mbrojtjes Alain Richard²⁴⁵, ashtu siç ka mendime se ky i fundit e akuzonte publikisht atë si *faktor destabiliteti*²⁴⁶.

Gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë, në krye të Francës qëndronin presidenti Jacques Chirac, kryeministri Lionel Jospin dhe ministri i Punëve të Jashtme, Hubert Védrine. Deklaratat, fjalimet dhe intervistat e tyre shpërfaqin interesimin, angazhimin dhe qëndrimin e zyrtarëve shtetëror francez për Kosovën në kontekst të parandalimit të dhunës, terrorit, luftës dhe arritjes së paqes. Mirëpo, kur bëhet fjalë për çështjen e statusit (autonomi a pavarësi), mund të themi se qëndrimi i tyre nuk ishte ai që synonin shqiptarët²⁴⁷. Se cili ishte konkretisht qëndrimi i Francës për Kosovën, do të flas në vazhdim, natyrisht duke ju referuar deklaratave të presidentit Chirac, Kryeministri Jospin dhe ministrit të jashtëm Védrine.

Qëndrimet e presidentit francez i gjejmë të shtrira në kohë dhe hapësirë 1998-1999. Ato janë shfaqur publikisht përmes mediave në formë deklaratash, intervistash, fjalimesh në Grupin e Kontaktit, nëpër konferenca kombëtare e ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Konferencën e Rambujesë, përkatësisht Parisit, ku në mënyrë direkte dhe indirekte ka bërë publik qëndrimin e tij në krye të Francës gjatë periudhës në fjalë.

²⁴² Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018,14.

²⁴³ Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte organizata dhe forca e vetme në Kosovë që iu kundërvu me armë regjimit të Millosheviqit para se këtë ta bënte NATO.

²⁴⁴ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, Tiranë, 2013, kopertina e librit.

²⁴⁵ Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018, F.203)

²⁴⁶ Fehmi Baftiu, *Kosova krizë ndërkombëtare*, Prishtinë, Çlirimi, 2011, f. 281, 286, 287.

²⁴⁷ Discours de m. JacquesChirac 06/02/1999; Déclaration de m. JacquesChirac 24/03/1999; Déclarations de M. LionelJospin 06/04/1999 b.; Déclaration de M. LionelJospin, 27/04/1999; AMPJRSJ, Dosja: *Franca për Kosovën 1999*; Paskal Milo, *Ditari i një ministri të jashtëm-Konflikti i Kosovës (1997-2001)*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, f.211; Déclarations de M. Hubert Védrine 1999: ConflitKosovo: liste desrapports et discours par date du plus récentau plus ancien. Donnéesoriginales: <https://www.vie-publique.fr/ressources/mots-cles/conflit-kosovo?page=17>, Qasja 22.04.2021.

Pak ditë pas sulmit të forcave serbe në familjen Jashari në Prekaz të Drenicës, në Konferencën e përbashkët për shtyp të presidentit Chirac, kryeministrit Jospin dhe ministrit të Jashtëm Védrine, më 12 mars 1998, në Londër, presidenti deklaronte se Beogradi duhet ta dijë se qëndrimi i tij, i Francës dhe i bashkësisë ndërkombëtare është që të ndalet dhuna dhe t'i jepej mundësi një zgjidhjeje paqësore për Kosovën²⁴⁸. Kurse një muaj më vonë, më 12 prill 1998, deklaronte se Kosova është një çështje me interes për të gjithë rajonin dhe Grupi i Kontaktit aktualisht po vepron për të mundësuar një dialog që të çojë në gjetjen e një zgjidhjeje politike ndërmjet autoriteteve në Beograd dhe atyre të Kosovës...²⁴⁹. Në këtë drejtim shkojnë edhe deklaratat e 13 qershorit²⁵⁰ dhe 28 tetorit 1998²⁵¹. Qëndrimi i tij kundër barbarisë, në favor të paqes dhe lirisë së Kosovës, u bë publik edhe në ditën e parë të fillimit të Konferencës së Rambujesë, më 6 shkurt 1999. Ai me atë rast deklaronte:

Franca, jo më shumë se partnerët e saj evropianë, amerikanë apo rusë, nuk do të tolerojë vazhdimin e një konflikti që shpërfill parimet thelbësore të dinjitetit njerëzor. Ne nuk do të pranojmë që cikli i dhunës të kërcënon, hap pas hapi, stabilitetin e gjithë Evropës Juglindore. Ne duam paqe në kontinentin tonë²⁵².

²⁴⁸ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1998/03/12/conference-de-presse-conjointe-de-mm-jacques-chirac-president-de-la-republique-lionel-jospin-premier-ministre-et-hubert-vedrine-ministre-des-affaires-etrangeres-sur-lelargissement-de-lunion-europeenne-les-relations-avec-la-turquie-et-avec-chypr>, Qasja e fundit 31.05.2022

²⁴⁹ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1998/04/07/declaration-a-la-presse-de-m-jacques-chirac-president-de-la-republique-sur-laide-de-la-france-a-la-bosnie-herzegovine-lengagement-de-cooperer-avec-le-tribunal-penal-international-pour-la-recherche-des-criminels-de-guerre-la-crise-au-kosovo-et-le-r>, Qasja e fundit 31.05.2022

²⁵⁰ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1998/06/13/point-de-presse-conjoint-de-mm-jacques-chirac-president-de-la-republique-et-ibrahim-rugova-dirigeant-albanais-du-kosovo-sur-la-situation-au-kosovo-et-la-rencontre-entre-mm-eltsine-et-milosevic-paris-le-13-juin-1998> Qasja e fundit, 31.05.2022

²⁵¹ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1998/10/28/conference-de-presse-conjointe-de-mm-jacques-chirac-president-de-la-republique-et-flavio-cotti-president-de-la-confederation-helvetique-sur-la-situation-au-kosovo-les-relations-privilegiees-avec-la-suisse-romande-et-leventualite-de-fermeture-de-cen>, Qasja e fundit 31.05.2022.

²⁵² <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1999/02/06/discours-de-m-jacques-chirac-president-de-la-republique-francaise-sur-les-enjeux-de-la-negotiation-pour-lavenir-de-la-paix-en-europe-et-lobjectif-dun-accord-entre-les-belligerants-serbes-et-kosovars-sur-lautonomie-substantielle-du-kosovo-rambouil>, Qasja e fundit 31.05.2022

Masakra e Reçakut (janar 1999) e kishte tronditur Francën dhe botën e qytetëruar, kurse kundërshtimi i Serbisë për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, e kishte detyruar botën demokratike që të vepronte ushtarakisht kundër regjimit të Millosheviqit, sepse nëpër fshatrat dhe qytetet e Kosovës shihje:

“Ushtarakët serbë me fytyra të mbuluara me kapuç të zi, të cilët si ditën ashtu edhe natën, rrethonin fshatrat ose lagje të tëra... Banorët kishin kohë një orë ose dy orë për t’u larguar, para se të shkretohet vendi. Kjo e drejtë për t’u larguar për të mbijetuar i nënshtrohej nganjëherë sulmeve të papritura. Nga ana tjetër njerëzit çoheshin me forcë drejt një destinacioni të panjohur. Sapo të formoheshin këto kolona të pafundme me mijëra refugjatë që gjarpëronin drejt kufirit maqedonas ose malazez, dy shtete fqinj, shtëpitë e tyre grabiteshin, digjeshin, fushat përflakeshin, kafshët vriteshin, në mënyrë që “ata” të mos ktheheshin. Në Prishtinë, kryeqyteti i Kosovës, skuadriljet serbe të vdekjes mbillnin terrorin me një mision: shfarosjen e elitës kosovare. Tërësia e operacionit kishte një emër: akoma, spastrim etnik”²⁵³. Nuk ka më dyshim që forcat serbe kanë kryer krim kundër njerëzimit”-shkruante ndër të tjera në një artikull gazetarja I.Lasserre, të botuar te “Le Figaro”, më 20 prill 1999, me titull “Si e spastroi Milloshoviqi Kosovën”²⁵⁴.

Pas përfundimit të Konferencës së Parisit (që ishte vazhduese e Rambujesë) dhe refuzimit të Serbisë për ta nënshkruar marrëveshjen, gjatë një konference për shtyp, më 19 mars 1999, presidenti Chirac e akuzonte me emër dhe mbiemër Sllobodan Millosheviqin se *mban përgjegjësi të plotë për situatën dhe pasojat e saj*²⁵⁵. Mirëpo, shumë më e ashpër ishte deklarata e tij kundër Millosheviqit dhe forcave serbe, më 24 mars 1999, me rastin e fillimit të bombardimeve të NATO-s, ku duke iu drejtuar popullit francez përmes mediave, ndër të tjera deklaronte:

...Për një kohë të gjatë, autoritetet serbe janë sjellë në mënyrë të paprueshme ndaj shqiptarëve të Kosovës që përfaqësojnë, ju kujtoj, 90% të popullsisë së kësaj krahine. Për këtë dëshmojnë grupet e refugjatëve, shkatërrimet

²⁵³ *Le Monde*, 30/03/1999, p.17; AMPJRS, Dosja: Franca për Kosovën.

²⁵⁴ AMPJRS, Dosja: Franca për Kosovën, 1999

²⁵⁵ <https://www.elysee.fr/front/pdf/elysee-module-9199-fr.pdf>, Qasja 31.05.2022

e fshatrave, atentatet, masakrat. Kjo është e patolerueshme. Ajo që është në rrezik sot është paqja në tokën tonë, paqja në Evropë... Aleatët konsideruan njëzëri se nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të ndërhyjnë ushtarakisht kundër objektivave serbe, për të frenuar një tragjedi e cila, në fund, kërcënon stabilitetin e të gjithë Ballkanit²⁵⁶.

Kësisoj, Franca, nga një angazhim politik e diplomatik për ta zgjedhur çështjen e Kosovës përmes bisedimeve, për çka ishte organizuar edhe Konferenca në Rambuje e Paris, mori edhe një vendim më rigoroz për veprime ushtarake.

Epilogu i gjithë këtij angazhimi të Francës dhe shteteve të tjera ishte se Kosova u çlirua nga Serbia falë luftës së UÇK-së dhe ndërhyrjes së NATO-s. Çështje e diskutueshme e opinionit edhe atëkohë ishte nëse Serbia kapitulloi, nëse ajo u mund. Në një intervistë dhënë në televizion, presidenti Chirac, më 10 qershor 1999, përgjigjet: *Po. Po, është një dorëzim, do të thosha, pa kushte.* Lidhur me statusin e Kosovës ai kishte këtë qëndrim:

Ne nuk e duam pavarësinë e Kosovës. Dhe përveç kësaj, nga rezoluta është parashikuar qartë se kjo hipotezë është e përjashtuar. Do të ishte shumë e rrezikshme sepse mund të sfidonte ekuilibrin e këtij rajoni dhe ta vendoste sërish në rrugë të vështira²⁵⁷.

Janë mbi 50 deklaratat, intervista e fjalime të presidentit francez në Konferenca kombëtare e ndërkombëtare, në vende të ndryshme, duke përfshirë Konferencën e Rambujesë, Parisit etj., ku shprehet në mënyrë direkte dhe indirekte qëndrimi i Francës për Kosovën²⁵⁸.

Përveç presidentit Chirac, them se është me interes të dihet se cilat ishin edhe qëndrimet e kryeministrit Lionel Jospin për Kosovën. Duke i lexuar deklaratat e intervistat të publikuara në media dhe raportimet në Asamblenë Kombëtare, në Senatin francez, shihet se Qeveria e Francës, të cilën e

²⁵⁶ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1999/03/24/declaration-de-m-jacques-chirac-president-de-la-republique-sur-les-raisons-de-la-decision-dune-action-militaire-de-lotan-en-serbie-et-au-kosovo-berlin-le-24-mars-1999>

²⁵⁷ <https://www.elysee.fr/jacques-chirac/1999/06/10/intervie-de-m-jacques-chirac-president-de-la-republique-a-tf1-le-10-juin-1999-sur-la-capitulation-de-m-milosevic-la-suspension-des-bombardements-laide-internationale-a-la-reconstruction-du-kosovo-et-le-role-militaire-et-diplomatique-de-la-france>, Qasja e fundit 31.05.2022

²⁵⁸ <https://www.vie-publique.fr/ressources/mots-cles/conflit-kosovo?page=24>, Qasja 31.05.2022

udhëhiqte në atë kohë Jospin, ka qenë e informuar mjaft shumë për zhvillimet në Kosovë edhe nga 1998, prandaj edhe kishte qëndrim të qartë në favor të paqes dhe lirisë.

Në “*Deklaratën për gjendjen në Kosovë*”, lexuar në emër të Qeverisë nga kryeministri Jospin në Asamblenë Kombëtare të Francës, më 26 mars 1999, jepen të dhëna të rëndësishme për gjendjen reale në Kosovë; për dhunën dhjetë vjeçare të Serbisë në Kosovë; për heqjen e autonomisë së Kosovës (1989); për reagimet e shqiptarëve kundër dhunës dhe terrorit si pasojë e drejtpërdrejtë e represionit politik dhe ushtarak të kryer nga Serbia; për ofensivën ushtarake të Serbisë në Drenicë në shkurt 1998; për ofensivën vdekjeprurëse në Kosovë në shtator 1998, e cila ngjalli indinjatën e komunitetit ndërkombëtar; për Marrëveshjen e tetorit 1998 dhe vendosjen e Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë; për mijëra shqiptarë të vrarë e qindra e mija të zhvendosur nga shtëpitë e tyre si pasojë e terrorit serb; për Masakrën e Raçakut (janar 1999); për angazhimin e Grupit të Kontaktit për ndërprerjen e terrorit të Serbisë në Kosovë; për Konferencën e Rambujesë etj. Në këtë *Deklaratë* shprehet qartë se paralajmërimet, kërcënimet, sanksionet, embargoja e armëve, veprimet diplomatike të faktorit ndërkombëtar drejtuar Serbisë, ishin të kota. Bazuar në *Deklaratën e Qeverisë*: “...ndërhyrja ushtarake ishte e nevojshme. Sepse irracionaliteti i regjimit jugosllav nuk la zgjidhje tjetër”. Franca nuk mund të qëndronte indiferent duke parë imazhe të tmerrshme - dhunën ndaj civilëve, fshatrat e fshira nga harta, vërshimet e refugjatëve...*Beogradi*, siç thuhet më tutje në Deklaratën e Qeverisë së Francës, nuk ka respektuar asnjë rezolutë, nuk ka përmbushur asnjë detyrim, nuk ka marrë asnjë përgjegjësi. Në disa raste, përkundrazi, Republika Federale e Jugosllavisë ka shkelur qëllimisht rregullat e së drejtës ndërkombëtare²⁵⁹. Lidhur me statusin e Kosovës, kryeministri Jospin, kishte qëndrim identik si presidenti Chirac:

Objektivi ynë politik, i përcaktuar për një vit nga grupi i kontaktit, nuk ka ndryshuar: vendosja e një statuti të përkohshëm të autonomisë thelbësore në

²⁵⁹ <https://www.assemblee-nationale.fr/11/cra/1998-1999/99032611.asp> Qasja e fundit 31.05.2022

*Kosovë, brenda kornizës së kufijve ekzistues të Jugosllavisë, i garantuar nga një prani civile dhe ushtarake ndërkombëtare*²⁶⁰.

Përveç deklaratave, fjalimeve, intervistave, sqarimeve etj., të kryeministrit Jospin, të cilave ju referova, për të parë qëndrimet e tij për Kosovën 1998-1999, janë me interes edhe deklarata dhe intervistat e tij dhënë me 2, 6, 8, 13, 15 dhe 27 prill 1999.²⁶¹

Deklaratat, intervistat, fjalimet dhe përpjekjet e hershme të Ministrit të Punëve të Jashtme, HybertVédrine, për Kosovën, i kam dhënë kronologjikisht në formë referencash në pjesën e parë të punimit. Megjithatë, është me rëndësi të veçohen edhe deklaratat, intervistat, konferencat për media të datave 25, 28 e 29 mars dhe 7 e 17 prill 1999²⁶², etj.

Falë qëndrimeve të drejta politike e diplomatike, veprimeve ushtarake dhe humanitare të Francës dhe Fuqive të tjera Perëndimore, regjimi i Millosheviqit u detyrua të dorëzohet. Më 9 qershor arrihet Marrëveshje e Kumanovës për tërheqjen e të gjitha trupave jugosllave nga Kosova. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1244, sipas së cilës u krijua një administratë civile ndërkombëtare dhe u vendosën trupat paqeruajtëse. Më 12 qershor 1999, Kosova u çlirua, forcat paqeruajtëse të NATO-s, me emrin KFOR, afërsisht 40 mijë veta, duke përfshirë këtu edhe Brigadën Shumëkombëshe Veri me 8000 ushtarë nga Franca²⁶³, hyjnë në Kosovë. Kështu përfundoi lufta, kështu iu dha mundësi paqes, filloi kthimi i popullatës dhe ndërtimi i institucioneve të përkohshme. Në përputhje me

²⁶⁰ <https://www.vie-publique.fr/discours/177710-declarations-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-sur-la-situation-au>, Qasja, 4.04.2021

²⁶¹ <https://www.vie-publique.fr/discours/180581-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-sur-la-situation-au-k>, Qasja 12.04.2021; <https://www.vie-publique.fr/discours/185349-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-des-ques>, qasja 5.04.2021; <https://www.assemblee-nationale.fr/dg/dg1542.asp>, Qasja 6.04.2011; <https://www.vie-publique.fr/discours/183194-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-des-ques>; <https://www.vie-publique.fr/discours/177373-interview-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-france-2-le-8-avril-1>; <https://www.vie-publique.fr/discours/173977-declaration-de-m-lionel-jospin-premier-ministre-en-reponse-une-ques>, Qasja 5.04.2021; <https://www.vie-publique.fr/ressources/mots-cles/conflit-kosovo?page=17>, Qasja, 17.03.2022.

²⁶² <https://www.vie-publique.fr/discours/193293-conference-de-presse-de-m-hubert-vedrine-ministre-des-affaires-etrange>.

²⁶³ *Le Monde* 12/06/1999.

Rezolutën 1244 u krijua Misioni Administrativ i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që kishte si kryetar të parë mjekun francez BernardKushner. Si zyrtari më i lartë civil ndërkombëtar, ai kishte për detyrë të lehtësonte procesin politik për vendosjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, në përputhje me marrëveshjen e Rambujesë²⁶⁴. Edhe pse Franca, gjatë luftës 1998-1999, nuk kishte qëndrim favorizues për statusin e Kosovës, kur Kosova u shpall e pavarur, më 17 shkurt 2008, ajo u njoh nga shumë shtete, në mesin e të cilave edhe Franca. Sipas BernardKushneri ish-kryeadministratori i parë i Kosovës, kjo pavarësi qe një nga të rrallat suksese të bashkësisë ndërkombëtare dhe një sukses i madh për Evropën²⁶⁵. Ky ishte një proces i gjatë dhe i mundimshëm. Në këtë proces rol dhe kontribut të veçantë ka dhënë Franca. Pa rolin dhe kontributin e saj vështirë se do të kishte Konferencë të Rambujesë. Pa Konferencën e Rambujesë vështirë se do të kishte ndërhyrje të NATO-s. Pa ndërhyrjen e NATO-s kushedi se sa do të vonohej paqja dhe liria për Kosovën dhe popullin e saj. Nuk do të kishte as pavarësi, por nuk do të kishte as paqe në Ballkan dhe në Evropë.

²⁶⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi IV, Botimet Toena, Tiranë, 2008, f.377.

²⁶⁵ Jacques Baudoin, *Lindja e një demokracie*, Buzuku, Prishtinë, 2018, f. 9, 283.

Besnik EMINI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

QENDRAT E STUDIMEVE BALLKANIKE DHE BASHKËPUNIMI KULTUROR NË KUADËR TË DISA VENDEVE BALLKANIKE

Abstrakt

Studimet e ballkanistikës në fushën e historisë, gjuhës, letërsisë dhe kulturës në përgjithësi janë në qendër të vëmendjes të qendrave të ndryshme në vendet e Ballkanit. Themelimi i tyre daton kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore, por disa edhe që nga periudha e mëhershme dhe ata si qendra studimi veprojnë në kuadër të institucioneve të ndryshme apo edhe si të pavarura. Gjatë ekzistimit dhe veprimtarisë së tyre këto qendra kanë botuar disa botime të ndryshme, si libra dhe revista të specializuara për studimet ballkanike. Megjithatë, edhe pse këto qendra të studimeve ballkanike i referohen studimeve ballkanike në përgjithësi, në të shumtën e rasteve në këto qendra kryhen studime për popujt përkatës dhe për promovimin e kulturës së tyre në kontekstin më të gjerë ballkanik dhe shumë pak në bashkëpunim më të gjerë dhe të ndërsjellë ballkanik mes popujve të ndryshëm. Ballkani është një përzierje gjuhësh, popujsh, kulturash, traditash, religjionesh dhe në këtë kontekst bashkëpunimi kulturor e shkencor është mjaft i rëndësishëm edhe nëpërmjet kërkimeve që kryhen në qendrat e ndryshme të studimeve ballkanike. Punimi ka për qëllim të japë një pasqyrë të shkurtër të këtyre qendrave ballkanike në vendet e Ballkanit ku ata ekzistojnë dhe një historik të shkurtër të tyre.



Ballkani dhe popujt që jetojnë në të, shpesh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm. Në vende të ndryshme të botës ekzistojnë institucione që merren me studime të ndryshme lidhur me Ballkanin. Mirëpo, edhe në disa shtete ballkanike ekzistojnë institucione të ndryshme shkencore të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë merren me studime

ballkanike. Disa prej tyre veprojnë si institucione të pavarura, ndërsa disa të tjera si njësi pranë institucioneve të tjera. Me kalimin e viteve disa prej tyre kanë pësuar transformime të ndryshme, shuarje, rithemelime dhe riaktivizim të punës së tyre. Mirëpo jo që gjitha shtete në Ballkan kanë institute ballkanike, qoftë si të pavarura, qoftë si njësi pranë ndonjë institucioni tjetër. Sidoqoftë edhe në këto shtete, së paku pranë katedrave universitare ligjërohët historia e popujve të Ballkanit, ose studiues të këtyre shteteve kanë bërë studime të pavarura për tema të lidhura me Ballkanin. Në këtë

Bullgari

Instituti i Studimeve Ballkanike pranë Akademisë Bullgare të Shkencave është themeluar më 15 janar të vitit 1964 me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Bullgarisë. Është themeluar si qendër kërkimore dhe edukative për gjuhën, historinë, kulturën dhe zhvillimin modern në Ballkan. Që nga viti 2010 këtij Instituti i është bashkëngjitur Qendra e Trakologjisë, duke e krijuar Institutin e Studimeve Ballkanike dhe Qendrën e Trakologjisë “Prof. Aleksandër Fol”. Ky institut, pas themelimit të tij ka krijuar disa departamente, të cilat kryesisht janë marrë me historinë e popujve të Ballkanit edhe atë: Etnogjeneza e popujve të Ballkanit dhe gjeografia historike e Ballkanit, Popujt e Ballkanit në periudhën e zhvillimit të feudalizmit dhe epokën e kapitalizmit, Historia më e re e popujve të Ballkanit. Organi kryesor i këtij Instituti ka qenë që nga fillimi revista *Etudes balkaniques* si edhe revista *Izvori i Ballkani*. Në kuadër të institutit gjatë viteve 1968-69 janë botuar dy vëllimet e *Bibliographie d’etudes balkaniques*. Instituti gjithashtu ka organizuar edhe Javën e ndërsjellë ballkanike më 22 tetor – 1 nëntor 1965 në Sofje, kushtuar marrëdhënieve të Bullgarisë me Rumaninë, Greqinë, Jugosllavinë, Shqipërinë dhe Turqinë. Instituti në vitin 1966 ka organizuar Kongresin e parë të Ballkanistikës mbajtur në Sofje 26-1 shtator 1966. Më pas janë organizuar edhe Kongrese të tjera të Ballkanistikës. Ky Institut ofron të dhëna për aktivitet në ueb faqen e vet të posaçme.²⁶⁶ Të dhëna përmbledhëse për aktivitetin e këtij Instituti janë botuar në një

²⁶⁶ <https://balkanstudies.bg/en/>

numër të veçantë të revistës periodike “Ballkani” (Балкани), botim periodik i këtij instituti, me rastin e 50 vjetorit të themelimit dhe funksionimit të tij.²⁶⁷

Greqi

Instituti për Studime Ballkanike (zakonisht i njohur me akronimin e tij grek: IMXA) u themelua në mars 1953 dhe operoi si një degë e Shoqatës për Studime Maqedonase për njëzet vitet e ardhshme. Që nga viti 1974, është subjekt juridik i pavarur, nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës, Arsimit dhe Çështjeve Fetare.²⁶⁸

Aktivitetet e tij përfshijnë veprimtari të ndryshme si: kryerjen e kërkimeve mbi historinë, arkeologjinë, kulturën, marrëdhëniet ndërkombëtare, ekonominë dhe aspekte të tjera të Gadishullit Ballkanik; botimi e studimeve shkencore dhe i periodikëve; organizimin e konferencave dhe takimeve të tjera akademike; mësimin e gjuhëve ballkanike, rusisht dhe polonisht; dhe drejtimin e kurseve verore të greqishtes për folësit e gjuhëve të tjera.

Preokupimet kryesore të Instituti për Studime Ballkanike në Selanik janë të promovojë një kuptim më të mirë të zhvillimeve që kanë formësuar situatën aktuale në Evropën Juglindore dhe të punojë me komunitetin e studiuesve ndërkombëtarë dhe ballkanikë.

Në skenën ndërkombëtare, IMXA ka krijuar një rrjet të gjerë kontaktesh dhe bashkëpunimi me qendra të ndryshme kërkimore të nivelit të lartë dhe Akademitë e Shkencave në Evropën Juglindore, si dhe me homologët e vet në vende të tjera, si Shtetet e Bashkuara, Britania, Franca, Italia, Rusia dhe Gjermania.

Instituti ka botuar rreth 300 monografi, si dhe prodhon periodikët “Valkanika Symmeikta” (në greqisht) dhe Balkan Studies (në gjuhë ndërkombëtare).

IMXA gjithashtu drejton të vetmen bibliotekë në Greqi që është e specializuar për tema të lidhura me Ballkanin. Plotësisht e kompjuterizuar, disponon mbi 25.000 libra dhe 700 botime periodike aktuale dhe ka gjithashtu

²⁶⁷ Балкани, периодично научно издание, бр. 3/2014, София.

²⁶⁸ https://www.imxa.gr/profile_en.htm

një arkiv të gjerë mikrofilmash, me sisteme për leximin dhe shtypjen e tyre. Një aspekt shumë i rëndësishëm i aktiviteteve të Institutit është Shkolla e Gjuhëve Ballkanike dhe Rusishtes, e cila u hap në vitin 1963 dhe ka nxjerrë më shumë se 8.000 studentë deri më sot. Gjithashtu, çdo vit që nga viti 1964, Shkolla Verore Ndërkombëtare për Gjuhën, Historinë dhe Kulturën Greke u ofron studentëve dhe studiuesve të huaj mundësinë për të kultivuar njohuritë e gjuhës greke dhe për të mësuar më shumë rreth historisë dhe kulturës greke.

Rumani

Instituti për Studimet e Evropës Juglindore i Akademisë Rumune (ISEES), i rithemeluar në vitin 1963 nën drejtimin e Mihai Berza, është pardshtësi i ligjshëm i Institutit për Studime të Evropës Juglindore (i themeluar nga N. Iorga në 1913) dhe i Institutit për Studime dhe Kërkime Ballkanike (i themeluar nga Victor Papacostea në 1937), të dyja të shfuqizuara nga regjimi komunist në 1948.²⁶⁹

ISEES ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e kërkimeve shkencore të Ballkanit dhe në një kuptim më të gjerë, të të gjithë Evropës Juglindore, në njohjen progresive të popujve të kësaj zone, në nënvizimin e elementeve të përbashkëta të tyre, historisë dhe kulturës. ISEES hulumton sistematikisht ndikimin e faktorëve kryesorë të unitetit në botën e Evropës Juglindore: kultura dhe qytetërimi grek, Perandoria Romake dhe qytetërimi i saj, Perandoria Bizantine dhe qytetërimi i saj, shtetet, gjuhët dhe kulturat sllave juglindore, neohelenizmi, ortodoksia e krishterë, Perandoria Osmane dhe qytetërimi i saj, modernizmi evropian etj.²⁷⁰

Fushat e përgjithshme kërkimore të ISEES janë, sipas klasifikimit të UNESCO-s, historia krahasuese e popujve nga Evropa Juglindore, historia krahasuese e arteve dhe letërsisë së Evropës Juglindore, gjuhësia ballkanike dhe antropologjia e përgjithshme dhe krahasuese e Evropës Juglindore.

Instituti i parë për Studimet e Evropës Juglindore u themelua në Bukuresht, më 1913, nga N. Iorga (1871-1940) në bashkëpunim me arkeologun

²⁶⁹ <https://en.acadsudest.ro/>

²⁷⁰ Po aty.

Vasile Pârvan (1882-1927) dhe gjeografin Gheorghe Murgoci (1872-1925). Që në fillimet e tij, Instituti kishte karakter ndërdisiplinor si vendtakim i preokupimeve të ndryshme që mbulonin të gjithë fushën e shkencave shoqërore.

Ky person është i dukshëm në botimin e Institutit, *Buletin de l'Institut pour l'Étude de l'Europe Sud-Orientale* (1914-1923), i riemërtuar më vonë si *Revue historique du Sud-Est européen* (1924-1947). Të dy botimet u drejtuan nga themeluesi i Institutit deri në vitin 1940 dhe, pas vdekjes së tij, nga historianët Gheorghe Brătianu (1898-1953) dhe Nicolae Bănescu (1878-1971) deri në vitin 1947. Paralelisht me këtë, Instituti për Studime dhe Kërkime Ballkanike u themelua në vitin 1937 dhe u drejtua nga Victor Papacoste (1900-1962), nën mbikëqyrjen e të cilit Instituti botoi revistën periodike *Balcania* (1938-1947). Objektivi i përgjithshëm i të dy instituteve ishte studimi i detajuar i jetës dhe kulturave të popujve të Evropës Juglindore nga lashtësia deri në epokën moderne. Këto kërkime çuan në përcaktimin e një hapësire gjeografike, sociale dhe kulturore, si dhe të një domeni shkencor të pavarur.

Pas mbylljes së Institutit në vitin 1948, u rithemelua Instituti i ri i Studimeve të Evropës Juglindore në vitin 1963, nën udhëheqjen e Mihai Berzës. Instituti i ri mblodhi disa nga bashkëpunëtorët e instituteve të themeluara nga N. Iorga dhe Victor Papacoste, duke ruajtur të paprekur objektivat e tij të përgjithshëm dhe karakterin ndërdisiplinor. Në këtë pamje të re, Instituti rifitoi shpejt reputacionin e tij ndërkombëtar përmes cilësisë së kërkimeve dhe studimeve të anëtarëve të tij të botuar në botimin e tij kryesor, *Revue des Études sud-est européennes*, themeluar në vitin 1963 dhe që vazhdon edhe sot. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre periodikëve janë në dispozicion të kërkuesve shkencorë nëpërmjet ueb faqes në formë elektronike.²⁷¹

Riorganizimi i Institutit u shoqërua me themelimin e Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore (IASEES), me seli në Bukuresht, e cila organizoi Riorganizimin e Institutit u shoqërua me themelimin e Shoqatës Ndërkombëtare të Juglindjes. AIESEE, selia e të cilit ndodhet në

²⁷¹ <https://revistaen.acadsudest.ro/>

Bukuresht, nën kujdesin e të cilit janë organizuar rregullisht, që nga viti 1966, 11 Kongrese Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore, dy prej të cilave në Bukuresht, në 1974 dhe 1999, dhe në vitin 2019.

Serbi

Paraardhësi i Institutit Ballkanik të sotëm të Serbisë është Instituti Ballkanik, i themeluar në vitin 1934 në Beograd si i vetmi i këtij lloji në atë kohë në Ballkan. Iniciativa erdhi nga mbreti Aleksandër I Karagjorgjeviq dhe profilizimi shkencor i institucionit iu besua Ratko Parezaninit dhe Svetozar Spanaceviçit. Instituti botoi revistën *Revue internationale des Etudes balkaniques*, e cila mblodhi së bashku ekspertët më të shquar evropianë për Ballkanin. Ai u shfuqizua me urdhër të autoriteteve gjermane në vitin 1941.²⁷²

Instituti u riaktivizua në vitin 1969 me emrin Instituti Ballkanik, në kuadër të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve. Ai mblodhi një grup studiuesish që janë marrë me Ballkanin nga parahistoria deri në kohët moderne, përmes kërkimeve arkeologjike, antropologjike, etnografike, historike dhe studimeve të kulturës, artit, letërsisë, së drejtës zakonore etj.

Instituti ka zhvilluar bashkëpunim ndërkombëtar me një sërë institucionesh në vendet evropiane, dhe deri më tani ka organizuar dhjetëra konferenca ndërkombëtare, ka botuar vjetorin *Balkanica* dhe botimin e Botimeve Speciale nga të gjitha fushat e kërkimit ballkanik.²⁷³

²⁷² <http://www.balkaninstitut.com/>

²⁷³ <http://www.balkaninstitut.com/>

BASHKËPUNIMET NDËRKULTURORE SI URË LIDHËSE NË BALLKAN

Abstrakt

Antropologjia dhe etnologjia si shkencë kozmopolitejanë gjithnjë inovative dhe i promovojnë konceptet e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndër popuj. Të tilla ka shumë, në rrjetin e shoqatave me akses ndërkombëtar shkencor, ku si pjesë aktive e këtij aktiviteti me karakter ndërkombëtar është dhe Instituti i Etnologjisë dhe Antropologjisë – Shkup, e cila nëpërmjet të programeve të ndryshme, qoft nëpërmjet Ceipa apo shoqatës së etnologëve të rinj simulon bashkëpunim ndërkombëtar e sidomos nëpërmjet të programeve të Erasmus e cila ka si qëllim që të shkëmbej mendime shkencore në një rrjet më të zgjeruar dhe për zhvillim më të avancuar shkencor. Në aktivitete të tilla kam qenë dhe unë vetë si pjesmarrës dhe në mënyrë më të detajuar do të përshkruaj procesin se si yhvillime të tilla ndikojnë në të ardhmen shkencore të studentëve, doktorantëve por dhe studimeve të ndryshme postdoktorale në një nivel më të avancuar.

Fjalët kyçe: shoqatat, antropologjia, CEIPA, Erasmus



Studimet e bashkëpunimeve janë të anashkaluara nga shkencat sociale, por hulumtuesit nga organizatat gjithnjë e më shumë ftojnë për integrim në koncepte të shumënumërta të bashkëpunimit dhe takimet në sfidat e reja të diferencave kulturore. Në këtë tematik do ta zhvillojmë një kontigjent kulturor të modelit bashkëpunues. Ne dallojmë mekanizma të ndryshme nga sjelljet bashkëpunuese dhe teorizimin e tyre në atë se sa kultura ndikon në sjelljet bashkëpunuese nëpërmjet të mekanizmit të selektimit të ndryshimit.

Duke përcaktuar efektet kulturore, ne nxjerrim ndryshime të modeluara në motivet instrumentale dhe shprehëse të individualistëve dhe kolektivistëve dhe propozojmë mekanizma bashkëpunimi të kundërta kulturore. Studiuesit prej kohësh e kanë njohur se bashkëpunimi është thelbësor për suksesin e kulturës dhe bashkëpunimit të organizatave dhe implikimet e saj (Barnard, 1938).²⁷⁴ Ristrukturimi i fundit i punës dhe sjelljes organizative ka filluar të vlerësohet, organizimi drejt ndërdisiplinës edhe të zhvillohet. Për shembull, në bashkëpunimin ndërorganizativ dhe ndërkombëtar meqenëse kolektivismi do të thotë që anëtarët e grupit punojnë më sakt me oratat dhe aleancat, ka bërë që nëpërmjet bashkëpunimit drejt arritjes në kolektivitetit më me rëndësi është objektivi (Adler, 1991: Byrne. 1993: Manz & Sims, 1997).. Në të vërtetë, Adler (1991) konsideron se bashkëpunimi ndërnacional dhe interkultural është çelësi i suksesit të multinacionalitetit dhe organizatave kulturore.²⁷⁵

Dikush mund të nxjerrë një përfundim të gjerë kulturor diferencial në lidhje me bashkëpunimin. Për shembull, meqenëse kolektivizëm do të thotë grup, anëtarët punojnë duke shkuar së bashku drejt arritjes së kolektivitetit, qëllimet e gjalla, mund të thuhet që ka më shumë bashkëpunim midis kolektivistëve sesa midis individualistëve. Në fakt një përgjithësim i tillë ka njëfarë vlefshmërie, sepse studiuesit kanë treguar se kolektivistët, në krahasim me individualistët, kënaqen duke punuar më shumë, në përgjithësi janë më bashkëoperative, dhe janë më pak të prirur për "udhëtim falas" (Earley, 1989, 1993).²⁷⁶ Megjithatë, kuptimi ynë kulturor i bashkëpunimit duhet të shkojë më thellë. Në masën sesa është i nevojshëm një nivel optimal bashkëpunimi për të gjitha shoqëritë, pavarësisht nga origjina e tyre kulturore entiteteti, ne duhet të eksplorojmë se si bashkëpunimi arrihet ndryshe në kultura të ndryshme. Planifikimi dhe kontrastimi i bashkëpunimit të lidhur me kul-

²⁷⁴ Barnard, C. I. The functions of the executive. Cambridge, MA, Harvard University Press, 1938.

²⁷⁵ Adler, P. A., & Adler, P. Backboards and blackboards: College athletics and role engulfment. New York: Columbia University Press., 1991.

²⁷⁶ P. Christopher Earley, East Meets West Meets Mideast: Further Explorations of Collectivistic and Individualistic Work Groups, The Academy of Management Journal Vol. 36, No. 2 (Apr., 1993), pp. 319-348

turën mekanizmat e eracionit do të gjenerojnë njohuri të dobishme për të fituar një kuptim të të dyjave bashkëpunimeve intra dhe ndërkulturor.

Kultura nuk bën vetëm që individët të jenë variacion pak a shumë bashkëpunues, por mund të ndikojë në përzgjedhjen dhe efektivitetin e ndërhyrjes, mekanizmat që synojnë rritjen e situatave të bashkëpunimit.

Në vështrimin tonëidentifikojmë tre lloje të ndryshme konceptesh dhe definicionesh të bashkëpunimit. Një studim e merrë në këndvështrim motivin psikologjik të pjesëmarrësit sipas traditës së Mead. Mead poashtu e definon bashkëpunimin si një akt të punës së përbashkët deri në një fund (1976:8), ajo thekson motivet e bashkëpunimit të aktorëve të cilët punojnë rreth një qëllimi të përbashkët sesa mënyrat e hapura të sjelljes për t'u përfshirë në një aktivitet kolektiv. Mead e përdor konceptin e bashkëpunimit dhe kompeticionit që të paraqes mënyra te ndryshmetë motiveve psikologjike të shoqërive të ndryshme. Këto e përmbajnë një koncept të dytë të definicionit të bashkëpunimit në termine të relacioneve sociale dhe situatave të ndryshme sociale. Ky studim është filluar nga Deutsch (1949a, b, 1973, 1985)²⁷⁷ dhe është zhvilluar nga Tjosvold (1984, 1986) në kontekstin organizacional. Në mes të definicionit gjeneral dhe specifik të veprimit të bashkëpunimit qëndron edhe çështja dimensionale.

Pa njohuri kulturore, kërkimi tregon se OJQ -të dhe menaxherët e tyre shpenzojnë burime dhe kohë për idetë e projektit që mund të jenë të dobishme për komunitetin. Duhet theksuar rëndësinë e njohjes së strategjive qeveritare për zhvillim si dhe identifikimin e nevojave të përfituesve përpara se të zhvillohen idetë. Dialogët mund të rrisin ndërgjegjësimin dhe njohuritë dhe kështu aftësinë për të bashkëpunuar në mënyrë efektive.

Përvoja të tilla na mundësojnë që ti kapërcejmë barrierat ideore për grupime të caktuara etnitetesh edhe pse për një studiues të kulturës të qenurit etnocentrik është dobësia e madhe kurse nga ana tjetër gjuha e komunikimit duhet të jetë jo vetëm shkencore por edhe njerëzore, Ka shumë organizata joqeveritare kulturore që merren me koperimin e popujve duke i përfshirë në projekte të përbashkëta operative apo edhe në konferenca

²⁷⁷ Morton Deutsch, A Pioneer in Developing Peace Psychology, Cooperation, Competition, and Conflict, 2015 f. 47-70

shkencore me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe afrimit ndërnjerëzor. Një të tillë personalisht e patëm edhe ne si student të doktoratës, apo disa studiues shqiptar të Etnologjisë dhe Antropologjisë në Universitetin Kiril dhe Metodij, në njëkonferencë të përbashkët shkencore me studentët e Ljubjanës dhe Selanikut apo me saktë nga departamentet e Antropologjisë në Lubjan, departamenti i Antropologjisë sociale të Selanikut dhe Intituti i Etnologjisë dhe Antropologjisë në Shkup.

Mënyra e punës të secilit përfaqësues ishte në focus grupe tematike. Tradicionalisht, kërkimi i fokus grupeve është "një mënyrë për të mbledhur të dhëna cilësore, e cila në thelb përfshin përfshirjen e një numri të vogël njerëzish në një diskutim (ose diskutime) grupore joformale", të fokusuar "rreth një teme të caktuar ose një sërë çështjesh" (Wilkinson, 2004).²⁷⁸Në këtë diskurs shkencor, grupet joformale të fokusit u angazhuan për të inkurajuar një diskutim mbi gjetjet kryesore, për të përmirësuar cilësinë e vëzhgimeve dhe për të fituar perspektiva të reja për hulumtimin. Në këto hulumtime të paraqitura grupe njerëzish u mblodhën sipas disponueshmërisë së pjesëmarrësve dhe nevojës specifike për informacion në atë fazë të veçantë të hulumtimit. Njerëzit e përfshirë ishin vendas dhe ballkanas dhe ishin të gjithë të lidhur ngushtë me projektin në mënyra të ndryshme; punonjësit e shëndetit, menaxherët e projektit, etj. Diskutimet krijuan mundësi për të bërë vëzhgime interesante dhe ndihmuan formën dhe sqarimin e çështjeve që rezultuan kritike për hulumtimin.

Për të mundur të krijosh një strategji pune sipas kolegëve nevojitet edhe aftësia kulturore. Një aftësi kulturore përshkruhet si aftësia për të mbledhur të dhëna kulturore përkatëse, duke paraqitur një problem, si dhe duke kryer me saktësi një vlerësim fizik të bazuar në kulturë (Campinha-Bacote, 2002).²⁷⁹Me fjalë të tjera, për të zhvilluar aftësitë e kërkuara që plotësojnë nevojat dhe pritjet në një kulturë tjetër nga ajo e vet. Vulpe etj.(2000), e përshkroi një person efektiv ndërkulturor si një person me aftësinë për të treguar empati kulturore, mendjehapur, aftësi provuese për të diskriminuar

²⁷⁸ Wilkinson, C. Status of Coral Reefs of the World, 2004 (Vol. 1). Australian Institute of Marine Science, Townsville, (2004) f. 301

²⁷⁹ Campinha-Bacote, J, The Process of Cultural Competence in the Delivery of Healthcare Services: A Model of Care. Journal of Transcultural Nursing, 13, 2002, f.181-184.

dallimet kulturore, si dhe komunikuar në mënyrë efektive në një kontekst ndërkulturor.

Siç u tha nga udhëheqësit e këtij projekti diskursi shkencor: "Projektet kanë të bëjnë me njerëzit dhe komunikimi është ajo që na mundëson të punojmë së bashku ... Prandaj komunikimi është thelbi i gjithçkaje që duhet të bëhet si menaxher i projektit". Në mbështetje, tjetri profesor tha; "Ju nuk mund të arrini tek njerëzit dhe të krijoni besim pa komunikim".

Megjithatë, zbulimi i këtyre aspekteve mund të kërkojë kuriozitet, si dhe aftësi hetimore, ose siç thuhet nga udhëheqësi, "aftësia për të bërë pyetjet e duhura", e cila është në përputhje me vëzhgimet në terren dhe e mbështetur nga Vulpe et al. (2000).²⁸⁰

Ky diskurs shkencor gjithashtu identifikoi aftësinë për të komunikuar me shumë grupe profesionale, duke kuptuar nevojat e tyre, ndërsa në të njëjtën kohë përshtat informacionin në nivelin e tyre profesional si vendimtar. Si shembull, udhëheqësi theksoi aftësinë për të përshtatur stilin e komunikimit me mënyrën e tyre të folurit gojor. Meqenëse shkalla e nivelit arsimor në komunitetin është shumë e ulët, veçanërisht tek të moshuarit që janë vendimmarrësit kryesorë në komunitet, përdorimi gojor i gjuhës është jashtëzakonisht i rëndësishëm: "Në kulturën gojore ne shpesh mësojmë përmendësh gjëra. Ne nuk mund të shkruajmë shënime ose të lexojmë përmbledhje nga takimet. Një folës i mirë është, pra, një person që di të organizojë fjalimin e tij në një kontest që do të kuptohet dhe mbahet mend. Duhet të jetë i artikuluar mirë, i drejtpërdrejtë deri në pikën për të shqyer për fjalë dhe fjali të parëndësishme.

Aftësia për të zgjedhur kanalet e duhura të komunikimit

Puna ndërkombëtare e projektit normalisht përfshin përdorimin e përkthyesve të trajnuar zyrtarisht për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin efektiv. Sipas gjetjeve të hulumtimit, përdorimi i interpretesve të patrajnuar, miqve ose anëtarëve të familjes mund të përbëjë problem për shkak të mungesës së neutralitetit dhe rrjedhshmërisë së gjuhës së

²⁸⁰ Mohammed M. J. Alqahtani, Understanding the Sociocultural Health Belief Model Influencing Health Behaviors among Saudi Stroke Survivors. 2015

dytë. Për më tepër, sjellja e një personi të tretë mund të kërcënojë privatësinë, veçanërisht në situatat ku bëhet fjalë për çështje të ndjeshme. Për të ilustruar këtë pikë, ishte një shembull i një vajze 17-vjeçare që refuzoi t'i thoshte infermierit se ishte shtatzënë pasi përkthyesi ishte burrë. Prandaj, është e rëndësishme që udhëheqesi lokal të jetë i vetëdijshëm për këto çështje dhe kështu të dijë të lehtësojë interpretimet që mund t'i përshtaten qëllimit në mënyrë efektive. Kjo është arsyeja pse komunikimi ballë për ballë është një metodë më efektive e komunikimit. Sidoqoftë, ballë për ballë kërkon prani fizike, e cila është me burime dhe e pamundur të arrihet në çdo kohë. Për të adresuar këtë çështje, ky hulumtim identifikoi përdorimin e përfaqësuesve vendorë të zgjedhur me kujdes që mund të përcjellin informacionin me gojë. Për ta bërë këtë opsion të funksionojë në mënyrë efektive, udhëheqesi thekson aftësitë për të krijuar besim dhe besnikëri;

Kur u pyet nga kolegu se çfarë e bëri atë të qëndrojë përgjatë kohëzgjatjes së projektit pavarësisht nga këto sfida, ajo tha: Në rastin tim, shkakun e projektit më motivoi për të luftuar dhe rriti gatishmërinë time për t'u përshtatur me mjedisin e ri "(duke mbështetur përsëri rëndësinë e një qëllimi të fortë të projektit) atë të bashkëpunimit. Në përputhje me rrethanat, gjetjet e tjera mbështesin më lart dhe kështu theksojnë fuqishëm aftësinë e "vetë-motivimit" dhe aftësinë për t'u përshtatur me mjedisin e ri si faktorë suksesi. Kjo çon në dimensionin tjetër të kompetencës kulturore, që ka të bëjë me dëshirën kulturore dhe vullnetin për të mësuar.

Dëshira kulturore është motivimi për t'u përfshirë në procesin e të qenit i vetëdijshëm kulturor, i ditur nga ana kulturore, i aftë kulturalisht dhe i njohur me takimet kulturore (Campinha-Bacote, 2002).²⁸¹ Alderfer (1987)²⁸² i mbështet këto gjetje dhe rrit më tej gatishmëria për të mësuar si një proces i përjetshëm që nuk duhet të motivohet nga presioni i jashtëm, por më tepër të iniciohet nga dëshira e brendshme. Për më tepër, Dahl (2001)²⁸³ thekson

²⁸¹ Campinha-Bacote, J, The Process of Cultural Competence in the Delivery of Healthcare Services: A Model of Care. *Journal of Transcultural Nursing*, 13, 2002, f.181-184.

²⁸² Jane R. Caulton The Development and Use of the Theory of ERG: A Literature Review, *Emerging Leadership Journeys*, 2012

²⁸³ Review of: Dahl, Östen & Koptjevskaja-Tamm, Maria (eds) 2001. *The Circum-Baltic Languages I-II*. Amsterdam/Philadelphia

përulësinë si një aspekt të rëndësishëm të procesit dhe thekson rëndësinë e të qenit kurioz, gatishmërinë për të ndihmuar dhe demonstruar. Pa këtë hapje kulturore dhe dëshirë për të kuptuar kultivuesit, mund të jetë e vështirë të fitosh kompetencë brenda secilit prej dimensioneve të të cilave kompetenca kulturore mund të zhvillohet.

Ky diskurs shkencor gjeti motivimin të mësuarit si thelbësor, por të nxitur nga prerogativat e ndryshme dhe ndoshta nga motivet themelore kulturore. Siç është thënë nga një punonjësi lokal: "Disa njerëz janë të motivuar nga paratë... disa nga kauza... disa nga njohjet në mjedis... pavarësisht se çfarë duhet të mësojmë se si të bashkëpunojmë; Në shumicën e rasteve ne duhet të dëgjojmë hapur se çfarë thonë njerëzit e tjerë.... edhe nëse nuk jemi thellësisht dakord ". Kjo mbështetet nga udhëheqesi i cili shton rëndësinë e kujdesit dhe ndjeshmërisë; "Nëse ju intereson, dëshira për të mësuar vjen natyrshëm ..." Për më tepër, hulumtimet tregojnë se dëshira për të kuptuar dallimet kulturore mund të kontribuojë në një mendje më të hapur dhe kështu të nxisë një atmosferë më të lartë inovative të punës. Këto vendime bazoheshin në përvojat e mëparshme brenda organizatës, të cilat i bënë ekipet të kuptojnë vlerën e madhe të të qenit prezent dhe të aftë për të "jetuar kontekstin në vend që ta imagjinojnë atë" (mbështetur nga vëzhgimet dhe shumica e të intervistuarve). Për këtë arsye, gjetjet mund të nënvizojnë dhe mbështesin rëndësinë e të qenit prezent (Campinha-Bacote, 2002)²⁸⁴, e cila çon në dimensionin tjetër të "takimeve kulturore. Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me kolegët nga grupe të ndryshme kulturore do të përsosë ose modifikojë besimet ekzistuese të dikujt për një grup kulturor dhe do të parandalojë stereotipet e mundshme. Argumentohet se për shkak të variacionit brenda etnik, d.m.th.ka më shumë ndryshime brenda një grupi kulturor sesa midis grupeve kulturore, që ndërveprimi me disa anëtarë të një grupi etnik nuk do të na mundësonte të kuptonim plotësisht besimet dhe vlerat e atij grupi (Miguel, 2004).²⁸⁵Sidoqoftë, Campinha-Bacote (2002) argumenton se të qenit i pranishëm në terren mund të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet e

²⁸⁴Campinha-Bacote, J, The Process of Cultural Competence in the Delivery of Healthcare Services: A Model of Care. *Journal of Transcultural Nursing*, 13, 2002, f. 184.

²⁸⁵Edward Miguel and Michael Kremer, Worms: Identifying Impacts on Education and Health in the Presence of Treatment Externalities, " *Econometrica* 72 (1): 159-217.

diversitetit dhe kështu të përmirësojë bazat mbi të cilat janë marrë vendimet dhe veprimet.

Mbështetur në literaturë, rëndësia e pranisë në terren tenton të jetë unison mes të intervistuarve. Si shembull, udheheqesi ishte përpjekur të përgatiste ekipin e tij ndërkombëtar për kontekstin e ri duke u treguar atyre fotografi dhe video, si dhe duke ndarë përvojat e tij. Siç u tha nga drejtuesi si përgjigje ndaj një përgatitjeje të tillë; "Kur jeni në fushë, përballeni me gjëra të reja çdo ditë ...", duke treguar vështirësitë e të arsimuarit para se të hyni në këtë fushë. Për ta dhënë shembullin edhe më tej, një kolege lokale bëri metaforën e mëposhtme pasi vizitoi Maqedonine për herë të parë: "Unë kam qenë në këtë organizatë që nga fillimi dhe kam dëgjuar shumë për Maqedonine nga kolegët e mi. Megjithatë, para se të mbërrija, kisha pikturuar një fotografi bazuar në atë që më kishin thënë... kur u ktheva në Maqedoni, fotografia dukej krejtësisht ndryshe". Fraza e mëposhtme mund të shpjegojë këto përvoja të përbashkëta dhe të theksojë rëndësinë e dimensionit të takimit kulturor: "Ju nuk mund ta dini se çfarë shije ka një mollë para se të hani kafshimin tuaj të parë" (e panjohur).

Me fjalë të tjera, ndërveprimet e drejtpërdrejta dhe të qenit prezent duket se ka përmirësuar mirëkuptimin reciprok, si dhe mundësinë për të zgjidhur konfliktet në një fazë të hershme. Deklaratat e mëposhtme mund të mbështesin këtë gjetje: "Bisedat dhe dialogët ishin mjaft të dobishëm sot", ose siç u tha nga shoferi; "Unë ju kuptoj më mirë tani," ose drejtuesi i bordit lokal "Unë jam vërtet i kënaqur që ndodhi- pa këtë ngjarje nuk do ta kisha njohur". Pyetjet mund të tregojnë se dialogët dhe mundësia për të shprehur veten mund të rrisin vetëdijen, njohuritë dhe të mësuarit organizativ. Këto takimet shoqërore janë thelbësore për të krijuar mirëkuptim kulturor dhe kështu një hap më afër në procesin e të qenit kompetent nga ana kulturore.

Bibliografi

- Barnard, C. I. *The functions of the executive*. Cambridge, MA, Harvard University Press, 1938.
- Adler, P. A., & Adler, P. *Backboards and blackboards: College athletics and role engulfment*. New York: Columbia University Press, 1991

- P. Christopher Earley, *East Meets West Meets Mideast: Further Explorations of Collectivistic and Individualistic Work Groups*, The Academy of Management Journal Vol. 36, No. 2, 1993.
- Morton Deutsch, *A Pioneer in Developing Peace Psychology*, Cooperation, Competition, and Conflict, 2015
- Wilkinson, C. *Status of Coral Reefs of the World, 2004 (Vol. 1)*. "Australian Institute of Marine Science", Townsville, 2004
- Campinha-Bacote, J, *The Process of Cultural Competence in the Delivery of Healthcare Services: A Model of Care*. "Journal of Transcultural 13", 2002.
- Mohammed M. J. Alqahtani, *Understanding the Sociocultural Health Belief Model Influencing Health Behaviors among Saudi Stroke Survivors*. 2015.
- Jane R. Caulton, *The Development and Use of the Theory of ERG: A Literature Review*, "Emerging Leadership Journeys", 2012.
- Review of: Dahl, Östen & Koptjevskaja-Tamm, Maria (eds) 2001. *The Circum-Baltic Languages I-II*. Amsterdam/Philadelphia, 2007.
- Edward Miguel and Michael Kremer, *Worms: Identifying Impacts on Education and Health in the Presence of Treatment Externalities*, "Econometrica 72".

Stefan OKANT

Ish drejtor i Aleancës Franceze në Tetovë

“PALLATI I ËNDRRAVE” NGA ISMAIL KADARE APO MAKTHI KOMUNIST SIPAS NJË EVROPE TË CAKTUAR

I lindur në vitin 1936 në Shqipërinë e Jugut, Ismail Kadare mbetet padyshim njëri nga autorët dhe intelektualët më të rëndësishëm evropianë; ai mishëron gjithashtu një zë të fortë dhe universal kundër totalitarizmit, të cilit e përjetoi në vendin e tij të origjinës, ku u aplikua komunizmi i rreptë “kinez” nga viti 1946 deri në 1991. Shqipëria ishte edhe diktatura më e rëndë në botë pas LDB-së në Europë, ku u dënuan më shumë se 8,000 njerëz me vdekje gjatë kësaj periudhe.

Me romanin e tij *Le Palais des Rêves* (Pallati i ëndrrave), i botuar në vitin 1981, një roman ky anti-totalitar i shkruar nën një regjim totalitar, Ismail Kadare i shmanget ngushtë këtij nocioni dhe padyshim u detyrohet mbështetësve të tij të shumtë në botën perëndimore (ku ai është më i famshëm dhe më i njohur se në vendin e tij të lindjes), ku shtjellon vuajtjet e punës së detyruar në fshat, sipas mënyrës së "Revolucionit Kulturor « i njohur në Kinë gjatë kohës së Mao Ce Dunit. Në vitin 1990, Ismail Kadare aplikoi dhe mori azil politik në Francë, ku edhe më tej vazhdon të qëndrojë në pjesën më të madhe të kohës.

« Pallati i Ëndrrave » rrëfen historinë e Mark-Alemit, një nëpunës i ri civil i punësuar për të shërbyer në administratën më të fshehtë të Perandorisë Osmane, e cila mbledh, rendit dhe analizon të gjitha ëndrrat e të gjithë nënshtetasve të Perandorit, për të zbuluar në të njëjtën kohë plane të mundshme sulmesh dhe për të lexuar aty të ardhmen e kombit. Gradualisht, nga shërbimi në shërbim, nga rrethi në rreth dhe pavarësisht frikës dhe tmerrit të detyrës së tij, Mark-Alemi do të ngjitet në të gjitha nivelet e Ministrisë së tij dhe do të bëhet zotëruesi i saj i plotfuqishëm. Kjo ngritje profesionale nuk ndodh pa i ngulfatur ëndrrat e tij dhe pa refuzuar një lidhje dashurie.

Në lidhje me librin e tij, Ismail Kadare kishte theksuar: "Për një kohë të gjatë, dëshiroja të ndërtoja një ferr. Përpiqesha të gjeja diçka ambicioze, e mbase edhe kimerike (me iluzione) një projekt të tillë, diç të ngjajshme pas egjiptianëve anonimë, Virgjilit, Shën Agustinit dhe veçanërisht Dantes. "Dhe në fakt, është me të vërtetë një ferr në këtë pallat, ku ëndrrat njerëzore të zhveshura krejtësisht, të racionalizuara asgjësohen, shkatërrohen përfundimisht. Dhe nëse romani i ka goditur aq shumë lexuesit perëndimorë, kjo ndodh sepse prek njërin nga themelet e lirisë: të drejtën për të ëndërruar, për të shprehur. Kjo është arsyeja, se pse ajo që përshkruhet në libër duket më shumë si një makth.

Ky aspekt i përshkruar me makth mund të gjendet veçanërisht edhe në skenën e një filmi, që shënoi vitet '80 në Evropë dhe që frymëzohet tërthorazi nga romani i Kadaresë. Filmi titullohet « Brazili » nga Terri Gilliam. Si e tillë, skena e hapjes tejet famshme e filmit flet shumë për lidhjet e fshehta mes tij dhe librit. Filmi mund të ndiqet në këtë link të internetit në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=esSUJjmlPPI>

Përktheu nga frëngjishtja: Ardian RAMADANI

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP

BALLKANOLOGJIA - Edicioni IV
“BALLKANI MIDIS INTEGRIMIT EVROPIAN
DHE BASHKËPUNIMIT RAJONAL”

Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Redaktore gjuhësore: Florentina Fetahi
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: DataPons – Shkup
Rr. 1550, nr. 52, Vizbeg
Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH–Shkup, nr. 0201-109/8, të datës 24.01.2022, si pjesë e programit të punës së Institutit për vitin 2022.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски

341.171(4-672ЕУ:497)(062)
341.232(497)(062)

АКТЕ të konferencës shkencore ndërkombëtare Ballkani midis integrimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal (2021 ; Shkup)

Ballkanologjia - 4 : Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare Ballkani midis integrimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal organizuar nga ITShKSh-ja, Shkup, 28 tetor 2021 / [redaksia Skender Asani ... и др.]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2022. - 194 стр. : илустр. ; 23 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите. - Абстракт

ISBN 978-608-4897-65-1

а) Регионална соработка -- Балкан -- Собири б) Балкан -- Европска Унија
-- Собири

COBISS.MK-ID 58399237